



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
“Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor”

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI
PËRPUTHSHMËRIE & RREGULLSHMËRIE
NË
“DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT
RRUGOR”

Dhjetor 2023

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
1.	Përshkrim i shkurtër i Raportit Përfundimtar të Auditimit	3
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	3
3.	Konkluzion i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	9
II.	HYRJA	11
1.	Titulli.....	11
2.	Marrësi.....	11
3.	Objektivat dhe qëllimi.....	11
4.	Identifikimi i çështjes.....	11
5.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.....	11
6.	Përgjegjësitë e audituesve.....	12
7.	Kriteret e vlerësimit.....	12
8.	Standardet e auditimit.....	14
9.	Metoda e auditimit.....	14
10.	Dokumentimi i auditimit.....	14
III.	PËRSHRIMI I AUDITIMIT.....	14
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.....	14
2.	Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit.....	15
2.1	Pika 1 Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditi i mëparshëm	15
2.2	Pika 2 Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese të DPSHTRR-së, bazueshmërisë ligjore të vendimeve të marra dhe realizimi i tyre.	25
2.3	Pika 3 Mbi zbatimin e strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.	33
2.4	Pika 4 Hartimi, shqyrtimi dhe miratimi i programit ekonomik-financiar në organet drejtuese të ndërmarrjes dhe në institucionet e prore, si dhe realizimi i tij.	43
2.5	Pika 5 Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në mbajtjen e evidencës kontabile, ndjekjen e debitorëve e kreditorëve, si dhe menaxhimin e aktiveve.	56
2.6	Pika 6 Zbatimi i ligjshmërisë në prokurimet për investime, për blerje mallrash e shërbimesh, si dhe zbatimi i kontratave (saktësinë e realizimit të procedruave të prokurimit (vlerësim i kriterëve, fondi limit, vlerësim i ofertave dhe shpallja e fituesit), si dhe zbatimi i punimeve, deri në marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve dhe zbatimi i kontratave të punëve publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim.	70
2.7	Pika 7 Auditim me zgjedhje sipas periudhave mbi rregullshmërinë e blerjeve me vlera të vogla (shpenzimet administrative për automjete, udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit, sponsorizime, etj)	94
2.8	Pika 8 Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit (identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK Mjedisi i Kontrollit, Menaxhimi i Riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informimi, Komunikimi dhe Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm)	99
IV.	GJETJET DHE REKOMANDIMET.....	101
	Masa Organizative	101
	Masa për Eliminimin e Efekteve Negative	109
V.	Lista e dokumentacionit të auditimit.....	110
VI	ANEKSE.....	-

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Përshkrim i shkurtër i Raportit Përfundimtar të Auditimit

Mbështetur në Ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, në zbatim të projektit dhe Programit të Auditimit të miratuar nga Kryetari i KLSH-së nr.409/1 Prot., datë 05.06.2023, i ndryshuar me nr. 409/2 Prot., datë 20.07.2023 për periudhën nga data 01.07.2021 deri më datë 31.12.2022 si dhe zhvillimin e auditimit “Të Përputhshmërisë dhe Rregullshmërisë” nga data 06.06.2023 deri më datë 29.09.2023 në subjektin Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR), nga Grupi i Auditimit me përbërje:

- E.K. (përgjegjës grupi)
- M.B (anëtarë)
- Q.M. (anëtarë)
- A.B. (anëtarë)

Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

Nr.	Përmbledhje	Ref.	Rëndësia	Rekomandimi
1	<p>Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:</p> <p>-Nga 20 masa organizative të rekomanduara gjithsej, 16 janë zbatuar plotësisht, 1 është në proces zbatimi dhe 3 nuk janë zbatuar.</p> <p>-Nga 1 masë për shpërbllim dëmi e rekomanduar dhe e zbatuar plotësisht.</p> <p>-Nga 1 masë për eliminimin e efekteve negative konstatuar në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficientë dhe efektivitet të fondeve publike e rekomanduar, por e pa zbatuar.</p>	2.1	E mesme	Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrë masa për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, të hartojë një plan veprimi për detyrat e përcaktuara duke përcaktuar afatet dhe personat përgjegjës për zbatimin e tyre.
2	<p>Vendimet e marra nga Këshilli Mbikëqyrës në përgjithësi janë në përputhshmëri me aktet ligjore e nënligjore në fuqi për sa i përket tematikave për të cilat janë marrë, por nga auditimi i praktikave të disa vendimeve të marra nga Këshilli Mbikëqyrës me dokumentacionin e plotë justifikues, vihet re një menaxhim jo i duhur financiar i institucionit për arsye e mëposhtme:</p> <p>- vendimi për marrjen me enfiteozë të sheshit funksional të Qendrës së Kontrollit Teknik dhe Fizik Fier, ku nuk është përdorur çmimi referencë për m² i marrjen me qera është 37 lekë/m² bazuar në VKM nr. 54 datë 05.04.2014, por një çmim tjetër më i lartë, ku është hasur pengesë nga Bashkia Fier, edhe pse përmirësimi i kushteve të Qendrës së Kontrollit Teknik dhe Fizik Fier është në të mirë të banorëve të Bashkisë Fier. Gjithashtu nisur nga më sipër kontrata e mësipërme, nuk shihet si kontratë enfiteoze nga Bashkia Fier pasi Enfiteoza ka si qëllim jo vetëm përdorimin e sendit, por edhe përmirësimin e tij, i cili duhet të cilësohet në kontratë, gjë e cila nuk është marrë në konsideratë gjatë diskutimit të çmimit nga ana e Bashkisë Fier.</p> <p>- Vendimi nr. 30 datë 22.07.2022 “Për miratimin e kërkesës për huadhënie për Albcontrol sh.a.”, për mbështetje financiare në formën e huadhënies deri në shumën 936,000,000 lekë të ndara në këste mujore. Në dokumentacionin mbështetës jepen sqarime të detajuara që DPSHTRR nuk mund të mbulojë këtë shumë me fondet e veta, por gjithashtu jep si alternative marrjen e një overdrafti pranë bankave të nivelit të dytë. Në gjykimin e grupit të auditimit dhe praktikave më të mira nuk duket e arsyeshme marrja e një overdrafti për huadhënien drejt një shoqërie tjetër.</p>	2.2	E mesme	Organet Drejtuese të DPSHTRR-së, gjatë marrjes së vendimeve të kenë në konsideratë menaxhimin e fondeve në proporcion me 3 E (efektivitet, eficientë dhe ekonomicitet), vendime në proporcion me objektivat e institucionit si dhe të krijojë kushtet për arritjen e tyre sipas strategjive të institucionit.

	<p>DPSHTRR kryen aktivitetin e saj në bazë Rregullores së Brendshme dhe Statutit.</p> <p>Rregullorja e Personelit është miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 27, datë 23.11.2012, e cila nuk është azhurnuar me ndryshimet në Statut dhe strukturë dhe nuk i përgjigjet stadi të zhvillimit të drejtorisë.</p> <p>Me urdhrin e Drejtorit nr.778, datë 19.06.2018 është hartuar dhe miratuar “Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të transportit rrugor” por nuk është e miratuar nga Këshilli Drejtues. Rregullorja e Brendshme vijon të jetë e miratuar vetëm nga Drejtori dhe jo nga Këshilli Drejtues.</p> <p>Statuti i Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, ka ndryshuar referuar shkresës nr. 14825, datë 07.06.2022, drejtuar Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë me lëndë “Për miratimin e disa ndryshimeve në statutin e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor” dhe miratuar ndryshimet e kërkuara nga Drejtori i Përgjithshëm me shkresën nr.4572, datë 21.12.2022, ose miratuar 6 muaj me vonë.</p> <p>Edhe pse në DPSHTRR ka patur ndryshime të vazhdueshme të “Rregullores së brendshme” apo edhe të “Strukturës së DPSHTRR” si dhe në “Statutin e DPSHTRR” vihet re se “Rregullorja e Personelit të DPSHTRR-së” nuk është përditësuar dhe (përshkrimet e punës) nuk janë miratuar në Këshillin Drejtues.</p>	2.3	E mesme	Drejtoria e Burimeve Njerëzore në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrë masa për përmirësimet në Rregulloren e Personelit duke reflektuar ndryshimet e vazhdueshme të Rregullores së Brendshme dhe Statutit të DPSHTRR, si edhe miratimin e saj nga strukturat drejtuese duke respektuar afatet kohore, me qëllim funksionimin e institucionit sipas kërkesave të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme dhe Statut të Institucionit.
3	<p>Nga auditimi në lidhje me zbatimin e Strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi për periudhën 01.07.2021 deri më 31.12.2022, u konstatua se struktura dhe pagat e punonjësve të DPSHTRR, kanë pësuar ndryshime referuar urdhrave të Ministrit Infrastrukturës dhe Energjisë. Rekrutimi i punonjësve është kryer sipas procedurave të përcaktuara që nga njoftimet, aplikimet, paraqitja e dokumentacionit dhe vlerësimi nga komisioni i ngritur për këtë qëllim. Megjithëse është rritur numri i shërbimeve, konstatohet rritje e numrit të punonjësve si në përbërje të Kabinetit ashtu edhe në Njësi, Drejtori dhe Sektorë. Struktura e DPSHTRR (Administrata) përbëhet nga Kabineti me 12 persona, 5 Njësi me 10 Sektorë dhe 60 persona si edhe 10 Drejtori me 27 Sektorë dhe 142 persona. Pra, struktura është e organizuar në 1 Kabinet, 5 Njësi, 10 Drejtori dhe 37 Sektorë me numër punonjësish 214 persona.</p>	2.3	E mesme	Strukturat drejtuese të DPSHTRR dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore, të analizojnë dhe vlerësojnë nevojat për numrin e punonjësve referuar strukturës organike të DPSHTRR, me qëllim uljen e numrit të punonjësve dhe shfrytëzimin me efektivitet të kohës së punës në çdo Njësi, Drejtori dhe Sektorë, pa çenuar cilësinë e shërbimeve.
4	<p>Nga auditimi në lidhje me emërimin e punonjësve në mbështetje të nenit 21, të Ligjit Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, “Forma e Kontratës së punës”, nenit 8 të vendimit nr. 27 datë 23.11.2012, të Këshillit Drejtues, Rregullores së Personelit të DPSHTRR dhe strukturën e miratuar për rekrutimin e punonjësve, nga verifikimi i administrimit të dosjeve të punonjësve të DPSHTRR-së, Drejtorive Rajonale dhe DTSH-së u konstatua se në Drejtorinë e Auditit të Brendshëm nga 7 punonjës, 4 prej tyre kanë kryer detyrën pa u pajisur me certifikatën e auditit të brendshëm,</p> <p><i>Mangësi në emërimin e punonjësve nga ku në 5 raste u konstatua mospërputhje në nivelin arsimor të punonjësve krahasuar me nivelin arsimor të kërkuar nga DPSHTRR.</i></p> <p><i>Mangësi në dokumentacionin e dosjeve të personelit</i> Nga auditimi i ushtruar në 112 dosje personeli të DPSHTRR dhe Degëve Rajonale për plotësimin e dosjeve të personelit me dokumentacionin ligjor, u konstatua se 17 dosje nuk janë të plotësuara me dokumente si certifikata, vërtetime nga prokuroria dhe gjykata, si edhe në 3 dosje mungojnë vlerësimet vjetore të punës. Po kështu u konstatua se dosjet e personelit nuk kanë rregullshmëri në pasqyrimin, renditjen sipas inventarit si edhe mënyrën e mbajtjes së dokumenteve pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore.</p>	2.3	E mesme	Strukturat drejtuese të DPSHTRR dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore, të marrin masa për emërimin e punonjësve sipas nivelit arsimor dhe profesional referuar kërkesave të miratuara për çdo vend pune si edhe plotësimin dhe arkivimin e dosjeve me dokumentacionin ligjor-profesional me qëllim rritjen e nivelit profesional dhe realizimin e objektivave të institucionit.

5	<p>Sa më sipër janë vënë në dukje të ardhurat dhe shpenzimet, mbi të cilat planifikimi i tyre nuk ka qene i saktë, dhe devijanca e tyre në lidhje me realizimin është e lartë.</p> <p>Shpenzimet janë rritur ndërkohë që të ardhurat janë pakësuar. Shpenzimet për vitin 2022 krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021 kemi rritje të shpenzimeve në masën 21% ose 479,994 mijë lekë ndërsa për të ardhurat për vitin 2022 krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021 ka një tejkalim me 11% ose 323,652 mijë lekë më tepër.</p> <p>Në 12/mujorin 2022, Fitimi bruto nga aktiviteti i Drejtorive Rajonale dhe DPSHTRR arriti vlerën 577,549 mijë lekë, duke u ulur me -49,951 mijë lekë ose me 8% më pak krahasuar me Programin Ekonomik për të njëjtën periudhë të vitit.</p> <p>Zërat si “Shpërblime për vjetërsi ne pune” “Gjoha dëmshpërblime” dhe “Humbje nga kursi” nuk jane planifikuar.</p>	2.4	E Mesme	<p>Organet drejtuese të DPSHTRR, gjatë hartimit të buxheteve, të analizojnë me kujdes situatën e institucionit, të hartojnë plane financiare për përmirësimin e tyre, negocimin e kushteve më të mira si dhe mundësitë e shtimit të kapitalit të shoqërive. Të marrë në konsideratë legjislacionin në fuqi si dhe të kryejë një planifikim të saktë të të ardhurave dhe shpenzimeve, duke u bazuar dhe në vitet e mëparshme.</p>
6	<p>Nga analiza e zërave të pasqyrës së “Pozicionit Financiar” dhe analizës së të drejtave dhe detyrimeve konstatohet se institucioni ka të drejta dhe detyrime të mbartura që nga vitet 2005-2016, për të cilat nuk janë krijuar provizionime. Të drejtat janë në vlerën 19,715,496 lekë, të cilat përbëhen nga gjendjet e llogarive në fund të vitit 2022 si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - llog. 427 “Kërkesa të tjera të arkëtueshme” paraqitet në vlerën 2,979,035 lekë, që përfaqëson detyrimet e personelit të pa arkëtuar nga Drejtoritë ose në procese gjyqësore të krijuara që nga viti 2008, ku vlerën më të madhe të detyrimeve e kanë punonjësit e Drejtorisë Rajonale Tiranë, prej 2,111,919 lekë, për të cilat nuk është marrë asnjë masë për ndjekjen, arkëtimin dhe vlerësimin e tyre, duke tejkaluar afatet e kërimit të këtyre të drejtave, pasi janë parashkruar. - llog. sintetike “Instrumente te tjera borxhi detyrime buxheti” në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 6,096,620 lekë, e cila përbëhet nga gjendja e llogarisë 4664 “Derdhur gabimisht” në vlerën 5,809,740 lekë, që përfaqëson detyrimet që kanë për kthim DRT përsa paguar më tepër tatim fitimi për vitin 2022 dhe nga sistemimi i veprimeve për shpenzim përsa faturuar tepër në vlerën 286,880 lekë. - llog. 468/467 “Debitorë të tjerë” paraqitet në fund të vitit 2022 në vlerën 10,639,841 lekë, me nje zbritje prej prej 2,196,247 lekë nga viti 2021, që përfaqëson detyrimet e punonjësve të lindura nga rekomandimet e KLSH dhe Ministria e linjës si edhe nga proceset gjyqësore për largimet që janë të pa arkëtuar në kohë. Për disa raste nuk është ngritur padi me pretendimin për mungesë adresash të sakta si dhe detyrime të subjekteve private për detyrime të lindura ndaj DPSHTRR të cilat janë në ndjekje në shkallë të ndryshme të gjyqësorit, vlera të cilat janë të konsiderueshme, dhe ndikojnë negativisht në rritjen e të ardhurave. 	2.5	E mesme	<p>Drejtoria e Ekonomike në bashkëpunim me Drejtoritë Rajonale dhe Drejtorinë Juridike të marrin masa për analizimin e hollësishëm të debitorëve, për gjetjen e saktë të të dhënave të debitorëve fizik (ish-punonjës) dhe të subjekteve fizikë e juridik, duke identifikuar shumat pa mundësi arkëtimi të klientëve/debitorëve të ndryshëm, si dhe të sigurojë inicimin e një procesi rivlerësimi, ku të gjitha të drejtat me palët e treta të analizohen sipas vjetërsisë dhe mundësive reale për arkëtimin dhe likuidimin e tyre, ku të propozohen masa konkrete, duke mos e përfshirë masat administrative si dhe të gjitha rrugët ligjore për mbledhjen ose shuarjen e tyre.</p> <p>-Drejtoria e Ekonomike të marrë masa për krijimin e provizioneve për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme, pasi të jenë evidentuar të dhënat për klientët/debitorët, si shumën e detyrimit, vjetërsinë e tyre dhe situatën aktuale të tyre, duke kaluar më parë të gjitha rrugët e mundshme ligjore për mbledhjen e tyre.</p>
7	<p>Gjendja e llogarisë 460 “Hua të dhëna dhe interesa për t’u paguar” në fund të vitit 2022 paraqitet në shumën 429,099,135 lekë, vlerë që përfaqëson detyrimin e A. Sha për huanë e dhënë sipas VKD nr.30, datë 22.07.2022 “Për miratimin e huadhënies së A. Sha” miratuar nga MIE me shkresën 5646/1 datë 26.07.2022. Huaja është dhënë në shumën 421,200,000 lekë dhe interesat e huasë në vlerën 7,898,236 lekë. Në lidhje me këtë huadhënie u krye auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Institucioni nga ku rezultoi se, DPSHTRR për periudhën 01.08.2022-04.01.2023 ka tërhequr shumën 429,099,135 lekë nga “B.C.”, nga të cilat vlera 100,000</p>	2.5	E mesme	<p>Strukturat Drejtuese të DPSHTRR të marrin masa për shlyerjen e Huasë nga shoqëria “A.” në respektim të kushteve kontraktuale, me qëllim shlyerjen e overdraftit të marrë nga “C. B.” dhe arkëtimin e të ardhurave të krijuara nga DPSHTRR.</p>

	<p>Euro në formën e overdraftit me interes 1.5%. Në nenin nr. 4 “Detyrimet e Huamarrësit” në pikën 4.5 përcaktohet se: “Kthimi i shumës së marrë do të kryhet menjëherë me përmirësimin e situatës ekonomike të Huamarrësit(A.), në llogarinë bankare të Huadhënësit, brenda muajit Dhjetor të vitit 2023”</p> <p>Pika 4.6, përcakton se, “Në rast pagese me këste, kësti i parë do të paguhet nga Huamarrësi brenda muajit Shtator 2023 në vlerën 300,000,000 lekë Kësti i dytë do të paguhet nga Huamarrësi brenda muajit Tetor 2023 në vlerën 300,000,000 lekë. Pjesa e mbetur do të paguhet nga Huamarrësi brenda muajit Dhjetor 2023.</p> <p>Nga auditimi konstatohet se ende nuk ka filluar shlyerja e huasë si edhe nga DPSHTRR, nuk ka komunikim shkresor me Huamarrësin për kthimin e Huasë.</p>			
8	<p>Sipas të dhënave dhe analizës së gjendjes së llogarisë 401-404 “Furnitorë e llogari të lidhura me to (detyrime ndaj furnitorëve)” në fund të vitit 2022 në vlerën 229,997,821 lekë rezulton se, detyrimet e konstatuara ndaj furnitorëve dhe klientëve për parapagime në periudhën ushtrimore janë në vlera të konsiderueshme dhe nga Drejtoria e Ekonomike nuk janë marrë masat e nevojshme për shlyerjen e detyrimeve ndaj të tretëve.</p>	2.5	E mesme	<p>Drejtorja Ekonomike të marrë masa për shlyerjen në kohë të detyrimeve ndaj Furnitorëve dhe Klientëve me qëllim uljen e borxhit dhe eliminimin e penalteteve të mundshme nga pagesat e vonuara.</p>
9	<p>Gjendja e llogarisë 486 “Shpenzime te periudhave te ardhshme” në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 5,835,167 lekë, gjendje e cila është regjistruar nga DR Tiranë, dhe pasqyron detyrimet e punonjësve të Drejtorisë Rajonale Tiranë, që janë në procese gjyqësore, të trashëguara prej vitit 2016. Kjo gjendje krahasuar me vitin 2021 ka rritje në vlerën 2,164,476 lekë. Për detyrimet e proceseve gjyqësore, DR Tiranë duhej të krijonte provizionin për vlerën e tyre 5,835,167 lekë.</p>	2.5	E mesme	<p>Drejtorja e Ekonomike të marrë masa të menjëhershme për njohjen në kontabilitet të vlerës së plotë të proceseve gjyqësore të cilat kanë marrë formë të prerë si shpenzime të periudhës në “Pasqyrën e performancës financiare” të institucionit dhe krijimin e provizioneve si një detyrim në pasqyrën e “Pozicionit financiar”.</p>
10	<p>Gjendja e llogarisë 486 “Shpenzime te periudhave te ardhshme” në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 5,835,167 lekë, gjendje e cila është regjistruar nga DR Tiranë, dhe pasqyron detyrimet e punonjësve të Drejtorisë Rajonale Tiranë, që janë në procese gjyqësore, të trashëguara prej vitit 2016. Kjo gjendje krahasuar me vitin 2021 ka rritje në vlerën 2,164,476 lekë. Për detyrimet e proceseve gjyqësore, DR Tiranë duhej të krijonte provizionin për vlerën e tyre 5,835,167 lekë.</p>	2.5	E mesme	<p>Drejtorja e Ekonomike të marrë masa të menjëhershme për njohjen në kontabilitet të vlerës së plotë të proceseve gjyqësore të cilat kanë marrë formë të prerë si shpenzime të periudhës në “Pasqyrën e performancës financiare” të institucionit dhe krijimin e provizioneve si një detyrim në pasqyrën e “Pozicionit financiar”.</p>
11	<p>Gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit me objekt “Blerje Prokat Leje Qarkullimi për mjetet rrugore”, oferta e dhënë nga O.E. "A." shpk me ofertë 23.600.000 lekë pa TVSH, shpallet ofertë anomalisht e ulët, ku pas sqarimeve të dhënë nga O.E. pranohet si ofertë e suksesshme, ku një prokat leje qarkullimi jepet me çmimin 59 lek. Nisur nga kjo, përlllogaritja e fondit limit si dhe zhvillimi i procedurave të mëparshme të ngjashme mbi blerjen e prokatis të lejeve të qarkullimit është kryer mbi një përlllogaritje jo të saktë të fondit limit, duke rritur kostot e institucionit.</p>	2.6	E lartë	<p>Organet Drejtuese të DPSHTRR-së, gjatë përlllogaritjes së fondit limit të përdorin mënyrën më efektive të mundshme, si dhe në rastin kur merren oferta në treg nga O.E., të merren nga O.E. të cilët kanë eksperiencë në treg, në mënyrë që të shmangen aludimet mbi fryrjen e fondit limit.</p>
12	<p>Gjatë zbatimit të kontratës me objekt “Blerje Prokat Leje Qarkullimi për mjetet rrugore”, sipas Procesverbalit nr.1 në marrjen në dorëzim të prokatis të lejeve të qarkullimit, mbajtur më datë 11.06.2022, u morën në dorëzim në total 17474 copë prokat leje qarkullimi. Nga grupi i auditimit u konstatua që numri serial i marrjes në dorëzim ishte 0000000096402 dhe jo 0000000000001 siç duhet të ishte, duke marrë në konsideratë që është dorëzimi i parë dhe numri serial të vazhdojë nga numri 1.</p>	2.6	E lartë	<p>Organet drejtuese të DPSHTRR-së, Komisioni i ndjekjes dhe i zbatimit të kontratës, të marrë në konsideratë të gjitha kushtet e kontratës dhe të garantojë zbatimin e tyre me përpikmëri nga të dyja palët.</p>

13	Gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit me objekt “Blerje Prokat Leje Qarkullimi për mjetet rrugore”, Specifikimet Teknike janë të detajuara dhe në grupin e hartimit të specifikimeve teknike konstatohet se nuk është asnjë specialist i fushës për hartimin e tyre si dhe nga grupi i marrjes në dorëzim nuk është asnjë pjesëtarë specialist i fushës për verifikimin e tyre për marrjen në dorëzim si dhe laboratorë për verifikimin e tyre.	2.6	E lartë	Organet drejtuese të DPSHTRR-së, gjatë zhvillimit të një procedurë prokurimi, të kenë në konsideratë që në përbërje të njësisë së prokurimit është detyrimisht, personi përgjegjës për prokurimin, dhe të paktën një specialist fushe, në rast se kërkohen njohuri të specializuara për objektin e prokurimit.
14	Gjatë auditimit të procedurës së prokurimit “Blerje pajisjesh per qendrat e kontrollit teknik (Furnizim- Vendorsje e Makinerive dhe Pajisjeve të Testimit të Q.K.T pranë Drejtorive Rajonale), është kërkuar në lidhje me përmbushjen e kriterëve, një inxhinier mekanik, ku në dokumentin e sjellë nga O.E. “kontratë individuale”, që mban datën 06.12.2021, O.E. V.A.sh.p.k. me administrator z. A.Z. në rolin e punëdhënësit merr në punë njëkohësisht z. A.Z. në rolin e punëmarrësit.	2.6	E mesme	Organet drejtuese të DPSHTRR-së të bëjnë të mundur verifikimin e dokumentacionit justifikues të O.E. pjesëmarrës dhe njëkohësisht fitues dhe të analizojë situatën nëse z. A. Z. në cilësinë e inxhinierit mekanik është tërësisht i angazhuar në përmbushjen e objektivave të kontratës dhe nuk ndikohet nga roli i tij si administrator i subjektit me të cilin operon në treg.
15	Gjatë auditimit të procedurës së prokurimit “Blerje letër dhe karton me logo” 2022, në dokumentet standarde të tenderit DST, në pikën 2.1.2 të kapacitet profesional të O.E. është kërkuar Certifikata ISO 27001;2013, Sistemi Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit. Ky kriter nuk është i lidhur ngushtë dhe nuk është në përpjesëtim me objektin e prokurimit pasi natyra objektit të procedurës ka të bëjë me blerjen e mallit e cila në asnjë moment nuk lidhet cënimin e sigurisë informacionit. Është lënë rekomandim nga Agjencia e Prokurimit Publik (APP) mbi rishikimin e këtij kriteri pasi nuk është i lidhur ngushtë dhe në përpjesëtim me natyrën e objektit të prokurimit por përsëri nuk është marr në konsideratë nga NJP.	2.6	E mesme	Organet drejtuese të DPSHTRR-së, gjatë hartimit të specifikimeve teknike të bazohet në legjislacionin dhe udhëzimet përkatëse duke hartuar specifikime teknike të cilët janë gjithëpërfshirëse duke krijuar pjesëmarrje të gjerë të O.E. dhe jo diskriminuese si dhe të jenë të detajuara në mënyrë që të jenë të kuptueshme për O.E. pjesëmarrës dhe që të përlllogaritet drejtë fondi limit.
16	Gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit me objekt “Mobilim i objekteve të reja të ndërtuara nga DPSHTRR e ndarë me lote , DRSHTRR Berat, Korçë, Laç, Vlorë” u konstatua parregullsi në hartimin e kriterëve në dokumentet e tenderit(DST).Më konkretisht vihet re se pothuajse në të gjitha procedurat e zhvilluara në kërkesat në lidhje me kapacitetin ekonomik/financiar kërkohet që xhiro mesatare vjetore të jetë sa dyfishi i vlerës së fondit limit të përlllogaritur. Kriter ky i cili nuk nxit pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm.	2.6	E lartë	AK, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, të marrë masa që në kërkesat në lidhje me kapacitetet ekonomik-financiar, të përcaktojë qartë kufirin minimal të xhiros vjetore në përputhje me LPP dhe VKM. Pra të përcaktohen sa më qartë kërkesat mbi kapacitet ekonomik-financiar referuar parimeve të ligjit.
17	Gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit me objekt “Mobilim i objekteve të reja të ndërtuara nga DPSHTRR e ndarë me lote , DRSHTRR Berat, Korçë, Laç, Vlorë”, afatet e lëvrimin të mallrave pothuajse në të gjitha procedurat e audituara në DST përcaktohen nga 1 deri në 45 ditë, duke bërë që numri i OE pjesëmarrës të kufizohet madje në disa raste dhe duke i shkakuar pamundësi OE ofertues të përgatisin të gjithë sasinë e mallit me një afat kaq të shkurtër kohor të përcaktuar.	2.6	E lartë	AK, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, të marrë masa në përcaktimin e afateve kohore në lidhje me lëvrimin e mallrave, të shihet e arsyeshme apo të merret në konsideratë në mënyrë të tillë që në përcaktimi i afatit të lëvrimin të mallrave të mos

				kufizojë numrin e OE pjesëmarrës.
18	<p>Gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit me objekt “Botim manuali të përgatitur për kandidatët që do të pajisen me leje drejtimi të kategorive A1, A2, A, B1, BE, viti 2022”, kërkesa e përcaktuar në DST si më poshtë:</p> <p>OE të vërtetojnë që disponojnë makineri shtypëse 61x43 formati letrës, 5C+llak. Një OE pjesëmarrës duhet të disponojë 1 pajisje shtypi të përmasa 5 Color+llak , për aq kohë sa në DST dhe specifikime teknike nuk kërkohet që mallrat e prokuruar të jenë në 5 ngjyra të ndryshme. Pra në asnjë rast nuk është kërkuar që makina shtypëse të shtyp me 5 ngjyra, njëkohësisht në shtojcën 5 të specifikimeve teknike të DST përcaktohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> · Letra të jetë format A4; · Numri faqeve 216; · Letra e brendshme 110gr/m2; · Pjesa e brendshme e shtypur me 4 ngjyra bazë+llak Etj. <p>Pra specifikohet që pjesa e brendshme që do shtypet të jetë me 4 ngjyra.</p>	2.6	E lartë	Organet Drejtuese të DPSHTRR-së, gjatë hartimit të specifikimeve teknike dhe kritereve të veçanta të tregojnë kujdes në hartimin e tyre, të bazohet në legjislacionin dhe udhëzimet përkatëse duke hartuar specifikime teknike të cilët janë gjithëpërfshirëse duke krijuar pjesëmarrje të gjerë të O.E. dhe jo diskriminuese si dhe të jenë të detajuara në mënyrë që të jenë të kuptueshme.
19	<p>Në procedurën me vlerë të vogël “Blerje holli protokollar” me urdhër prokurimi nr.8862/3 datë 23.05.2022, përlogaritja e fondit limit e kryer me testim tregu me 3(tre) oferta është në kundërshtim me VKM Nr.285 RRPP datë 19.05.2021, neni 76 ,b si dhe Udhëzimin Nr.5 datë 25.06.2021 pika 7 ku citon që përlogaritja e fondit limit bëhet duke u mbështetur në testimin e tregut me 3(tre) oferta ekonomike të administruara. Në testimin e tregut të kryer nga KBV ofertat e administruara nga OE “F.T (PF) me NIPT LF dhe OE “I.E.” PF me NIPT KE nuk e kanë në veprimtarinë e tyre objektin të prokurimit.</p>	2.6	E mesme	A.K., Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, KBV në rastet e përlogaritjes së fondit limit me testim tregu me 3(tre) oferta ekonomike të verifikojë veprimtarinë në QKB të OE nga ku të përputhet veprimtaria e tyre me objektin e prokurimit.
20	<p>Në disa procedura të cilat OE ofertues nuk janë prodhues nuk është kërkuar asnjë deklaratë apo vërtetimin në lidhje me origjinën e këtyre mallrave. Më konkretisht në asnjë rast nuk vërtetohet se cili është prodhuesi në mënyrë të tillë që të vërtetohet lidhja ndërmjet prodhuesit apo distributorit të autorizuar prej tij me OE</p>	2.7	E mesme	AK, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, të kërkojë në lidhje me OE ofertues, në rastet e tilla kur ato nuk janë prodhues deklarata apo vërtetime të ndryshme mbi origjinën e mallrave që të vërtetohet lidhja ndërmjet prodhuesve apo distributorëve të autorizuar prej prodhuesit me OE ofertues në procedurat e prokurimit.
21	<p>Për periudhën objekt auditimi u konstatua se janë ekzekutuar 18 vendime të formës së prerë për personat të cilët kanë qenë punonjës në DPSHTRR dhe janë larguar nga puna. Detyrimi i paguar për këto vendime të formës së prerë për periudhën objekt auditimi është 15,258,500 lekë, konstatohet se nga këto 18 vendime, 14 prej tyre janë ekzekutuar me zyrë përmbarimore, për të cilat është shpenzuar vlera 872,389 lekë. Janë edhe 3 vendime të tjera në fazën e Apelit, të cilat nuk kanë përfunduar. Nëse ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë do të ishte kryer me ekzekutim vullnetar do të minimizoheshin kostot në buxhetin e DPSHTRR.</p>	2.3	E lartë	Strukturat drejtuese të DPSHTRR, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria Juridike në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike, të marrin masa për likuidimin e menjëhershëm të detyrimeve që rrjedhin nga proceset gjyqësore përpara vendimeve të zyrave përmbarimore, me qëllim uljen e kostove të këtyre detyrimeve.
22	<p>Gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit me objekt “Blerje karta memorie për tahografët digjital, viti 2021”, Çmimi i aplikimit i përcaktuar nga Udhëzimi i përbashkët të Ministrisë Financave dhe Ekonomisë (MFE) dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) me Nr.9785/1 datë 01.06.2022 dhe me Nr.12 datë 30.05.2022 është 40 euro ose 4,821 lekë më pak se çmimi i kontratës lidhur ndërmjet AK dhe OE “C. d.”. Pra për sa më sipër nga çmimi i aplikimit të përcaktuar nga udhëzimi përbashkët si dhe</p>	2.6	E lartë	Organet drejtuese të DPSHTRR-së, në lidhje me vendosjen dhe përcaktimin e çmimit të përdorimit të kartës së memories së tahografëve, të marrin në konsideratë rrethanat dhe faktorët e tjerë, se cila është kategoria që

	çmimit të kontratës së lidhur, për sasinë prej 6000 karta memorie tahograf digjital AK ka humbur $6000 * 4,821 = 28,926,000$ lekë.		është e prekur nga vendosja e këtij çmimi dhe se sa implikohet kjo kategori në lidhje me këtë çmim, duke qenë se impakti kryesisht është në biznese dhe jo në individ.
--	--	--	--

KONKLUZION I PËRGJITHSHËM DHE OPINIONI I AUDITIMIT

Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR), në përgjithësi ka zbatuar kuadrin rregullator, por janë konstatuar edhe shmangie të cilat kanë ndikuar në performancën financiare të shoqërisë. Gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit nuk përcaktohen qartë specifikimet teknike dhe kriteret e veçanta si dhe zbatimit dhe ndjekja e kontratës nuk kryhet si duhet nga grupet e marrjes në dorëzim dhe ndjekjes së kontratave.

Opinion i Auditimit

Opinion për auditimin e përputhshmërisë:

Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR), sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave dhe marrëveshjeve që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR), gjatë ushtrimit të aktivitetit përkatës.

“Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se veprimtaria e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR) është në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur justifikojnë dhënien e një opinionit të pakualifikuar”.”

Baza për opinionin e përputhshmërinë.

Në kemi audituar veprimtarinë e subjektit “Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR)” në zbatim të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ISSAI 4000 dhe ISSAI 100, paragrafi 42.

Auditimi u krye në përputhje me kërkesat e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë të KLSH-së si dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit të zbatueshme për Institucionet Supreme të Auditimit (ISSAI-s); me parimet ISSAI-P1, “Deklarata e Limës”; ISSAI P-10, “Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t”, si dhe ISSAI P-12, ISSAI P-20, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin përputhshmërisë, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 4000 “Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë”. Në i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 27, datë 20.04.2018, të Kryetarit të KLSH-së.

Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë në institucionet publike, KLSH është e pavarur nga Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR) dhe përgjegjësitë janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Në besojmë së dëshmitë e evidencës së auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për sigurimin e bazës për opinionin tonë. Auditimi ynë përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e transaksioneve. Procedurat janë përzgjedhur mbështetur gjithashtu mbi gjykimin profesional të audituesit. Gjithashtu, në besojmë

së dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjet nën auditim:

Menaxhimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR) është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjithë bazën ligjore dhe rregullatore në fuqi. Drejtimi është përgjegjës për hartimin dhe miratimin e buxhetit dhe të pasqyrave të llogaridhënies vjetore në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar dhe funksionimin e kontrollit të brendshëm efektiv, për të mundësuar përgatitjen e tyre pa gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Përgjegjësia e Audituesve të KLSH-së:

Përgjegjësia e auditimit është të shprehë një opinion bazuar në rezultatet e auditimit të kryer, për të marrë *siguri të arsyeshme*, që veprimtaria e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR), në të gjitha aspektet, është pa gabime dhe anomali materiale. Audituesit e KLSH-së nëpërmjet auditimit të realizuar në këtë institucion krijuan bindjet, të cilat do të shprehen në opinionin e grupit të auditimit mbi shkallën e zbatueshmërisë nga subjekti, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (*kriteret e auditimit të përputhshmërisë*), Objektivi ynë lidhet me *dhënien e sigurisë së arsyeshme* mbi përputhshmërinë e aktivitetit të DPSHTRR-së, me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara, administrative si dhe mbi përdorimin e duhur dhe eficient të burimeve financiare e administrative të institucionit. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Për këtë audituesit e KLSH, aplikojnë gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese nëpërmjet të cilës, audituesit identifikojnë çështjet më të rëndësishme që trajtohen në Raportin Përfundimtar të auditimit.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, në zbatim të projektit dhe Programit të Auditimit të miratuar nga Kryetari i KLSH-së nr.409/1 Prot., datë 05.06.2023, i ndryshuar me nr. 409/2 Prot., datë 20.07.2023 për periudhën nga data 01.07.2021 deri më datë 31.12.2022 si dhe zhvillimin e auditimit “Të Përputhshmërisë dhe Rregullshmërisë” nga data 06.06.2023 deri më datë 29.09.2023 në subjektin Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR), nga Grupi i Auditimit me përbërje:

- E.K. (përgjegjës grupi)
- M.B. (anëtarë)
- Q.M. (anëtarë)
- A.B. (anëtarë)

Titulli: Raport Përfundimtar auditimi “Përputhshmërie dhe Rregullshmërie” në subjektin Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR) për periudhën e aktivitetit nga data 01.07.2021 deri më datë 31.12.2022.

Raporti Përfundimtar i auditimit është i strukturuar në gjashtë kapituj. Në kapitullin e parë të hyrjes janë trajtuar çështjet e objektivave dhe qëllimi i auditimit, përgjegjësitë e strukturave drejtuese dhe të audituesve, kriteret, identifikimi i çështjeve, etj. Në vijim është përshkrimi i auditimit, në të cilin trajtohet një informacion i përgjithshëm mbi subjektin e audituar dhe vazhdon me trajtimin e rezultateve të auditimit për secilin prej drejtimeve të auditimit. Në kreun e tretë jepet konkluzioni i përgjithshëm dhe opinionin e auditimit, bazuar në rezultatet e auditimit. Gjetjet dhe rekomandimet të strukturuar sipas llojit të tyre janë vendosur në kreun e katërt. Projekt Raporti ka në kreun e pestë anekse dhe mbyllet me kreun VI-Lista e dokumenteve të auditimit.

Marrësi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR), z. B.G. me detyrë Drejtor i Përgjithshëm.

Objektivat dhe qëllimi: Në objektivat dhe qëllimet e auditimit përfshihet vlerësimi objektiv i evidencave, dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion, për të përcaktuar nëse të dhënat e raportuara për periudhën objekt auditimi përputhen me kriteret përkatëse të kuadrit rregullator. Objektivi i Auditimit është dhënia e opinionit nëse DPSHTRR në të gjithë aspektet materiale, aktiviteti ekonomik dhe financiar, transaksionet dhe informacioni janë në përputhje ose jo me dispozitat ligjore dhe rregulloret përkatëse.

Qëllimi i këtij auditimi përputhshmërie dhe rregullshmërie është evidentimi i devijimit nga standardet e pranura i shkëlqes së parimeve të ligjshmërisë, të menaxhimit financiar me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga ana e subjektit të audituar.

Auditimi i përputhshmërisë dhe rregullshmërisë i ndërmarrë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, ka për qëllim promovimin e qeverisjes së mirë në sektorin publik duke marrë parasysh rrezikun e mashtrimit në lidhje me përputhshmërinë (*sipas ISSAI 400, p 18*).

Me auditimin e përputhshmërisë, duhet të përcaktohet niveli i zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi lidhur me realizimin e proceseve dhe aktiviteteve të institucionit.

Identifikimi i çështjes: Raport Përfundimtar mbi auditimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë të DPSHTRR-së për periudhën 01.07.2021 - 31.12.2022, ka identifikuar sipas kriterëve specifikë të vlerësimit, shqyrtimin dhe vlerësimin e fushave në vijim:

- Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditi i mëparshëm;
- Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese të DPSHTRR-së, bazueshmërisë ligjore të vendimeve të marra dhe realizimi i tyre;
- Mbi zbatimin e strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me

dispozitat ligjore në fuqi;

- Hartimi, shqyrtimi dhe miratimi i programit ekonomiko-financiar në organet drejtuese të ndërmarrjes dhe në institucionet eprorë, si dhe realizimi i tij;
- Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në mbajtjen e evidencës kontabile, ndjekjen e debitorëve e kreditorëve, si dhe menaxhimin e aktiveve;
- Zbatimi i ligjshmërisë në prokurimet për investime, për blerje mallrash e shërbimesh, si dhe zbatimi i kontratave (saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësim i kritereve, fondi limit, vlerësim i ofertave dhe shpallja e fituesit), si dhe zbatimi i punimeve, deri në marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve dhe zbatimi i kontratave të punëve publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim;
- Auditim me zgjedhje sipas periudhave mbi rregullshmërinë e blerjeve me vlera të vogla (shpenzimet administrative për automjete, udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit, sponsorizime, etj);
- Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit (identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK Mjedisi i Kontrollit, Menaxhimi i Riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informimi, Komunikimi dhe Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm).

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese: Strukturat drejtuese kanë për detyrë që të përgjigjen për garantimin e sistemeve të përshtatshme dhe efektive të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator përkatës.

Strukturat drejtuese janë përgjegjëse për realizimin e objektivave dhe zbatimin e përgjegjësive të caktuara në kuadrin ligjor dhe rregullator, për të menaxhuar fondet publike në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet.

Strukturat drejtuese, duhet të orientojnë strukturat e institucionit, për përmirësimin e furnizimit me ujë dhe kanalizimet.

Përgjegjësitë e audituesve: Audituesit e KLSH janë përgjegjës për dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen apo jo, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuar si: rregullat, ligjet, politikat, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, ku mund të përmendim si burim të këtyre kritereve: standarde, ligje, vendime të Këshillit të Ministrave, rregullore, buxhete, kontrata, marrëveshje, instrumente të tjerë që përmbajnë rregulla se si duhet të menaxhohen transaksionet dhe zbatohen buxhetet, etj.; shpreh nëpërmjet opinionit të auditimit, duke respektuar Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI, si dhe kodin e etikës me qëllim që të arrihet niveli i arsyeshëm i sigurisë për dhënien e opinionit, në mënyrë që të merren veprime korrigjuese si dhe të identifikojë personat përgjegjës për veprimet e tyre.

Kriteret e vlerësimit: Kriteret e vlerësimit të përdorura në këtë auditim e kanë burimin në legjislacionin bazë e dytësor, në dispozita të tjera si dhe kuadrin rregullator përkatës sipas çështjeve të auditimit:

- Kushtetuta dhe Ligji nr. 154/2014 “Mbi Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Manualët e Auditimit, Rregullat, Udhëzimet e KLSH;
- Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë;
- Ligji Nr. 10 081, date 23.02.2009 Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar;

- Ligji Nr. 10 221, date 04.02.2010 Për mbrojtjen nga diskriminimi, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 118, viti 2012 Për transportin e mallrave te rrezikshëm;
- Ligji Nr. 119, viti 2014 Për te drejtën e informimit;
- Ligji Nr. 8308, date 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 8378, datë 22.07.1998 Kodi Rrugor i Republikës se Shqipërisë, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 9131, date Për rregullat e etikes ne administratën publike, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 9154, date 06.11.2003 Për arkivat;
- Ligji Nr. 9272, date 16.09.2004 Për aderimin e Republikës se Shqipërisë ne Marrëveshjen Europiane per Transportin Nderkombetar Rrugor te mallrave te rrezikshme (ADR) dhe protokollin e nënshkrimit;
- Ligji Nr. 9289, date 07.10.2004 Per Aderimin e Republikës se Shqipërisë ne Marrëveshjen Per Transportin Nderkombetar te ushqimeve deikate dhe pajisjet speciale qe perdoren ne keto transporte;
- Ligji Nr. 9887, date Per mbrojtjen e te dhenave personale, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare“, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 9573 Dt.03.07.2006 për Autoriparimin, Shitblerjen, Depozitimin e Mjeteve Rrugore me Motor. të Rimorkiove dhe Pjesëve të Tyre të Dala Jashtë Përdorimit ose të Braktisura dhe për Veprimtaritë që Lidhen me To;
- Ligji Nr.33 2017 për Pagesën dhe Fshirjen Shuarjen e Detyrimeve Tatimore, Detyrimeve Të Pagueshme në Doganë, si dhe Procedurën e Heqjes nga Qarkullimi të Mjeteve të Transportit pas Fshirjes Shuarjes së Detyrimeve Tatimore;
- Ligji Nr.9514 Dt.18.04.2006 për Aderimin e Republikës së Shqipërisë në Marrëveshjen Europiane Për Punën e Ekuipazheve të Mjeteve të Përfshira në Transportin Ndërkombëtar Rrugor (AETR);
- Ligji Nr.9986 Dt.11.09.2008 Për faljen e Detyrimeve Doganore dhe Tatimore, të Detyrimeve të Prapambetura të Taksës Vjetore të Qarkullimit Rrugor të Mjeteve e të Taksës së Regjistrimit të Përvitshëm të Mjeteve;
- Ligji Nr.10296, Dt.08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin".Republikën e Shqipërisë”;
- VKM nr.527 datë 10.06.2020 Për kompensimin financiar të taksës vjetore të mjeteve të përdorura, të vitit 2020, për mjetet e destinuara për transport udhëtarve, kategoria M2 dhe M3;
- VKM nr 101, datë 09.02.2011 Për miratimin e rregullave për lejet e transportit dhe kryerjen e operacioneve të transportit nga transportuesit e huaj;
- VKM nr 495 datë 13.09.2017 Për miratimin e rregullave të përfitimit të shërbimeve publike elektronike;
- VKM nr 1147 datë 09.12.2020 Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore, portal unik qeveritar e-albania dhe për miratimin e rregullave, per menyren e funksionimit të pikës së vetme të kontaktit;
- VKM nr. 85 datë 03.02.2017 Për përcaktimin e rregullave për prodhimin, shpërndarjen dhe pajisjen e udhëtarve me bileta transporti rrugor;
- VKM nr. 465 datë 26.07.2018 Për krijimin e task-forcës për përmirësimin e nivelit të kontroollit të mjeteve motorike e rimorkiove të tyre;
- VKM nr. 1035 datë 09.07.2008 Për caktimin e trafiks së licencimit të subjekteve, nga ministria e punëve publike, transportit dhe telekomunikacionit;
- VKM nr. 1054 datë 22.12.2010 Për miratimin e rregullores, për pajistjet e regjistrimit në transportin rrugor;
- VKM Nr.83, datë 3.02.2016 _Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësisë të Auditimit të

Brendshëm në Sektorin Publik.

Standardet e auditimit: Auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranuar të kuadrit ligjor, rregullator dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit. Projekt Raporti i auditimit është hartuar në përputhje me kërkesat e Rregullores së Procedurave të Auditimit në KLSH, mbështetur në:

- Ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Kodi etik i KLSH dhe Rregullorja e Brendshme;
- ISSAI 100- Parimet themelore të auditimit të sektorit publik;
- ISSAI 400-Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë;
- ISSAI 4000-Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”;
- ISSAI 1500 (ISA 500)- Objektivi i audituesit është të hartojë dhe të kryejë procedurat e auditimit në mënyrë të tillë që të mundësojë marrjen e evidencës së mjaftueshme për të nxjerrë konkluzione të arsyeshme në të cilin do të bazojë opinionin e tij;
- Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve;
- Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë”; si dhe në praktikat më të mira të fushës.

Metodat e auditimit: Audituesit e KLSH, mbi bazën e evidencave të kërkuara dhe të vëna në dispozicion, intervistave, takimeve dhe konsultave me nëpunësit e QKUM-së., kanë përgatitur dokumentacionin e mjaftueshëm të auditimit, si rezultat i kuptimit të qartë të kriterëve të përdorura, të fushë-veprimit të auditimit, të gjykimeve, të përfundimeve të arritura, programin e auditimit dhe natyrën, kohën, shtrirjen dhe rezultatet e procedurave të kryera; si dhe konkluzioneve lidhur me to. Në këtë mënyrë, dokumentimi i auditimit është kryer nëpërmjet letrave të punës, shënimeve, pyetësorëve, të finalizuar me akt konstatimet dhe observacionet e subjektit, të cilat kanë shërbyer si bazë për hartimin e këtij Projekt Raporti.

Dokumentimi i auditimit: Është kryer bazuar në kërkesat e manualit të auditimit financiar dhe të përputhshmërisë, në standardet ndërkombëtare të auditimit (ISAI), për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

III.1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR) është krijuar me vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 343, dt. 21.07.1999, në zbatim të Ligjit Nr. 8378, dt. 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, si institucion me vetëfinancim, me kapital tërësisht shtetëror, mbi bazën e pasurisë dhe kapitalit të Ndërmarrjes së Shërbimeve të Transportit Rrugor. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor drejtohet nga një Këshilli Drejtues, që përbëhet nga 5 anëtarë të cilët emërohen nga Ministri përgjegjës për Transportin Rrugor. Me drejtimin dhe administrimin e DPSHTRR-së është i ngarkuar Drejtori i Përgjithshëm i cili emërohet nga Kryeministri me propozim të Ministrit.

DPSHTRR ofron shërbim përmes 13 drejtorive rajonale dhe nënzyrave të shërbimeve të transportit rrugor. Shërbimet e ofruara janë:

Shërbimet për mjetin

Regjistrimi i mjeteve, pajisja e mjetit me targa dhe leje qarkullimi

Pronësia e mjetit
Shërbime të tjera

Leje Drejtimi dhe Autoshkolla

Monitorimi i kualifikimit të drejtuesve të mjeteve rrugore

Pajisja me leje drejtimi për drejtuesit e mjeteve

Kontrolli i veprimtarisë së autoshkollave

Dëshmi, Certifikata dhe Licenca

Pajisje me dëshmi, certifikata dhe licenca për subjekte të ndryshme të transportit rrugor si: transporti i udhëtarëve, i mallrave, autoshkollat, etj.

Kontrolli Teknik i Mjeteve

Ofrimi i shërbimit të kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve

Pajisja me dokumentacionin përkatës

Regjistri Kombëtar i Mjeteve dhe Drejtuesve të tyre

Transmetimi i menjëhershëm i të dhënave te organet e tjera

Platforma Open Data DPSHTRR për statistika për publikun

Agjent Tatimor për Taksat e Mjeteve

Mbledhja e të ardhurave nga pagesa e taksave vjetore e mjeteve (TVMP +TVML)

Prodhim i Targave dhe Shtypshkrimeve

Organizimi, shtypja dhe shpërndarja e dokumentacionit bazë për transportin rrugor

Prodhim i targave të mjeteve sipas formateve të ndryshme

Siguria Rrugore

Promovimi dhe ndërgjegjësimi për sigurinë rrugore

Automoto Park Albania

RETRO

Vlerësimi dhe regjistrimi i mjeteve historike RETRO

Promovimi i koleksionistëve shqiptarë të mjeteve historike

III.2. Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit:

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i njaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet e rëndësishme profesionale të bëra në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, u përgatit Projekt Raporti i Auditimit.

II.2.1. “Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm”

Për auditimin e zbatimit të rekomandimeve nga KLSH, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Detyrat e lëna nga auditimi i mëparshëm, dërguar me shkresën e KLSH-së, nr. 934/13, datë 04.04.2022.

- Korrespondenca shkresore e ndjekur nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor (DPSHTRR) dhe KLSH.
- Dokumentacioni shoqërues dhe justifikues për kryerjen e rekomandimeve.
- Dokumentacioni i mbajtur nga Këshilli Drejtues për këtë qëllim, etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet se:

- DPSHTRR, ka respektuar afatin 20 ditor të kthimit të përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, në përputhje me nenin 15 germa “j”, të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- DPSHTRR, nuk ka respektuar afatin 6 mujor të kthimit të përgjigjes për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, në kundërshtim me nenin 30, pika 2 të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Realizimi i rekomandimeve në mënyrë të detajuar pasqyrohet si më poshtë vijon:

Auditimi u krye në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe të Udhëzimit të Kryetarit të KLSH nr. 1, datë 04.11.2016 “Mbi procedurat që duhen të ndiqen në lidhje me ndjekjen e zbatimit të masave të rekomanduara dhe dokumentacioni që hartohet në auditimin e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të KLSH”.

Nga auditimi i ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “Mbi auditimin e përputhshmërisë” trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr.43, datë 24.03.2022, të Kryetarit të KLSH-së, të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 934/13, datë 04.04.2022, verifikohet se:

- Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor, për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, ka nxjerrë urdhrin nr.604, datë 19.04.2022 dhe me shkresën nr.17590/40, datë 22.04.2022, ka dërguar kthimin e përgjigjes mbi zbatimin e rekomandimeve, në përputhje me nenin 15 germa “j”, të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.
- Nga DPSHTRR, nuk është kthyer përgjigje për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6-mujor, në kundërshtim me nenin 30, pika 2 të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, me shkresën përcjellëse janë lënë **22 masa gjithsej**, nga të cilat **20** Masa Organizative, **1** masë për shpërblim dëmi dhe **1** masë për shpenzime jo në përputhje me parimet e ekonomicitetit, efijencës dhe efektivitetit.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- Nga **20** masa organizative të rekomanduara gjithsej, **16** janë zbatuar plotësisht, **1** është në proces zbatimi dhe **3** nuk janë zbatuar.
- Nga **1** masë për shpërblim dëmi e rekomanduar dhe e zbatuar plotësisht.
- Nga **1** masë për eliminimin e efekteve negative konstatuar në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efijencë dhe efektivitet të fondeve publike e rekomanduar, por e pa zbatuar.

Më hollësisht, auditimi i ndjekjes së rekomandimeve paraqitet si vijon:

Masa Organizative

1.1. Rekomandim: Nga Këshilli Drejtues në vazhdimësi të kryhet raportimi periodik me shkrim ministrit përgjegjës për transportin rrugor, për ecurinë e DPSHTRR-së sipas germës “p” të nenit 10 të Statutit të DPSHTRR-së.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit: Referuar rekomandimit, nga Këshilli Drejtues janë dërguar shkresat përkatëse sipas periudhave mbi ecurinë e DPSHTRR. Shkresat për këtë qëllim janë me nr. 12361/1, date 06.05.2022 “Mbi ecurinë 12- mujore të vitit 2021”, nr.1190, datë 19.01.2023 “Mbi ecurinë për 10-mujorin e vitit 2022”, nr.12440, datë 23.06.2023 “Mbi ecurinë për periudhën 12 mujore të vitit 2022”.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

2.1. Rekomandim: DPSHTRR të marrë masat e nevojshme për të siguruar hartimin e programeve afatmesme dhe afatgjatë, si dhe miratimin e tyre paraprakisht nga Këshilli Drejtues dhe më pas nga Ministri i MIE, me qëllim që të përcaktohen synimet e institucionit për të ardhmen, të bëhet e mundur matja dhe vlerësimi i progresit kundrejt objektivave, si dhe të marren në kohë masat për përmirësim të nevojshme.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit: Referuar rekomandimit, në zbatim të germës a), të pikës 4, të nenit 9, të ligjit nr. 10 296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar “*propozimin të nëpunësit autorizues i njësisë publike të sistemit të rregullave dhe procedurave të brendshme të njësisë, të planeve strategjike dhe të objektivave afatmesëm dhe vjetorë, si dhe monitorimin e zbatimit të tyre në njësi*”, si dhe statutit të miratuar nga ministri përgjegjës me shkresën nr.4572/1, datë 21.12.2022, protokolluar me nr.14825/1, datë 22.12.2022, germa k, e nenit 10 të statutit të DPSHTRR-së citohet se “*Miraton paraprakisht Programin Ekonomiko Financiar të vitit pasardhës dhe programin afatmesëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, të cilat ia propozon për miratim përfundimtar Ministrit përgjegjës për transportin rrugor;*

DPSHTRR, në Programin Ekonomiko-Financiar vjetor, planifikon buxhetin për gjithë veprimtarinë e njësisë dhe investimet. Tabela e investimeve në relacionin që përcillet tek Ministri përcjell informacion duke përcaktuar financimin e vitit aktual dhe financimin për vitet në vijim, shkresa nr. 27559 prot, datë 27.12.2019, një ekstrakt nga relacioni dhe tabela e investimeve.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

3.1. Rekomandim: Drejtori i Përgjithshëm i DPSHTRR, në cilësinë e administruesit të shpenzimeve, të marrë masat e nevojshme që në të gjitha rastet në vijim, ndryshimet në planin e shpenzimeve (*brenda totalit të miratuar nga ministri*) të miratohen nga Këshilli Drejtues, me qëllim për të rivendosur në funksion hallkën e fundit të kontrollit të këtij procesi, rrjedhimisht për të zvogëluar riskun e menaxhimit jo efektiv të fondeve të institucionit.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit: Referuar rekomandimit, në zbatim të germës i, të nenit 12 të statutit të DPSHTRR-së të miratuar nga ministri përgjegjës për transportin rrugor me shkresën nr. 4572/1 Prot, datë 21.12.2022, protokolluar me tonën me nr. 14825/1 Prot, datë 22.12.2022, citohet se Drejtori i Përgjithshëm “*Administraton shpenzimet, si dhe miraton ndryshimet e zërave brenda totalit të shpenzimeve. Detajon zërat e investimeve të lëna në kompetencën e tij nga Këshilli*

Drejtues, sipas kërkesave të Drejtorisë së Përgjithshme dhe drejtorive rajonale, brenda totalit të tyre në Programin Ekonomiko Financiar, të miratuar nga Ministri përgjegjës për transportet”.

Në zbatim të rekomandimit nuk është kryer asnjë ndryshim plani shpenzimesh (rialokim shpenzimesh), përpara miratimit të ndryshimeve në statut.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

3.2. Rekomandim: Nga DPSHTRR të merren masat e nevojshme që në të gjitha rastet, kërkesat e drejtorive rajonale për ndryshime në shpenzime, të argumentohen në mënyrë të detajuar zë për zë, pasjen e fondeve të lira apo tejkalimet e zërave, më qëllim njohjen e strukturave vendimmarrëse me arsyet e kërkesave për ndryshime, si dhe për të siguruar informacion që do të ndihmojë në mirë-menaxhimin e shpenzimeve.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit: Në të gjitha drejtoritë rajonale me shkresën nr. 2473/2 Prot, datë 09.02.2022 është përcjellë informacioni “Gjatë vitit 2022, ndryshimi i zërave të shpenzimeve brenda programit të shpenzimeve të drejtorisë Tuaj për rastet e nevojshme, duhet të jetë i argumentuar jo vetëm për shkaqet e shtesës së zërave të shpenzimeve por edhe shkaqet e pakësimeve, arsyet e krijimit të tepcave të shpenzimeve. Rastet e tejkalimit të zërave të shpenzimeve pa miratim nga ana jonë, konsiderohet shkelje e rëndë financiare”.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

4.1. Rekomandim: Sektori i Planifikimit në Drejtorinë Ekonomike në DPSHTRR në të gjitha rastet të marrë masat e nevojshme, për të ndjekur në mënyrë të vazhduar realizimin e të gjitha kategorive të investimeve, me qëllim analizimin e detajuar të tyre dhe ndërmarrjen e hapave për përmirësime në planifikimin e vitit pasardhës.

Në vijimësi.

Përgjigjja e institucionit: Referuar rekomandimit, duke filluar nga muaji Janar 2022, Sektori i Analizës dhe Statistikave ka krijuar formate të 2 llojeve të reja të evidencave ekonomike:

“Evidenca e Realizimit të kontratave aktive gjatë vitit 2022” dhe

“Evidenca e Procedurave të prokurimit gjatë vitit 2022”.

Të dyja evidencat plotësohen dhe raportohen pranë Sektorit të Analizës dhe Statistikave brenda datës 10 të muajit pasardhës për muajin paraardhës nga Degët e Financës të secilës Drejtori Rajonale.

Ndërsa, për DPSHTRR, “Evidenca e Realizimit të kontratave aktive gjatë vitit 2022”, ku përfshihen Investimet dhe Shpenzimet, plotësohet dhe raportohet nga Sektori i Financës dhe “Evidenca e Procedurave të prokurimit gjatë vitit 2022”, plotësohet dhe raportohet nga Drejtoria e Prokurimit. Pas mbledhjes dhe analizimit të materialit, Sektori i Analizës dhe Statistikave i dërgon informacionin për rakordim dhe ndjekjen e ecurisë së Investimeve, Prokurimeve dhe Shpenzimeve, Njesisë së Investimeve dhe Shërbimeve Mbështetëse dhe Sektorit të Planifikimit Ekonomik.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

5.1. Rekomandim: DPSHTRR, nëpërmjet Drejtorisë Ekonomike të marrë masat e nevojshme, që krahas statistikave periodike, me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit përkatës, të hartojë

raportin e monitorimit të vitit përkatës (në të cilin të paraqitet analiza e detajuar e zbatimit të programit ekonomik-financiar të vitit, dhe rastet e mos përfshirjes së një projekti investimi në programin e vitit pasardhës, duhen argumentuar në mënyrë të detajuar), i cili duhet të paraqitet për miratim, çdo vit, në Këshillin Drejtues të DPSHTRR-së, dhe mbas miratimit, t'iu bëhet me dije të gjithë punonjësve të institucionit.

Në vijimësi.

Përgjigjja e institucionit: Referuar rekomandimit, Sektori i Analizës dhe Statistikave ka marrë masa që me mbylljen e pasqyrave financiare vjetore të rakordojë evidencat/indikatore ekonomiko-financiarë me të gjitha Drejtoritë Rajonale, Drejtorinë e Targave dhe Shtypshkrimeve dhe Sektorin e Financës në DPSHTRR. Pasi ka përfunduar faza e rakordimit është hartuar Raporti i indikatorëve Ekonomiko-Financiarë për vitin përkatës ku analiza ka qene e detajuar sipas rekomandimit Tuaj.

Konkretisht është raportuar ne Këshillin Drejtues:

“Mbi ecurinë e DPSHTRR-së për 6-mujorin e parë të vitit 2021” me shkresën nr. 14433, datë 26.07.2021

“Mbi ecurinë dhe realizimit të treguesve kryesore ekonomiko – financiar të DPSHTRR-së për periudhën 12-mujore të vitit 2021” me shkresën nr. 12361 Prot, datë 05.05.2022

“Mbi ecurinë e DPSHTRR-së për periudhën 10-mujore të vitit 2022” me shkresën nr. 12361/2, datë 30.12.2022

“Mbi ecurinë e DPSHTRR-së për periudhën 12-mujore të vitit 2022” me shkresën nr.11591, datë 13.06.2023

Komenti i grupit të auditimit: Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

6.6. Rekomandim: Të merren masat për përditësimin e Rregullores së Brendshme të Personelit duke pasur parasysh gjithë ndryshimet në Strukturën, Statutin dhe Rregulloret e Brendshme të DPSHTRR, gjë që do të sjellë rritjen e eficensës dhe efektivitetit të personelit të DPSHTRR-së.

Në vijimësi.

Përgjigjja e institucionit: Referuar rekomandimit, nisur nga zbardhja e akteve të mësipërme ligjore nga ana e DPSHTRR-së në mbledhjen e Këshillit Drejtues datë 28.01.2022, paraqiti për miratim draft rregulloren e përfunduar me gjithë proceset e punës sipas dispozitave ligjore dhe strukturës në fuqi të DPSHTRR. Duke qenë se MIE me Urdhrin nr.34, datë 16.02.2022, miratoi strukturën e re të DPSHTRR-së aktualisht po punohet me azhornimin dhe përshtatjen e rregullores sipas përcaktimeve të reja, në mënyrë që të vijohet me miratimin e rregullores përkatëse brenda afateve të rekomanduara.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces**.

7.1. Rekomandim: Nga DPSHTRR të merren masat për ngritjen e një grupi pune për hartimin e formularëve të vlerësimit të personelit të DPSHTRR-së.

- Vlerësimi vjetor i personelit të DPSHTRR-së të kryhet në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e Brendshme të DPSHTRR-së duke plotësuar Dosjen e Personelit të DPSHTRR me Formularët e Vlerësimit.

Në vijimësi.

Përgjigjja e institucionit: Referuar rekomandimit, mbi formularët e vlerësimit vjetor të punonjësve me urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm, nr.1338, datë 16.09.2022 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e formularit për vlerësimin e ecurisë dhe rezultateve në punë” dhe urdhrin nr. 1338/1,

datë 26.09.2022 “Për miratimin e formularit për vlerësimin e ecurisë dhe rezultateve në punë” nga ku rezulton se janë hartuar dhe plotësuar formularët përkatës.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

8.1.Rekomandim: Drejtoria e Ekonomike e DPSHTRR-së në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale dhe me Drejtorinë Juridike të marrin masat për analizimin e hollësishëm të debitorëve, për gjetjen e saktë të të dhënave të debitorëve fizik (ish-punonjës) dhe të subjekteve fizike e juridike, për të identifikuar shumat pa shpresë arkëtimi të klientëve/debitorëve të ndryshëm, si dhe të sigurojë iniciimin e një procesi rivlerësimi, ku të gjitha të drejtat me palët e treta të analizohen në kuptimin e vjetërsisë dhe mundësive reale për arkëtimin dhe likuidimin e tyre, ku të propozohen masa konkrete, duke mos e përjashtuar masat administrative si dhe të gjitha rrugët e mundshme ligjore për mbledhjen ose shuarjen e tyre.

Përgjigjja e institucionit: Referuar rekomandimit, Drejtoria Juridike ka ndjekur dhe ndjek në vijimësi të gjitha rastet ku DPSHTRR është palë kreditore duke ndjekur të gjitha rrugët e mundshme ligjore për arkëtimin e tyre, deri në daljen e një vendimi gjyqësor të formës së prerë e më pas vijimin e veprimeve të mëtejshme sipas procedurave ligjore për ekzekutimin e tyre.

Spektori i Financës pas hartimit të pasqyrave financiare të vitit 2022, do të marrë masa për realizimin e këtij rekomandimi brenda afateve të caktuara.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pa zbatuar**.

8.2.Rekomandim: Drejtoria Ekonomike e DPSHTRR-së të marrë masa për krijimin e provizioneve për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme, pasi të jenë evidentuar të dhënat për klientët/debitorët, si shuma e detyrimit, vjetërsia e tyre dhe situata aktuale e tyre, si dhe pasi të jenë kaluar më parë të gjitha rrugët e mundshme ligjore për mbledhjen e tyre.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit: Referuar rekomandimit, Drejtoria Juridike ka ndjekur dhe ndjek në vijimësi të gjitha rastet ku DPSHTRR është palë kreditore duke ndjekur të gjitha rrugët e mundshme ligjore për arkëtimin e tyre, deri në daljen e një vendimi gjyqësor të formës së prerë e më pas vijimin e veprimeve të mëtejshme sipas procedurave ligjore për ekzekutimin e tyre.

Spektori i Financës, do të marrë masa për krijimin e provizioneve për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme në vijimësi.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pa zbatuar**.

9.1. Rekomandim: Drejtoria e Ekonomike e DPSHTRR-së të marrë masa të menjëhershme për njohjen në kontabilitet të vlerës së plotë të proceseve gjyqësore të cilat kanë marrë formë të prerë si shpenzime të periudhës në “Pasqyrën e performancës financiare” të institucionit dhe krijimin e provizioneve si një detyrim në pasqyrën e “Pozicionit financiar”.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit: Referuar rekomandimit, Drejtoria Juridike ka marrë masat e nevojshme për përmbushjen e kësaj pike, ku ka dërguar informacion mbi proceset gjyqësore të cilat kanë marrë formë të prerë, në Drejtorinë Ekonomike.

Spektori i Financës, do të marrë masa për njohjen në kontabilitet të vlerës së plotë të proceseve gjyqësore të cilat kanë marrë formë të prerë, si shpenzime të periudhës në "Pasqyrën e

performancës financiare" të institucionit dhe krijimin e provizioneve si një detyrim në pasqyrën e "Pozicionit financiar".

Komenti i grupit të auditimit: Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pa zbatuar**.

10.1. Rekomandim: Drejtoria ekonomike e DPSHTRR-së të marrë masa në vijimësi për ndarjen e shpenzimeve të cilat i shërbejnë aktivitetit dhe atyre të cilat janë shpenzime të panjohura për efekte fiskaliteti, me qëllim saktësinë e deklaratës së TVSH-së dhe të Tatim Fitimit.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit: Referuar rekomandimit, Nga Drejtoria Ekonomike - Sektori i Financës për sa i përket shpenzimeve të panjohura për efekte fiskale, me qëllim saktësinë e deklaratës së TVSH-së dhe të Tatim Fitimit, për faturat e blerjes së ujit nga subjekti "L.I.", e ka zbatuar rekomandimin duke mos kredituar TVSH-në e blerjes dhe do të marrë parasysh ta pasqyrojë dhe në pasqyrat financiare si shpenzim të panjohur për efekte fiskaliteti. Në të njëjtën mënyrë do të veprojmë edhe për zërin shpenzime për pritje përcjellje.

Bashkëlidhur fatura nr. 62/2022, date 31.01.2022 e subjektit "L.I.", dhe regjistrimi i bërë për këtë faturë duke mos kredituar TVSH-në.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

11.1. Rekomandim: Titullari i institucionit të DPSHTRR-së të marrë masa në vazhdimësi, që menjëherë pas marrjes së relacionit nga Komisioni i inventarizimit, të nxjerrë urdhrat për ngritjen e komisionit për vlerësimin e aktiveve, si dhe nëse konstatohen aktive të dëmtuara ngritjen e komisionit të nxjerrjes jashtë përdorimi.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit: Referuar rekomandimit, Në zbatim të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 1246, datë 14.12.2022 "Për krijimin e komisionit të inventarizimit të aktiveve", i ndryshuar, nga komisioni i ngritur për inventarizimin e aktiveve afatgjata materiale e jomateriale dhe inventarit në përdorim, si dhe komisioni për inventarizimin e aktiveve afatshkurtra në magazinë dhe në njësinë e personalizimit të kartave, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe urdhrin e sipërcituar është kryer inventarizimi i aktiveve afatgjata e afatshkurta materiale, inventarit në përdorim, mallrave dhe materialeve në magazinë dhe njësinë e personalizimit të kartave për vitin 2021, në Drejtorinë e Përgjithshme.

Komisioni inventarizimit të aktiveve afatgjata materiale e jomateriale dhe inventarit në përdorim pas përfundimit të inventarit fizik të aktiveve ka hartuar relacionin për procedurën e ndjekur drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm me shkresën nr. 26981/3 Prot, datë 05.01.2022 "Informacion për inventarin e aktiveve afatgjata në Drejtorinë e Përgjithshme", duke pasqyruar hapat e ndjekura dhe rezultatin e procesit të inventarizimit.

Komisioni për inventarizimin e aktiveve afatshkurtra në magazinë dhe në njësinë e personalizimit të kartave pas përfundimit të inventarit fizik të aktiveve në magazinë dhe njësinë e personalizimit të kartave ka hartuar relacionin për procedurën e ndjekur drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm me shkresën nr. 26981/2 Prot, datë 05.01.2022 "Relacion mbi kryerjen e inventarizimit fizik në magazinë dhe në njësinë e personalizimit të kartave", duke pasqyruar hapat e ndjekura dhe rezultatin e procesit të inventarizimit.

Në lidhje me procedurat për nxjerrje jashtë përdorimi të aktiveve në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor dhe drejtoritë rajonale në varësi për vitin 2021 janë realizuar. Në lidhje me procesin e inventarizimit fizik të aktiveve në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor për vitin 2022 janë realizuar.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

12.1. Rekomandim: Autoriteti Kontraktor, Njësia e Prokurimit në procedurat e prokurimit të mallrave/shërbimeve dhe punëve që do të zhvillohen në vazhdimësi, të marrë masa që çdo kriter i veçantë të jetë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Vendosija e çdo kriteri duhet të jetë e argumentuar dhe e dokumentuar.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit: Në lidhje me këtë rekomandim, është vepruar duke zbatuar legjislacionin dhe për çdo procedurë prokurimi nga njësia e prokurimit janë përcaktuar dhe argumentuar kriteret e veçanta për punë/mallra dhe shërbime sipas natyrës së kontratës. Në të gjitha prokurimet e zhvilluara në përbërje të grupeve të punës për hartimin e specifikimeve teknike, përcaktimin dhe argumentimin e kriterëve teknike të kualifikimit si dhe llogaritjen dhe argumentimin e fondeve limit, janë vendosur specialist të fushës referuar objektit të prokurimit. Nga specialistët e fushës argumentimi i kriterëve teknike të kualifikimit si dhe argumentimi i fondit limit në përgjithësi është pasqyruar me një procesverbal të veçantë. Nga Njësia e Prokurimit në përbërje të së cilës është përcaktuar dhe specialist i fushës argumentimi i kriterëve teknike është pasqyruar me procesverbal të veçantë. Në vazhdimësi për të gjitha prokurimet do të mbahet në konsideratë rekomandimi Juaj lidhur me argumentimin e çdo kriteri në mënyrë të detajuar.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

13.1. Rekomandim: Autoriteti Kontraktor, Njësia e Prokurimit në procedurat e prokurimit të mallrave/shërbimeve dhe punëve që do zhvillohen në vazhdimësi, të marrë masa që çdo kriter i veçantë të jetë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Vendosija e çdo kriteri duhet të jetë e argumentuar dhe e dokumentuar.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit: Në lidhje me këtë rekomandim, është vepruar duke zbatuar legjislacionin dhe për çdo procedurë prokurimi nga njësia e prokurimit janë përcaktuar dhe argumentuar kriteret e veçanta për punë/mallra dhe shërbime sipas natyrës së kontratës.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

14.1. Rekomandim: Autoriteti Kontraktor, Njësia e Prokurimit në procedurat e prokurimit të mallrave/shërbimeve dhe punëve që do zhvillohen në vazhdimësi, të marrë masa që do kriter i veçantë të jetë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Vendosija e çdo kriteri duhet të jetë e argumentuar dhe e dokumentuar.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit: Në lidhje me këtë rekomandim, është vepruar duke zbatuar legjislacionin dhe për çdo procedurë prokurimi nga njësia e prokurimit janë përcaktuar dhe argumentuar kriteret e veçanta për punë/mallra dhe shërbime sipas natyrës së kontratës.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

15.1. Rekomandim: Autoriteti Kontraktor, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në procedurën e vlerësimit të ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës nëse kanë paguar detyrimet përkatëse për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore, në bashkitë ku kanë ushtruar apo ushtrojnë aktivitetin subjektet, të kenë parasysh Ekstraktin Historik të Regjistrimit Tregtar për të dhënat e subjektit dhe vetëdeklarimin e operatorëve mbi kontratat e lidhura dhe/ose në proces ku kanë ushtruar apo ushtrojnë aktivitetet.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit: Në lidhje me këtë rekomandim, është vepruar duke zbatuar legjislacionin dhe për çdo OE, nga komisioni i vlerësimit të ofertave janë verifikuar detyrimet ndaj taksave dhe tarifave vendore për ushtrimin e aktivitetit.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

16.1. Rekomandim: Autoriteti Kontraktor, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të vlerësojë plotësimin e kapaciteteve financiare dhe ekonomike të operatorëve ekonomikë në funksion të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës së punëve ose shërbimeve.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit: Në lidhje me këtë rekomandim, është vepruar duke zbatuar legjislacionin dhe për çdo procedurë prokurimi nga komisioni vlerësimit të ofertave është bërë vlerësimi i kapaciteteve financiare, për punë/mallra dhe shërbime sipas natyrës së kontratës.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

17.1. Rekomandim: Autoriteti kontraktor, Komisioni i Vlerësimit të ofertave të vlerësojë plotësimin e kapaciteteve financiare dhe ekonomike të operatorëve ekonomikë në funksion të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës së punëve ose shërbimeve.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit: Në lidhje me këtë rekomandim, është vepruar duke zbatuar legjislacionin dhe për çdo procedurë prokurimi nga komisioni vlerësimit të ofertave është bërë vlerësimi i kapaciteteve financiare, për punë/mallra dhe shërbime sipas natyrës së kontratës.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

18.1. Rekomandim: Nga DPSHTRR, të merren masa që për investimet për punë publike me objekt rikonstruksioni të objekteve me të njëjtën natyrë ndërtimi, të pajisen me leje ndërtimi/deklaratë paraprake për fillimin e punimeve, duke garantuar realizimin e punimeve të ndërtimit në përputhje me kërkesat e lejes së ndërtimit/deklaratës paraprake.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit: Referuar rekomandimit, në të gjitha prokurimet në vazhdimësi do të merret në konsideratë rekomandimi.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

Masa Për Shpërblim Dëmi

1.1. Rekomandim: Nga Autoriteti Kontraktor DPSHTRR, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 300,803 lekë pa TVSH nga BOE “A.” & “E.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 5195 prot., datë 24.02.2020 me objekt “Rikonstruksion dhe përmirësim i ambienteve të

Drejtoria Rajonale Tiranë”, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e DPSHTRR, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve jo në përputhje me specifikimet teknike.

Deri me datë 30.06.2022

Përgjigjja e institucionit: Në lidhje me këtë rekomandim, është vepruar nga DPSHTRR duke njoftuar BOE “A.” & “E.” SHPK për arkëtimin e vlerës prej 300,803 lekë pa TVSH, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 5195 prot., datë 24.02.2020 me objekt “Rikonstruksion dhe përmirësim i ambienteve të Drejtoriaj Rajonale Tiranë, për diferencat e konstatuara në zërin “Furnizim vendosje dyer të brendshme”. Vlera prej 300,803 lekë është mbajtur si diferencë nga vlera për zhbllokimin e garancisë së punimeve në masën 5%, prej 2,229,533 lekë, duke u likuiduar vlera 1, 928,730 lekë me urdhër transfertën e datës 16.12.2022 të C.B.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

Masa Për Eliminimin E Efekteve Negative Të Konstatuara Në Administrimin E Fondeve Publike Dhe Për Menaxhimin Me Ekonomicitet, Eficencë Dhe Efektivitet Të Fondeve Publike

1.1.Rekomandim: Strukturat përgjegjëse të DPSHTRR-së të marrin masa për të kryer ekzekutimin vullnetar për vendimet gjyqësore që kanë marrë formë të prerë e si rrjedhojë minimizimin e kostove shtesë që vijnë si pasojë e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë me anë të zyrës përmbartimore.

Në vijimësi.

Përgjigjja e institucionit: Në lidhje me këtë rekomandim, konstatohet se likuidimi i vendimeve gjyqësore është kryer duke paguar edhe vlerën e përmbartimit.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pa zbatuar**.

Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm paraqitet si më poshtë:

Emërtimi	Rekomanduar	Zbatuar	Pa zbatuar	Në proces	Pjesërisht
Masa Organizative	20	16	3	1	
Masa Shpërbllim dëmi	1	1			
Efekte negative	1		1		
Total	22	17	4	1	

Sa më sipër arrihet në konkluzionin se:

- Drejtoria Ekzekutive, nuk ka respektuar afatin 6 mujor të kthimit të përgjigjes për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve.
- Drejtoria Ekzekutive, ka vepruar dhe ka marrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimeve.
- Niveli i pranimit të rekomandimeve është 100% dhe realizimi në masën 77%.

1. Titulli i Gjetjes:	Zbatimi rekomandimeve
Situata:	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor, për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, ka nxjerrë urdhrin nr.604, datë 19.04.2022 dhe me shkresën nr.17590/40, datë 22.04.2022, ka dërguar kthimin e përgjigjes mbi zbatimin e rekomandimeve, në përputhje me nenin 15 germa “j”, të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

	<p>- <i>DPSHTRR, nuk ka respektuar afatin 6 mujor të kthimit të përgjigjes për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, në kundërshtim me nenin 30, pika 2 të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.</i></p> <p>Nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, me shkresën përcjellëse janë lënë 22 masa gjithsej, nga të cilat 20 Masa Organizative, 1 masë për shpërblim dëmi dhe 1 masë për shpenzime jo në përputhje me parimet e ekonomicitetit, efikasitetit dhe efektivitetit.</p> <p>Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:</p> <p>-Nga 20 masa organizative të rekomanduara gjithsej, 16 janë zbatuar plotësisht, 1 është në proces zbatimi dhe 3 nuk janë zbatuar.</p> <p>-Nga 1 masë për shpërblim dëmi e rekomanduar dhe e zbatuar plotësisht.</p> <p>-Nga 1 masë për eliminimin e efekteve negative konstatuar në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike e rekomanduar, por e pa zbatuar.</p> <p>Drejtoria Ekzekutive, ka vepruar dhe ka marrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimeve nga ku niveli i pranimit të rekomandimeve është 100% dhe realizimi në masën 77%.</p>
Kriteri:	Ligji nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.
Ndikimi/Efekti:	Përmirësim i aktivitetit të institucionit
Shkaku:	Neglizhencë nga personat përgjegjës
Rëndësia:	E mesme
Rekomandim:	Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrë masa për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, të hartojë një plan veprimi për detyrat e parealizuara duke përcaktuar afatet dhe personat përgjegjës për zbatimin e tyre.

II.2.2. “Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese të DPSHTRR-së, bazueshmërisë ligjore të vendimeve të marra dhe realizimi i tyre”

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR) është krijuar me vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 343, dt. 21.07.1999, në zbatim të Ligjit Nr. 8378, dt. 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, si institucion me vetëfinancim, me kapital tërësisht shtetëror, mbi bazën e pasurisë dhe kapitalit të Ndërmarrjes së Shërbimeve të Transportit Rrugor. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor drejtohet nga një Këshilli Drejtues, që përbëhet nga 5 anëtarë të cilët emërohen nga Ministri përgjegjës për Transportin Rrugor. Me drejtimin dhe administrimin e DPSHTRR-së është i ngarkuar Drejtori i Përgjithshëm i cili emërohet nga Kryeministri me propozim të Ministrit.

Këshilli Drejtues i DPSHTRR përbëhet nga 5 anëtarë:

- Z. H.B. Kryetar
- Z. M.T. Anëtar
- Znj. E.G. Anëtare

- Z. E.K. Anëtar
- Z. S.T. Anëtar

Mbledhjet dhe vendimet e marra nga Këshilli Drejtues Korrik-Dhjetor 2021

- *Mbledhja e Këshillit Drejtues datë 14.07.2021*

Vendimet e marra:

- Vendimi nr.17, datë 14.07.2021 “Për miratimin e normave të uniformave të punonjësve të Drejtorive Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor”.
- Vendimi nr.18, datë 14.07.2021 “Për dhënie ambienti me qira në Drejtorinë Rajonale Tiranë për vendosjen e makinetave automatike”.
- Vendimi nr.19, datë 14.07.2021 “Për marrje objekti me qira për DRSHTRR Berat”.
- Vendimi nr.20, datë 14.07.2021 “Për shpërndarjen e pagesës për vështirësi në punë për 6 mujorin e parë të vitit 2021, nga arkëtimi i taksave”.
- Vendimi nr.21, datë 14.07.2021 “Për miratimin e llogarive vjetore, ndarjen e fitimit neto dhe miratimin e kapitalit të vitit 2020”.
- Vendimi nr.22, datë 14.07.2021, “Për miratimin e dhënies me qira të ambientit mensë për shërbimin catering më DRSHTRR Tiranë”.
- Vendimi nr.23, datë 14.07.2021, “Për miratimin e kërkesës për mbështetje financiare të qendrës “Albani s’ka problem” për organizimin e festivalit të sigurisë rrugore në qytete Përmet-Tepelenë-Gjirokastër”.

- *Mbledhja e Këshillit Drejtues datë 04.08.2021*

Vendimet:

- Vendimi nr.24, datë 04.08.2021 “Për marrjen me enfitozë të sheshit funksional të qendrës së kontrollit teknik dhe fizik Fier, të DRSHTRR Fier”.

- *Mbledhja e Këshillit Drejtues datë 24.09.2021*

Vendimet:

- Vendimi nr.25, datë 24.09.2021 “Për transferim capital të autoveturës në Agjencinë shtetërore të Shpronësimeve.
- Vendimi nr.26, datë 24.09.2021 “Për transferimin e pajisjeve nga DRSHTRR Tiranë në Bashkinë Memaliaj”.
- Vendimi nr.27, datë 24.09.2021, “Për daljen nga përdorimi të aktiveve afatgjata, materiale të DRSHTRR Tiranë”.
- Vendimi nr.28, datë 24.09.2021, “Për disa shtesa dhe ndryshime në tabelën e investimeve nr.3/1, “Pasqyra e investimeve në vite dhe programi për vitin 2021”.
- Vendimi nr.29, datë 24.09.2021, “Për shpërndarjen e fondit për shpërblimin suplementar të punonjësve”.
- Vendimi nr.30, datë 24.09.2021, “Për dhënie ndihme Znj. D.H.”

- *Mbledhja e Këshillit Drejtues datë 29.09.2021*

Vendimet:

- Vendimi nr.31, datë 29.09.2021, Për blerje trualli dhe godine për sistemimin e punonjësve të DPSHTRR-së”

- *Mbledhja e Këshillit Drejtues datë 26.10.2021*

Vendimet:

- Vendimi nr.32, datë 26.10.2021 “Për miratimin e tarifës së rinovimit të Leje Drejtimit për kategorinë “B” me afat vlefshmërie 5 vjet ose më pak”.
- *Mbledhja e Këshillit Drejtues datë 26.11.2021*
Vendimet:
 - Vendimi nr.33, datë 26.11.2021 “Për refuzimin e çmimit të shitjes së katalogut”.
 - Vendimi nr.34, datë 26.11.2021, “Për një ndryshim në VKD nr.42, datë 17.10.2019, “Për miratimin e tarifave të shërbimit për regjistrimin për herë të parë të automjeteve me motor elektrik, plug-in hybrid”, I ndryshuar”.
 - Vendimi nr.35, datë 26.11.2021, “Për miratimin e kërkesës për mbështetje financiare të fondacionit “D.H.” për programin edukativ televiz “N’timon”.
- *Mbledhja e Këshillit Drejtues datë 14.12.2021*
Vendimet:
 - Vendimi nr.36, datë 14.12.2021, “Për daljen nga përdorimi të aktiveve afatgjata në DRSHTRR Durrës”.
 - Vendimi nr.37, datë 14.12.2021, “Për daljen nga përdorimi të aktiveve afatgjata në DRSHTRR Dibër”.
 - Vendimi nr.38, datë 14.12.2021, “Për daljen nga përdorimi të aktiveve afatgjata, materiale në DRSHTRR Vlorë”.
 - Vendimi nr.39, datë 14.12.2021, “Për daljen nga përdorimi të aktiveve afatgjata, në DRSHTRR Laç”.
 - Vendimi nr.40, datë 14.12.2021, “Për dhënie me qira të një ambienti në DRSHTRR Durrës”.
 - Vendimi nr.41, datë 14.12.2021, “Për shpërndarjen e pagesës për vështirësi në punë për 6 mujorin e dytë të vitit 2021, nga arkëtimi i taksave”.
 - Proces-Verbali i mbajtur (i zbardhur) me datë 14.12.2021, për mbledhjen e Këshillit Drejtues datë 14.12.2021.

Mbledhjet dhe vendimet e marra nga Këshilli Drejtues për vitin 2022

- *Mbledhja e Këshillit Drejtues datë 28.01.2022*
Vendimet:
 - Vendimi nr.01, datë 28.01.2022 “Për miratimin paraprak të programit Ekonomiko-financiar të vitit 2022”.
 - Vendimi nr.02, datë 28.01.2022 “Për miratimin paraprak të strukturës, organigramës, strukturës së pagave dhe klasave përkatëse të pagave për punonjësit e DPSHTRR-së, DRSHTRR-ve dhe DTSH-së”.
 - Vendimi nr.03, datë 28.01.2022 “Për shkatërrimin e objektit 2 kat dhe implementimin e projektit për DRSHTRR Durrës”.
 - Vendimi nr.04, datë 28.01.2022 “Për marrje objekti me qira për zyrën e shërbimeve Pogradeç, në DRSHTRR Korçë”.
 - Vendimi nr.05, datë 28.01.2022 “Për miratimin e dhënies me qira të ambientit mensë për shërbimin catering në godinën me vendndodhje në Fushë Prezë”.
 - Vendimi nr.06, datë 28.01.2022, “Për miratimin e tarifave të shërbimit të mjeteve”.
 - Vendimi nr.07, datë 28.01.2022, “Për daljen nga përdorimi të aktiveve në DRSHTRR Berat”.
 - Vendimi nr.08, datë 28.01.2022, “Për daljen nga përdorimi të aktiveve në DTSH”.

- Vendimi nr.09, datë 28.01.2022, “Për daljen nga përdorimi të aktiveve afatgjata materiale në DRSHTRR Vlorë”.
 - Vendimi nr.10, datë 28.01.2022, “Për transferimin e pajisjeve nga DRSHTRR Vlorë në shkollën publike “Ali Demi”, Vlorë.
 - Vendimi nr.11, datë 28.01.2022, “Për daljen nga përdorimi të aktiveve afatgjata materiale në DRSHTRR Laç”.
 - Vendimi nr.12, datë 28.01.2022, “Për daljen nga përdorimi të aktiveve afatgjata materiale në DRSHTRR Elbasan”.
 - Vendimi nr.13, datë 28.01.2022, “Për dhënie ndihme Znj. L.K.”
 - Vendimi nr.14, datë 28.01.2022, “Për dhënie ndihme Z. G.B.”
- *Mbledhja e Këshillit Drejtues datë 06.05.2022*
Vendimet:
- Vendimi nr.15, datë 06.05.2022 “Për dhënie me qira të ambientit të DPSHTRR-së në Fushë Prezë për vendosjen e makinetave automatike”.
 - Vendimi nr.16, datë 06.05.2022, “Për dhënie ndihme Znj. T.A.”
 - Vendimi nr.17, datë 06.05.2022, “Për daljen nga përdorimi të aktiveve afatgjata materiale në DRSHTRR Gjirokastër”.
 - Vendimi nr.18, datë 06.05.2022, “Për daljen nga përdorimi të aktiveve afatgjata materiale në DRSHTRR Tiranë”.
 - Vendimi nr.19, datë 06.05.2022, “Për marrje objekti me qira për zyrën e shërbimeve Çorovodë, në DRSHTRR Berat”.
 - Vendimi nr.20, datë 06.05.2022, “Për dhënie ndihme Znj. SH.L.”
 - Vendimi nr.21, datë 06.05.2022, “Për miratimin e tarifave të pajisjeve me targa HCC”.
 - Vendimi nr.22, datë 06.05.2022, “Për marrje objekti me qira për organizimin e panairit Automotive Fair Albania në datat 17-19 Qershor 2022”.
 - Vendimi nr.23, datë 06.05.2022, “Për akordim fondi në formën e ndihmës”.
 - Vendimi nr.24, datë 06.05.2022, “Për miratimin e tarifës për kartën e memories së Tahogرافit Digjital”.
- *Mbledhja e Këshillit Drejtues datë 14.06.2022*
Vendimet:
- Vendimi nr.25, datë 14.06.2022 “Për miratimin e kërkesës për mbështetje financiare të projektit “Artistë dhe Automobilë”.
 - Vendimi nr.26, datë 14.06.2022 “Për miratimin e kërkesës për mbështetje financiare të projektit “Automotive Fair Albania”.
- *Mbledhja e Këshillit Drejtues datë 01.07.2022*
Vendimet:
- Vendimi nr.27, datë 01.07.2022, “Për miratimin e treguesve ekonomiko-financiar, llogarive vjetore, raportin vjetor të veprimtarisë ekonomike, ndarjen e fitimit neto dhe kapitalit të vitit 2021”.
 - Vendimi nr.28, datë 01.07.2022, “Për daljen nga përdorimi të aktiveve në DPSHTRR”
 - Vendimi nr.29, datë 01.07.2022, “Për shpërndarjen e fondit për shpërblimin suplementar të punonjësve”.

- *Mbledhja e Këshillit Drejtues datë 22.07.2022*

Vendimet:

- Vendimi nr.30, datë 22.07.2022, “Për miratimin e kërkesës për huadhënie për A.I sha”
- Vendimi nr.31, datë 22.07.2022, “Për disa ndryshime në tabelën e investimeve nr.3/1, “Pasqyra e investimeve në vite dhe programi për vitin 2022”.
- Vendimi nr.32, datë 22.07.2022, “Për shpërndarjen e pagesës për vështirësi në punë të punonjësve të DPSHTRR-së për gjashtë mujorin e parë të vitit 2022, nga arkëtimi i taksave”.
- Vendimi nr.33, datë 22.07.2022, “Për miratimin e kriterëve të shpërndarjes të fondit për ndihma sociale dhe fondit për rezerva të tjera”.

- *Mbledhja e Këshillit Drejtues datë 10.10.2022*

Vendimet:

- Vendimi nr.34, datë 10.10.2022 “Për blerjen e truallit ku ushtron veprimtarinë DRSHTRR Kukës”.
- Vendimi nr.35, datë 10.10.2022, “Për daljen nga përdorimi të aktiveve në DRSHTRR Gjirokastër”.
- Vendimi nr.36, datë 10.10.2022, “Për dhënie ambienti me qira për shërbimin catering në DRSHTRR Tiranë”.
- Vendimi nr.37, datë 10.10.2022, “Për dhënie ambienti me qira për vendosjen e makinave në DRSHTRR Tiranë”.
- Vendimi nr.38, datë 10.10.2022, “Për disa shtesa në VKD nr.17, datë 14.07.2021, “Për miratimin e normave të uniformave të punonjësve të DRSHTRR-ve”.
- Vendimi nr.39, datë 10.10.2022, “Për daljen nga përdorimi të aktiveve në DRSHTRR Durrës”.
- Vendimi nr.40, datë 10.10.2022, “Për disa shtesa në VKD nr.2, datë 28.01.2022, të KD “Për miratimin paraprak të strukturës së pagave dhe klasave përkatëse të pagave për punonjësit e DPSHTRR-së dhe DRSHTRR-ve”.
- Vendimi nr.41, datë 10.10.2022, “Për dhënie ndihme Z. F.I.”.
- Vendimi nr.42, datë 10.10.2022, “Për transferim capital të autoveturës për sekretariatit kombëtar nisma për transparencë në industrinë nxjerrëse”.
- Vendimi nr.43, datë 10.10.2022, “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKD nr.17/1, datë 21.12.20218, “Për miratimin e tarifave për targat me përzgjedhje”, I ndryshuar.
- Vendimi nr.44, datë 10.10.2022, “Për daljen nga përdorimi të aktiveve në DRSHTRR Sarandë”.
- Vendimi nr.45, datë 10.10.2022, “Për transferimin e pajisjeve nga DRSHTRR Sarandë në konviktin e shkollës profesionale “Antoni Athanas”, Sarandë.
- Vendimi nr.46, datë 10.10.2022, “Për shkatërrimin e objektit 2+3 Kat dhe implementimin e projektit për DPSHTRR”.

- *Mbledhja e Këshillit Drejtues datë 23.12.2022*

Vendimet:

- Vendimi nr.47, datë 23.12.2022 “Për dhënie ambienti me qira në DRSHTRR Durrës”.
- Vendimi nr.48, datë 23.12.2022, “Për miratimin e tarifave të Kontrollit Teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre”.
- Vendimi nr.49, datë 23.12.2022, “Për miratimin e paraprak të programit ekonomiko-financiar të vitit 2023”.

- Vendimi nr.50, datë 23.12.2022, “Për shpërndarjen e pagesës për vështirësi në punë të punonjësve të DPSHTRR-së, për gjashtë mujorin e dytë të vitit 2022, nga arkëtimi I taksave”.
- Vendimi nr.51, datë 23.12.2022, “Për disa shtesa dhe ndryshime ne Vendimin nr.47, datë 24.12.2019, Për miratimin e tarifave të shërbimit për pajisjen me dëshminë e aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke”.
- Vendimi nr.52, datë 23.12.2022, “Për marrje me qira të ambientit për ushtrimin e veprimtarisë së zyrës së shërbimeve Pogradec, të DRSHTRR Korçë”.
- Vendimi nr.53, datë 23.12.2022, “Për transferimin e pajisjeve nga DRSHTRR Korçë në shkollën publike “Pandeli Cale” Korçë, Filialin e Postës Shqiptare Korçë dhe në ndërmarrjen e shërbimeve mbështetëse e arsimit e çerdhes”.
- Vendimi nr.54, datë 23.12.2022, “Për daljen nga përdorimi të aktiveve në DRSHTRR Korçë”.
- Vendimi nr.55, datë 23.12.2022, “Për transferimin e pajisjeve nga DPSHTRR në shkollën e arsimit 9-vjecar “Skënder Luarasi”, Tiranë.
- Vendimi nr.56, datë 23.12.2022, “Për daljen nga përdorimi të aktiveve në DRSHTRR Tiranë”.
- Vendimi nr.57, datë 23.12.2022, “Për daljen nga përdorimi të aktiveve në DTSH”.
- Vendimi nr.58, datë 23.12.2022, “Për transferimin e pajisjeve nga DPSHTRR në gjimnazin “John F.Kennedy”, Kamëz.
- Vendimi nr.59, datë 23.12.2022, “Për dhënie ndihme znj. D.H..

Bazuar në një vlerësim me bazë risku nga grupi i auditimit janë kërkuar të vihen në dispozicion praktikat e disa nga vendimeve të mësipërme me dokumentacionin e plotë justifikues.

Sa më sipër u konstatua:

- Vendimet e marra nga Këshilli Mbikëqyrës në përgjithësi janë në përputhshmëri me aktet ligjore e nënligjore në fuqi për sa i përket tematikave për të cilat janë marrë.
- Për sa i përket vendimit për marrjen me enfiteozë të sheshit funksional të Qendrës së Kontrollit Teknik dhe Fizik Fier, sheshi funksional i formës truall, është në pronësi të Bashkisë Fier me certifikatë pronësie nr. 000013472, datë 03.02.2021 me nr. pasurie 7/667 e ndodhur në zonën kadastrale 8531 me sipërfaqe 6300 m². Nisur nga korrespondenca nga dy palët midis DPSHTRR dhe Bashkisë Fier në lidhje me vendosjen e çmimit për m² të marrjes me qera të truallit, Bashkia Fier në përcaktimin e çmimit nuk ka dhënë arsye mbi vendosjen e çmimit si dhe nuk bazohet në VKM nr. 54, datë 05.02.2014 ku çmimi referencë për Bashkinë Fier është 37 lekë/m². Gjithashtu nisur nga më sipër kontrata e mësipërme, nuk shihet si kontratë enfiteoze nga Bashkia Fier pasi Enfiteoza ka si qëllim jo vetëm përdorimin e sendit, por edhe përmirësimin e tij, i cili duhet të cilësohet në kontratë, gjë e cila nuk është marrë në konsideratë gjatë diskutimit të çmimit.
- Në regjistrin e mbajtur për këtë qëllim evidentohen respektivisht, anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të cilët kanë qenë prezent dhe cilët nuk kanë marrë pjesë në mbledhje.
- Për sa i përket vendimit për marrje objekti me qira për organizimin e panairit Automotive Fair Albania, sipërfaqja e ambientit të marrë me qera për data 17-19 Qershor 2022, rreth 4000m² me cmimin 2,512,867 lekë pa TVSH, gjatë momentit të marrjes së ofertave në treg, nga O.E. nuk u dhanë detaje mbi ofertën e dhënë, të ndara në zëra sipas specifikimeve teknike të ofruara nga A.K. Gjithashtu për zhvillimin e panairove ekzistojnë dhe mënyra të tjera të cilat mund të rezultojnë më ekonomike dhe efikase, që i shërbejnë më mirë arritjeve të objektivave të institucionit.
- Grupi i auditimit konstatoi dhe mori në shqyrtim dhe një vendim nr. 30 datë 22.07.2022 “Për miratimin e kërkesës për huadhënie për A. sh.a.”, për mbështetje financiare në formën e huadhënies deri në shumën 936,000,000 lekë të ndara në këste mujore. Në dokumentacionin mbështetës jepen sqarime të detajuara që DPSHTRR nuk mund të mbulojë këtë shumë me fondet e veta, por

gjithashtu jep si alternative marrjen e një overdrafti pranë bankave të nivelit të dytë. Në gjykimin e grupit të auditimit dhe praktikave më të mira nuk duket e arsyeshme marrja e një overdrafti për huadhënien drejt një shoqërie tjetër.

2.Titulli i Gjetjes:	Vendimmarrje të cilat nuk janë në proporcion me menaxhimin e duhur financiar të institucionit.
Situata:	<p>Vendimet e marra nga Këshilli Mbikëqyrës në përgjithësi janë në përputhshmëri me aktet ligjore e nënligjore në fuqi për sa i përket tematikave për të cilat janë marrë, por nga auditimi i praktikave të disa vendimeve të marra nga Këshilli Mbikëqyrës me dokumentacionin e plotë justifikues, vihet re një menaxhim jo i duhur financiar i institucionit për arsye të mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - vendimi për marrjen me enfiteozë të sheshit funksional të Qendrës së Kontrollit Teknik dhe Fizik Fier, ku nuk është përdorur çmimi referencë për m² i marrjen me qira është 37 lekë/m² bazuar në VKM nr. 54 datë 05.04.2014, por një çmim tjetër më i lartë, ku bazuar në dhe është hasur pengesë nga Bashkia Fier, edhe pse përmirësimi i kushteve të Qendrës së Kontrollit Teknik dhe Fizik Fier është në të mirë të banorëve të Bashkisë Fier. Gjithashtu nisur nga më sipër kontrata e mësipërme, nuk shihet si kontratë enfiteoze nga Bashkia Fier pasi Enfiteoza ka si qëllim jo vetëm përdorimin e sendit, por edhe përmirësimin e tij, i cili duhet të cilësohet në kontratë, gjë e cila nuk është marrë në konsideratë gjatë diskutimit të çmimit nga ana e Bashkisë Fier. - Vendimi nr. 30 datë 22.07.2022 “Për miratimin e kërkesës për huadhënie për A. sh.a.”, për mbështetje financiare në formën e huadhënies deri në shumën 936,000,000 lekë të ndara në këste mujore. Në dokumentacionin mbështetës jepen sqarime të detajuara që DPSHTRR nuk mund të mbulojë këtë shumë me fondet e veta, por gjithashtu jep si alternative marrjen e një overdrafti pranë bankave të nivelit të dytë. Në gjykimin e grupit të auditimit dhe praktikave më të mira nuk duket e arsyeshme marrja e një overdrafti për huadhënien drejt një shoqërie tjetër.
Kriteri:	Statut i Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor Rregullorja nr. 10562/1 Prot., datë 19.06.2018 Ligji nr. 10296 datë 08.07.2010 Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin
Ndikimi/Efekti:	Menaxhimi jo i duhur i të ardhurave
Shkaku:	Keqinterpretimi i kuadrit ligjor
Rëndësia:	E mesme
Rekomandim:	Organet Drejtuese të DPSHTRR-së, gjatë marrjes së vendimeve të kenë në konsideratë menaxhimin e fondeve në proporcion me 3 E (efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet), vendime në proporcion me objektivat e institucionit si dhe të krijojnë kushtet për arritjen e tyre sipas strategjive të institucionit.

Përsa është trajtuar në këtë pjesë të P/Raportit të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacion me shkresë nr. 409/5 prot, datë 06.12.2023 “Kundërshtime për akt konstatimet e grupit të auditimit të KLSH”, nga ana e përfaqësuesve të institucionit, të cilat janë të paraqitura më poshtë, pa ndërhyrje dhe rregullime nga ana drejtshkrimore:
Pretendimet e subjektit:

Në lidhje me shkresën nr. 409/4 Prot, datë 02.11.2023 “Dërgohet Projekt Raporti i Auditimit”, protokolluar me tonën nr. 8295/30 Prot, datë 06.11.2023, lidhur me Gjetjen 2, me titull “Vendimmarrje të cilat nuk janë në proporcion me menaxhimin e duhur financiar të institucionit” jeni shprehur se vendimet e marra nga Këshilli Mbikëqyrës në përgjithësi janë në përputhshmëri me aktet ligjore e nënligjore në fuqi për sa i përket tematikave për të cilat janë marrë, por nga auditimi i praktikave të disa vendimeve të marra nga Këshilli Mbikëqyrës me dokumentacionin e plotë justifikues, vihet re një menaxhim jo i duhur financiar i institucionit për arsyt e mëposhtme:

Shpërndarja e pagesës për vështirësi në punë nga arkëtimi i taksave bazohet në pikën 4, të nenit 2, pikën 3, të nenit 8, nenin 11, të Ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare”, i ndryshuar.

Sipas pikës 4, të nenit 2 “Agjent i taksave dhe tarifave” është personi i cili, sipas kërkesave të këtij ligji, është përgjegjës për llogaritjen, arkëtimin dhe transferimin në llogaritë e drejtorive rajonale tatimore, për t’u transferuar, më pas, në Buxhetin e Shtetit, të të ardhurave nga taksat dhe tarifatat kombëtare.

Referuar nenit 5, Sipas llojit të taksave kombëtare, agjentët që ngarkohen me vjeljen e tyre janë:

c) Për taksën vjetore të mjeteve të përdorura ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor. gj) për taksën e regjistrimit fillestar dhe taksën e përvitshme për automjetet luksoze ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.

Referuar nenit 11, përveç tarifave të shërbimit, të përcaktuara në aktet e tjera ligjore dhe nënligjore, quhen tarifa shërbimi edhe:

a) tarifa e pajisjes me leje drejtimi e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor;

Nivelet minimale të tarifave të shërbimit, të përcaktuara në paragrafin e parë të këtij neni, si dhe agjentët tatimorë e komisionet përkatëse të tyre përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Financave dhe të titullarëve të institucioneve përkatëse.

Në zbatim të pikës 2, të Udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 34, datë 29.12.2014 “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për pajisjen me lejedrejtimi”, i ndryshuar, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor caktohet agjent për mbledhjen e tarifës të pajisjes me leje drejtimi.

Në zbatim të pikës 3, të nenit 8 shprehet se komisionet e përfituara nga agjentët e taksave dhe tarifave përdoren:

a) në formën e shpërblimit mbi pagën, për vështirësi në punë, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi;

b) në formën e pagës, për rastet kur merren punonjës të rinj, për përballimin e vjeljes së taksave;

c) për mekanizimin, informatizimin, përmirësimin e kushteve të punës, si dhe për përballimin e shpenzimeve për vjeljen e taksave.

Nisur nga sa trajtuam më lartë është e qartë se agjenti i taksave dhe tarifave është Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, pra përgjegjës për llogaritjen, arkëtimin dhe transferimin në llogaritë e drejtorive rajonale tatimore, njësitë e qeverisjes vendore dhe përqindjen e agentit janë të gjithë punonjësit dhe strukturat e DPSHTRR duke filluar nga punonjësit në Drejtorinë e Përgjithshme, punonjësit në drejtoritë rajonale e deri në zyrat e shërbimeve, sepse:

Për procedurën e arkëtimin të taksave dhe tarifave, marrjen e masave shtërnguese për arkëtimin në afat të tyre janë të angazhuar të gjitha strukturat, kjo për faktin se:

1-Degët e regjistrimit të mjeteve nuk kryejnë asnjë veprim me mjetin pa arkëtuar taksat njofton qytetarin për rastet kur ka në pronësi mjete që nuk kanë likuiduar taksat;

2-Punonjësit me detyrë jurist/specialist i ndryshimit të pronësisë që është pjesë e Degës së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse nuk hartojnë kontratën e ndryshimit të pronësisë për mjetet që nuk kanë arkëtuar taksat e mjeteve, njëkohësisht njofton qytetarin/subjektin për mjetet debitore për pagesën e taksave.

3-Punonjësit në Degën e Drejtuesve të Mjeteve nuk kryejnë procedurat për marrjen e kategorive për leje drejtimi pa paguar tarifën e kategorisë së lejedrejtimin si dhe njofton qytetarin për rastet kur ka në pronësi mjete që nuk kanë likuiduar taksat;

4-Specialistët e Kontrollit Teknik nuk kryejnë kontrollin teknik të mjetit pa paguar taksat;

5-Punonjësit me detyrë specialist i arkëtimit të taksave dhe tarifave, Punonjësit në Degën e Financës dhe në Drejtorinë Ekonomike bëjnë kontrollin, rakordimin dhe transferimin e shumave të arkëtuara për drejtorinë rajonale tatimore, njësitë e qeverisjes vendore dhe pjesën e agentit. Hartojnë procedura në funksion të arkëtimin të taksave dhe tarifave.

6-Njësia e Promovimit të Shërbimeve dhe Sensibilizimit, Njësia e Koordinimit të Shërbimeve dhe Projekteve Digitale, Njësia e Marrëdhënieve me Publikun bëjnë njoftimet, e sensibilizimin për pagesën e taksave nëpërmjet faqes së Eëb, rrjeteve sociale, etj të DPSHTRR-së;

7-Punonjësit në Drejtorinë e Licensimit dhe Çertifikimit nuk kryejnë procedurat për marrjen e lejeve dhe certifikatave pa paguar takasat, si dhe njofton qytetarin për rastet kur ka në pronësi mjete që nuk kanë likuiduar taksat;

8-Drejtorja e Regjistrimit të Mjeteve, Drejtoria e Kontrollit Teknik të Mjeteve dhe Mbikëqyrjes së Q.K.T-ve, Drejtoria e Drejtuesve të Mjeteve, Drejtoria Juridike Drejtoria Ekonomike hartojnë procedurat, miratojnë rregullore, bëjnë

interpretime në lidhje me llogaritjen dhe arkëtimin e taksave dhe tarifave.

9-Njësia e Investimeve dhe Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Trajnimeve dhe Protokoll-Arkivit, Drejtoria e Administrimit dhe Monitorimit dhe Drejtoria e Prokurimeve janë të lidhura me mekanizimin, informatizimin, përmirësimin e kushteve të punës, si dhe për përballimin e shpenzimeve për vjeljen e taksave.

10-Llogaritja dhe arkëtimi i taksave dhe tarifave, ndarja e tyre bëhet nga sistemi informatik e DPSHTRR dhe eDM. Hartimi i termave të referencës për të gjitha ndryshimet dhe zhvillimet bëhen nga strukturat e ngritura nga Drejtori i Përgjithshëm, miratimi i fondeve kalon nga strukturat përkatëse në DP, nga Grupin e Menaxhimit Strategjik dhe Këshilli Drejtues.

11-Pagesës për vështirësi në punë nga arkëtimi i taksave, por jo më shumë se 2.4 paga për punonjësit dhe anëtarët e Këshillit Drejtues, është e miratuar në Programin Ekonomiko Financiar të çdo viti në zërin “pagësa për vështirësi në punë nga arkëtimi i taksave (llog.648)”. Pas miratimit të Programit Ekonomiko-Financiar nga Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas përcaktimit të bërë nga MIE shpërndarja e pagesës për vështirësi në punë nga arkëtimi i taksave sipas përqindjes së realizimit dhe në raport me kohën e punës bëhet me Vendim të Këshillit Drejtues.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit të KLSH –së:

Gjatë analizimit të observacionit sjellë nga subjekti nën auditim, grupi i auditimit merr në konsideratë pjesërisht observacionin duke reflektuar këto të dhëna përgjatë materialit të mësipërm.

Për këto arsye, sa më sipër, observacioni juaj merret në konsideratë.

II.2.3. “Mbi zbatimin e strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi”

Në lidhje me zbatimin e strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- *Rregullorja e brendshme dhe urdhrat për organizimin dhe funksionimin ;*
- *Statuti i Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor;*
- *Urdhrat e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë për miratimin e strukturës dhe organikës për periudhën objekt auditimit;*
- *Struktura Organizative e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor dhe Drejtorive Rajonale dhe numri i punonjësve;*
- *Planet e nevojave për rekrutim,*
- *Databaza e vendimeve gjyqësore për punonjësit e larguar nga puna.*

Mbi zbatimin e Strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

DPSHTRR kryen aktivitetin e saj në bazë Rregullore së Brendshme dhe Statutit.

Rregullorja e Personelit është miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 27, datë 23.11.2012, e cila nuk është azhurnuar me ndryshimet në Statut dhe strukturë, e cila nuk i përgjigjet stadi të zhvillimit të drejtorisë.

Me urdhrin e Drejtorit nr.778, datë 19.06.2018 është hartuar dhe miratuar “Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të transportit rrugor” por nuk është e miratuar nga Këshilli Drejtues, në kundërshtim me germa “m” neni 10 “Kompetencat e Këshillit Drejtues”.

Me shkresën nr.4055, datë 17.02.2022, të Drejtorit të Përgjithshëm “Mbi miratimin e përkrahimit të punës sipas strukturës së miratuar me urdhrin nr.34, datë 16.02.2022” janë shtuar përkrahimet e punës për pozicionet e reja drejtori, sektorë, etj.

Rregullorja e Brendshme vijon të jetë e miratuar vetëm nga Drejtori dhe jo nga Këshilli Drejtues, në kundërshtim me shkronjën m), të nenit 10, të Statutit të të DPSHTRR, të ndryshuar.

Statuti i Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, ka ndryshuar referuar shkresës nr. 14825, datë 07.06.2022, drejtuar Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë me lëndë “Për miratimin e disa ndryshimeve në statutin e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor” dhe miratuar ndryshimet e kërkuara nga Drejtori i Përgjithshëm me shkresën nr.4572, datë 21.12.2022, ose miratuar 6 muaj me vonë.

Nga audimi i kryer u konstatua se edhe pse në DPSHTRR ka pasur ndryshime të vazhdueshme të “Rregullores së brendshme” apo edhe të “Strukturës së DPSHTRR” si dhe në “Statutin e DPSHTRR” vihet re se “Rregullorja e Personelit të DPSHTRR-së” nuk është përditësuar.

Rregullorja e personelit (përshkrimet e punës) nuk është miratuar në Këshillin Drejtues.

3.Titulli i Gjetjes:	Mangësi në hartimin e rregullores së personelit dhe Statutin e DPSHTRR
Situata:	<p>DPSHTRR kryen aktivitetin e saj në bazë Rregullores së Brendshme dhe Statutit.</p> <p>Rregullorja e Personelit është miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 27, datë 23.11.2012, e cila nuk është azhurnuar me ndryshimet në Statut dhe strukturë dhe nuk i përgjigjet stadi të zhvillimit të drejtorisë. Me urdhrin e Drejtorit nr.778, datë 19.06.2018 është hartuar dhe miratuar “Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të transportit rrugor” por nuk është e miratuar nga Këshilli Drejtues. Rregullorja e Brendshme vijon të jetë e miratuar vetëm nga Drejtori dhe jo nga Këshilli Drejtues.</p> <p>Statuti i Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, ka ndryshuar referuar shkresës nr. 14825, datë 07.06.2022, drejtuar Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë me lëndë “Për miratimin e disa ndryshimeve në statutin e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor” dhe miratuar ndryshimet e kërkuara nga Drejtori i Përgjithshëm me shkresën nr.4572, datë 21.12.2022, ose miratuar 6 muaj me vonë.</p> <p>Edhe pse në DPSHTRR ka pasur ndryshime të vazhdueshme të “Rregullores së brendshme” apo edhe të “Strukturës së DPSHTRR” si dhe në “Statutin e DPSHTRR” vihet re se “Rregullorja e Personelit të DPSHTRR-së” nuk është përditësuar dhe (përshkrimet e punës) nuk janë miratuar në Këshillin Drejtues.</p>
Kriteri:	Pika “m”, neni 10 “Kompetencat e Këshillit Drejtues” i Statutit, i ndryshuar.
Ndikimi/Efekti:	Rregullorja nuk i përgjigjet stadi të zhvillimit të DPSHTRR
Shkaku:	Nuk është zbatuar legjislacioni
Rëndësia:	E mesme
Rekomandim:	Drejtorja e Burimeve Njerëzore në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrë masa për përmirësimet në Rregulloren e Personelit duke reflektuar ndryshimet e vazhdueshme të Rregullores së Brendshme dhe Statutit të DPSHTRR, si edhe miratimin e saj nga strukturat drejtuese duke respektuar afatet kohore, me qëllim funksionimin e institucionit sipas kërkesave të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme dhe Statut të Institucionit.

Mbi zbatimin e strukturës organizative

Nga auditimi në lidhje me zbatimin e Strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi për periudhën 01.07.2021 deri më 31.12.2022, u konstatua se struktura dhe pagat e punonjësve të Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, kanë pësuar ndryshime, si më poshtë:

- **Me urdhrin nr. 107, datë 22.02.2021** të Ministrit Infrastrukturës dhe Energjisë “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Përgjithshme dhe Drejtorive Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor”, numri total i punonjësve ishte **831** dhe bëhet **991 punonjës**.

Në këtë urdhër është përcaktuar një shtesë deri në 5% e numrit total të punonjësve për punonjës provizorë.

- **Me urdhrin nr. 34, datë 16.02.2022** të Ministrit Infrastrukturës dhe Energjisë “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së DPSHTRR, si dhe miratimin e strukturës së pagave”, numri total i punonjësve ishte **991** dhe bëhet **1042 punonjës**, si edhe një shtesë prej **40 punonjës për Shërbim Task Forcë**, të cilët trajtohen me pagë nga DPSHTRR. Në këtë urdhër është përcaktuar një shtesë deri në 2% e numrit total të punonjësve për punonjës provizorë.

Struktura e DPSHTRR (Administrata) përbëhet nga:

	Emërtimi	Nr Punonjës
1	Kabineti	12
	1 Drejtor i Përgjithshëm	1
	2 Zv/Drejtorë	2
	1 kordinator	1
	1 Drejtor kabineti	1
	6 Këshilltarë	6
	1 Asistent	1
2	5 Njësi	60
	Njësia e Promovimit të Shërbimeve dhe Sensibilizimit, 9 persona - 2 Sektorë	9
	Njësia e Marrëdhënieve me Publikun, 7 persona - 2 Sektorë	7
	Njësia e Kordinimit të Shërbimeve Dixhitale, 9 persona - 2 Sektorë	9
	Njësia e Shërbimeve Mbështetëse dhe Investimeve, 30 persona - 4 Sektorë	30
	Njësia e Personalizimit, 5 persona	5
3	10 Drejtori	142
	Drejtoria Juridike, 9 persona - 2 Sektorë	9
	Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve, 17 persona - 3 Sektorë + 1 Zyrë	17
	Drejtoria e Auditimit, 7 persona	7
	Drejtoria e Regjistrimit të Mjeteve, 28 persona - 5 Sektorë	28
	Drejtoria e Drejtuesve të Mjeteve, 21 persona - 5 Sektorë	21
	Drejtoria Ekonomike, 18 persona - 3 Sektorë	18
	Drejtoria e Prokurimeve, 10 persona - 2 Sektorë	10
	Drejtoria e Administrimit dhe Monitorimit, 12 persona - 3 Sektorë	12
	Drejtoria e Licencimit dhe Certifikimit, 11 persona - 2 Sektorë	11
	Drejtoria e Kontrollit Teknik të Mjeteve, 9 persona - 2 Sektorë	9
	Totali	214

Referuar sa më lart rezulton se Struktura e DPSHTRR (Administrata) përbëhet nga Kabineti me 12 persona, 5 Njësi me 10 Sektorë dhe 60 persona si edhe 10 Drejtori me 27 Sektorë dhe 142 persona. Pra, struktura është e organizuar në 1 Kabinet, 5 Njësi, 10 Drejtori dhe 37 Sektorë me numër punonjësish 214 persona.

Për miratimin e strukturës dhe pagave është nxjerrë Urdhri Drejtorit të Përgjithshëm nr. 41, datë 14.01.2022 “Për miratimin paraprak të strukturës, organigramës, klasave dhe pagave baze përkatëse të Drejtorisë së Përgjithshme, Drejtorive Rajonale dhe DTSH-së”, si edhe relacioni hartuar nga Grupi Punës (Grupi Menaxhimit) për Këshillin Drejtues “Për miratimin e strukturës, organigramës dhe klasave përkatëse të pagave të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të

Transportit Rrugor, Drejtorive Rajonale dhe DTSH-së” me shkresë nr. 1043/1 Prot, datë 18.01.2022, miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues nr.2, datë 28.01.2022.

Miratimi nga ministri përgjegjës me nr. 7740/1, datë 26.10.2022, protokolluar ne DPSHTRR me nr.22641/3, date 27.10.2023 dhe Urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm nr. 1393, date 03.10.2022 “Për pagat e punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme, Drejtorive Rajonale dhe DTSH-së”, si edhe Relacioni hartuar nga Grupi Punës (Grupi Menaxhimit) për Këshillin Drejtues për pagat e punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme dhe Drejtorive Rajonale me shkresën nr. 22641/1, datë 06.10.2022, miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues nr.40, datë 10.10.2022.

Rritja e pagave është bazuar në analizën e hollësishme të treguesve financiar dhe të dhënave statistikore mbi ecurinë e shërbimeve dhe të të ardhurave, mbi numrin e shërbimeve të ofruara sipas viteve me trend në rritje të konsiderueshme, si edhe në VKM nr. 621, datë 28.09.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr.187, datë 08.03.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione të administratës publike”, të ndryshuar”, referuar burimeve zyrtare të INSTAT dhe Bankës së Shqipërisë, konkretisht ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të konsumit në muajin Gusht 2022 është 8.0 %, kur një vit më parë ky ndryshim ishte 2.4 %, apo ndryshimi mujor i indeksit të çmimeve të konsumit në muajin Gusht 2022, krahasuar me Korrik 2022 është 0.8 %, është konsideruar si nevojë indeksimi i pagave.

Rekrutimi i punonjësve është kryer sipas procedurave të përcaktuara që nga njoftimet, aplikimet, paraqitja e dokumentacionit dhe vlerësimi nga komisioni i ngritur për këtë qëllim. Megjithëse është rritur numri i shërbimeve, konstatohet rritje e numrit të punonjësve si në përbërje të Kabinetit ashtu edhe në Njësi, Drejtori dhe Sektorë.

Respektimi i dispozitave ligjore për pagat e punonjësve.

DPSHTRR, funksionon referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 343 datë 21.07.1999 “Për krijimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor” dhe ligjit nr. 7582, datë 13.07.1992 “Për Ndërmarrjet Shtetërore”, i ndryshuar.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për përcaktimin e pagës së Drejtorit të Përgjithshëm të DPSHTRR-së, i është referuar Kategorisë II-a, të lidhjes nr. 6/7 ose 6/8 të VKM-së nr.187, datë 08.03.2017, i ndryshuar. Pagat e punonjësve janë miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues nr.2, datë 28.01.2022 “Për përcaktimin e pagave të punonjësve të D.P.SH.T.RR-së”, i ndryshuar.

Gjithashtu në zbatim të Nenit 70, të ligjit nr. 7691, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, të VKM-së nr. 68, datë 07.02.2018, “Për kufijtë dhe kriteret e përcaktimit të shpërblimit që i përgjigjet pagës së përfutur në natyrë dhe që i shtohet pagës për pushimet vjetore”, është miratuar Vendimi i Këshillit Drejtues nr. 2/1, datë 19.11.2018 “Për dhënien e shpërblimit në formën e pagës në natyrë të punonjësve”, si edhe në zbatim të Urdhrave të Drejtorit të Përgjithshëm “Për Ngritjen e Grupit të Punës për Përcaktimin e Strukturës së Pagave të DPSHTRR-së”, dhe vendimeve të marra nga Këshilli Drejtues.

Për caktimin e pagave referuar strukturës së miratuar është përgatitur relacioni përkatës nga grupi menaxhimit, tabelat e strukturës së pagave, klasat e pagave, niveli arsimor dhe profesioni. Për periudhën objekt auditimi, realizimi i fondit të pagave, sigurimeve shoqërore dhe realizimi i numrit të punonjësve, për punonjësit e DPSHTRR, paraqitet si më poshtë:

Nr	Artikulli	Viti 2021			Viti 2022		
		Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%
1.	Paga gjithsej	1,332,195	1,102,065	83	1,364,960	1,361,282	100
2.	Sig. shoqërore	222,481	178,625	80	227,954	219,340	96
3.	Paga DP	330,280	281,451	85	360,945	360,760	100
4.	Sig shoq. DP	55,156	42,625	77	60,554	53,695	89
5.	Paga rajonale	962,215	783,312	81	964,215	961,101	99
6.	Sig shoq. Rajon	160,495	129,776	81	160,551	159,065	99
7.	Paga Task forca	39,700	37,302	94	39,800	39,421	99
8.	Sig.shoq task.f	6,630	6,224	94	6,850	6,580	96

Referuar tabelës në lidhje me realizimin e fondit të pagave për vitin 2021 realizimi paraqitet në masën 83%, ku ka dhënë ndikim parashikimi për rritje pagash në masën 10%, e cila nuk është realizuar në vitin 2021.

Nr	Emërtimi	Viti 2021		Viti 2022	
		Plan	Fakt	Plan	Fakt
1.	Punonjës gjithsej	1031	1047	1082	1094
2.	Punonjës në organikë D P	183	189	213	216
3.	Punonjës Taske Forca	40	38	40	40
4.	Drejtoritë Rajonale	781	792	801	810
5.	Drejtoria e targave	27	28	28	28
2.	Paga mesatare	107,678	87,716	105,126	103,693
3.	Fondi i pagave	1,332,195	1,102,065	1,364,960	1,361,282

Referuar tabelës në lidhje me realizimin e numrit të punonjësve, konstatohet se *për vitin 2021* janë +16 punonjës, nga të cilët +6 punonjës në DP, +11 punonjës në drejtoritë rajonale dhe +1 punonjës në drejtorinë e targave, si edhe strukturë e pa plotësuar me -2 punonjës Task Forca.

Për vitin 2022 janë +12 punonjës, nga të cilët +3 punonjës DP, +9 punonjës drejtoritë rajonale. Realizimi i numrit të punonjësve paraqitet në përputhje me urdhrat për miratimin e strukturës referuar +5% për vitin 2021 dhe +2% për vitin 2022.

Për periudhën objekt auditimi, janë kryer lëvizje të personelit si rekrutime të reja ashtu edhe largime.

Viti	Punësime	Largime	Procese Gjyqësore
01.07-31.12.2021	56	35	1
01.01-31.12.2022	100	55	1

Rekrutimet janë kryer sipas procedurës e cila fillon me shpalljen e pozicioneve të lira në faqen e ëeb-it të Drejtorisë, paraqitjen e kërkesës dhe dokumentacionin e nevojshëm për konkurrim si edhe dokumentacioni i mbajtur nga grupi i punës për vlerësimin e dokumentacionit dhe kriterëve të punësimit deri në shpalljen e fituesit.

Largimet nga puna, referuar dokumentacionit në dispozicion, janë kryer kryesisht me dëshirën e punonjësve.

Shpërndarja e fondit për shpërblimin suplementar të punonjësve, në zbatim të gurmës c, të nenit 19, të Statutit të DPSHTRR-së, pas mbylljes dhe miratimit të pasqyrave financiare nga eksperti i miratuar dhe Këshilli Drejtues i rezervës për shpërblimin suplementar të punonjësve në masën 15% të fitimit vjetor neto, shpërndarja është kryer bazuar në urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm “Për shpërndarjen e fondit për shpërblimin suplementar të punonjësve nga fitimi neto i vitit” me miratim nga Këshilli Drejtues dhe Ministri.

Nga auditimi gjithashtu rezultoi se për shpërndarjen e pagesës për vështirësi në punë si dhe për shpërblimin suplementar është zbatuar ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimi Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

Janë audituar me zgjedhje listë pagesat e punonjësve për periudhën tetor - dhjetor 2021, Janar-qershor 2022, nga ku rezulton se llogaritja e pagave dhe kontributeve për sigurime shoqërore dhe shëndetësore është kryer referuar legjislacionit në fuqi dhe vendimeve të drejtorisë dhe Këshillit Drejtues për caktimin e pagave. Listë pagesat janë hartuar me të gjitha ekstremitetet bazuar edhe në listë prezencat mujore të hartuara nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore. Në lidhje me masën e shpërblimit që përfitojnë punonjësit janë respektuar procedurat e miratuara nga KD, ku përfitimi është në masën e 2 pagave në vit, 1 pagë për performancën në punë dhe 1 pagë nga rezultati ekonomik.

4.Titulli i Gjetjes:	Strukturë organizative e mbingarkuar
Situata:	Nga auditimi në lidhje me zbatimin e Strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi për periudhën 01.07.2021 deri më 31.12.2022, u konstatua se struktura dhe pagat e punonjësve të DPSHTRR, kanë pësuar ndryshime referuar urdhrave të Ministrit Infrastrukturës dhe Energjisë. Rekrutimi i punonjësve është kryer sipas procedurave të përcaktuara që nga njoftimet, aplikimet, paraqitja e dokumentacionit dhe vlerësimi nga komisioni i ngritur për këtë qëllim. Megjithëse është rritur numri i shërbimeve, konstatohet rritje e numrit të punonjësve si në përbërje të Kabinetit ashtu edhe në Njësi, Drejtori dhe Sektorë. Struktura e DPSHTRR (Administrata) përbëhet nga Kabineti me 12 persona, 5 Njësi me 10 Sektorë dhe 60 persona si edhe 10 Drejtori me 27 Sektorë dhe 142 persona. Pra, struktura është e organizuar në 1 Kabinet, 5 Njësi, 10 Drejtori dhe 37 Sektorë me numër punonjësish 214 persona.
Kriteri:	Shfrytëzimi me efektivitet i kohës së punës
Ndikimi/Efekti:	Rritje e kostove të personelit
Shkaku:	Rekrutime mbi nevojat
Rëndësia:	E mesme
Rekomandim:	Strukturat drejtuese të DPSHTRR dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore, të analizojnë dhe vlerësojnë nevojat për numrin e punonjësve referuar strukturës organike të DPSHTRR, me qëllim uljen e numrit të punonjësve dhe shfrytëzimin me efektivitet të kohës së punës në çdo Njësi, Drejtori dhe Sektorë, pa çënuar cilësinë e shërbimeve.

Mbi plotësimin e Strukturës sipas nivelit arsimor

Në mbështetje të nenit 21, të Ligjit Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, “Forma e Kontratës së punës”, nenit 8 të vendimit nr. 27 datë 23.11.2012, të Këshillit Drejtues, Rregullores së Personelit të DPSHTRR dhe strukturën e miratuar për rekrutimin e punonjësve, nga verifikimi i administrimit të dosjeve të punonjësve të DPSHTRR-së, Drejtorive Rajonale dhe DTSH-së u konstatua se në Drejtorinë e Auditit të Brendshëm nga 7 punonjës, 4 prej tyre kanë kryer detyrën pa u pajisur me certifikatën e auditit të brendshëm, veprim në kundërshtim me ligjin nr.114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, si më poshtë:

- *B.H., me detyrë përgjegjës i grupit të auditimit, ka filluar punë në datën 04.12.2020 dhe nuk është i pajisur me Certifikatën e audituesit, si edhe nuk ka eksperiencë pune 5vjet në profesion,*

por vetëm 3 vjet, në kundërshtim me ligjin nr.114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik neni 11 “Punësimi i audituesit të brendshëm” germa “c” dhe “ç” .

- *B.F., me detyrë auditues*, ka filluar punë në datën 07.12.2020 dhe nuk është i pajisur me Certifikatën e audituesit në kundërshtim me ligjin nr.114/2015 “ Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik neni 11 “ Punësimi i audituesit të brendshëm” germa “ç” .
- *H.K., me detyrë auditues*, ka filluar punë në datën 25.05.2021 dhe nuk është i pajisur me Certifikatën e audituesit në kundërshtim me ligjin nr.114/2015 “ Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik neni 11 “Punësimi i audituesit të brendshëm” germa “ç”.
- *E.T., me detyrë auditues* ka filluar punë në datën 24.03.2022 dhe nuk është i pajisur me Certifikatën e audituesit.
- Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr.114/2015 “ Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik neni 11 “Punësimi i audituesit të brendshëm” germa “ç”.

Mangësi në emërimin e punonjësve

- Emërimi në pozicionin K/Dege të Kontrollit Teknik në DPSHTRR Fier, i z. *A.M.*, konstatohet se nuk është plotësuar sipas strukturës së miratuar niveli arsimor pasi kërkohet ing mekanik dhe është diplomuar për ing materiale.
- Emërimi në pozicionin Përgjegjës Sektori i Homologimit, i z. *O.GJ.*, konstatohet se nuk është plotësuar sipas strukturës së miratuar niveli arsimor pasi kërkohet ing. mekanik dhe është diplomuar për ing.elektronik.
- Emërimi në pozicionin P/Sektori i projekteve dixhitale, i zj. *A.B.*, konstatohet se nuk është plotësuar sipas strukturës së miratuar niveli arsimor pasi kërkohet ing. Juridik, Shkenca Natyrore, Sociale Shoqërore, ekonomi, arte dhe është diplomuar për Anglisht.
- Emërimi në pozicionin P/Sektori Informacionit në marrëdhënie me publikun, i zj. *XH.H.* diplomuar për Infermieri (Bachelor). Specialisteve të këtij sektori ju kërkohet profesioni ndërsa p/sektorit lihet bosh niveli profesional.
- Emërimi në pozicionin Specialiste I në Sektorin e Trajnimeve dhe vlerësim Performance, i zj. *J.M.*, konstatohet se nuk është plotësuar sipas strukturës së miratuar niveli arsimor, pasi kërkohet jurist, ekonomist, inxhinieri, shkenca shoqërore dhe është diplomuar për Infermieri (Bachelor).

Mangësi në dokumentacionin e dosjeve të personelit.

Nga auditimi i ushtruar në 112 dosje personeli të DPSHTRR dhe Degëve Rajonale për plotësimin e dosjeve të personelit me dokumentacionin ligjor, konstatohet se:

17 dosje nuk janë të plotësuara me dokumente si certifikata, vërtetime nga prokuroria dhe gjykata, si edhe në 3 dosje mungojnë vlerësimet vjetore të punës. Po kështu u konstatua se dosjet e personelit nuk kanë rregullshmëri në pasqyrimin dhe renditjen sipas inventarit si edhe mënyrës së mbajtjes pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore.

5.Titulli i Gjetjes:	Mangësi në emërimin e punonjësve për nivelin arsimor dhe dokumentet në dosjet e personelit
Situata:	Nga auditimi në lidhje me emërimin e punonjësve në mbështetje të nenit 21, të Ligjit Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, “Forma e Kontratës së punës”, nenit 8 të vendimit nr. 27 datë 23.11.2012, të Këshillit Drejtues, Rregullores së Personelit të DPSHTRR dhe strukturën e miratuar për rekrutimin e punonjësve, nga verifikimi i administrimit të dosjeve të punonjësve të

	<p>DPSHTRR-së, Drejtorive Rajonale dhe DTSH-së u konstatua se në Drejtorinë e Auditit të Brendshëm nga 7 punonjës, 4 prej tyre kanë kryer detyrën pa u pajisur me certifikatën e auditit të brendshëm.</p> <p><i>Mangësi në emërimin e punonjësve</i> nga ku në 5 raste u konstatua mospërputhje në nivelin arsimor të punonjësve krahasuar me nivelin arsimor të kërkuar nga DPSHTRR.</p> <p><i>Mangësi në dokumentacionin e dosjeve të personelit</i> Nga auditimi i ushtruar në 112 dosje personeli të DPSHTRR dhe Degëve Rajonale për plotësimin e dosjeve të personelit me dokumentacionin ligjor, u konstatua se 17 dosje nuk janë të plotësuara me dokumente si certifikata, vërtetime nga prokuroria dhe gjykata, si edhe në 3 dosje mungojnë vlerësimet vjetore të punës. Po kështu u konstatua se dosjet e personelit nuk kanë rregullshmëri në pasqyrimin, renditjen sipas inventarit si edhe mënyrën e mbajtjes së dokumenteve pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore.</p>
Kriteri:	Ligji nr.114/2015 “ Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik neni 11 “Punësimi i audituesit të brendshëm” germa “ç”, Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
Ndikimi/Efekti:	Mangësi profesionale në kryerjen e detyrës
Shkaku:	Nuk është zbatuar legjislacioni
Rëndësia:	E mesme
Rekomandim:	Strukturat drejtuese të DPSHTRR dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore, të marrin masa për emërimin e punonjësve sipas nivelit arsimor dhe profesional referuar kërkesave të miratuara për çdo vend pune si edhe plotësimin dhe arkivimin e dosjeve me dokumentacionin ligjor-profesional me qëllim rritjen e nivelit profesional dhe realizimin e objektivave të institucionit.

Proceset Gjyqësore.

Për periudhën objekt auditimi u konstatua se janë ekzekutuar 18 vendime të formës së prerë për personat të cilët kanë qenë punonjës në DPSHTRR. Detyrimi i paguar për këto vendime të formës së prerë për periudhën objekt auditimi është **15,258,500 lekë**. Detyrimi i paguar, ndarë në vlerë detyrimi dhe tarifë përmbartimore, për gjithë periudhën objekt auditimi, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Viti	Përshkrimi	Pagesë për vendimin gjyqësor	Pagesë përmbartimore	TOTALI
2021	Pagesë për Vendimet gjyqësore	4,864,455	306,275	5,170,730
2022	Pagesë për Vendimet gjyqësore	9,521,656	566,114	10,087,770
	TOTALI	14,386,111	872,389	15,258,500

Burimi: Drejtoria Juridike dhe Financës

Gjithashtu, konstatohet se nga këto 18 vendime, 14 prej tyre janë ekzekutuar me zyrë përmbartimore, për të cilat është shpenzuar vlera **872,389 lekë**. Referuar periudhave në të cilat janë kryer ekzekutimet e vendimeve rezulton se 11 raste janë kryer nga z. A.I., 4 raste nga z. Y.S. dhe 3 raste nga z. B.G..

Janë edhe 3 vendime të tjera në fazën e Apelit, të cilat nuk kanë përfunduar.

Nëse ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë do të ishte kryer me ekzekutim vullnetar do të minimizoheshin kostot në buxhetin e DPSHTRR-së.

6.Titulli i Gjetjes:	Mangësi në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore
Situata:	Për periudhën objekt auditimi u konstatua se janë ekzekutuar 18 vendime të formës së prerë për personat të cilët kanë qenë punonjës në DPSHTRR dhe janë larguar nga puna. Detyrimi i paguar për këto vendime të formës së prerë për periudhën objekt auditimi është 15,258,500 lekë , konstatohet se nga këto 18 vendime, 14 prej tyre janë ekzekutuar me zyrë përmbarimore, për të cilat është shpenzuar vlera 872,389 lekë . Janë edhe 3 vendime të tjera në fazën e Apelit, të cilat nuk kanë përfunduar. Nëse ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë do të ishte kryer me ekzekutim vullnetar do të minimizoheshin kostot në buxhetin e DPSHTRR.
Kriteri:	Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar.
Ndikimi/Efekti:	Rritja e shpenzimeve të DPSHTRR
Shkaku:	Nuk është zbatuar legjislacioni
Rëndësia:	E mesme
Rekomandim:	Strukturat drejtuese të DPSHTRR, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria Juridike në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike, të marrin masa për likuidimin e menjëhershëm të detyrimeve që rrjedhin nga proceset gjyqësore përpara vendimeve të zyrave përmbarimore, me qëllim uljen e kostove të këtyre detyrimeve.

Përsa është trajtuar në këtë pjesë të P/Raportit të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacion me shkresë nr. 409/5 prot, datë 06.12.2023 “Kundërshtime për akt konstatimet e grupit të auditimit të KLSH”, nga ana e përfaqësuesve të institucionit, të cilat janë të paraqitura më poshtë, pa ndërhyrje dhe rregullime nga ana drejtshkrimore:

Pretendimet e subjektit:

Lidhur me gjetjen Nr. 3, “Mangësi në hartimin e rregullores së personelit dhe Statutin e DPSHTRR-së”, ju informojmë se për sa i përket ndryshimeve të strukturës në vijim, miratuar nga MIE me Urdhrin nr 107. datë 22.02.2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKD nr 6, datë 25.04.2019 ‘Për disa shtesa në strukturën e DPSHTRR dhe DRSHTTR-ve’”, DPSHTRR-së iu kalua një shërbim i ri mjaft i rëndësishëm, siç ishte ai i kryerjes së kontrollit teknik të mjeteve rrugore, deleguar me urdhër të MIE-së, nr. 349, datë 14.12.2020 “Për delegim kompetence”.

Duke qenë që ky ishte një shërbim i ri për DPSHTRR-në dhe në pritje të ndryshimeve ligjore në Kodin Rrugor që u bënë me udhëzimin e MIE nr. 6, datë 12.11.2021 “Mbi kontrollin teknik të mjeteve rrugore” publikuar në Fletoren Zyrtare me nr. 181, datë 23.11.2021, akte të cilat normojnë përgjithësisht proceset e punës në këtë shërbim, pati vonesa edhe në draftimin e azhurnimeve të rregullores së DPSHTRR-së. Gjithashtu duke qenë që këto akte ligjore, përfshirë këtu edhe zbardhjen e ndryshimeve të VKM-së 153/2000 “Për rregulloren e zbatimit të Kodit Rrugor” e cila u botua në fletoren zyrtare nr.197, datë 21.12.2021, me VKM nr. 778, datë 15.12.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM 153/2000”, normojnë shumë sektorë përbërës në strukturën e DPSHTRR përfshirë ato të regjistrimit të mjeteve, drejtuesve të mjeteve si dhe mjeteve retro kushtëzonte edhe mënyrën e konceptimit të përmbytjes së azhurnuar të Rregullores së DPSHTRR-së. Nisur nga zbardhja e akteve të mësipërme ligjore si dhe referuar konstatimit të bërë, nga ana e DPSHTRR-së, iu paraqit për miratim, Këshillit Drejtues në mbledhjen e datës 28.01.2022, draft rregullorja e përfunduar me gjithë proceset e punës sipas dispozitave ligjore dhe strukturës në fuqi. Duke qenë se ishin kërkuar ndryshime në strukturë, MIE me Urdhërin nr. 34, datë 16.02.2022, miratoi strukturën e re të DPSHTRR-së, aktualisht po punohet me azhurnimin dhe përshtatjen e rregullores sipas përcaktimeve të reja, në mënyrë që të vijohet me miratimin e rregullores përkatëse.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit të KLSH –së:

Sqarojmë se në lidhje me këtë pretendim nuk është paraqitur asnjë fakt ose dokument shkresor ligjor i cili të vërtetojë të kundërtën e sa është trajtuar në Raport.

Pretendimet e subjektit:

Lidhur me gjetjen Nr. 5, “Mangësi në emërimin e punonjësve për nivelin arsimor dhe dokumenteve në dosjet e personelit”, ju informojmë si më poshtë:

z. B.H., me detyrë “Përgjegjës Grupi/Specialist auditimi”, në Drejtorinë e Auditimit në DPSHTRR, figuron i regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Audituesve të Brendshëm, me numër Amze “2070”. Gjithashtu z. H., së bashku me eksperiencën e mëparshme, ka eksperiencë pune në profesion, mbi 5 vite, pasi pozicionet e punës si më poshtë, kanë patur kriterin arsimor të përcaktuar “Jurist”:

•“Përgjegjës Sektori”, në Sektorin e Investigimit të Burimeve Njerëzore, në Drejtorinë e Investigimit Administrativ, në DPSHTRR;

•“Specialist i Përcaktuar”, në Sektorin e Verifikimit të Specializuar, në Drejtorinë e Regjistrimit të Mjeteve”, në DPSHTRR;

z. B.F., me detyrë “Përgjegjës Grupi/Specialist auditimi”, në Drejtorinë e Auditimit në DPSHTRR, figuron i regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Audituesve të Brendshëm, me numër Amze “2071”.

z. E.T., me detyrë “Specialist auditimi”, në Drejtorinë e Auditimit në DPSHTRR, figuron i regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Audituesve të Brendshëm, me numër Amze “2087”.

z. H.K., me detyrë “Specialist auditimi”, në Drejtorinë e Auditimit në DPSHTRR, në datë 17.06.2024, i ndërpriten marrëdhëniet e punës pasi plotëson kushtet për pension pleqërie.

zj. A.B., me detyrë “Përgjegjës Sektori”, në Sektorin e Koordinimit të Shërbimeve, në Njësinë e Koordinimit të Shërbimeve dhe Projekteve Digitale, në DPSHTRR, ka kryer studimet e larta në Universitetin e Tiranës, në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, në degën “Gjuhë Angleze”. Kriteri Arsimor i miratuar për këtë pozicion përfshin fushat “Inxhinieri, Juridik, Ekonomik, Arte, Shkenca Sociale, Shkenca Natyrore dhe Shkenca Shoqërore”. Fakulteti i Gjuhëve të Huaja merret me aspektet njohëse dhe sociale të gjuhës dhe si e tillë është konsideruar si një fushë shkencore e aplikuar si dhe një disiplinë akademike brenda shkencave shoqërore.

zj. XH.H., me detyrë “Përgjegjës Sektori”, në Sektorin e Informacionit, në Njësinë e Marrëdhënieve me Publikun, në DPSHTRR ka kryer studimet Bachelor në Universitetin e Mjekësisë Tiranë, në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike, në degën “Infermieri e Përgjithshme” dhe studimet Master Shkencor në Universitetin e Mjekësisë Tiranë, në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike, në degën “Infermieri”. Kriteri Arsimor i miratuar për këtë pozicion nuk është i përcaktuar.

zj. J.M., me detyrë “Specialist i Parë”, në Sektorin e Trajnimeve dhe Vlerësimit të Performancës, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, Trajnimeve dhe Protokoll-Arkivit, në DPSHTRR, në zbatim të Urdhrit Nr. 1517, datë 17.11.2023, është transferuar në pozicionin e punës “Specialist”, në Sektorin e Monitorimit, në DAM, në DPSHTRR, pozicion ky në përputhje me kriterin arsimor dhe profesional.

Për sa i përket punonjësve z. A.M. dhe z. O.GJ., do të merren masat për emërimin e këtyre punonjësve sipas kriterit arsimor dhe profesional.

Për sa i përket 17 dosjeve të punonjësve, të evidentuara me mangësi në dokumentacion (si certifikata dhe vërtetime), ju informojmë se këto dosje janë plotësuar me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm.

Për sa i përket 3 dosjeve të punonjësve, në të cilat mungonin Formularët e Vlerësimit Vjetor, ju informojmë se këto Formularë janë administruar në dosjet përkatëse.

Gjithashtu ju informojmë se dokumentacioni pjesë përbërëse e dosjes së personelit, për të gjithë punonjësit është renditur sipas fletëinventarit.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit të KLSH –së:

Sqarojmë se ky argument nuk ka bazë ligjore dhe nuk merret në konsideratë. Në lidhje me përcaktimin e punonjësve referuar profesionit sipas vendit të punës sqarojmë se kjo i shërben përmirësimit dhe rritjes së performancës të çdo vendi pune.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit të KLSH –së:

Lidhur me mënyrën e mbajtjes së dosjeve të personelit, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, Trajnimeve dhe Protokoll-Arkivit, ju informojmë se kemi kryer kërkesa të vazhdueshme për blerjen e dosjeve për administrimin e dokumentacionit të depozituar nga punonjësit.

Pretendimet e subjektit:

Sqarojmë se ky argument nuk ka bazë ligjore dhe nuk merret në konsideratë.

II.2.4. “Hartimi, shqyrtimi dhe miratimi i programit ekonomik-financiar në organet drejtuese të ndërmarrjes dhe në institucionet eprore, si dhe realizimi i tij”

Në zbatim të Pikës 4 të Programit të Auditimit nr.409/1 Prot. datë 05.06.2023, i ndryshuar, “*Hartimi, shqyrtimi dhe miratimi i programit ekonomik-financiare në organet drejtuese të ndërmarrjes dhe në institucionet eprore, si dhe realizimi i tij*” u shqyrtua dokumentacioni i vënë në dispozicion nga ana e Drejtorisë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (këtu e tutje DPSHTRR):

VITI 2021

Në 12/mujorin e vitit 2021, të ardhurat nga shërbimet/praktikat e kryera në Drejtorinë Rajonale dhe DPSHTRR arritën vlerën 3,052,112 mijë lekë duke pasur një rritje në vlerën 816,670 mijë lekë me 37% më tepër krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020.

Shpenzimet e realizuara në 12/mujorin e vitit 2021, nga Drejtorinë Rajonale dhe DPSHTRR arritën vlerën 2,318,221 mijë lekë, duke u ulur me 13% krahasuar me Programin Ekonomik për të njëjtën periudhë të vitit 2020.

Të ardhurat e realizuara në 12/mujorin e vitit 2021 nga shërbimet/praktikat e kryera në Drejtorinë Rajonale dhe DPSHTRR arritën vlerën 3,052,112 mijë lekë, me 353,512 mijë lekë më shumë, krahasuar me Programin Ekonomik për të njëjtën periudhë të vitit 2020. Të ardhurat e realizuara gjatë kësaj periudhe janë në masën 3,052,112 mijë lekë, nga 2,698,600 mijë lekë të planifikuara në Programin Ekonomik për 12/mujorin e vitit 2021. Pra realizimi është në masën 113%, ose 353,512 mijë lekë më shumë. Gjithashtu krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020 ka një tejkalim me 37% ose 816,670 mijë lekë më tepër.

Në 12/mujorin 2021, Fitimi bruto nga aktiviteti i Drejtorive Rajonale dhe DPSHTRR arriti vlerën 733,891 mijë lekë, duke u rritur me 708,390 mijë lekë krahasuar me Programin Ekonomik për të njëjtën periudhë të vitit 2020.

Analiza e të ardhurave sipas aktiviteteve *Regjistrimi i Mjeteve, Licencim, Certifikim*

Nga aktiviteti i Regjistrimit të Mjeteve për periudhën 12/mujore të vitit 2021 janë realizuar 1,313,410 mijë lekë. Realizimi i planit është në masën 116% ose 183,726 mijë lekë më tepër kundrejt 1,129,684 mijë lekë të parashikuara në programin ekonomik të vitit 2021, gjithashtu në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2020 kemi tejkalim në masën 287,093 mijë lekë ose 28 % më shumë.

Lejet e Drejtimit

Nga aktiviteti i Lejeve të Drejtimit për periudhën 12/mujore të vitit 2021 janë realizuar 718,766 mijë lekë të ardhura, kundrejt 655,100 mijë lekë të parashikuara në Programin- Ekonomik të vitit 2021. Janë realizuar të ardhura në masën 110% ose 63,666 mijë lekë më tepër në krahasim me programin e vitit 2021, gjithashtu në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2020 kemi tejkalim të të ardhurave me 103,172 mijë lekë ose 17% më tepër.

Të ardhurat nga taksat

Të ardhurat nga taksat për periudhën 12/mujore të vitit 2021 janë realizuar 490,686 mijë lekë, nga 374,555 mijë lekë që janë parashikuar në Programin-Ekonomik të vitit 2021, ka një realizim në

masën 131%. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020 kemi tejkalim në vlerën 44,562 mijë lekë ose në masën 10% më tepër.

Të ardhurat nga taksat e tarifat të realizuara në krahasim me programin janë:

- Taksa vjetore e mjeteve të përdorura është realizuar 446,948 mijë lekë, nga 340,074 mijë lekë të parashikuara në programin ekonomik, pra është realizuar në masën 131%.
- Të ardhura nga regjistrimi i TVML-së (TRML-ja) dhe të ardhura nga TVML-ja është realizuar 27,160 mijë lekë nga 19,652 mijë lekë të parashikuara në programin ekonomik, pra kemi tejkalim në masën 38%.
- Tarifa e lejes së drejtimit është realizuar 16,578 mijë lekë nga 14,829 mijë lekë të parashikuara në programin ekonomik, pra është realizuar në masën 112%.

Të ardhurat nga kontrolli teknik

Të ardhurat nga kontrolli teknik për periudhën 12/mujore të vitit 2021 janë realizuar 419,393 mijë lekë, nga 457,500 mijë lekë që janë parashikuar në Programin-Ekonomik të vitit 2021, ka një realizim në masën 92%.

Të ardhurat “Të tjera”

Të ardhurat në zërin “Të tjera” për periudhën 12/mujore të vitit 2021 janë realizuar me 109,856 mijë lekë. Në krahasim me programin janë me tejkalim në vlerën 28,093 mijë lekë, pra është realizuar në masën 134 %.

Analiza e të ardhurave sipas Drejtorive Rajonale

- DRSHTRR Berat ka realizuar 128,934 mijë lekë të ardhura ose 122% të programit, me tejkalim prej 23,354 mijë lekë. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020 ka një tejkalim me 50% ose 43,243 mijë lekë më shumë.
- DRSHTRR Durrës ka realizuar 401,613 mijë lekë të ardhura ose 110% të programit dhe paraqet tejkalim të programit me 37,281 mijë ose 10% më shumë. Ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020 ka një tejkalim 40% ose 114,236 mijë lekë më tepër.
- DRSHTRR Elbasan ka realizuar 215,380 mijë lekë të ardhura ose 113% të programit me një tejkalim prej 27,731 mijë lekë. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020 ka një tejkalim 33% ose 53,783 mijë lekë më tepër.
- DRSHTRR Fier ka realizuar 290,449 mijë lekë të ardhura ose 111% të programit me një tejkalim prej 27,731 mijë lekë. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020 ka një tejkalim me 80,152 mijë lekë ose 38% më tepër.
- DRSHTRR Gjirokastrë ka realizuar 62,304 mijë lekë të ardhura ose 110% të programit me tejkalim prej 5,824 mijë lekë. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020 ka një tejkalim me 16,530 mijë lekë ose 36% më tepër.
- DRSHTRR Korçë ka realizuar 144,487 mijë lekë të ardhura ose 105% të programit me tejkalim prej 6,848 mijë lekë. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020 ka një tejkalim me 28% ose 31,626 mijë lekë.
- DRSHTRR Kukës ka realizuar 79,649 mijë lekë të ardhura ose 113% të programit me një tejkalim prej 9,356 mijë lekë. Gjithashtu krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020 ka një tejkalim me 38% ose 21,810 mijë lekë më tepër.
- DRSHTRR Laç ka realizuar 142,273 mijë lekë të ardhura ose 102% të programit me tejkalim prej 3,448 mijë lekë. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020 ka një tejkalim me 27% ose 30,352 mijë lekë.

- DRSHTRR Dibër ka realizuar 86,256 mijë lekë të ardhura, ose 106% të programit me një tejkallim prej 5,084 mijë lekë. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020 ka një tejkallim me 25% ose 17,524 mijë lekë më tepër.
- DRSHTRR Shkodër ka realizuar 230,534 mijë lekë të ardhura ose 125% të programit, me tejkallim prej 45,803 mijë lekë. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020 ka një tejkallim me 57% ose 83,525 mijë lekë më tepër.
- DRSHTRR Tiranë ka realizuar 1,023,232 mijë lekë të ardhura ose 114% të programit, me një tejkallim 123,329 mijë lekë. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020 ka një tejkallim me 262,818 mijë lekë ose 35% më tepër.
- DRSHTRR Vlorë ka realizuar 143,952 mijë lekë të ardhura ose 120% të programit me një tejkallim prej 23,829 mijë lekë. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020 ka një tejkallim prej 38% ose 39,693 mijë lekë më tepër.
- DRSHTRR Sarandë ka realizuar 61,419 mijë lekë të ardhura, ose 122% të programit me tejkallim prej 10,903 mijë lekë. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020 ka një tejkallim me 20,541 mijë lekë ose 50% të ardhura më shumë të realizuara.
- DPSHTRR ka realizuar 28,953 mijë lekë të ardhura, ose 80% të programit me një mosrealizim prej 7,258 mijë lekë. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020 ka një tejkallim me 4,615 mijë lekë ose 19% të ardhura më shumë të realizuara.

Shpenzimet për vitin 2021

Shpenzimet e realizuara për periudhën 12/mujore 2021 janë realizuar 2,318,221 mijë lekë, nga 2,673,100 mijë lekë të parashikuara në Programin Ekonomik të Vitit 2021. Janë shpenzuar rreth 354,879 mijë lekë më pak ose në nivelin 87% të programit. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020 kemi rritje të shpenzimeve në masën 23% ose 434,112 mijë lekë. Në përgjithësi të gjithë zërat e shpenzimeve të programuara për periudhën në fjalë janë me kursim me përjashtim të disa zërave të cilat kanë tejkallim si më poshtë:

- llog.601.1 “blerje materiale të tjera ” me vlerë 595 mijë lekë
- llog.605 “blerje mallra” me vlerë 3,830 mijë lekë
- llog.622/1 “shërbime printimi” me vlerë 2,886 mijë lekë
- llog.638 “të tjera tatime, taksa” me vlerë 570 mijë lekë
- llog.6811 “shpenzime amortizimi” me vlerë 71,674 mijë lekë
- llog.6812 “shpenzime jashtë përdorimit” me vlerë 12,148 mijë lekë
- dhe për zërat për të cilat nuk planifikohet ka arritur vlerën si më poshtë:
 - “Shpërblime për vjetërsi ne pune” në vlerën 768 mijë lekë.
 - “Shpenzimi në zërin “Gjoha dëmshpërblime” në vlerën 19,863 mijë lekë.

Drejtoritë të cilat kanë tejkallim në këto zëra po i paraqesim si më poshtë:

Shpenzime Pagat e Punonjësve	1,070,909 mijë lekë
Blerje Mallra me vlerë, DTSH	221,176 mijë lekë
Shpenzime Objekti	433,887 mijë lekë
Shpërblime vjetërsi pune, dëmshpërblime:	20,631 mijë lekë
Të tjera	571,617 mijë lekë

- **DRSHTRR Berat** - Planin e shpenzimeve e ka realizuar në masën 87%, paraqitet me tejkallim në zërin 605 “Blerje mallra me vlerë” në vlerën 1214 mijë lekë si rezultat i rritjes së çmimit të targave e cila dhe rritjes së numrit të shërbimeve në sektorin e regjistrimit të mjeteve, në zërin “Shpenzime PTT” në vlerën 7 mijë lekë për shkak të ndarjes së shpenzimeve të rrjetit , në zërin 622/1 “shërbime

printimi” për të cilin nuk kemi pas planifikim, shërbimi i printimit ka filluar tre mujorin e katërt dhe ka arritur vlerën 106 mijë lekë, në zërin 6811 “shpenzime amortizimi” në vlerën 640 mijë lekë për qendrat e kontrollit teknik të paprogramuara. Në zërin 657 “Gjoha dëmshpërblime” ka arritur vlerën 205 mijë lekë.

- *DRSHTRR Durrës* - Planin e shpenzimeve e ka realizuar në masën 86%, paraqitet me tejkallim në zërin 601.1 “Blerje materiale” në vlerën 443 mijë lekë dhe në zërin 605 “Blerje mallra me vlerë” në vlerën 550 mijë lekë, për arsye të rritjes së numrit të shërbimeve, në zërin 621 “ruajtje objekti” në vlerën 56 mijë lekë për shkak të ndryshimit të pagës, në zërin 622/1 “shërbime printimi” në vlerën 1,149 mijë lekë për shkak të rritjes së numrit të shërbimeve, në zërin 6811 “shpenzime amortizimi” në vlerën 3,237 mijë lekë për qendrat e kontrollit teknik të cilat nuk kanë qënë të programuara, në zërin 657 “Gjoha dëmshpërblime” ka arritur vlerën 4,953 mijë lekë shpenzime të paplanifikuara.
- *DRSHTRR Elbasan* - Planin e shpenzimeve e ka realizuar në masën 86%, paraqitet me tejkallim në zërin 605 “Blerje mallra me vlerë” në vlerën 877 mijë lekë për arsye të rritjes së numrit të shërbimeve, në zërin 622/1 “shërbime printimi” në vlerën 304 mijë lekë pasi ky shërbim nuk është parashikuar në projekt-programin e vitit 2021 dhe ka filluar në muajin shtator sipas kontratës me Infosoft. Këto shpenzime për vitin 2021 ishin parashikuar në zërin 601/23 “Blerje Kancelari” i cili është në mos realizim në vlerën 508 mijë lekë, në zërin 626 “Shpenzime PTT” në vlerën 20 mijë lekë përfshihet shërbimi postës dhe shërbimi internetit, këtu është shtuar edhe shërbimi internetit nga Vodafone i cili ka filluar në muajin Tetor 2021, në zërin “të tjera tatime taksa” në vlerën 14 mijë lekë janë paguar taksat në bashkinë e Gramshit për zyrën e shërbimeve në Gramsh të cilat nuk kanë qënë të planifikuara., në zërin “shpenzime amortizimi” në vlerën 3,644 mijë lekë pasi kur është bërë projekt- programi nuk kanë qënë bërë rivlerësimi i aseteve të ndërmarrjes si dhe kemi hyrjen e Aktiveve të Qendrës së kontrollit teknik të cilat kanë rritur vlerën aseteve, për rrjedhojë edhe amortizimi është me tejkallim, në zërin 657 “Gjoha dëmshpërblime” ka arritur vlerën 607 mijë lekë cili është shpenzim i paplanifikuar.
- *DRSHTRR Fier* - Planin e shpenzimeve e ka realizuar në masën 89%, paraqitet me tejkallim në zërin 601.1 “Blerje materiale (furnizime në DTSH)” në vlerën 1,177 mijë lekë dhe në zërin 601.2 “Blerje materiale (të tjera)” në vlerën 1,072 mijë lekë për arsye të rritjes së disa çmimeve të DTSH në zërin 604 “blerje energjie, ujë” në vlerën 61 mijë lekë për arsye të rritjes së energjisë, në zërin 621 “ruajtje objekti” në vlerën 1,633 mijë lekë pasi fatura e shërbimit të rojeve ka ardhur në janar të vitit 2021, në zërin 622/1 “shërbime printimi” në vlerën 487 mijë lekë i cili nuk ishte i parashikuar në projekt-programin e vitit 2021, në zërin 626 “Shpenzime PTT” në vlerën 264 mijë lekë pasi janë shtuar në shpenzime faturat për internetin në zyrat Fier, Mallakastër, Lushnjë, në zërin 638 “të tjera tatime, taksa” në vlerën 467 mijë lekë me shtimin e pagesë vjetore të taksave vendore për QKT Fier dhe Lushnjë, në zërin 6811 “shpenzime amortizimi” në vlerën 7,038 mijë lekë për arsye të investimit të ri të godinës së Lushnjës, gjithashtu ka arritur vlerën 233 mijë lekë nga humbjet e këmbimeve valutore.
- *DRSHTRR Gjirokastrë* - Planin e shpenzimeve e ka realizuar në masën 95%, paraqitet me tejkallim në zërin 604 “Blerje energji,ujë” në vlerën 88 mijë lekë për shkak të fillimit të aktivitetit të QKT në muajin maj 2021 dhe shtimit të faturave përkatëse të energjisë dhe ujit të cilat nuk ishin parashikuar në program, në zërin 611 “Shp.për uniforma të punonjësve të pranimit” në vlerën 111 mijë lekë ku futen shpenzimet për uniformat e punonjësve të pranimit, në zërin 622/1 “shërbime printimi” në vlerën 86 mijë lekë ka qënë shpenzim paparashikuar në programin ekonomik 2021, në zërin 638 “të tjera tatime, taksa” në vlerën 47 mijë lekë, në zërin 6811 “shpenzime amortizimi” në vlerën 2,867 mijë lekë nga rivlerësimet e aktiveve të QKT.

- *DRSHTRR Korçë* - Planin e shpenzimeve e ka realizuar në masën 90%. paraqitet me tejkalim në zërin 605 “Blerje mallra me vlerë” në vlerën 1,748 mijë lekë kjo nga rritja e numrit të veprimeve sidomos në sektorin e regjistrimit të mjeteve me risitë e reja të futura kohët e fundit e cila ka sjellë dhe rritjen e te ardhurave, në zërin 622/1 “shërbime printimi” në vlerën 161 mijë lekë i cili nuk ishte i parashikuar në projekt-programin e vitit 2021, në zërin 626 “Shpenzime PTT” në vlerën 24 mijë lekë me futjen e sistemit të fiskalizimit u futën në shpenzim dhe faturat e dhjetorit të cilat më parë deklaroheshin në muajin pasardhës, në zërin 6811 “shpenzime amortizimi” në vlerën 3,541 mijë lekë gjatë vitit 2021 u shtua dhe aktiviteti i Qendrës së kontrollit teknik transferuar nga SGS mbasi vlera e planifikuar në programin ekonomik është llogaritur me vlerat para rivlerësimit të aseteve që u bë në fund të vitit 2020.
- *DRSHTRR Kukës* - Planin e shpenzimeve e ka realizuar në masën 87%. në zërin 622/1 “shërbime printimi” në vlerën 90 mijë lekë, i cili nuk ishte i parashikuar në projekt- programin e vitit 2021, në zërin 6811 “shpenzime amortizimi” në vlerën 1,499 mijë lekë gjatë vitit 2021 si rezultat i investimeve dhe transferimeve të aktiveve të kryera gjatë vitit 2021 të cilat nuk kanë qenë të planifikuara.
- *DRSHTRR Laç* - Planin e shpenzimeve e ka realizuar në masën 99% dhe paraqitet me tejkalim në zërin 601.2 “Blerje materiale (të tjera)” në vlerën 119 mijë lekë për arsye të rritjes së numrit të shërbimeve në zërin 601.23 “Blerje kancelari” në vlerën 80 mijë lekë, në zërin 604 “blerje energji, ujë” në vlerën 274 mijë lekë, në zërin 638 “të tjera tatime, taksa” në zërin 601.23 “Shp. për uniforma të punonj. të pranimit” në vlerën 38 mijë lekë, në zërin “shpenzime amortizimi” në vlerën 2,642 mijë lekë pasi kur është bërë projekt- programi nuk kanë qenë bërë rivlerësimi i aseteve të ndërmarrjes si dhe kemi hyrjen e Aktiveve të Qendrës së kontrollit teknik të cilat kanë rritur vlerën aseteve, për rrjedhojë edhe amortizimi është me tejkalim.
- *DRSHTRR Dibër* - Planin e shpenzimeve e ka realizuar në masën 87% dhe paraqitet me tejkalim në zërin 601.1 “Blerje materiale (të tjera)” në vlerën 110 mijë lekë për arsye të rritjes së numrit të shërbimeve, në zërin 601.24 “karburant për mjete” në vlerën 86 mijë lekë, në zërin 628 “komisione bankare” në vlerën 71 mijë lekë, në zërin 608 “të tjera” në vlerën 124 mijë lekë për shkak te kontratës se DPSHTRR se me C. sh.a me drop -box te mjeteve monetare, në zërin 621 “ruajtje objekti” në vlerën 302 mijë lekë vjen për shkak te shtesës se rojeve për QKT dhe te ndryshimit te pagës minimale , në zërin “shpenzime amortizimi” në vlerën 347 mijë lekë pasi kur është bërë projekt- programi nuk kanë qenë bërë rivlerësimi i aseteve të ndërmarrjes si dhe kemi hyrjen e Aktiveve të Qendrës së kontrollit teknik të cilat kanë rritur vlerën aseteve për rrjedhojë edhe amortizimi është me tejkalim, në zërin 657 “Gjoha dëmshpërblime” ka arritur vlerën 150 mijë lekë cili është shpenzim i paplanifikuar i korrespondon urdhër sekuestro për faturën e Hyundai.
- *DRSHTRR Shkodër* - Planin e shpenzimeve e ka realizuar në masën 91%, paraqitet me tejkalim në zërin “Amortizime” në vlerën 2,675 mijë lekë për arsye të blerjes ose të ardhura nga DPSHTRR së pajisjeve kompjuterike dhe të zyrës për të cilat nuk është planifikuar amortizim.
- *DRSHTRR Tiranë* - Planin e shpenzimeve e ka realizuar në masën 84%, paraqitet me tejkalim në zërin në zërin “Blerje mallra me vlerë” në vlerën 3,316 mijë lekë për shkak të rritjes së numrit të shërbimeve dhe në zërin “Amortizime” në vlerën 8,602 mijë lekë për arsye të shtesës së aktiveve për vitin 2021 nga investimet në rikonstruksion, sistemim sheshi, mobilim i sallave dhe kontrollit teknik dhe pajisjeve kompjuterike për të cilat nuk është planifikuar amortizim.
- *DRSHTRR Vlorë* - Planin e shpenzimeve e ka realizuar në masën 91.3%, paraqitet me tejkalim në zërin në zërin “Blerje mallra me vlerë” në vlerën 973 mijë lekë për shkak të rritjes së numrit të shërbimeve, në zërin “Amortizime” në vlerën 3,169 mijë lekë për arsye të shtesës së aktiveve për vitin 2021 nga investimet: “Rikonstruksion, sistemim sheshi, pista e kandidatëve të testimit,

“Mobilim i sallave dhe kontrollit teknik” dhe pajisjeve kompjuterike për të cilat nuk është planifikuar amortizim, pasi DR Vlorë nuk kishte preventiv për vlerat e investimit, në zërin “Shërbime printimi” në vlerën 140 mijë lekë pasi nuk kanë qenë të planifikuara dhe në zërin “Shpenzime PTT” në vlerën 84 mijë lekë për arsye të rritjes së numrit të dosjeve të transferuara.

- *DRSHTRR Sarandë* - Planin e shpenzimeve e ka realizuar në masën 84%, paraqitet me tejkallim në zërin “Shërbime printimi” në vlerën 84 mijë lekë pasi nuk kanë qenë të planifikuara dhe në zërin “Amortizime” në vlerën 1,354 mijë lekë për arsye të shtesës së aktiveve për vitin 2021 nga investimet.
- *DPSHTRR* - Planin e shpenzimeve e ka realizuar në masën 85%, paraqitet me tejkallim në zërin 601/23 “blerje kancelari” në vlerën 1.525 mijë lekë, në zërin 616 “prime sigurimi” në vlerën 199 mijë lekë, në zërin 622/1 “shërbime printimi” ka arritur vlerën 2,294 mijë lekë në zërin 638 “shërbime printimi” ka arritur vlerën 781 mijë lekë dhe në zërin 6811 “shpenzime amortizimi” ka arritur vlerën 30,419 mijë lekë dhe në zërin “Gjoha dëmshpërblime” ka arritur vlerën 6,294 mijë lekë i cili është shpenzim i paplanifikuar.

Treguesit ekonomiko-financiarë për Drejtorinë e Targave dhe Shtypshkrimeve (DTSH) janë realizuar si më poshtë:

Të ardhurat e realizuara gjatë kësaj periudhe 12/mujore janë në masën 157,758 mijë lekë, nga 169,290 mijë lekë të planifikuara në Programin Ekonomik për 12/mujorin e vitit 2021. Realizimi i programit është në masën 93%, ose (11,533) mijë lekë më pak.

Shpenzimet e realizuara gjatë kësaj periudhe janë në masën 178,628 mijë lekë, nga 169,290 mijë lekë të planifikuara në Programin Ekonomik për 12/mujorin e vitit 2021. Realizimi i shpenzimeve për këtë periudhë, rezulton 106% ose 9,338 mijë lekë më shumë.

Të ardhura dhe shpenzime të tjera të cila janë specifike për periudhën 12/mujore 2021 u referohen Task Forcë-s:

Gjatë periudhës 12/mujore të vitit 2021 të ardhurat e Task Forcë-s janë 12,778 mijë lekë, ndërsa shpenzimet janë realizuar 61,654 mijë lekë nga 70,867 mijë lekë, ose në masën 87% të Programit ekonomik.

Fitimi bruto i realizuar për periudhën 12/mujore 2021 është 733,890 mijë lekë, nga 25,500 mijë lekë i parashikuar në Programin-Ekonomik të vitit 2021.

VITI 2022

Të ardhurat e realizuara gjatë kësaj periudhe janë në masën 3,375,764 mijë lekë, nga 3,680,000 mijë lekë të planifikuara në Programin Ekonomik për 12/mujorin e vitit 2022. Pra realizimi është në masën 92%, ose 304,237 mijë lekë më pak.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021 ka një tejkallim me 11% ose 323,652 mijë lekë më tepër.

Regjistrimi i mjeteve	1,221,134 mijë lekë
Licensimi+certifikimi	39,816 mijë lekë
Lejet e drejtimit	724,316 mijë lekë
Taksat	550,736 mijë lekë
Kontrolli teknik	749,484 mijë lekë
Të tjera	90,278 mijë lekë

Regjistrimi i Mjeteve

Nga aktiviteti i Regjistrimit të Mjeteve për periudhën 12/mujore të vitit 2022 janë realizuar 1,221,134 mijë lekë. Realizimi i planit është në masën 76% ose 392,026 mijë lekë më pak kundrejt 1,613,160 mijë lekë të parashikuara në programin ekonomik të vitit 2022.

Licencim, Certifikim

Nga aktiviteti i Licencimit, Certifikimit për periudhën 12/mujore të vitit 2022 janë realizuar 39,816 mijë lekë. Realizimi i planit është në masën 164% ose 15,496 mijë lekë më tepër kundrejt 24,320 mijë lekë të parashikuara në programin ekonomik të vitit 2022.

(Regjistrimi i Mjeteve + Licencim, Certifikim) të dyja sëbashku janë realizuar 1,260,950 mijë lekë, realizimi i planit është në masën 77% ose (376,530) mijë lekë më pak kundrejt 1,637,480 mijë lekë të parashikuara në programin ekonomik të vitit 2022, Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021 (Regjistrimi i Mjeteve Licencim, Certifikim) kemi mosrealizim në masën 52,460 mijë lekë ose 4 % më pak.

Lejet e Drejtimit

Nga aktiviteti i Lejeve të Drejtimit për periudhën 12/mujore të vitit 2022 janë realizuar 724,316 mijë lekë të ardhura, kundrejt 798,400 mijë lekë të parashikuara në Programin- Ekonomik të vitit 2022. Janë realizuar të ardhura në masën 91% ose 74,085 mijë lekë në krahasim me programin e vitit 2022, ndërsa në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2021 kemi tejkalim të të ardhurave me 5,550 mijë lekë ose 1% më tepër.

Të ardhurat nga taksat

Të ardhurat nga taksat për periudhën 12/mujore të vitit 2022 janë realizuar 550,736 mijë lekë, nga 394,467 mijë lekë që janë parashikuar në Programin-Ekonomik të vitit 2022, ka një realizim në masën 140%. Gjithashtu krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021 kemi tejkalim në vlerën 60,050 mijë lekë ose në masën 12% më tepër.

Të ardhurat nga taksat e tarifata të realizuara në krahasim me programin janë:

Taksa vjetore e mjeteve të përdorura është realizuar 503,743 mijë lekë, nga 355,846 mijë lekë të parashikuara në programin ekonomik, pra është realizuar në masën 142%. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021 kemi tejkalim në vlerën 56,795 mijë lekë ose në masën 13% më tepër.

- Të ardhura nga regjistrimi i TVML-së (TRML-ja) është realizuar 7,830 mijë lekë nga 8,850 mijë lekë të parashikuara në programin ekonomik, pra kemi realizim në masën 88%.
- Të ardhura nga TVML-ja është realizuar 21,710 mijë lekë nga 12,382 mijë lekë të parashikuara në programin ekonomik, pra kemi realizim në masën 175%.
- Tarifa e lejes së drejtimit është realizuar 17,453 mijë lekë nga 17,389 mijë lekë të parashikuara në programin ekonomik, pra është realizuar në masën 100.

Të ardhurat nga kontrolli teknik

Të ardhurat nga kontrolli teknik për periudhën 12/mujore të vitit 2022 janë realizuar 749,484 mijë lekë, nga 795,550 mijë lekë që janë parashikuar në Programin-Ekonomik të vitit 2022, ka një realizim në masën 94%.

Të ardhurat “Të tjera” Të ardhurat në zërin “Të tjera” për periudhën 12/mujore të vitit 2022 janë realizuar me 90,278 mijë lekë. Në krahasim me programin janë me tejkalim në vlerën 36,174 mijë lekë, pra është realizuar në masën 167%. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021 ka një realizim me 82% ose 19,578 mijë lekë më pak.

Analiza e të ardhurave sipas Drejtorive Rajonale

DRSHTRR Berat ka realizuar 124,488 mijë lekë të ardhura ose 79% të programit, me mosrealizim prej 33,895 mijë lekë. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021 ka një mosrealizim me 3% ose 4,446 mijë lekë më pak.

DRSHTRR Durrës ka realizuar 462,169 mijë lekë të ardhura ose 97% të programit dhe paraqet mosrealizim të programit prej 13,850 mijë lekë. Ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021 ka një tejkalim 15% ose 60,556 mijë lekë më tepër.

DRSHTRR Elbasan ka realizuar 251,148 mijë lekë të ardhura ose 99% të programit me një mosrealizim prej 1,979 mijë lekë lekë. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021 ka një tejkalim 17% ose 35,768 mijë lekë më tepër.

DRSHTRR Fier ka realizuar 315,756 mijë lekë të ardhura ose 90% të programit me një mosrealizim prej 35,688 mijë lekë. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021 ka një tejkalim me 25,307 mijë lekë ose 9% më tepër.

DRSHTRR Gjirokastrë ka realizuar 65,625 mijë lekë të ardhura ose 89% të programit me mosrealizim prej 8,146 mijë lekë. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021 ka një tejkalim me 3,321 mijë lekë ose 5% më tepër.

DRSHTRR Korçë ka realizuar 163,346 mijë lekë të ardhura ose 95% të programit me mosrealizim prej 9,229 mijë lekë. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021 ka një tejkalim me 13% ose 18,859 mijë lekë.

DRSHTRR Kukës ka realizuar 78,315 mijë lekë të ardhura ose 85% të programit me një mosrealizim prej 14,148 mijë lekë. Gjithashtu krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021 ka një mosrealizim me 2% ose 1,334 mijë lekë.

DRSHTRR Laç ka realizuar 166,088 mijë lekë të ardhura ose 105% të programit me tejkalim prej 7,378 mijë lekë. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021 ka një tejkalim me 17% ose 23,815 mijë lekë.

DRSHTRR Dibër ka realizuar 100,326 mijë lekë të ardhura, ose 106% të programit me një tejkalim prej 6,012 mijë lekë. Gjithashtu krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021 ka një tejkalim me 16% ose 14,070 mijë lekë më tepër.

DRSHTRR Shkodër ka realizuar 217,186 mijë lekë të ardhura ose 81% të programit, me mosrealizim prej 50,978 mijë lekë. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021 ka një mosrealizim me 6% ose 13,348 mijë lekë.

DRSHTRR Tiranë ka realizuar 1,141,183 mijë lekë të ardhura ose 90% të programit, me një mosrealizim 121,557 mijë lekë. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021 ka një tejkalim me 117,951 mijë lekë ose 12% më tepër.

DRSHTRR Vlorë ka realizuar 154,133 mijë lekë të ardhura ose 89% të programit me një mosrealizim prej 18,172 mijë lekë. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021 ka një tejkalim prej 7% ose 10,281 mijë lekë më tepër.

DRSHTRR Sarandë ka realizuar 58,351 mijë lekë të ardhura, ose 75% të programit me mosrealizim prej 19,239 mijë lekë. Gjithashtu krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021 ka një mosrealizim me 3,068 mijë lekë ose 5% më pak.

DPSHTRR ka realizuar 53,549 mijë lekë të ardhura, ose 78% të programit me një mosrealizim prej 14,851 mijë lekë. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021 ka një tejkalim me 24,596 mijë lekë ose 85% të ardhura më shumë të realizuara

Shpenzimet

Shpenzimet e realizuara për periudhën 12/mujore 2022 janë realizuar 2,798,215 mijë lekë, nga 3,052,500 mijë lekë të parashikuara në Programin Ekonomik të Vitit 2022. Janë shpenzuar rreth

254,285 mijë lekë më pak ose në nivelin 92% të programit. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021 kemi rritje të shpenzimeve në masën 21% ose 479,994 mijë lekë. Në përgjithësi të gjithë zërat e shpenzimeve të programuara për periudhën në fjalë janë me kursim me përjashtim të disa zërave të cilat kanë tejkalim si më poshtë:

- llog.601.1, “materiale” me vlerë 5,050 mijë lekë
- llog.601.23, “kancelari” me vlerë 1,463 mijë lekë
- llog.645 “Të përndjekurit politik” me vlerë 2,979 mijë lekë
- llog.6811 “shpenzime amortizimi” me vlerë 45,539 mijë lekë
- llog.6812 “shpenzime jashtë përdorimit” me vlerë 639 mijë lekë dhe për zërat për të cilat nuk planifikohet ka arritur vlerën si më poshtë:
 - “Shpërblime për vjetërsi ne pune” në vlerën 80 mijë lekë.
 - “Shpenzimi në zërin “Gjoha dëmshpërblime” në vlerën 9.708 mijë lekë.
 - “Shpenzimi në zërin “Humbje nga kursi” në vlerën 1,782 mijë lekë. Këto tre zëra të shpenzimeve të cilat nuk planifikohen zënë 0.41% të shpenzimeve.

Shpenzime Pagat e Punonjësve	1,325,742 mijë lekë
Blerje Mallra me vlerë, DTSH	294,100 mijë lekë
Shpenzime Objekti	257,716 mijë lekë
Shpërblime vjetërsi pune, dëmshpërblime:	9,788 mijë lekë
Të tjera	910,871 mijë lekë

DRSHTRR Berat - Planin e shpenzimeve e ka realizuar në masën 100%, paraqitet me tejkalim në zërin 605 “Blerje energji, ujë” në vlerën 543 mijë lekë si rezultat i akomodimit në godinën e re me një sipërfaqe më të madhe dhe me numër më të madh pajisjesh kondicionimi, në zërin 638 “te tjera tatime, taksa” në vlerën 174 mijë lekë, në zërin 6811 “shpenzime amortizimi” në vlerën 5,450 mijë lekë dhe në zërin 6812 “shpenzime jashtë përdorimit” ne vlerën 247 mijë lekë.

DRSHTRR Durrës - Planin e shpenzimeve e ka realizuar në masën 97%, paraqitet me tejkalim në zërin (601.1, 601.2, 601.3,) “materiale” në vlerën 959 mijë lekë dhe kjo për arsye të rritjes së numrit të veprimeve, në zërin 604 “energji, ujë” në vlerën 940 mijë lekë, në zërin 6811 “shpenzime amortizimi” në vlerën 4,440 mijë lekë për arsye të inventarit të marrë në dorëzim për arshivën e re, në zërin 648.1 “Shpërblime për vjetërsi ne pune” ka arritur vlerën 80 mijë lekë shpenzime të paplanifikuara.

DRSHTRR Elbasan - Planin e shpenzimeve e ka realizuar në masën 97%, paraqitet me tejkalim në zërin 601.1 “materiale nga DTSH” në vlerën 862 mijë lekë, në zërin 604 “energji, ujë” në vlerën 283 mijë lekë, në zërin 618 “Shërbime printimi” në vlerën 704 mijë lekë, në zërin “udhëtime dieta” në vlerën 190 mijë lekë, të cilat kanë ardhur si rezultat i shtimit të fluksit të punës dhe rritjes së kostove të një sërë artikujsh që vijnë nga DTSH -ja, në zërin 657 “Gjoha dëmshpërblime” ka arritur vlerën 1364 mijë lekë cili është shpenzim i paplanifikuar.

DRSHTRR Fier - Planin e shpenzimeve e ka realizuar në masën 94%, nuk ka tejkalim të zërave të shpenzimeve. Në zërin 657 “Gjoha dëmshpërblime” ka arritur vlerën 1,883 mijë lekë cili është shpenzim i paplanifikuar.

DRSHTRR Gjirokastrë - Planin e shpenzimeve e ka realizuar në masën 100%, paraqitet me tejkalim në zërin 601.1 “materiale” në vlerën 120 mijë lekë, në zërin 604 “Blerje energji,ujë” në vlerën 177 mijë, në zërin 605 “Blerje mallra me vlerë” në vlerën 114 mijë lekë, në zërin 626 “shpenzime PTT” në vlerën 9 mijë lekë, në zërin 6811 “shpenzime amortizimi” në vlerën 1,741 mijë lekë, dhe në zërin 6812 “shpenzime jashtë përdorimit” ne vlerën 364 mijë lekë ndërsa në zërin 657 “Gjoha dëmshpërblime” ka arritur vlerën 1,079 mijë lekë cili është shpenzim i paplanifikuar.

DRSHTRR Korçë - Planin e shpenzimeve e ka realizuar në masën 100%. paraqitet me tejkalim në zërin 605 “Blerje mallra me vlerë” në vlerën 108 mijë lekë, në zërin 6811 “shpenzime amortizimi” në vlerën 4,330 mijë lekë, në zërin 6811 “shpenzime jashtë përdorimit” në vlerën 2,336 mijë lekë
DRSHTRR Kukës Planin e shpenzimeve e ka realizuar në masën 95%, paraqitet me tejkalim në zërin 6811 “shpenzime amortizimi” në vlerën 1,707 mijë lekë.

DRSHTRR Laç - Planin e shpenzimeve e ka realizuar në masën 112% dhe paraqitet me tejkalim në zërin 601.1 “Blerje materiale” në vlerën 20 mijë lekë, në zërin 604 “blerje energji, ujë” në vlerën 918 mijë lekë ku konsumi ka qenë më i madh, në zërin 605 “mallra me vlerë” në vlerën 460 mijë lekë, në zërin 605 “mallra me vlerë” në vlerën 460 mijë lekë në zërin “shpenzime amortizimi” në vlerën 13,693 mijë lekë, për arsye të investimeve dhe janë rritur shumë asetet e Drejtorisë.
DRSHTRR Dibër Planin e shpenzimeve e ka realizuar në masën 101% dhe paraqitet me tejkalim në zërin 601.1 “materiale” në vlerën 438 mijë lekë, në zërin 601.23 “kancelari” në vlerën 61 mijë lekë, në zërin 601.25 “karburant për gjenerator” në vlerën 41 mijë lekë për arsye të ndërprerjes së energjisë elektrike dhe rritjes së çmimit, në zërin 605 “mallra me vlerë” në vlerën 71 mijë lekë, në zërin 638 “të tjera tatime, taksa” në vlerën 63 mijë lekë për të cilat janë paguar faturat e bashkisë për gjelbërim ndriçim etj, në zërin 641 “pagat e punonjësve” në vlerën 853 mijë lekë, në zërin 644 “sigurime shoqërore” në vlerën 59 mijë lekë, në zërin 644.1 “sigurime suplementar” në vlerën 115 mijë lekë për shkak të shtesës në organikë të një punonjësi, në zërin “shpenzime amortizimi” në vlerën 2,855 mijë lekë për shkak të kontabilizimit të investimit dhe përlllogaritjes së amortizimit për periudhën përkatëse, në zërin 657 “Gjoha dëmshpërblime” ka arritur vlerën 718 mijë lekë.

DRSHTRR Shkodër - Planin e shpenzimeve e ka realizuar në masën 94%, paraqitet me tejkalim në zërin 601.1 “Blerje materiale (të tjera)” në vlerën 232 mijë lekë, në zërin 626 “shpenzime PTT” në vlerën 103 mijë lekë, në zërin “Amortizime” në vlerën 3,509 mijë lekë, për shkak të fluksit të madh të punës dhe me investimet e reja të kryera.

DRSHTRR Tiranë - Planin e shpenzimeve e ka realizuar në masën 97%, paraqitet me tejkalim në zërin në zërin “Blerje materiale” në vlerën 2,605 mijë lekë për, në zërin 626 “shpenzime PTT” në vlerën 246 mijë lekë, në zërin 638 “ të tjera tatime, taksa” në vlerën 153 mijë lekë, në zërin 622 “honorare” ka arritur në vlerën 80 mijë lekë për të cilin është paplanifikuar, në zërin “Amortizime” në vlerën 13,890 mijë lekë, në zërin 657 “Gjoha dëmshpërblime” ka arritur vlerën 56 mijë lekë. Këto tejkalime kanë ardhur për arsye të daljes nga përdorimi në magazinë sipas urdhrit me Nr.56 datë 23.12.2022 .

DRSHTRR Vlorë - Planin e shpenzimeve e ka realizuar në masën 100%, paraqitet me tejkalim në zërin në zërin “materiale” në vlerën 420 mijë lekë furnizime të bëra për maska, në zërin 626 “shpenzime PTT” në vlerën 14 mijë lekë, në zërin “Amortizime” në vlerën 4,446 mijë lekë për amortizimin e investimeve të bëra për “Rikonstruksionin e Kontrollit Teknik” furnizim me kompjuterë për të cilat nuk është planifikuar amortizim pasi nuk ka pasur preventiv për vlerat e investimit, në zërin 657 “Gjoha dëmshpërblime” ka arritur vlerën 4,540 mijë lekë në të cilën kanë ndikuar vendimet gjyqësore në shumën 2328 mijë lekë për tre punonjës: E.B. 641 mije lekë, A.B. 314 mije lekë, E.S. 1,224 mijë leke. Vendim gjyqi për kthim TVML-je për mjetin me targë A...H i cili ka paguar TVMP të prapambetur 149 mijë lekë. Vendim gjykate ne favor të V. shpk, subjekt i ruajtjes së objekteve për vjedhjen e arkës së taksave ne vlerën 2,211 mije lekë.

DRSHTRR Sarandë - Planin e shpenzimeve e ka realizuar në masën 95%, paraqitet me tejkalim në zërin 601.1 “blerje materiale” në vlerën 234 mijë lekë si rezultat i rritjes së çmimit të disa artikujve si targa të gjata, targa katrore, targa motori si dhe dosar arkive dhe numrit të konsumit të tyre për arsye të çregjistrimeve të përhershme ku dorëzohen në arkivën qendrore dhe nuk qe parashikuar në projekt-buxhet, në zërin 626 “shpenzime PTT” në vlerën 10 mijë lekë si rezultat i faturave

Vodafone dhe One, në zërin “shpenzime amortizimi” në vlerën 1,038 mijë lekë pasi është kryer investimi i ri tek QKT-ja dhe si rrjedhojë janë shtuar asetet e reja , në zërin 6812 “shpenzime jashtë përdorimit” në vlerën 122 mijë lekë. DPSHTRR Planin e shpenzimeve e ka realizuar në masën 78%, paraqitet me tejkallim në zërin 601/23 “blerje kancelari” në vlerën 1,619 mijë lekë, në zërin 601/25 “karburant për gjeneratorë” në vlerën 289 mijë lekë, në zërin 625 “udhëtime dieta” në vlerën 419 mijë lekë, në zërin 638 “të tjera tatime, taksa” në vlerën 228 mijë lekë, në zërin 657 “Gjoha dëmshpërblime” ka arritur vlerën 68 mijë lekë i cili është shpenzim i paplanifikuar dhe në zërin 669 “humbje nga kursi” në vlerën 1,782 gjithashtu shpenzim i paplanifikuar.

Treguesit ekonomiko-financiarë për Drejtorinë e Targave dhe Shtypshkrimeve (DTSH) janë realizuar si më poshtë:

Të ardhurat e realizuara gjatë kësaj periudhe 12/mujore 2022 janë në masën 210,477 mijë lekë, nga 257,870 mijë lekë të planifikuara në Programin Ekonomik për 12/mujorin e vitit 2022. Realizimi i programit është në masën 82%, ose (47,393) mijë lekë më pak.

Shpenzimet e realizuara gjatë kësaj periudhe janë në masën 201,551 mijë lekë, nga 257,870 mijë lekë të planifikuara në Programin Ekonomik për 12/mujorin e vitit 2022. Realizimi i shpenzimeve për këtë periudhë, rezulton 78% ose 56,319 mijë lekë më pak. DTSH ka tejkallim në zërin “Udhëtime dieta” vlerën 77 mijë lekë si rezultat i zhvillimit të aktiviteteve retro, në zërin “Sigurime suplementarë” në vlerën 11 mije leke, shpenzime rrjedhëse” në vlerën 625 mijë lekë kjo shumë ka kaluar në ndihmë për Ukrainën dhe në zërin “Shpenzime për jashtë përdorimit” në vlerën 120 mijë lekë.

Të ardhura dhe shpenzime të tjera të cila janë specifike për periudhën 12/mujore 2022 u referohen Task- Forcë-s: Gjatë periudhës 12/mujore të vitit 2022 të ardhurat e Task Forcë-s janë 24,104 mijë lekë, ndërsa shpenzimet janë realizuar 56,266 mijë lekë nga 70,620 mijë lekë, ose në masën 80% të Programit ekonomik.

Fitimi bruto i realizuar për periudhën 12/mujore 2022 është 577,549 mijë lekë, nga 627,500 mijë lekë i parashikuar në Programin-Ekonomik të vitit 2022.

7.Titulli i Gjetjes:	Planifikimi i programit ekonomik
Situata:	<p>Sa më sipër janë vënë në dukje të ardhurat dhe shpenzimet, mbi të cilat planifikimi i tyre nuk ka qene i saktë, dhe devijanca e tyre në lidhje me realizimin është e lartë.</p> <p>Shpenzimet janë rritur ndërkohë që të ardhurat janë pakësuar. Shpenzimet për vitin 2022 krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021 kemi rritje të shpenzimeve në masën 21% ose 479,994 mijë lekë ndërsa për të ardhurat për vitin 2022 krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021 ka një tejkallim me 11% ose 323,652 mijë lekë më tepër.</p> <p>Në 12/mujorin 2022, Fitimi bruto nga aktiviteti i Drejtorive Rajonale dhe DPSHTRR arriti vlerën 577,549 mijë lekë, duke u ulur me -49,951 mijë lekë ose me 8% më pak krahasuar me Programin Ekonomik për të njëjtën periudhë të vitit.</p> <p>Zërat si “Shpërblime për vjetërsi ne pune” “Gjoha dëmshpërblime” dhe “Humbje nga kursi” nuk janë planifikuar.</p>
Kriteri:	Ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.

Ndikimi/Efekti:	Ndikim në objektivave të shoqërisë.
Shkaku:	Përfshirja e shërbimeve të reja
Rëndësia:	E mesme
Rekomandim:	Organet drejtuese të DPSHTRR, gjatë hartimit të buxheteve, të analizojë me kujdes situatën e institucionit, të hartojnë plane financiare për përmirësimin e tyre, negocimin e kushteve më të mira si dhe mundësitë e shtimit të kapitalit të shoqërive. Të marrë në konsideratë legjislacionin në fuqi si dhe të kryejë një planifikim të saktë të të ardhurave dhe shpenzimeve, duke u bazuar dhe në vitet e mëparshme.

Përsa është trajtuar në këtë pjesë të P/Raportit të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacion me shkresë nr. 409/5 prot, datë 06.12.2023 “Kundërshtime për akt konstatimet e grupit të auditimit të KLSH”, nga ana e përfaqësuesve të institucionit, të cilat janë të paraqitura më poshtë, pa ndërhyrje dhe rregullime nga ana drejtshkrimore:

Pretendimet e subjektit:

Në lidhje me analizën e të ardhurave të realizuar gjatë vitit 2021 ju sqarojmë si më poshtë:

- Në shërbimet e ofruara nga DPSHTRR u shtua aktiviteti i Kontrollit Teknik të Mjeteve. Në zbatim të shkresës nr. 8073 prot, datë 17.11.2020 të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, “Mbi përfundimin e kontratës koncesionare “Për dhënie me koncesion të shërbimit të kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre në Republikën e Shqipërisë”, në zbatim të pikës 3.6 “Dorëzim i Mjediseve të Koncesionit dhe Infrastrukturës” ka caktuar autoritetin e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, që koncesionari ti kthejë të gjithë mjediset e koncesionit dhe infrastrukturës. Referuar kësaj shkrese si dhe në zbatim të urdhërit nr. 349, datë 14.12.2020, pika 3 Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor të bëjë miratimin, pranimin dhe nënshkrimin e “Certifikatës së pranimit të dorëzimit”, sipas Aneksit III, të Kontratës Koncesionare, pjesë e shërbimeve të ofruara nga DPSHTRR u bë aktiviteti i Kontrollit Teknik të Mjeteve Motorrike Ky aktivitet në vitin 2020, nuk ka qënë pjesë e aktivitet të DPSHTRR-së. Realizimi i të ardhurave për vitin 2021 nga ky aktivitet shkon në vlerën 419,393 mijë lekë ose 51% e rritjes së të ardhurave të vitit 2021.
- DPSHTRR ka ndërrmarrë disa shërbime risi që kanë ndikuar në shtimin e numrit të veprimeve, dhe si rrjedhojë edhe në rritjen e të ardhurave, kryesisht në aktivitetin e Regjistrimit të Mjeteve më konkretisht shërbimet për “Targat me përzgjedhje”, “Retro” etj.
- Në Programin Ekonomik nuk planifikohen të ardhurat nga gjoba të ndryshme që aplikon DPSHTRR, si gjobat e TVMP/TVML-së, KTV-së, Ndryshimeve Konstruktive, Task-Forcës etj, të cilat për vitin 2021, shkojnë në vlerën 133,190 mijë lekë ose 38% të vlerës së rritjes së të ardhurave.
- Gjithashtu, vlen të përmendet se planifikimi i vitit 2021, është përllogaritur mbi treguesit e realizuar të vitit 2020, i cili konsiderohet si vit pandemik.

Në lidhje me analizën e shpenzimeve të realizuar gjatë vitit 2021 ju sqarojmë si më poshtë:

Mosrealizim i shpenzimeve të planifikuara për vitin 2021, vjen kryesisht si rezultat i mosrealizimit të zërit të shpenzimit “Pagat e punonjësve dhe derivatët e saj” që shkojnë në vlerën 351, 941 mijë lekë. Në Programin Ekonomiko-Financiar të vitit 2021 është planifikuar rritje page prej 10%, rritje e cila nuk u miratua nga Grupi i Menaxhimit Strategjik.

Ndërsa, tejkalmi i disa zërave të shpenzimeve, të cilat janë konstatuar edhe nga ne, referuar analizës së treguesve kryesore ekonomiko financiar të DPSHTRR-së për periudhën 12 mujore të vitit 2021 me nr.12361Prot, datë 05.05.2022, vjen si rezultat i disa faktorëve të listuara si më poshtë:

- Llogaria 601.1 "Blerje materiale të tjera" dhe llogaria 605 “Blerje mallra" vjen si rezultat i rritjes së numrit të veprimeve dhe tejkalmi të të ardhurave të Drejtorive Rajonale në varësi.
- Llogaria 622/1 “Shërbime Printimi”, ka tejkalmi pasi Grupi i Menaxhimit Strategjik me shkresën nr.8535 Prot, datë 05.05.2021, me qëllim menaxhimin e pajisjeve informatike në pronësi të DPSHTRR-së, argumentoj që shërbimi i printimit do të përfshihet edhe në Drejtori Rajonale të cilat nuk e kishin të planifikuar këtë shpenzim.
- Llogaria 638 "Të tjera tatime, taksa" ka tejkalmi si rrjedhojë e taksave vendore që janë paguar për Qendrat e Kontrollit Teknik të Mjeteve, të cilat janë marrë në administrim të DPSHTRR-së në vitin 2021, për këtë arsye ishte e pamundur një planifikim i saktë. Gjithashtu për një shërbim më të zgjeruar gjeografikisht gjatë vitit 2021 janë hapur disa zyra shtesë në qytete të ndryshme të Shqipërisë, më konkretisht “Zyra e Shërbimeve Tepelenë”, “Zyra e Shërbimeve Përmet”, “Zyra e Shërbimeve Mallakastër”, “Zyra e Shërbimeve Gramsh” etj.

- Llogaria 6811 "Shpenzime amortizimi" ka tejkalim si pasojë e amortizimit vjetor të aktiveve të Qendrave të Kontrollit Teknik të cilat kaluan në kontabilitetin e DPSHTRR-së në vitit 2021.
- Llogaria 6812 "Shpenzime jashtë përdorimit" ka tejkalim si pasojë e nxjerrjes jashtë përdorimit (prishja) e godinës së Drejtorisë Rajonale Laç.

Në lidhje me analizën e të ardhurave të realizuar gjatë vitit 2022 ju sqarojmë si më poshtë:
Ndikim të drejtëpërdrejtë në mosrealizimin e të ardhurave për vitin 2022 kanë pasur:

a)DPSHTRR në zbatim të VKM-së nr. 153, datë 07.04.2000 “Për miratimin e Rregullores në zbatim të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Udhëzimi nr. 4, datë 28.06.2019 “Për dokumentacionin e qarkullimit dhe regjistrimit të mjeteve rrugore”, Direktiva nr. 1999/37/EC, e ndryshuar, deri në vitin 2014 si dhe Urdhëri i Ministrit të MIE me nr. 284, datë 07.10.2020” Për miratimin e lejes së re të qarkullimit për mjetet rrugore” filloi aplikimin e Lejes së re të Qarkullimit, e cila automatikisht çon në heqjen e shërbimit “Çertifikatë Pronësie” me tarifë 1.000 lekë me TVSH, si dhe ndikon në uljen e numrit të veprimeve për “Lejen Ndërkombëtare të Qarkullimit” me tarifë shërbimi 500 lekë me TVSH. Efekti financiar i çertifikatave të pronësisë shkon 166,948 mijë lekë.

b)Në zbatim të Udhëzimit nr. 1, datë 18.09.2022 "Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimi nr.4, datë 28.06.2019 “Për dokumentacionin e qarkullimit dhe regjistrimit të mjeteve rrugore” të ndryshuar, kemi ulje të numrit të veprimeve për shërbimin “Identifikimi i treguesve teknik të mjeteve” me tarifë 1.500 lekë me TVSH. Efekti financiar i zbatimit të këtij ndryshimi ligjor shkon në vlerën 93,752 mijë lekë.

c)Miratimi i tarifës për “Rinovimi i leje drejtimit për kategorinë “B” me afat vlefshmërie 5 vjet ose më pak” me vlerë 2.000 lekë me TVSH, nga tarifa ekzistuese 3.500 lekë me TVSH. Efekti financiar për këtë tarifë të ulur shkon në vlerën 49,848 mijë lekë.

Në lidhje me analizën e shpenzimeve të realizuar gjatë vitit 2022 ju sqarojmë si më poshtë:

- Mosrealizimi i të ardhurave sjell për rrjedhojë mosrealizim të shpenzimeve, të cilat janë në masën 8% në krahasim me Programin Ekonomik të Vitit 2022, kemi mosrealizim të shpenzimeve kryesisht në llogaritë (605) bleje mallrash.
- Programi Ekonomiko-Financiar i vitit 2022, është përlllogaritur mbi treguesit financiar të realizuar gjatë vitit 2021, i cili ka pasur nje trend rritje shumë më të lartë të numrit të veprimeve që nuk ndjek trendin e zakonshëm deri në 10% rritje, siç ka ndodhur në vitet paraardhëse.

Ndërsa, tejkalimi i disa zërave të shpenzimeve, të cilat janë konstatuar edhe nga ne, referuar analizës së treguesve kryesore ekonomiko financiar të DPSHTRR-së për periudhën 12 mujore të vitit 2022 me nr.12121 Prot, datë 20.06.2023, vjen si rezultat i disa faktorëve të listuara si më poshtë:

- Llogaria 601.1 "Blerje materiale të tjera" ka tejkalim si rezultat i rritjes së çmimit të disa artikujve që prodhohen nga DTSH, si targa të gjata, targa katrore, targa motori etj. Me rikonstruksionin e Arkivës Qendrore të DPSHTRR-së, janë sistemuar të gjitha arkivat e Drejtorive Rajonale, ku të gjitha dosjet e çrregjistrimeve të përhershme janë dorëzuar në arkivën qendrore, kjo ka sjellë rritjen e konsiderueshme të numrit të konsumit të dosarëve të arkivës, të cilat prodhohen në DTSH.
- Llogaria 601.23, "Kancelari" ka tejkalim për arsye të rritjes së çmimeve të mallrave dhe shërbimeve dhe rritjes së inflacionit.
- Llog.645 “Të përndjekurit politik”, NUK ka tejkalim fondi
- Llogaria 6812 "Shpenzime jashtë përdorimit" ka tejkalim si pasojë e nxjerrjes jashtë përdorimit (prishja) e godinës së Drejtorisë Rajonale Korçë.

Në lidhje me zërat e shpenzimeve si "Shpërblime për vjetërsi në punë" dhe "Gjoha dëmshpërblime" të cilat nuk janë planifikuar gjatë hartimit të Programit Ekonomiko-Financiar, si një rekomandim i Juaj do të planifikohen si “Provizione” në hartimin e Programeve Ekonomiko – Financiare pasardhëse.

Lutemi që shpjegimet dhe argumentimet tona, të merren në konsideratë nga ana Juaj për konstatimet e sipërcituara.

3-Lidhur gjetjen 9, paragrafi 1 “masa organizative”, rekomandimi 9.1 “drejtoria ekonomike e DPSHTRR-së të marrë masa të menjëherëshme për njohjen në kontabilitet të vlerës së plotë të proceseve gjyqësore të cilat kanë marrë formë të prerë si shpenzime të periudhësne “Pasqyrën e performancës financiare “ të institucionit dhe krijimin e provizioneve

si një detyrim në Pasqyrën e pozicionit financiar, sqarojmë se ky rekomandim për njohjen në kontabilitet të vlerës së plotë të proceseve gjyqësore të cilat kanë marrë formë të prerë si shpenzime të periudhës në “Pasqyrën e performancës financiare”, është zbatuar nga ana jonë.

Në “Pasqyrën e performancës financiare” të DRSHTRR Shkodër llogaria 657 “Gjoha e dëshmshpërblime” është në vlerën 3,084,157 lekë e cila përbëhet nga kontabilizimi i 2 vendimeve gjyqësore që kanë marrë formë të prerë në vitin 2022 dhe janë likuiduar në Shkurt të vitit 2023 (Z. F.P me vlerë 2,295,500 lekë paguar në bankë më datë 06.02.2023 dhe Znj O.M. me vlerë 788,657 lekë, paguar në bankë më datë 15.02.2023)

Në “Pasqyrën e performancës financiare” të DRSHTRR Vlorë llogaria 657 “Gjoha e dëshmshpërblime” është në vlerën 2,328,682 lekë e cila përbëhet nga kontabilizimi i 4 vendimeve gjyqësore që kanë marrë formë të prerë në vitin 2022 (Vlera 2,014,328 lekë është likuiduar në vitin 2022 dhe vendimi për Z. E.S. me vlerë 1,224,354 lekë është likuiduar më datë 16.03.2023)

Bashkëlidhur dokumentet që vërtetojnë njohjen në kontabilitet si shpenzime të Vitit 2022, edhe pse pagesa është bërë në vitin 2023 si transfera bankare dhe vendimet gjyqësore përkatëse.

Oëndrimi i Grupit të Auditimit të KLSH –së:

Gjetjet e konstatuara nga grupi i auditimit janë ta karakterit organizativ dhe në qëllim të përmbushjes së objektivave të institucionit, duke bërë të mundur që organet drejtuese të shoqërisë ti marrin në konsideratë për përmirësimin e punës. Disa nga observacionet janë marrë në konsideratë dhe janë kryer rregullimet përkatëse përgjatë materialit.

Për këto arsye, sa më sipër, observacioni juaj pranohet pjesërisht.

II.2.5. “Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në mbajtjen e evidencës kontabile, ndjekjen e debitorëve e kreditorëve, si dhe menaxhimin e aktiveve”

Për zbatimin e dispozitave ligjore në lidhje me mbajtjen e evidencës kontabël, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- *Dokumentacioni i pasqyrave financiare.*
- *Dokumentacioni i regjistrimit të llogarive kontabël.*
- *Dokumentacioni mbi hartimin dhe miratimin e pasqyrave financiare.*
- *Dokumentacioni i mbajtur mbi përllogaritjen, njohjen, pagesën dhe regjistrimin e detyrimeve fiskale.*
- *Dokumentacioni i mbajtur mbi debitorët dhe kreditorët.*
- *Dokumentacioni mbi kryerjen e inventarizimit të aktiveve.*

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet se:

Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR) si institucion shtetëror, është person juridik, publik, jo buxhetor, në varësi të Ministrit përgjegjës për transportet, e krijuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.343, datë 21.07.1999 “Për krijimin e DPSHTRR”.

Veprimtaria e shoqërisë bazohet në ligjin nr. 7582, datë 13.07.1992 “Për ndërmarrjet shtetërore” i ndryshuar, në statutin e saj, si dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, si dhe Ligjit nr.25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”.

Ky subjekt është regjistruar në Drejtorinë Rajonale Tatimore, Tiranë me NIPT J.....C

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është shërbimi ndaj subjekteve fizike dhe juridike, shtetërore dhe private, në veprimtarinë e transportit rrugor.

DPSHTRR e ka organizuar mbajtjen e kontabilitetit mbi bazën e parimeve dhe metodave, të përcaktuara nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit, në zbatim të Ligjit nr. 25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, si dhe në zbatim të nenit 5, pika 2 e ligjit, DPSHTRR ka zbatuar SNRF-të për hartimin e pasqyrave financiare.

Sistemi kontabël i shoqërisë është i organizuar mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

Pasqyrat financiare janë përgatitur në lekë, si monedha funksionale e shoqërisë. Transaksionet në monedha të huaja janë konvertuar në monedhën funksionale (lekë) me kursin e datës në të cilën ndodh transaksioni.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin 2022, janë të shoqëruara me Pasqyrën e Pozicionit Financiar, Pasqyrën e Performancës, Pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare, Pasqyrën e ndryshimit të kapitalit, si dhe shënimet sqaruese përkatëse mbi pasqyrat financiare.

Këshilli Drejtues me vendimin nr. 23, datë 10.07.2023 “Për miratimin e llogarive vjetore, ndarjen e fitimit neto dhe miratimin e kapitalit të vitit 2022” ka miratuar pasqyrat financiare të vitit 2022, pas ekspertimit ligjor të llogarive vjetore të realizuara nga audituesit ligjorë të caktuar nga ministria përgjegjëse.

DPSHTRR me shkresën nr. 14366, datë 21.07.2023, ka dërguar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë pasqyrat financiare të miratuara nga këshilli drejtues, në zbatim të nenit 20 të Statutit të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

Pasqyrat financiare janë dorëzuar në Drejtorinë e Tatimeve Tiranë nëpërmjet sistemit C@ts, duke respektuar kërkesat e UMF nr.5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, pika 3.12. “Deklarimi tatimor dhe llogaritja përfundimtare e detyrimit” në lidhje me depozitimin online të pasqyrave financiare brenda afateve ligjore deri me 31 mars të çdo viti pasardhës, të shoqëruara këto me deklaratën vjetore të tatimit mbi fitimin.

Aktive afatgjata materiale

Aktivitet afatgjata të qëndrueshme të trupëzuara, zëri “toka, ndërtesa, makineri dhe pajisje, aktive në proces” paraqiten me koston e tyre historike minus amortizimin e akumuluar, përveç tokës e cila pasqyrohet me koston e blerjes dhe aktiveve në proces.

Kosto historike e aktiveve përfshin koston e blerjes si dhe të gjitha kostot shtesë që lidhen me vendosjen e aktivitet në gjendje pune, apo edhe kosto të përmirësimit të jetës së aktivitet të ndodhura gjatë jetës së tij të dobishme.

Aktivitet afatgjata materiale paraqiten në bilanc me vlerën e tyre kontabël neto 3,968,484,072 lekë, përveç tokës e aktiveve në proces të cilat paraqiten me vlerën kontabël historike. Amortizimi i aktiveve është llogaritur me metodën lineare në mënyrë që kosto e çdo aktivitet deri në vlerën e mbetur të shpërndahet përgjatë gjithë jetës së tij të dobishme.

Në pasqyrën e të ardhurave, amortizimi me norma fiskale për vitin 2022, është paraqitur si zë i shpenzimeve më vete për shumën 273,407,973 lekë.

Gjatë periudhës ushtrimore të vitit 2022 në AAM ka pasur shtesa dhe pakësime krahasuar me vitin 2021, si më poshtë:

Në llogarinë 211 “Toka” shtesë për vlerën 96,798,924 lekë e ndarë DR Korçë në vlerën 30,357,572 lekë, transferim kapitali nga Autoriteti Rrugor në zërin truall dhe ndërtesë me VKM. Dr. Kukës në vlerën 37,884,352 lekë, blerë në vitin 2022 dhe DR Berat në vlerën 28,557,000 lekë blerë në vitin 2021.

Pakësimet në vlerën 4,991,198 lekë, tokë e transferuar nga DR Korçë tek Autoriteti Rrugor, sipas VKM përkatëse.

Në llogarinë 212 “Ndërtim”, shtesë për vlerën 802,632,956 lekë, nga kalimi i investimeve në proces të marra në dorëzim në vitin 2022 duke kredituar llogarinë 231 “Aktive në proces” dhe

debituar llogarinë 212 në vlerën 797,819,024 lekë, dhe 4,813,932 lekë, transferim kapitali nga Autoriteti Rrugor në zërin truall dhe ndërtesë me VKM.

Pakësim në vlerën 36,231,966 lekë nga transferimi Kapital për Autoritetin Rrugor 31,295,547 lekë dhe vlera 4,936,419lekë, ndërtesa të shkatërruara në DR Korçë, Elbasan.

Në llogarinë 213 “Makineri e pajisje” shtesa totale në vlerën 29,344,966 lekë, nga te cilat blerë nga Drejtoria Rajonale Durrës 1,511,250lekë, DR Tiranë në vlerën 2,019,607 lekë. Vlera 25,724,109 lekë, si transferim nga magazina e DPSHTRR-së dhe investime në proces. Vlera 90,000 lekë, transferim mes Drejtorive.

Pakësim në vlerën 5,928,450 lekë, nxjerrje jashtë përdorimi sipas VKD përkatëse vlera 5,838,450 lekë dhe 90,000 lekë, transferim mes D.Rajonale

Në llogarinë 215 “Mjete Transporti” për vitin 2022, pakësim në vlerën totale 14,084,842lekë nga të cilat 11,539,363 lekë, dalje nga përdorimi për DR Tiranë, Durrës, Sarandë dhe vlera 2,545,479 lekë, autoveturë transferuar ASHSH, sipas Shkresës së MIE nr.208, datë 27.10.2022 “Për kalim kapital të autoveturës”.

Në llogarinë 2181 “Pajisje zyre” shtesa totale 95,164,905lekë, e përbërë nga blerjet nga D.Rajonale në vlerën 20,688,495lekë, shtesë nga kalimi i mallrave të magazinuara në DPSHTRR në drejtoritë e tjera Rajonale duke kredituar llogarinë 231 “Aktive në proces” dhe debituar llogarinë 2181në vlerën 73,421,677 lekë, dhe vlera 1,054,733 lekë, transferim mes Drejtorive Rajonale sipas urdhrave përkatës. Pakësim në vlerën 15,953,296 lekë, nga daljet jashtë përdorimi të aktiveve sipas VKD përkatëse 14,898,563 lekë dhe 1,054,733 lekë, transferim mes Drejtorive Rajonale.

Në llogarinë 2182 “Pajisje informatike” shtesa totale 37,349,360 lekë, nga të cilat blerjet nga D.Rajonale 705,700 lekë, shtesë nga kalimi i mallrave të magazinuara në DPSHTRR në Drejtoritë e tjera Rajonale në vlerën 33,322,095 lekë, duke kredituar llogarinë 231 “Aktive në proces” dhe debituar llogarinë 2182, shtesa nga lëvizjet e brendshme në vlerën 3,321,564 lekë. Pakësim në vlerën 22,698,181 lekë, nga të cilat për jashtë përdorimi 19,376,617 lekë, pakësim në nga lëvizjet e brendshme në vlerën 3,321,564 lekë.

Në llogarinë 231 “Aktive në proces”, shtesa në vlerën 727,034,352 lekë, blerë nga DPSHTRR gjatë vitit 2022 kaluar nga fondi i investimeve 1,611,890 lekë, kaluar nga magazina e DPSHTRR por gjendje në magazinën e D. Rajonale vlera 1,297,382 lekë, në përdorim të Cetis sipas kontratës. Pakësim në vlerën 1,046,141,242 lekë, nga të cilat 950,920,395 lekë kanë kaluar në llogaritë e aktiveve në përdorim në zërat përkatëse të aktiveve për Drejtoritë Rajonale; (“Toka” në vlerën 66,441,352 lekë “Ndërtesa” në vlerën 792,837,939 lekë, “Makineri e pajisje” në vlerën 22,026,709 lekë, “Pajisje zyre” në vlerën 58,619,528lekë, “Pajisje informatike” në vlerën 9,382,969 lekë) dhe 92,234,902 lekë, kaluar në llogaritë e aktiveve në përdorim në zërat përkatëse të aktiveve për aparatit e Drejtorisë së Përgjithshme (Programe në vlerën 51,529,800 lekë, “Makineri e pajisje” në vlerën 3,697,400 lekë, “Pajisje zyre” në vlerë 14,213,550 lekë, si dhe “Pajisje informatike” në vlerën 22,794,152 lekë).

Pakësimet në vlerën 1,046,141,242 lekë, kanë kredituar llogarinë 231 “Aktive në proces” dhe debituar shtesa aktivesh në zërat përkatës në Drejtoritë Rajonale dhe Drejtorinë e Përgjithshme detajuar si më poshtë:

Llogari të arkëtueshme dhe të tjera:

Përshkrimi	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Llogari/Kërkesa të arkëtueshme (Klientë, Furnitorë)	9,705,325	5,497,545
Llogari/Kërkesa të tjera të arkëtueshme Personeli	2,979,035	2,998,279
Instrumente të tjera borxhi Detyrime buxheti	6,096,620	4,000
Investime të tjera financiare Debitore të tjere	10,639,841	12,836,088
Hua të dhena	429,099,135	-

Llogari/Kerkesa te arkëtueshme shp periudhave të ardhshme	1,906,116	3,880,979
Totali	460,426,071	25,216,891

Gjendja e llogarisë sintetike “Kërkesa të arkëtueshme” është në vlerën 9,705,325 lekë, e cila përbëhet nga gjendja e llog.411 “Klientë” në vlerë prej 8,576,232 lekë, që përfaqëson detyrimet e klientëve ndaj institucionit, gjendja e llog.401-404 “Furnitorë e llog të lidhura me to” në vlerën 29,593 lekë, që përfaqëson detyrimet për kthim të furnitorëve për shuma të paguara më tepër nga institucioni dhe gjendja e llog.413 “efekte për tu arkëtuar” në vlerën 1,099,500 lekë, që përfaqëson gjoba për tu arkëtuar nga autoserviset në vlerën 1,000,000 lekë dhe vlera e derdhur tepër në thesar nga Dr.Dibër dhe Dr.Berat prej 99,500 lekë. Peshën më të madhe në gjendjen llogarisë “Kërkesa të arkëtueshme” e zë gjendja e llog. “klientë”, e cila paraqitet në fund të vitit 2022 në shumë të konsiderueshme prej 8,576,232 lekë, dhe ka pësuar rritje krahasuar me vitin 2021 në vlerën prej 4,093,243 lekë, gjë e cila ndikon në të ardhurat e institucionit.

Konkluzion: Nga analiza e zërave të pasqyrës së “Pozicionit Financiar” dhe analizës së të drejtave dhe detyrimeve konstatohet se institucioni ka të drejta dhe detyrime të mbartura që nga viti 2005-2016, për të cilat nuk janë krijuar provizionime, veprime në mospërputhje me SKK 6. “Provizionet, detyrimet dhe aktivet e kushtëzuara” pika 3, si dhe Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të Ardhurat”, i ndryshuar.

Gjendja e llogarisë 427 “Kërkesa të tjera të arkëtueshme” në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 2,979,035 lekë, me ulje nga viti 2021, në vlerën 19,944 lekë. Kjo gjendje, përfaqëson detyrimet e personelit të trashëguara ndër vite kryesisht detyrime të punonjësve ndër vite nga akte të ndryshme të paarkëtuar nga Drejtoritë ose në procese gjyqësore në ndjekje, ku vlerën më të madhe të detyrimeve e kanë punonjësit e Drejtorisë Rajonale Tiranë, prej 2,111,919 lekë. Për këtë gjendje janë mbajtur analiza të detajuara, duke identifikuar individët që kanë detyrimin, vlerën për secilin, objektin e detyrimit si dhe kohën e krijimit. Këto “të drejta” të identifikuar janë të krijuara shumë vite më përpara, duke krijuar risk të lartë për mosarkëtimin e tyre.

Për të drejtat që institucioni ka ndaj ish- punonjësve të krijuara që nga viti 2008, nuk është marrë asnjë masë për ndjekjen, arkëtimin dhe vlerësimin e tyre, pasi këto shuma janë vlera të paarkëtueshme si rezultat i parashkrimit të afateve për të kërkuar të drejtën, bazuar në nenin 203 pika 1 Kodi i Punës “Afati i parashkrimit për të drejtat e punëmarrësit kundrejt punëdhënësit, dhe të punëdhënësit kundrejt punëmarrësit është 3 vjet”, si dhe neni 115 Kodit Civil “Parashkruhen brenda afateve prej dh) tre vjetëve paditë për shpërblimin e dëmit jokontraktor dhe paditë për kthimin e përfitimit pasuror pa të drejtë”, në kundërshtim me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të Ardhurat” i ndryshuar, SKK 6. “Provizionet, detyrimet dhe aktivet e kushtëzuara” pika 3.

Gjendja e llogarisë sintetike “Instrumente të tjera borxhi detyrime buxheti” në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 6,096,620 lekë e cila përbëhet nga gjendja e llogarisë 4664 “Derdhur gabimisht” në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 5,809,740 lekë, e cila përfaqëson detyrimet që kanë për kthim DRT përsa paguar më tepër tatim fitimi për vitin 2022 dhe nga sistemimi i veprimeve për shpenzim përsa faturuar tepër në vlerën 286,880 lekë.

Gjendja e llogarisë 468/467 “Debitorë të tjerë” paraqitet në fund të vitit 2022 në vlerën 10,639,841 lekë me një zbritje prej prej 2,196,247 lekë nga viti 2021, dhe përfaqëson detyrime të ndryshme kryesisht detyrime të ish punonjësve të liruar nga puna të lindura nga raportet e auditimit të brendshëm të Ministrisë së linjës apo KLSH, që janë të paarkëtuar në kohë ose në procese gjyqësore. Për disa raste nuk është ngritur padi me pretendimin për mungesë adresash të sakta si dhe detyrime të subjekteve private për detyrime të lindura ndaj DPSHTRR të cilat janë në ndjekje

në shkallë të ndryshme të gjyqësorit, vlera të cilat janë të konsiderueshme, dhe ndikojnë negativisht në rritjen e të ardhurave.

8.Titulli i Gjetjes:	Të drejta dhe detyrime të mbartura
Situata:	<p>Nga analiza e zërave të pasqyrës së “Pozicionit Financiar” dhe analizës së të drejtave dhe detyrimeve konstatohet se institucioni ka të drejta dhe detyrime të mbartura që nga vitet 2005-2016, për të cilat nuk janë krijuar provizionime. Të drejtat janë në vlerën 19,715,496 lekë, të cilat përbëhen nga gjendjet e llogarive në fund të vitit 2022 si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - llog. 427 “Kërkesa të tjera të arkëtueshme” paraqitet në vlerën 2,979,035 lekë, që përfaqëson detyrimet e personelit të paarkëtuara nga Drejtoritë ose në procese gjyqësore të krijuara që nga viti 2008, ku vlerën më të madhe të detyrimeve e kanë punonjësit e Drejtorisë Rajonale Tiranë, prej 2,111,919 lekë, për të cilat nuk është marrë asnjë masë për ndjekjen, arkëtimin dhe vlerësimin e tyre, duke tejkaluar afatet e kërimit të këtyre të drejtave, pasi janë parashkruar. - llog. sintetike “Instrumente të tjera borxhi detyrime buxheti” në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 6,096,620 lekë, e cila përbëhet nga gjendja e llogarisë 4664 “Derdhur gabimisht” në vlerën 5,809,740 lekë, që përfaqëson detyrimet që kanë për kthim DRT përsa paguar më tepër tatim fitimi për vitin 2022 dhe nga sistemimi i veprimeve për shpenzim përsa faturuar tepër në vlerën 286,880 lekë. - llog. 468/467 “Debitorë të tjerë” paraqitet në fund të vitit 2022 në vlerën 10,639,841 lekë, me një zbritje prej prej 2,196,247 lekë nga viti 2021, që përfaqëson detyrimet e punonjësve të lindura nga rekomandimet e KLSH dhe Ministria e linjës si edhe nga proceset gjyqësore për largimet që janë të paarkëtuara në kohë. Për disa raste nuk është ngritur padi me pretendimin për mungesë adresash të sakta si dhe detyrime të subjekteve private për detyrime të lindura ndaj DPSHTRR të cilat janë në ndjekje në shkallë të ndryshme të gjyqësorit, vlera të cilat janë të konsiderueshme, dhe ndikojnë negativisht në rritjen e të ardhurave.
Kriteri:	SKK 6. “Provizionet, detyrimet dhe aktivet e kushtëzuara” pika 3, si dhe Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të Ardhurat”
Ndikimi/Efekti:	Rritja e detyrimeve, mosarkëtim të të drejtave duke ulur të ardhurat e institucionit
Shkaku:	Punë e pamjaftueshme e strukturave të institucionit për arkëtimin e të drejtave dhe zvogëlimin e detyrimeve
Rëndësia:	E mesme
Rekomandim:	Drejtoria e Ekonomike në bashkëpunim me Drejtoritë Rajonale dhe Drejtorinë Juridike të marrin masa për analizimin e hollësishëm të debitorëve, për gjetjen e saktë të të dhënave të debitorëve fizik (ish-punonjës) dhe të subjekteve fizikë e juridik, duke identifikuar shumat pa shpresë arkëtimi të klientëve/debitorëve të ndryshëm, si dhe të sigurojë iniciimin e një procesi rivlerësimi, ku të gjitha të drejtat me palët e treta të analizohen sipas vjetërsisë dhe mundësive reale për arkëtimin dhe likuidimin e tyre, ku të propozohen masa konkrete, duke mos e

përrjashtuar masat administrative si dhe të gjitha rrugët ligjore për mbledhjen ose shuarjen e tyre.

-Drejtoria e Ekonomike të marrë masa për krijimin e provizioneve për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme, pasi të jenë evidentuar të dhënat për klientët/debitorët, si shumën e detyrimit, vjetërsinë e tyre dhe situatën aktuale të tyre, duke kaluar më parë të gjitha rrugët e mundshme ligjore për mbledhjen e tyre

- Gjendja e llogarisë 460 “*Hua të dhëna dhe interesa për t’u paguar*” në fund të vitit 2022 paraqitet në shumën 429,099,135 lekë, vlerë përfaqëson detyrimin e A.Sha për huanë e dhënë sipas VKD nr.30, datë 22.07.2022 “Për miratimin e huadhënies së A.Sha” miratuar nga MIE me shkresën 5646/1 datë 26.07.2022. Huaja është dhënë në shumën 421,200,000 lekë dhe interesat e huasë në vlerën 7,898,236 lekë.
- Në lidhje me këtë huadhënie u krye auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Institucioni nga ku rezultoi se, DPSHTRR për periudhën 01.08.2022-04.01.2023 ka tërhequr shumën 429,099,135 lekë nga “B.C.”, nga të cilat vlera 100,000 Euro në formën e overdraftit me interes 1.5%.
- Me shkresën nr.1892, datë 19.07.2022, nga Drejtoria e “A.” SHA, është bërë një kërkesë për mbështetje financiare në vlerën 8(tetë) milion Euro (gusht 2022-korrik 2023), si pasojë e mungesës së likuiditeteve nga një urdhër ekzekutimi i një gjykate belge mbi një proces gjyqësor.
- Me shkresën nr.17940/1, datë 19.07.2022 Drejtori i DPSHTRR, kthen përgjigje se do të shqyrtojë kërkesën për dhënie e huas në përputhje me mundësitë financiare dhe likuiditetin që disponon. Po kështu në shkresë citohet se: “në mbështetje të germës “a” të nenit 6, të germës “g” të nenit 10, të germës “a” dhe “l” të nenit 12 të Statutit do ti propozohet Këshillit Drejtues për miratim vlera e mundshme e huas, e cila i kalon për miratim Ministrin përgjegjës për transportin.
- Me shkresën nr.17940/2, datë 22.07.2022 Drejtori i DPSHTRR, i ka drejtuar Këshillit Drejtues kërkesë për miratimin e huadhënies. GMS, ka arritur në konkluzionin se DPSHTRR nuk ka mundësitë financiare për mbulimin e gjithë shumës së kërkuar nga A. sh.a., por të shqyrtoj mundësinë e marrjes së një overdrafti nga bankat e nivelit të dytë.
- Me vendimin nr.30, datë 22.07.2022, Këshilli Drejtues ka miratuar marrjen e overdraftit në shumën 936,000,000 lekë.
- Me shkresën nr.5646/1, datë 26.07.2022, kërkesa për huadhënie është miratuar nga Ministri.
- Me shkresën nr.18683, datë 02.08.2022, nga DPSHTRR është kërkuar çelja e overdraftit në shumën 936,000,000 lekë, pranë “C.B.” dhe në datën 05.08.2022 është nënshkruar kontrata.
- Me vendimin e Asamblesë së Aksionarit nr.88, datë 23.08.2022 Ministri i Financave znj. D.I., ka miratuar marrjen e një huaje nga DPSHTRR si edhe reflektimin e ndryshimeve në Programin e zhvillimit ekonomik.
- Në datën 24.08.2022, është nënshkruar Kontratë Huaje midis 2 Drejtorëve të Përgjithshëm z. B.G. dhe znj. L.O. ku palët marrin përgjegjësitë reciproke dhe shuma prej 936,000,000 lekë do të disbursohet në 12 këste.
- Me shkresën nr.3184, datë 29.12.2022 të Drejtorit Përgjithshëm të A. sh.a., znj. L.O., është kërkuar ndërprerje e përkohshme e disbursimit të huas ndaj A.I SHA nga DPSHTRR, përfshirë edhe këstin e muajit janar 2023. Në këto kushte nga DPSHTRR me datë 12.07.2023 i është kërkuar “C.B.”, ndërprerja e overdraftit sipas nenit nr.3 të kontratës.

- Në nenin nr.4 “Detyrimet e Huamarrësit” në pikën 4.5 përcaktohet se: “*Kthimi i shumës së marrë do të kryhet menjëherë me përmirësimin e situatës ekonomike të Huamarrësit(A.), në llogarinë bankare të Huadhënësit, brenda muajit Dhjetor të vitit 2023*”.
 - Pika 4.6, përcakton se, “Në rast pagese me këste, kësti i parë do të paguhet nga Huamarrësi brenda muajit Shtator 2023 në vlerën 300,000,000 lekë”
 - Kësti i dytë do të paguhet nga Huamarrësi brenda muajit Tetor 2023 në vlerën 300,000,000 lekë.
 - Pjesa e mbetur do të paguhet nga Huamarrësi brenda muajit Dhjetor 2023 në monedhën lekë.
- Nga auditimi konstatohet se ende nuk ka filluar shlyerja e huas si edhe nga DPSHTRR, nuk ka komunikim shkresor me Huamarrësin për kthimin e huas.

Konkluzion: DPSHTRR me këtë transaksion financiar, ka ulur të ardhurat e veta dhe ka rritur shpenzimet e vitit 2022, ndërkohë sipas përcaktimeve në kontratën e nënshkruar me Huamarrësin shlyerja e kësaj huaje nga “Albcontrol” SHA duhet të fillonte në muajin Shtator 2023.

- Gjendja e llogarisë 486 “*Shpenzime të periudhave të ardhshme*” në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 1,906,116 lekë, vlerë e cila ka të bëjë me konsumin e uniformave me përdorim më shumë se një vit.

9.Titulli i Gjetjes:	Huadhënie nga të ardhurat dhe overdraft nga C.B.
Situata:	<p>Gjendja e llogarisë 460 “<i>Hua të dhëna dhe interesa për t’u paguar</i>” në fund të vitit 2022 paraqitet në shumën 429,099,135 lekë, vlerë që përfaqëson detyrimin e A. Sha për huanë e dhënë sipas VKD nr.30, datë 22.07.2022 “Për miratimin e huadhënies së A. Sha” miratuar nga MIE me shkresën 5646/1 datë 26.07.2022. Huaja është dhënë në shumën 421,200,000 lekë dhe interesat e huasë në vlerën 7,898,236 lekë. Në lidhje me këtë huadhënie u krye auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Institucioni nga ku rezultoi se, DPSHTRR për periudhën 01.08.2022-04.01.2023 ka tërhequr shumën 429,099,135 lekë nga “B.C.”, nga të cilat vlera 100,000 Euro në formën e overdraftit me interes 1.5%. Në nenin nr. 4 “Detyrimet e Huamarrësit” në pikën 4.5 përcaktohet se: “<i>Kthimi i shumës së marrë do të kryhet menjëherë me përmirësimin e situatës ekonomike të Huamarrësit(A.), në llogarinë bankare të Huadhënësit, brenda muajit Dhjetor të vitit 2023</i>”.</p> <p>Pika 4.6, përcakton se, “Në rast pagese me këste, kësti i parë do të paguhet nga Huamarrësi brenda muajit Shtator 2023 në vlerën 300,000,000 lekë.</p> <p>Kësti i dytë do të paguhet nga Huamarrësi brenda muajit Tetor 2023 në vlerën 300,000,000 lekë. Pjesa e mbetur do të paguhet nga Huamarrësi brenda muajit Dhjetor 2023.</p> <p>Nga auditimi konstatohet se ende nuk ka filluar shlyerja e huas si edhe nga DPSHTRR, nuk ka komunikim shkresor me Huamarrësin për kthimin e Huas.</p>
Kriteri:	Kontratë Huaje nënshkruar në datën 24.08.2022 neni 4 “Detyrimet e Huamarrësit”.
Ndikimi/Efekti:	DPSHTRR me këtë transaksion financiar, ka ulur të ardhurat e veta dhe ka rritur shpenzimet e vitit 2022.
Shkaku:	Urdhër i Ministrit të linjës

Rëndësia:	E mesme
Rekomandim:	Strukturat Drejtuese të DPSHTRR të marrin masa për shlyerjen e Huas nga shoqëria “A.” në respektim të kushteve kontraktuale, me qëllim shlyerjen e overdraftit të marrë nga “C.B.” dhe arkëtimin e të ardhurave të krijuara nga DPSHTRR.

Mjete monetare në arkë dhe bankë në vlerën 3,061,550,286 lekë, paraqesin gjendjen e likuiditetit në llogaritë rrjedhëse të shoqërisë më 31.12.2022, të cilat paraqiten si vijon:

Përshkrimi	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Mjete monetare në bankë	1,459,712	4,425,053
Mjete monetare në arkë	3,012,656,098	3,263,356,181
Likuiditete në udhëtim	47,434,475	16,556,162
Totali	3,061,550,285	3,284,337,396

Likuiditete në udhëtim, janë vlera monetare të arkëtuara në 31.12.2022, të cilat janë depozituar me dropbox në bankë nga Drejtoritë Rajonale dhe janë arkëtuar në llogarinë bankare të DPSHTRR, nga banka me datën 05.01.2023.

Kapitali, Rezerva ligjore më 31.12.2022 është në vlerën 291,710,331 lekë, ku në krahasim me vitin 2021 ka pësuar një rritje në vlerën 29,930,490 lekë, (jo më shumë se 1/10 e shumës së kapitalit), sipas Vendimit të Këshillit Drejtues nr.27, datë 01.07.2022 “Për miratimin e llogarive vjetore dhe ndarjen e fitimit neto dhe miratimin e kapitalit të vitit 2021”.

Rezerva statutore ka pësuar ndryshime gjatë vitit 2022. Është shtuar në shumën 29,930,490 lekë, sipas Vendimit të Këshillit Drejtues nr. 27, datë 01.07.2022 “Për miratimin e llogarive vjetore dhe ndarjen e fitimit neto dhe miratimin e kapitalit të vitit 2021” Është pakësuar në shumën 25,447,440 lekë, nga të cilat shuma 21,877,173 lekë e shpërndarë me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm, bazuar në Vendimin e Këshillit Drejtues Nr.33, datë 22.07.2022 “Për miratimin e kriterëve të shpërndarjes së fondit për ndihma sociale”.

-Shpërblim performance vlera 10,712,908 lekë.

-Shpërblim për festimet e fund vitit vlera 10,550,000 lekë.

-Ndihmë për pagë dalje pension 614,265 lekë,

-Ndihmë rast sëmundje shuma 3,276,000 lekë

-Ndihmë në raste fatkeqësie familjare në vlerë 294,267 lekë.

Shuma 4,483,049 lekë e papërdorur gjatë vitit është mbyllur me rezervat për investime në zbatim të Statutit.

Rezerva për shpërblim është shtuar në vitin 2022 sipas Vendimit të Këshillit Drejtues nr. 27, datë 01.07.2022 “Për miratimin e llogarive vjetore dhe ndarjen e fitimit neto dhe miratimin e kapitalit të vitit 2021” në shumën 89,791,470 lekë. E përdorur gjatë vitit për shpërblim për punonjësit shuma 81,679,225 lekë. Shuma 8,112,245lekë e papërdorur gjatë vitit është mbyllur me rezervat për investime në zbatim të Statutit.

Rezerva të tjera është shtuar për vitin 2022 në shumën 29,930,490 lekë, sipas Vendimit të Këshillit Drejtues nr.27, datë 01.07.2022 “Për miratimin e llogarive vjetore dhe ndarjen e fitimit neto dhe miratimin e kapitalit të vitit 2021”. Përdorur gjatë vitit 2022, në shumën 7,000,000 lekë për mbështetje financiare për Fondacionin “D.H.”. Shuma 22,930,490 lekë, e papërdorur gjatë vitit është mbyllur me rezervat për investime në zbatim të Statutit.

Rezerva për investime Gjendja në 01.01.2021 në shumën -709,536,014 lekë, shtuar për vitin 2022 në shumën 419,026,858 lekë, sipas Vendimit të Këshillit Drejtues nr.27, datë 01.07.2022 “Për miratimin e llogarive vjetore dhe ndarjen e fitimit neto dhe miratimin e kapitalit të vitit 2021”, shtuar me shumën 35,525,784 lekë fondet e papërdorura (Rezerva ndihma sociale, rezerva për

shpërblim dhe rezerva te tjera), është pakësuar në shumën 755,651,388 lekë për investimet e kryera gjatë vitit sipas programit të investimeve dhe shkresave përkatëse, për çelje fondi për investime, të pasqyruara si shtesë në aktivet afatgjata për vitin 2022.

Detyrime afatshkurtra

Llogari të pagueshme tregtare e të tjera:

Ky post i bilancit më 31.12.2022 paraqitet në vlerën 2,089,626,651 lekë dhe përfaqëson detyrimet e shoqërisë ndaj furnitorëve, të drejta ndaj klientëve e ndarë në zëra si më poshtë:

Përshkrimi	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Llogari/Kerkesa te arketueshme (klient Furnitor)	229,997,821	196,440,529
Llogari/Kerkesa te tjera te arketueshme Personeli	22,938,894	6,113,411
TOTALI	252,936,715	202,553,940

- Gjendja e llogarisë “Kërkesa të arkëtueshme dhe të tjera” në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 252,936,715 lekë, vlerë e cila përbëhet nga:
- Gjendja e llogarisë “Kërkesa të pagueshme personeli” në vlerën 22,938,893 lekë e përbërë nga Llogaria 427 në vlerën 1,328,382lekë dhe llogaria 421 në vlerën 21,610,512 lekë detyrime për pagat e Muajit Dhjetor të paguara në Janar 2023.
- Gjendja e llog. 401-404 “Furnitorë e llogari të lidhura me to (detyrime ndaj furnitorëve)” në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 229,997,821 lekë e përbërë nga:
- Gjendja e llogarisë 401 detyrime ndaj furnitorëve në vlerën 213,884,579 lekë (për mallra) dhe llogaria 404 Furnitorë për investime në shumën 162,494 lekë, ku pjesën më të madhe e përbëjnë detyrimet e DPSHTRR në shumën 195,465,115 lekë.
- Gjendja e llogarisë 419 “Klientë për parapagime” në vlerën 14,833,177 lekë
- Gjendja e llogarisë 413 “Efekte për tu arkëtuar” në vlerën 1,117,571 lekë, llogari të cilat janë analizuar nga secila Drejtori Rajonale. Pjesa më e madhe e këtyre detyrimeve janë të trashëguara nga vitet e mëparshme.

Konkluzion: Sipas të dhënave dhe analizës së gjendjes së llogarisë 401-404 “Furnitorë e llogari të lidhura me to (detyrime ndaj furnitorëve)” në fund të vitit 2022 në vlerën 229,997,821lekë rezulton se, detyrimet e konstatuara ndaj furnitorëve dhe klientëve për parapagime në periudhën ushtrimore janë në vlera të konsiderueshme dhe nuk është bërë punë e mjaftueshme nga Drejtoria e Ekonomike për shlyrjen e detyrimeve ndaj të tretëve, me qëllim uljen e borxhit dhe eliminimin e penalteteve të mundshme nga pagesat e vonuara. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 10 296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, neni 12 “Përgjegjësia menaxheriale e nëpunësve zbatues” dhe Udhëzimin nr.30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.

10.Titulli i Gjetjes:	Detyrime të larta ndaj Furnitorëve dhe Klientëve
Situata:	Sipas të dhënave dhe analizës së gjendjes së llogarisë 401-404 “Furnitorë e llogari të lidhura me to (detyrime ndaj furnitorëve)” në fund të vitit 2022 në vlerën 229,997,821 lekë rezulton se, detyrimet e konstatuara ndaj furnitorëve dhe klientëve për parapagime në periudhën ushtrimore janë në vlera të konsiderueshme dhe nga Drejtoria e Ekonomike nuk janë marrë masat e nevojshme për shlyrjen e detyrimeve ndaj të tretëve.
Kriteri:	Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, neni 12 “Përgjegjësia menaxheriale e

	nëpunësve zbatues” dhe Udhëzimin nr.30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.
Ndikimi/Efekti:	Rritje e nivelit të detyrimeve
Shkaku:	Punë e pamjaftueshme nga Drejtoria Ekonomike
Rëndësia:	E mesme
Rekomandim:	Drejtoria Ekonomike të marrë masa për shlyerjen në kohë të detyrimeve ndaj Furnitorëve dhe Klientëve me qëllim uljen e borxhit dhe eliminimin e penaliteteve të mundshme nga pagesat e vonuara.

- Gjendja e llogarisë 4311 “Te drejta dhe taksa për t'u derdhur në zyrat e tatimeve” në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 1,302,376,330 lekë. DPSHTRR ushtron veprimtarinë si agjent për mbledhjen e taksave kombëtare të: taksa e mjeteve të përdorura të transportit rrugor, taksa e regjistrimit fillestar të automjeteve luksoze dhe taksa e përvitshme e automjeteve luksoze dhe tarifave të pajisjes me leje drejtimi, sipas përcaktimeve të bëra në ligin nr.9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare” i ndryshuar. Këto detyrime janë likuiduar në Janar të vitit 2023 sipas Deklarimeve përkatëse brenda afateve ligjore’. Analiza e gjendjes së kësaj llogarie paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Përshkrimi	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Detyrime Tatim Taksa	1,158,500,921	1,040,510,516
Detyrim Tarifa leje drejtimi	35,343,803	33,458,053
Tatim mbi te ardhurat personale	32,460,705	26,594,130
Sigurime shoqërore e shëndetësorë	33,015,387	26,634,360
TVSH	41,125,072	10,856,364
Tatim në burim	1,930,442	320,793
Tatim fitimi		27,452,814
Gjendja më 31 dhjetor	1,302,376,330	1,165,827,029

- Gjendja e llogarisë 4313 “Te drejta dhe taksa për t'u derdhur në Thesar” në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 534,313,606 lekë. Kjo gjendje përbëhet nga:
- Detyrim ndaj Degëve të Thesarit për gjokat e arkëtuara, nga të cilat 60% është pjesë e DPSHTRR dhe 40% derdhet në thesar, të cilat janë derdhur në vitin.
- Detyrim për kontribut pensioni suplementar ndaj “C.P.” Sha dhe Instituti i Integritimit të Përndjekurve Politik për muajin dhjetor 2022, derdhur në janar 2023 për shumën 3,290,828 lekë.
- Si dhe shumën 39,461,270 lekë, e cila ka të bëjë me kreditorë të tjerë kryesisht nga detyrimet e lindura nga njohja e detyrimeve nga VKM e shpronësimit për pronarët e truallit të Godinës së DPSHTRR, shuma të cilat janë refuzuar të tërhiqen nga pronarët, si dhe derdhje gabim të vlerave monetare nga subjekte të ndryshme shuma të cilat nuk janë kthyer për mungesë informacioni lidhur me nr e llogarive përkatëse të cilat janë të analizuara nga Drejtoritë Rajonale, sipas viteve të krijimit të tyre.
- Shuma prej 100,515,733 lekë, që përfaqëson overdraft e tërhequr nga DPSHTRR në C.B., sipas marrëveshjes së huadhënies të nënshkruar me A. sh.a..

Analiza e gjendjes së kësaj llogarie paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Detyrime të pagueshme të tjera

Përshkrimi	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Detyrime të tjera Thesari	11,380,866	2,844,933
Detyrim Bashkie taksa mjeteve 25%	361,802,425	292,206,590
Detyrime të tjera	15,318,444	1,004,822
Detyrim për sigurim vullnetar	3,290,828	2,617,459
Kreditorë të tjerë	39,461,270	39,661,900
Huamarrje nga banka	100,515,733	

Të ardhura të shtyra(Shpenz.periudh.ardhshme)	5,835,167.24	3,670,691.00
Gjendja më 31 dhjetor	534,313,606	342,006,395

Konkluzion: Gjendja e llogarisë 486 “Shpenzime te periudhave te ardhshme” në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 5,835,167 lekë, gjendje e cila është regjistruar nga DR Tiranë, dhe pasqyron detyrimet e punonjësve të Drejtorisë Rajonale Tiranë, që janë në procese gjyqësore, të trashëguara prej vitit 2016. Kjo gjendje krahasuar me vitin 2021 ka rritje në vlerën 2,164,476 lekë. Për detyrimet e proceseve gjyqësore, DR Tiranë duhej të krijonte provizionin për vlerën e tyre 5,835,167 lekë. Mos llogaritja e provizioneve për vitin 2022, për detyrimet e proceseve gjyqësore e njohur dhe e kontabilizuar si një detyrim në pasqyrën e pozicionit financiar, është në kundërshtim me SKK 6 “Provizionet, detyrimet dhe aktivet e kushtëzuara” pika 37.

11.Titulli i Gjetjes:	Detyrime të proceseve gjyqësore
Situata:	Gjendja e llogarisë 486 “Shpenzime te periudhave te ardhshme” në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 5,835,167 lekë, gjendje e cila është regjistruar nga DR Tiranë, dhe pasqyron detyrimet e punonjësve të Drejtorisë Rajonale Tiranë, që janë në procese gjyqësore, të trashëguara prej vitit 2016. Kjo gjendje krahasuar me vitin 2021 ka rritje në vlerën 2,164,476 lekë. Për detyrimet e proceseve gjyqësore, DR Tiranë duhej të krijonte provizionin për vlerën e tyre 5,835,167 lekë.
Kriteri:	SKK 6 “Provizionet, detyrimet dhe aktivet e kushtëzuara” pika 37.
Ndikimi/Efekti:	Mos njohja e detyrimeve në momentin e konstatimit të tyre, por në momentin që likuidohen.
Shkaku:	Mungesë koordinimi midis Drejtorisë Ekonomike dhe Drejtorisë Juridike
Rëndësia:	E mesme
Rekomandim:	Drejtorja e Ekonomike të marrë masa të menjëhershme për njohjen në kontabilitet të vlerës së plotë të proceseve gjyqësore të cilat kanë marrë formë të prerë si shpenzime të periudhës në “Pasqyrën e performancës financiare” të institucionit dhe krijimin e provizioneve si një detyrim në pasqyrën e “Pozicionit financiar”

Detyrimet afatgjata

Ky post i bilancit më 31.12.2022 paraqitet në vlerën 28,468,568 lekë e përbërë nga grante, ku vlera e amortizimit të tyre e përlogaritur është pasqyruar në zërin “Te ardhura nga grantet” dhe në shpenzime në zërin “Amortizimet e AA Materiale” me efekt 0 në pasqyrën e performancës financiare të institucionit. Analiza e gjendjes së këtij posti të bilancit paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Përshkrimi	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Programe informatike ABS	366,359	488,479
Makineri pajisje Projekti IPA	22,128,618	27,660,776
Pajisje zyre	5,304,153	6,622,695
Pajisje informatike	669,445	871,833
Gjendja më 31 dhjetor	28,468,568	35,643,783

Të ardhurat, përbëhen kryesisht nga të ardhurat nga shërbimi regjistrimi i mjeteve, lejet e drejtimit, nga shërbimi i prerjes së taksave, nga gjobat e Taksave Vjetore e Mjeteve të Përdorura (TVMP), Taksave Vjetore e Mjeteve te Luksit (TVML), Kontrolli teknik vjetor (KTV) dhe Task Forca etj, në vlerën 3,594,826,492 lekë, krahasuar me vitin 2021 ka një rritje prej 383,973,798

lekë.

Ndikim në rritjen e të ardhurave në vitin 2022 krahasuar me 2021, kanë dhënë të ardhurat e regjistrimit të mjeteve, të ardhurat nga penalitetet dhe gjobat nga taksat vjetore e mjeteve të përdorura, si dhe të ardhura nga agjentë tatimor sipas ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare” i ndryshuar dhe TRML 5%.

Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesi nga fondet e investuara në depozita bankare dhe fitimet nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave. Të ardhurat nga interesi njihen dhe përllogariten duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Kostot financiare përfshijnë shpenzimet e interesit për huatë, humbjet nga kursi i këmbimit dhe humbjet nga zhvlerësimet. Të gjitha kostot e huave janë njohur në pasqyrën e të ardhurave duke përdorur metodën e interesit efektiv. Humbjet apo fitimet nga kursi i këmbimit dhe interesi janë paraqitur në vlerë neto dhe paraqiten si vijon:

Përshkrimi	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Shpenzime për interesa OVD	6,902,783	-
Humbje nga konvertimi	2,749,949	1,228,996
Fitime nga këmbimet valutore	35,627	33,229
Të ardhura nga interesa	34,249,348	40,091,511
Të ardhura interesa OVD Albkontroll	6,923,067	-
Totali	31,555,310	38,895,744

Të ardhurat nga interesat në vlerën 34,249,348 lekë, ka të bëjë me të ardhurat nga interesat e llogarive rrjedhëse prej 1.5%, për të cilat shoqëria ka një marrëveshje të lidhur me C.B., me nr.7579, datë 01.04.2019 dhe A. B.me nr.7579/1, datë 01.04.2019.

Shpenzime për materiale dhe energji

Shpenzimet për materiale dhe energji për vitin e mbyllur janë detajuar si më poshtë:

Përshkrimi	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Furnizime mallra dhe shërbime	255,520,301	189,978,632
Blerje materiale të para	206,409,865	171,980,300
Energji elektrike	35,376,794	29,400,290
Shërbime të tjera	14,095,115	2,858,172
Totali	511,402,075	394,217,394

Rritja e shpenzimeve krahasuar me vitin 2021 është pasojë e kalimit të aktivitetit të Kontrollit Teknik Vjetor nga Koncensionari në Maj të vitit 2021 dhe shpenzimet për vitin 2022 janë të plota për 12 muaj.

Shpenzimet e personelit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 paraqiten si vijon:

Përshkrimi	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Paga personeli	1,361,237,391	1,101,800,316
Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	219,447,396	178,669,397
Shpenzime të tjera (shpërblime)	237,491,204	189,494,841
Shpenzime të tjera për personelin vjetërsi në punë	1,107,322	120,638
Totali	1,819,283,314	1,470,085,192

Në krahasim me vitin 2021, konstatohet rritje e shpenzimeve për personelin, kjo për arsye të ndryshimit të strukturës në vitin 2021, me kalimin e aktivitetit të kontrollit teknik të detyrueshëm për mjetet rrugore të propozuara sipas VKD nr. 2, datë 10.02.2021 dhe të miratuar nga MIE me urdhrin nr. 107, datë 22.02.2021 dhe me VKD nr. 2 datë 28.01.2022, të miratuar nga MIE me urdhrin nr. 34, datë 16.02.2022 dhe VKD nr 40, datë 10.10.2022, të miratuar nga MIE me shkresën nr. 7740/1, datë 26.10.2022.

Shpenzime të tjera

Shpenzimet e tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 detajohen si më poshtë në lekë:

Përshkrimi	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Mirëmbajtje dhe riparime	80,784,519	68,260,990
Sigurime	14,353,624	10,863,711

Roje private	162,973,055	157,475,753
Shpenzime qiraje	8,240,003	18,456,437
Shpenzime pritje dhe përfaqësime	1,796,705	524,800
Udhëtime e dieta	17,039,173	11,641,814
Kontribut për përndjekurit politik	12,428,922	9,932,969
Shpenzime komunikimi dhe postare	15,202,597	13,479,298
Tatime dhe taksa	2,291,601	1,573,380
Komisione dhe tarifa bankare	626,671	637,015
Gjoha dhe dëmshpërblime	12,703,745	21,804,362
Shërbime Rivlerësimi AMM	0	28,170,000
Shërbime auditimi	1,710,000	5,700,000
Honorare këshilli drejtues e tjera	4,928,980	4,472,197
Shpenzime transport	3,944,085	3,428,577
taksa tarifa vendore	1,678,386	3,060,249
Publicitete dhe reklama	7,974,380	2,992,326
Vlera kontabël e AAM të dala jashtë përdorimi	7,046,719	14,542,026
Sherbim Printimi	16,555,458	9,224,878
Shpenzime per sponsorizime	5,340,300	10,588,035
Te tjera	3,388,627	4,182,908
Humbje nga gabime lejuara	16,960	212,582
Totali	372,206,950	378,895,148

Në krahasim me vitin 2021 totali për këto zëra shpenzimesh është ulur 1,440,463 lekë, rritje ka zëri “*Mirëmbajtje dhe riparime*”, ku në vitin 2022 është lidhur kontrata nr. 16763. datë 08.08.2022 për “*Mirëmbajtje pajisje të testimeve të kontrollit teknik*” me vlerë 2,583,217 lekë/muaj si edhe rritje në shpenzimet për ruajtje objekti si rezultat i rritjes së kostove nga rritja e pagës minimale.

Tatim fitimi aktual është tatimi që përlllogarit mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi prej 15%. Tatimi i shtyrë nuk është aplikuar nga DPSHTRR, për faktin se institucioni përdor norma amortizimi manaxheriale, të cilat janë të njëjta me normat e amortizimit fiskal.

Për të llogaritur rezultatin neto të vitit 2021-2022, shoqëria ka bërë sistemimet e nevojshme të përcaktuara në ligjin për tatimin mbi të ardhurat, të konsideruara si shpenzime të pa zbritshëm për qëllimin e përcaktimit të rezultatit fiskal.

Përshkrimi	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Fitimi para tatimit	583,470,352	712,956,819
Total shpenzime të panjohura	33,424,026	49,356,646
Penalite gjoha dhe dëmshpërblime	12,703,745	21,804,362
Amortizim tej normave tatimore pas vleresimit	12,646,456	12,026,687
Shpenzime të tjera	7,045,819	14,977,558
Shpenzime uje + kafe	1,028,006	548,041
Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e njohura)	616,894,379	762,313,465
Tatim fitimi	92,534,157	114,347,020

Mbajtja e librave të blerjes dhe të shitjes nga institucioni si dhe deklarimet e bëra nga institucioni mbi tatimin e vlerës së shtuar.

Nga krahasimi i të dhënave të sistemit informatikë të regjistruar nga DPSHTRR, të librave të blerjes dhe të shitjes së deklaruara nga subjekti dhe deklaratës së tatimit mbi vlerën e shtuar nuk u konstatuan diferenca për periudhën objekt auditimi.

Shoqëria për blerjet e realizuara ka faturën origjinale të blerjes si dhe deklaratat origjinale te Importit. Faturat e blerjes dhe të shitjes përmbajnë të gjitha kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 92/2014 “*Për tatimin mbi vlerën e shtuar*” si dhe Udhëzimet e Ministrit të Financave nr. 6, datë 30.01.2015 “*Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar*”.

Në lidhje me faturat e shitjeve, rezultoi se ato janë të regjistruara në mënyrë kronologjike në librin e shitjeve dhe shuma e deklaruar në librin e shitjeve përputhet me deklaratën e tatimit mbi vlerën e shtuar në tatime.

Deklarimet e “*Tatimit mbi vlerën e shtuar*” janë bërë në përputhje me ligjin nr. 92/2014 “*Për*

tatimin mbi vlerën e shtuar” neni 106 “Deklarata e TVSH-së” dhe neni 107 “Afati i paraqitjes së deklaratës dhe periudha tatimore”, ku citohet se “..deklarata e TVSH-së, e bërë në përputhje me nenin 106, të këtij ligji, duhet të dorëzohet jo më vonë se 14 ditë pas përfundimit të periudhës tatimore që deklarohet”.

Të gjitha blerjet e realizuara nga institucioni janë të justifikuara me fatura tatimore blerje, të cilat janë kryer në funksion të aktivitetit që ushtron shoqëria dhe për qëllime të veprimtarisë ekonomike të shoqërisë, ku kreditimi i TVSH-së është kryer në përputhje me ligjin nr. 92/2014, datë 24.07.2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në RSH” i ndryshuar.

Sigurimet shoqërore

Në zbatim të Ligjit nr. 9136 date 11.02.2003 “Për mbledhjen e detyrueshme të Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësorë” si dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 23, datë 09.12.2014 “Për mbledhjen e detyrueshme të Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësorë” u bë kontrolli llogaritjeve dhe arkëtimit të tyre. Nga kontrolli i listëpagesave rezultoi që shoqëria ka llogaritur, mbajtur dhe derdhur rregullisht sigurimet shoqërore dhe shëndetësorë për të gjithë punonjësit.

Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore janë paguar për çdo muaj sipas legjislacionit në fuqi. Pagesat e bëra nga subjekti janë bërë duke u bazuar në listëpagesat e deklaruar on-line.

Gjithashtu kontrolli i bere në subjektin në lidhje me numrin e punonjësve të deklaruar rezultoi se DPSHTRR nuk ka punonjës të pa deklaruar në listëpagesë. Nga kontrolli i listëpagesave vërejmë që punonjësit e DPSHTRR për efekt të pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore si dhe pagesës së tatimit mbi të ardhurat personale janë trajtuar mbi kufijtë e pagës minimale, sipas pozicioneve dhe kualifikimeve të përcaktuara në VKM-të përkatëse.

Llogaritja e kontributeve për Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore është bere saktë, të cilat janë deklaruar dhe derdhur në afatet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

Inventarizimi i pronës shtetërore:

Nisur nga rëndësia dhe materialiteti sasior dhe në natyrë të aspekteve të menaxhimit material dhe mundësisë për veprime të pajustificuara, ky aspekt është audituar shtrirë për periudhën 2021-2022. Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i praktikave dokumentuara të vëna në dispozicion të grupit të auditimit, ka rezultuar se, çdo vit janë realizuar proceset e inventarizimit parashikuar në Paragrafi nr. 74, i Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar.

Regjistrimi i aktiveve është kryer konform Kreut III, “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, date 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësite e Sektorit Publik”. Hyrja e aktiveve për çdo raste dokumentohet me flete hyrjen përkatëse, të hartuat sipas gjendjes fizike të tyre, konform pikës 37, të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 30, date 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”. Dalja e aktiveve për çdo rast, janë kryer konform pikës 38, të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 30, date 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësite e Sektorit Publik”.

Procesi i inventarizimit të aktiveve, për vitet 2021-2022 është kryer nga disa komisione të ngritur sipas urdhrave të Titullarit të Institucionit “Për kryerjen e inventarit fizik” për të gjithë Drejtoritë Rajonale. Nga drejtoria janë nxjerrë urdhrat përkatës për inventarizimin e aktiveve nga ku rezulton se inventarët janë kryer konform udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Komisionit të Inventarizimit i është ngarkuar të verifikojë gjendjen fizike dhe cilësore të aktiveve në ngarkim/përdorim, të hartojë procesverbalin përkatës, të bëjë krahasimet me librat e kontabilitetit dhe të japë mendim për diferencat që mund të lindin.

Komisioni është bazuar në të dhënat e regjistrit kontabël për kryerjen e inventarizimit të pasurisë. Në dosje janë depozituar kartelat/fletët e inventarit të çdo punonjësi, të nënshkuara rregullisht nga komisioni i inventarizimit dhe persona materialisht përgjegjës.

Për vitin 2022, nga DPSHTRR janë kryer procedurat dhe ngritur komisione për vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimi të materialeve që kanë humbur funksionin e përdorimit.

II.2.6. “Zbatimi i ligshmërisë në prokurimet për investime, për blerje mallrash e shërbimesh, si dhe zbatimi i kontratave (saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësim i kriterëve, fondi limit, vlerësim i ofertave dhe shpallja e fituesit), si dhe zbatimi i punimeve, deri në marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve dhe zbatimi i kontratave të punëve publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim”

Për periudhën nga 07.2021- 31.12.2021 janë zhvilluar procedurat e prokurimit të mëposhtme:

Emertimi	Fondi Limit	Data	Operatori Ekonomik	Vlera e ofertuar
Blerje Karta të memories për tahografët dixhital	52,930,760	01.12.2021	C.	52,930,760
Blerje Prokat Leje Qarkullimi për mjetet rrugore	68,324,000	09.12.2021	A.	68,324,000
Objekti kryesor: “Mbikqyrësi i investimeve që do të kryhen në DPSHTRR dhe në Drejtoritë Rajonale”		13.08.2021		
#NAME?	564,145	22.11.2021	N-G	452,496
#NAME?	710,008	22.11.2021	T.	566,317
#NAME?	1,310,518	22.11.2021	M.C.	1,054,470
Rikonstruksioni i qendres së kontrollit teknik dhe sheshit funksional në DRSHTTR Korçë	27,736,514	27.10.2021	N.	18,854,206
#NAME?	716,789	20.08.2021	D.	577,345
Rikonstruksioni i kaponit për kryerjen e identifikimit teknik dhe fizik të mjeteve dhe sheshit funksional për DRSHTTR Sarandë	37,219,514	08.11.2021	I.- K.	36,501,847
Loti I: “Mobilim i DRSHTTR BERAT”	18,385,685	02.09.2021	B.	17,900,000
Loti III: “Mobilim i DRSHTTR LAC”	20,724,126	02.09.2021	B.	18,561,550
#NAME?	540,599	22.11.2021	P. D. 2.	432,384
Rikonstruksion në DRSHTTR Dibër, Rikonceptim dhe unifikim i veshjeve strukturore, rehabilitim i sheshit funksional dhe godinës së Kontrollit Teknik	46,247,107	28.07.2021	2.	36,877,887
Shërbim printimi, fotokopimi dhe skanimi në sistemin e Drejtorisë së Përgjithshme dhe Drejtoritë Rajonale në varësi	46,797,617	06.07.2021	I. O.	46,797,617
Mirëmbajtja e gjithë sistemit që përfshin softëare e ri, softëare-in MAHA të bërë upgrade, pajisjet Hardëare si dhe pajisjet e testimit	30,750,000	07.07.2021	V. A.	30,625,000
Mbikqyrësi i investimeve që do të kryhen në Drejtoritë Rajonale	3,740,910	12.11.2021		
Rikonstruksioni i Qendrës së Kontrollit Teknik dhe sheshit funksional në DRSHTTR Berat-Dega Dimël	31,149,001	26.10.2021	A.	25,453,815
Rikonstruksion i kaponit për kryerjen e identifikimit teknik dhe fizik të mjeteve dhe sheshit funksional për DRSHTTR Gjirokastrë	33,501,407	10.09.2021	I – K.	32,500,509
Loti IV: “Mobilim i DRSHTTR VLORE”	7,552,412	02.09.2021	K.	6,988,800
#NAME?	615,639	22.11.2021	L. C.	490,432
LOTI I: “Mbikqyrja e punimeve të investimit me objekt: “Rikonstruksion për qendrat e Kontrollit Teknik Tirana 1 dhe Tirana 2”	1,521,159	20.08.2021	M.. S.	1,236,146
Botime e publikime katalogje, libra	2,719,333	18.10.2021	K.K.	1,950,000
Sherbime me video animacione, promo dhe shërbime fotografike	5,835,000	06.07.2021	F. E.	5,835,000
Loti II: “Mobilim i DRSHTTR KORÇË”	18,385,685	02.09.2021	B.	17,900,000
Blerje materiale për evente	4,667,467	28.10.2021	L.	4,667,467
Qeramarrje foni dhe stage	3,966,500	09.08.2021	A.	3,966,500
Rikonstruksion i kaponit për kryerjen identifikimit teknik dhe fizik të mjeteve dhe sheshit funksional për DRSHTTR Fier	78,033,233	07.09.2021	D. C.	70,035,682

DPSHTRR bazuar në Regjistrin e Realizimeve vënë në dispozicion grupit të auditimit si dhe verifikimit në Sistemin e Prokurimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik, për periudhën nga 07.2021-31.12.2021 ka realizuar 20 procedura prokurimi me vlerë të lartë me fond limit në shumën 537,757,039 lekë pa tvsh, për gjatë vitit 2022 ka realizuar 27 procedura prokurimi me vlerë të lartë me fond limit në shumën 1,671,783,449 lekë pa tvsh.

Bazuar në një analizë risku dhe në metodat e përzgjedhjes për auditim të procedurave të prokuruarë u vendos për auditimin e procedurave të mëposhtme:

• **Procedura “Blerje Prokat Leje Qarkullimi për mjetet rrugore” 2021**

Fondi limit

Në vlerën (68,324,000) lekë pa TVSH

Përmbledhja e procedurës në tabelë

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “ Blerje Prokat Leje Qarkullimi për mjetet rrugore” 2021		
1. Urdhër Prokurimi Nr 1026 datë 17.10.2021		
Lloji i rocedures së Prokurimit: Procedurë e Hapur	2. Njësia e Prokurimit znj. A. G. znj. B.G. z. A.N.	3. Komisioni për hartimin e Specifikimeve Teknike: z. A. N. znj. A. M. znj. B. H. znj. A. D. z. E. B.
4. Fondi limit (pa tvsh) Lekë 33,395,993 lekë	5. Burimi i Financimit Buxheti i institucionit	6. Data e hapjes së tenderit 02.12.2021
7. Operatorët Ekonomikë a) Pjesmarrës A. shpk 23,600,000 lekë O.P. shpk 27,200,000 lekë A.S. shpk 33,950,000 lekë C. 41,600,000 lekë A. 49,000,000 lekë b) kualifikuar: A. shpk 23,600,000 lekë	8. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave z. D. A. z. E.H. znj. E. H.	9. Oferta fituese (pa tvsh) 23,600,000 lekë
10. Data e lidhjes së kontratës 2797/1 datë 08.02.2022	11. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 9,795,993 lekë	12. Ankimime Nuk ka
13.Struktura për ndjekjen e kontratës J. V. V. P. R. B.	14. Fletë hyrja	15. Afati i kontratës 24 muaj nga data e firmosjes së kontratës
16.Situacioni përfundimtar/Faturë malli/shërbimi Kontrata nr.1 datë 04.02.2022 200.000 leje Kontrata nr.2 datë 16.02.2023 200.000 leje		

Specifikimet Teknike (të përmbledhura)

Në vijim është tabela me karakteristikat teknike të materialit të letrës. Meqenëse materiali i letrës është shumë i veçantë dhe specifik me karakteristika të detajuara.

Nr	Përshkrimi	Njësia	Vlera	Metoda e testimit	Toleranca
1	Masa specifike sipërfaqësore	g/m ²	200	DIN EN ISO 536	±5%
2	Trashësia	µm	240	DIN EN ISO 534	±5%
3	Densiteti i dukshëm vëllimor	g/m ³	0,83	DIN EN ISO 534	±5%
4	Forca elasticitetit gjatësor	N/15mm	79	DIN EN ISO 1924-2	±5%
5	Forca elasticitetit tërthor	N/15mm	62	DIN EN ISO 1924-2	±5%
6	Elasticiteti gjatësor në tërheqje	%	14,3	DIN EN ISO 1924-2	±5%
7	Elasticiteti tërthor në tërheqje	%	19,7	DIN EN ISO 1924-2	±5%
8	Forca e elasticitetit gjatësor në lagështirë	N/15mm	20	DIN ISO 3781	±5%
9	Forca e elasticitetit tërthor në lagështirë	N/15mm	16	DIN ISO 3781	±5%
10	Rezistenca ndaj dëmtimit gjatësor	mN	4200	DIN EN ISO 1974	±5%
11	Rezistenca ndaj dëmtimit tërthor	mN	4800	DIN EN ISO 1974	±5%
12	Patejdukshmëria	%	90	DIN 53 146	±5%

Pesha specifike e prokatit **leje qarkullimi – 4,5 gr ±0,5 gr**
Përmasat e prokatit **leje qarkullimi – 210 mm x 105 mm**

Prokati duhet të ketë elemente të sigurisë me përshkrimin si më poshtë:

- **Hologramë**, e inkorporuar në sipërfaqen e letrës sipas **vizatimit me nr. 2**.
Imazhi holografik duhet të realizohet nga Teknologjia E-beam me rezolucion jo më pak se 500.000 dpi. Holograma është rreth me diameter 20 mm. Efekti kinetik holografik.
Imazhi holografik 3D i relievit të "Dea e Butrintit", ku në njërin plan ngjyrat lëvizin nga e majta në të djathtë me intensitet të lartë nën efektet e lëvizjes së figurës.
Holograma përmban mikrotekst 5 mikronë që lexohet vetëm me lupë zmadhuese. Mikroteksti është "AL & DPSHTRR". Holograma përmban nanotekst 5 mikronë që lexohet vetë me lupë zmadhuese "REPUBLIKA E SHQIPËRISË". Holograma përmban ngjyrat mat gri dinamik me hije të ndryshme që mundet të shihet në pozicionin qëndror të shikimit. Këndi akut ngjyra gri varion me hije dhe ndryshon në mënyrë të theksuar që nuk duket në pamjen kryesore, shfaqet me një rrotullim në aksin horizontal. Pamja e rrotullimit 90 gradë: Një shkrim info e fshehur "AI", në zonën e figurës përmban një imazh të fshehur i cili nuk është i dukshëm për syrin e lirë, që nuk duket në pamjen kryesore, shfaqet me një rrotullim prej 90 gradë në boshtin vertikal.
Efekt zbardhimi 180 gradë: një element i dukshëm në pamjen kryesore zhduket pasi të rrotullohet 180 gradë në aksin vertikale dhe shfaqet një zonë mat.
Holograma përmban mikroimazh të përcaktuar në pozicione të ndryshme të kampionit i jo më shumë se 100x100 mikronë. Holograma përmban nanoimazh i inkorporuar jo më shumë se 1000 x1000 mikronë. Holograma përmban simbole të ndryshme të përcaktuara me rezolucion të lartë në trashësi 50 mikronë.
- **Watermark**, e inkorporuar në sipërfaqen e letrës që duket nën veprimin e rrezeve të dritës, tekst "DPSHTRR" që përsëritet në mënyrë frekvente si edhe "Shqiponja" sipas **vizatimit me nr. 3**.
- **Kompozim fluoreshent** sipas **vizatimit me nr. 4**, të padukshëm me sy të lirë, por që të jetë qartësisht i dukshëm, nën rrezet ultraviolet (UV).
- **Fibra fluoreshente** të shpërndara të çrregullta, të padukshëm me sy të lirë, por që të jenë qartësisht të dukshëm, nën rrezet ultraviolet (UV), vendosja në prokat në anën e kundërt me kompozimin fluoreshent sipas pikës 6.
- **Mikrotekst** – REPUBLIKA E SHQIPËRISË e alternuar me DPSHTRR në konturet e dukshme me sy të lirë të shqiponjës, sipas **vizatimit me nr. 1**.
- **Harta e Shqipërisë** në miniaturë, ku në njërin plan ngjyrat lëvizin nga e majta në të djathtë (ndryshon ngjyrë) në kënde të ndryshme shikimi, sipas **vizatimit me nr.1**.
Elementë, karaktere, simbole apo dizeno, me reliev (që ndihen me prekje).

Më poshtë rendisim 5 elementet vizuale të domosdoshëm që duhet të përmbaje specimeni sipas DST, konkretisht:

- Kompozim fluoreshent sipas vizatimit 4, të padukshëm me sy të lirë, por që të jetë qartësisht i dukshëm, nën rrezet ultraviolet (UV).
- Fibra fluoreshente të shpërndara të çrregullta, të padukshëm me sy të lirë, por që të jenë qartësisht të dukshëm, nën rrezet ultraviolet (UV).
- Mikrotekst – REPUBLIKA E SHQIPËRISË e alternuar me DPSHTRR në konturet e dukshme me sy të lirë të shqiponjës, sipas vizatimit 1.
- Harta e Shqipërisë në miniaturë, ku në njërin plan ngjyrat lëvizin nga e majta në të djathtë (ndryshon ngjyrë) në kënde të ndryshme shikimi, sipas vizatimit 1.

- Elementë, karaktere, simbole apo dizenjo, me relief (që ndihen me prekje).

Mënyra si do kontrollohen nga specialistet e fushës :

- Dy treguesit e pare (1,2) nëpërmjet një llambe te thjeshte UV
- Mikroteksti nën ndriçimin e dritës me ndihmën e një lupe të thjeshtë
- Harta e Shqipërisë : Dallohet me sy te lire nen efektin e dritës në këndvështrime të ndryshme. Ngjyra është variable.
Elementë, karaktere, simbole apo dizenjo, me relief që ndihen me prekje.

Operatorët Ekonomik, pjesëmarrës në procedurën e prokurimit renditen si më poshtë:

- Operatori ekonomik "**A.**" shpk me ofertë **23.600.000** (njëzetë e tre milionë e gjashtëqind mijë) lekë pa TVSH.
Vlera e ofruar me TVSH është **28.320.000** (njëzetë e tetë milionë e treqind e njëzete mijë) leke.
- Operatori ekonomik "**O.P.**" shpk me ofertë **27.200.000** (njëzetë e shtatë milione e dyqind mijë) lekë pa TVSH.
Vlera e ofruar me TVSH është **32.640.000** (tridhjetë e dy milionë e gjashtëqind e dyzetë mijë) lekë.
- Operatori ekonomik "**A. S.**" shpk me ofertë **33,950.000** (tridhjetë e tre milionë e nëntëqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH.
Vlera e ofruar me TVSH është **40.740.000** (dyzetë milionë e shtatëqind e dyzetë mijë) lekë.
- Operatori ekonomik "**C., G. and D. S., d.d**" me ofertë **41.600.000** (dyzetë e një milionë e gjashtëqind mije) lekë pa TVSH.
Vlera e ofruar me TVSH është **49.920.000** (dyzetë e nëntë milionë e nëntëqind e njëzetë mijë) lekë.
- Operatori ekonomik "**A. P.**" shpk me ofertë **49.000.000** (dyzetë e nënte milionë) lekë pa TVSH.
Vlera e ofruar me TVSH është **58.800.000** (pesëdhjetë e tetë milionë e tetëqind mijë) lekë.
- Nga operatori ekonomik "**A.C. shpk** në listën e dokumenteve të paraqitura nga ky operator ekonomik rezulton të jetë vetëm një dokument "NIPTI". Nuk është paraqitur asnjë dokument tjetër. Nuk është paraqitur formulari i Mertës.

Nga auditimi i procedurës së mësipërme u konstatua:

- Oferta e dhënë nga O.E. "**A.**" shpk me ofertë **23.600.000** lekë pa TVSH, shpallet ofertë anomalisht e ulët, ku pas sqarimeve të dhënë nga O.E. pranohet si ofertë e suksesshme, ku një prokat leje qarkullimi jepet me çmimin 59 lek. Nisur nga kjo, përlllogaritja e fondit limit si dhe zhvillimi i procedurave të mëparshme të ngjashme mbi blerjen e prokatis të lejeve të qarkullimit është kryer mbi një përlllogaritje jo të saktë të fondit limit, duke rritur kostot e institucionit.
- Gjatë zbatimit të kontratës, sipas Procesverbalit nr.1 në marrjen në dorëzim të prokatis të lejeve të qarkullimit, mbajtur më datë 11.06.2022, u morën në dorëzim në total 17474 copë prokat leje qarkullimi. Nga grupi i auditimit u konstatua që numri serial i marrjes në dorëzim ishte 0000000096402 dhe jo 0000000000001 siç duhet të ishte, duke marrë në konsideratë që është dorëzimi i parë dhe numri serial të vazhdojë nga numri 1.
- Specifikimet Teknike janë të detajuara dhe në grupin e hartimit të specifikimeve teknike konstatohet se nuk është asnjë specialist i fushës për hartimin e tyre si dhe nga grupi i marrjes në dorëzim nuk është asnjë pjesëtarë specialist i fushës për verifikimin e tyre për marrjen në dorëzim

12. Titulli i gjetjes:	Testim i gabuar i tregut
Situata:	Gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit me objekt “Blerje Prokat Leje Qarkullimi për mjetet rrugore”, oferta e dhënë nga O.E. "A." shpk me ofertë 23.600.000 lekë pa TVSH, shpallet ofertë anomalisht e ulët, ku pas sqarimeve të dhënë nga O.E. pranohet si ofertë e suksesshme, ku një prokat leje qarkullimi jepet me çmimin 59 lek. Nisur nga kjo, përlogaritja e fondit limit si dhe zhvillimi i procedurave të mëparshme të ngjashme mbi blerjen e prokatis të lejeve të qarkullimit është kryer mbi një përlogaritje jo të saktë të fondit limit, duke rritur kostot e institucionit.
Kriteri:	Nenin 13 “Neni 13 “Studimi paraprak i tregut”, VKM Nr. 285, Datë 19.5.2021 “Për Miratimin E Rregullave Të Prokurimit Publik”
Ndikimi/Efekti:	Ndikim në shpenzimet e institucionit
Shkaku:	Mos testimi i duhur i tregut
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Organet Drejtuese të DPSHTRR-së, gjatë përlogaritjes së fondit limit të përdorin mënyrën më efektive të mundshme, si dhe në rastin kur merren oferta në treg nga O.E., të merren nga O.E. të cilët kanë eksperiencë në treg, në mënyrë që të shmangen aludimet mbi fryrjen e fondit limit.

13. Titulli i gjetjes:	Anomali në marrjen në dorëzim e mallrave
Situata:	Gjatë zbatimit të kontratës me objekt “Blerje Prokat Leje Qarkullimi për mjetet rrugore”, sipas Procesverbalit nr.1 në marrjen në dorëzim të prokatis të lejeve të qarkullimit, mbajtur më datë 11.06.2022, u morën në dorëzim në total 17474 copë prokat leje qarkullimi. Nga grupi i auditimit u konstatua që numri serial i marrjes në dorëzim ishte 0000000096402 dhe jo 0000000000001 sic duhet të ishte, duke marrë në konsideratë që është dorëzimi i parë dhe numri serial të vazhdojë nga numri 1.
Kriteri:	Nenin 107 “Zbatimi dhe Mbikëqyrja e kontratës”, të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.
Ndikimi/Efekti:	Ndikim në përmbushjen e objektivave të procedurës së prokurimit
Shkaku:	Mos zbatimi i kushteve të kontratës
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Organet drejtuese të DPSHTRR-së, Komisioni i ndjekjes dhe i zbatimit të kontratës, të marrë në konsideratë të gjitha kushtet e kontratës dhe të garantojë zbatimin e tyre me përpikmëri nga të dyja palët.

14. Titulli i gjetjes:	Parregullsi gjatë krijimit të komisioneve të procedurës së prokurimit
Situata:	Gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit me objekt “Blerje Prokat Leje Qarkullimi për mjetet rrugore”, Specifikimet Teknike janë të detajuara dhe në grupin e hartimit të specifikimeve teknike konstatohet se nuk është asnjë specialist i fushës për hartimin e tyre si dhe nga grupi i marrjes në dorëzim nuk është asnjë pjesëtarë specialist i fushës për verifikimin e tyre për marrjen në dorëzim si dhe laboratorë për verifikimin e tyre.
Kriteri:	Nenin 74 “Vendim Nr. 285, Datë 19.5.2021 Për Miratimin E Rregullave Të Prokurimit Publik”

Ndikimi/Efekti:	Hartim i gabuar i specifikimeve teknike dhe shqyrtim i gabuar i produkteve të sjella nga O.E. fitues
Shkaku:	Mungesa e punonjësve të specializuar në këto fusha
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Organet drejtuese të DPSHTRR-së, gjatë zhvillimit të një procedurë prokurimi, të kenë në konsideratë që në përbërje të njësisë së prokurimit është detyrimisht, personi përgjegjës për prokurimin, dhe të paktën një specialist fushe, në rast se kërkohen njohuri të specializuara për objektin e prokurimit.

Përsa është trajtuar në këtë pjesë të P/Raportit të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacion me shkresë nr. 409/5 prot, datë 06.12.2023 “Kundërshtime për akt konstatimet e grupit të auditimit të KLSH”, nga ana e përfaqësuesve të institucionit, të cilat janë të paraqitura më poshtë, pa ndërhyrje dhe rregullime nga ana drejtshkrimore:

Pretendimet e subjektit:

Prokurimi i zhvilluar për objektin “Blerje Prokat Leje Qarkullimi për mjetet rrugore” me Ref –10491-11-05-2021” është një prokurim që zhvillohet për herë të parë për futjen në qarkullim të Lejes së Re të Qarkullimit, e cila ishte një domosdoshmëri referuar Direktivës nr. 1999/37/EC, miratuar me Urdhërin e Ministrit të MIE me nr.284, datë 07.10.2020 “Për miratimin e lejes së re të qarkullimit për mjetet rrugore”, (përcaktuar kjo edhe në specifikimet teknike).

Leja e vjetër e qarkullimit është prodhuar nga Drejtoria e Targave dhe Shtypshkrimeve me letër pa element sigurie që blihej nga DPSHTRR me prokurimin me objekt “Blerje letër kimike dhe karton me logo”.

Specifikimet teknike hartuar për lejen e re të qarkullimit përshkruajnë qartazi ndër të tjera edhe elementët e sigurisë që duhet të përmbajë leja e re e qarkullimit, përshkrim ky i detajuar edhe në Akt Konstatimin e mbajtur nga Ju për këtë prokurim.

Materiali përbërës të letrës është material special letër e ndërthurur edhe me elemente plastik në raportin fibra (chemical pulp) 90% dhe polyamide / polyester 10%. Materiali bazë fibra (chemical pulp) është i veshur në të gjithë sipërfaqen në të dy anët me polyamide / polyester.

Leja e re e qarkullimit përmban elemente sigurie e cilësi të lartë, të dhëna të kodifikuara sipas BE, vit prodhimi e vit të parë regjistrimi mjeti, kod QR, prokat rezistent, personalizim me puntim e praktikitet që e ruan lejen e qarkullimit për një kohë të gjatë.

Referuar sa parashtroam më sipër lidhur me konstatimin Tuaj për këtë pikë arrijmë në konkluzionin që ndryshimi rrënjësor i specifikimeve teknike për këtë prokurim detyrimisht në përllogaritjen e fondit limit nuk mund ti referohemi procedurave paraardhëse, duke theksuar që nuk kishim asnjë eksperiencë të mëparshme për letër të prodhimit të Lejes së Qarkullimit. Pra nisur nga fakti që testimi i tregut bëhet mbi bazën e specifikimeve teknike, specifikime tërësisht të ndryshuara nga praktikata paraardhëse atëherë është e pamundur të merret për bazë në përllogaritjen e fondit limit për këtë prokurim eksperiencia e mëparshme.

Theksojmë: PROKURIMI ME KËTË OBJEKT ZHVILLOHET PËR HERË TË PARË

Leja e re e qarkullimit e mjetit lëshohet për regjistrime të reja ose kur qytetari azhiron të dhënat e mjetit, kur ndërron pronësinë, kur humb apo dëmtohet leja e vjetër dhe kur qytetari dëshëron vetë të marrë lejen e re! Nuk ka detyrim për mbajtësit e lejes së vjetër të mjetit që ta ndërrojnë atë.

Për qartësi dhe konkretizim ju paraqesim (bashkëlidhur) specimen të Lejes së vjetër të Qarkullimit (e cila nuk ka elementë sigurie) dhe Lejes së re të Qarkullimit (me element sigurie).

Lidhur me ndikimin në shpenzimet e Institucionit duhet të sqarojmë se vendimmarrja për realizimin e kësaj procedure nuk është e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rugor, por detyrimi për zbatimin e Urdhërit të Ministrit të MIE me nr.284, datë 07.10.2020 “Për miratimin e lejes së re të qarkullimit për mjetet rrugore” dhe Direktivës nr. 1999/37/EC, e ndryshuar deri në vitin 2014 të BE.

Leja e re e Qarkullimit të Mjetit, unifikon 3(tre) dokumenta të prodhuara si më poshtë:

-Leja e vjetër e qarkullimit, prodhohej nga Drejtoria e Targave dhe Shtypshkrimeve me letër pa element sigurie me koston e prodhimit 26 lekë copa.

-Certifikata e pronësisë së mjetit, prodhohej nga Drejtoria e Targave dhe Shtypshkrimeve me letër pa element sigurie me koston e prodhimit 26 lekë copa.

-Leje qarkullimi ndërkombëtare e mjetit, prodhohej nga Drejtoria e Targave dhe Shtypshkrimeve me letër pa element sigurie me koston e prodhimit 26 lekë copa.

Në total koston e insitucionit për të 3 (tre) këto dokumenta janë 78 lekë.

Prokati i lejes së qarkullimi që unifikon 3 (tre) dokumenta e mësipërme është me çmimin 59 lekë për copë dhe kjo procedurë ka sjell kursim në koston e institucionit.

Gjithashtu ju bëjmë me dije se ofertat e testimi të tregut janë marrë nga po të njëjtët operator pjesëmarrës në prokurimin me të njëjtin objekt.

Sa i përket numrit serial është një nga elementët e sigurisë së lejes së re të qarkullimit. Numri serial është progresiv, ka 13 karaktere dhe është një numër unik identifikimi i çdo prokati. Njëkohësisht në sistemin e regjistrimit të mjeteve është një dritare e dedikuar ku regjistrohet ky numër serial nga operatori (nëpunësi i pranimit në sportel), gjë e cila mundëson edhe kërkimin në sistem të të dhënave të mjetit për të cilin është lëshuar leja e qarkullimit. Mqs mbivendosja e të njëjtit numër serial është e pamundur në sistem, prandaj numri serial në raste të caktuara shërben edhe për verifikim të të dhënave, kur ka dyshim për fallsifikime apo ndryshime të tjera. Stampimi në lejen e qarkullimit është me një ngjyrë të përcaktuar me kodin përkatës.

Sa i përket konstatimit Tuaj mbi numrin serial ju sqarojmë që numrat seriale fillestar u përdorën për testim në të gjitha Drejtoritë Rajonale, sepse sistemi test i regjistrimit të mjeteve kërkonte numër serial funksional. Vetëm pasi u siguroam që përveç të tjerave dhe funksionet e numrit serial në sistem test ishin të plota atëherë morëm miratimin për të kaluar me sistemin live të regjistrimit të mjeteve.

Referuar përcaktimit mbi specialistin e fushës në Njësinë e Prokurimit sqarojmë që:

Për prokurimin me këtë objekt në grupin e hartimit të specifikimeve teknike është përcaktuar si specialist i fushës z.A. N., ku në këtë periudhë mbante pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë së Regjistrimit të Mjeteve (ne vijim DRM). Procedura e regjistrimit të mjeteve që ndjek dhe zbaton DRM, ka si pjesë të regjistrimit edhe paisjen me leje qarkullimi. Z.A. N.ka eksperiencë 15 vjecare me procedurat dhe dokumentacionin e regjistrimit të mjeteve dhe rrjedhimisht ky person është përcaktuar si specialist i fushës në Njësinë e Prokurimit për këtë objekt.

Sa i përket specialistit të fushës në grupin e ndjekjes dhe zbatimit të kontratës është përcaktuar përsëri z.J. V. specialist i cili është brenda DRM-së.

Sa më sipër arsyetojmë që konstatimet e grupit të auditit për këtë prokurim nuk qëndrojnë.

Duke marrë në konsideratë vërejtjet dhe sygjerimet Tuaja të përshkruara në këtë Projekt –Raport Auditimi Akt-Konstatim, shpresojmë që ky observacion të meret në konsideratë nga ana Juaj për të gjitha pikat e parashtruara më sipër.

Oëndrimi i Grupit të Auditimit të KLSH –së:

Për sa i takon gjetjeve të konstatuara nga ana e grupit të auditimit në lidhje me procedurat e mëparshme, nuk është kuptuar qartë nga ana e subjektit, pasi qëllimi i gjetjes së mësipërme konsiston në testimin e tregut aktual mbi të cilën fondi i përlogaritur ka qenë jo i saktë pasi ka arritur që një O.E. të fitojë një procedurë prokurimi me ofertë anomalisht të ulët. Gjithashtu në lidhje me procedurat e tjera të mëparshme që është kryer testim jo i saktë i tregut duke fryrë fondin limit, nisur nga më poshtë:

Një prokat leje qarkullimi që përmban shumë elementë sigurie kushton 59 lek, ndërkohë që në procedurat e mëparshme të zhvilluara për prokatë leje qarkullimi të cilat nuk përmbanin elementë sigurie kanë kushtuar shumë të shumë.

Në lidhje me numrin serial të prokatis të lejes së qarkullimit 0000000096402, grupi i auditimit mendon që 96402 testim është një numër i konsiderueshëm i lartë.

Në lidhje me specialistin e fushës, grupi i auditimit rithekson se përvoja e gjatë e punës e z. A. N. nuk ka pas të bëjë me krijimin dhe implementimin e elementeve të sigurisë në dokumente.

Për këto arsye, sa më sipër, observacioni juaj nuk pranohet.

- **Procedura "Blerje pajisjesh për qendrat e kontrollit teknik (Furnizim - Vendosje e Makinerive dhe Pajisjeve të Testimit të Q.K.T pranë Drejtorive Rajonale)" 2022**

Fondi limit

Në vlerën (124,719,448) lekë pa TVSH

Përmbledhja e procedurës në tabelë

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt "Blerje pajisjesh për qendrat e kontrollit teknik (Furnizim- Vendosje e Makinerive dhe Pajisjeve të Testimit të Q.K.T pranë Drejtorive Rajonale)" 2022

I. Urdhër Prokurimi
71 /3 datë 21.09.2022

Lloji I procedurës së Prokurimit: Procedurë e Hapur	2. Njësia e Prokurimit znj. B. Gj. z. E. C. z. E. H.	3. Komisioni për Përlogaritjen e Fondit Limit dhe Hartimit të Specifikimeve Teknike: z. E.H. z. Q. L. z. G. B.
4. Fondi limit (pa tvsh) Lekë 124,719,448 lekë	5. Burimi I Financimit Buxheti I institucionit	6. Data e hapjes së tenderit 27.10.2022
7. Operatorët Ekonomikë a) Pjesmarrës V. A. shpk 94,969,646 lekë R. Ë. sa 111,027,301 lekë b) kualifikuar: Velmar Albania shpk 94,969,646 lekë	8. Komisioni I Vlerësimit të Ofertave z. D. A. znj. J. D. z. L.D.	9. Oferta fituese (pa tvsh) 94,969,646 lekë
10. Data e lidhjes së kontratës 1576/26 datë 05.01.2023	11. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 29,749,802 lekë	12. Ankimime Nuk ka
13.Struktura për ndjekjen e kontratës E. H. K. B. R. C. A. S. D. K. A. M. M.M. F.B.	14. Fletë hyrja A. Z. I.R. E. C. S. Sh. A. M. Sh. C. I. N. A.H.	15. Afati I kontratës 77 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës
16.Situacioni përfundimtar/Faturë malli/shërbimi 01.06.2023 nr. fature 49/2023 19,585,609 lekë me tvsh 16.06.2023 nr. fature 53/2023 8,486,800 31.07.2023 nr. fature 62/2023 18,494,679		

Zhvillimi i procedurës së prokurimit inicohet me shkresën nr. 15294 Prot., datë 06.08.2021, nga Drejtori i DKTMM z. D.L., i cili në përmbajtje të shkresës cilëson që është realizuar inspektimi i të gjitha QKT në lidhje me gjendjen e funksionimit të tyre. Nga inspektimi i tyre shihet i arsyeshëm investimi në disa pajisje për përmirësimin e tyre. (tabela bashkëngjitur).

1	Testues konvergjence MINC 1	10
2	Testues konvergjence MINC 2	4
3	Testues i xhokove për cdo aks për autoveturë Model PMS	8
4	Testues i xhokove për cdo aks për kamion Model LMS20	6
5	Pajisje testimi të naftës MDO2	14
6	Pajisje testimi të benzineës dhe gazit MGT 5	14
7	Pajisje për matje të temperaturës së vajit të motorit	14
8	Pajisje e matjes së xhirove të motorit RPM MGT300 EVO	14
9	Pajisje e matjes së xhirove të motorit me EIFI-Bluetooth	14
10	Krik për ngritjen e aksit deri 5.5 ton (Pit jack MGH 5.5/45) për vetura	4
11	Krik për ngritjen e aksit deri 14.5 ton (Pit jack MGH 14.5/45) për kamion	6
12	Urë ngritëse tip gërshtëre me pajisjen testim xhoko DUO	2
13	Pajisje për matjen e fokusit të dritave MLT 3000	14
14	Matës i errësimit të xhamave, kompatibël me sistemin aktual (M.)	14
15	Matës i nivelit të zhurmave, kompatibël me sistemin aktual (M.)	14
16	Pajisje për matjen e forcës së fenimit (mjete 4x4 jo në rrulla)	14
17	Testues i amortizatorëve, për linjë universale	3
18	Testues i amortizatorëve, për linjë vetura	8
19	Panel komandimi pa elementë elektronike (post pune visual/gazra)	40
20	Bango prove testim frena, IË2 deri në 3.5 ton për aks	10
21	Bango prove testim frena, IË4 deri në 13 ton për aks	5

Me shkresën nr. 842 datë 20.08.2021, me nr. 16508 Prot., ngrihet komisioni për hartimin e specifikimeve teknike me përbërje grupin :

- z. E. H. (Kryetar)

- z. Q. L. dhe
- z. G. B.

Për përlogaritjen e fondit limit, përlogaritjet nga i njëjti grup i cili testoi dhe tregun duke siguruar oferta si më poshtë:

Lekë pa tvsh

V. A.	119,868,050
P. S. shpk	126,076,698
O.A.	128,213,591
Mesatarja e përbashkët	124,719,446

Me anë të shkresë nr. 16508/5 Prot., datë 18.01.2022 konfirmohet dhe miratohet fondi për zhvillimin e procedurës së prokurimit.

Me datë 23.03.2022 kryhet hapja e ofertave me pjesëmarrje si më poshtë:

- Bashkimi i operatorëve ekonomik “L.” shpk & “P. I.” shpk me ofertë **118,858,760 lekë**
- OE R.Ë. S. me ofertë **102,888,046 lekë**
- OE V. A.shpk me ofertë **109,500,000 lekë**
- OE V. me ofertë **115,989,124 lekë**
- OE X. S.shpk me ofertë **120,151,500 lekë**

Me anë të proces verbalit nr. 7 nga ana e komisionit të vlerësimit të ofertave shpallen të pavlefshme të 5 ofertat e mësipërme për shkak të parregullsive në dokumentacionin e dërguar.

Me anë të shkresës nr. 1576/1 Prot., datë 05.05.20222 dërgohet formulari për njoftimin e anulimit të procedurës së prokurimit.

Me anë të urdhrin nr. 708 datë 17.05.2022 ngrihet komisioni për shqyrtimin e ankesës nga ana e O.E V. A. shpk

Me anë të vendimit nr. 720/2022 me nr. 1033/4 Prot., datë 28.06.2022 nga Komisioni i Prokurimit Publik, AK duhet të anulohet dhe rihapë procedurën e mësipërme të prokurimit duke marrë në konsideratë konstatimet e bëra nga ana e KPP.

Me anë të shkresës nr. 1576/13 datë 13.07.2022 kërkohet konfirmimi për ndryshimet në specifikimet teknike sipas vendimit të KPP si dhe me anë të shkresës nr. 1576/15 prot. datë 21.09.2022 hartohet urdhri i prokurimit nr. 71/3 datë 21.09.2022 për kryerjen e prokurimit me objekt “ Blerje pajisjesh për qendrat e kontrollit teknik”.

Kapaciteti teknik:

2.3.2 Një punësim mesatar i të paktën 5 (pesë) personave, për periudhën e 3(tre) muajve të fundit të vërtetuar me

Nga punonjësit e mësipërm, Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të kenë në stafin e tyre të paktën:

- *Një inxhinier në sektorin e IT (është i nevojshëm për lidhjen e pajisjeve të kontrollit teknik me sistemin kompjuterik. Të realizojë komunikimin dhe ndërthurjen e pajisjeve të reja me programin aktual të testimit të linjës.)*
- *Një inxhinier mekanik, (është i nevojshëm për instalimin e pajisjeve të reja, kontrollin e funksionalitetit sipas kërkesave dhe nevojave, tarimin e pajisjeve komfort legjislacionit dhe direktivës).*
- *Tre teknike (për çmontimin e pajisjeve të vjetra dhe montimin e pajisjeve të reja).*

Me anë të procesverbalit nr.4 bëhet hapja e ofertave me pjesëmarrje si më poshtë:

- R. Ë. S.A. me ofertë **111,027,301 lekë**
- V. A. shpk me ofertë **94,969,646 lekë**

Pas verifikimit të dokumentacionit nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, shpall ofertë të suksesshme ofertën e sjellë nga O.E. V. A. shpk 94,969,646 lekë pa tvsh.

1	Pajsje për Testimin e Mbetjeve te Gazrave (mjete me lëndë djegëse Naftë)	14
2	Pajsje për Testimin e Mbetjeve të Gazrave (mjete me lëndë djegëse Benzinë/Gaz)	14
3	Pajsje Testimi e numrit të rrotullimeve të motorit të automjeteve	10
4	Pajisje Testimi e Devijimit për autovetura deri në 3.5 [ton]	5
5	Pajsje Testimi e Devijimit për Kamiona deri në 15 [ton]	5
6	Pajsje për Testimin e amortizatorëve/sospecioneve (linjë autoveturash).	5
7	Pajsje për Testimin e amortizatorëve/sospecioneve e perforcuar (linjë universale).	5
8	Pajsje për Testimin e Frenave të Autoveturave deri në 3.5 [ton].	6
9	Pajsje për Testimin e Frenave të Kamionave deri në 13 [ton].	3
10	Pult komunikimi dhe komandimi me paisjet e testimit	33
11	Pajsje për Testimin e Xhokove për autovetura deri në 3.5 [ton].	6
12	Pajsje për Testimin e Xhokove për Kamiona deri në 20 [ton].	5
13	Pajsje për Testimin e fokusit të dritave të Automjeteve	16
14	Pajsje për Testimin dhe Ngritjen e autoveturave deri në 4.2 Ton.	2
15	Pajsje Matëse për nivelin e zhurmave të automjeteve.	15
16	Pajsje për matjen e forcës së frenimit të mjeteve	6
17	Pajsje për ngritjen e Automjetit deri në 4 [ton].	6
18	Pajsje për ngritjen e Automjetit deri në 16.5 [ton].	5
19	Pajsje për matjen e temperaturës së vajit të motorit me infra të kuqe.	14
20	Pajsje për Testimin e numrit të rrotullimeve të motorit të automjetit me komunikim nëpërmjet OBD e automjeteve.	12
21	Pajsje për matjen e nivelit të errësimit të xhamave të automjeteve.	15

Nga auditimi i procedurës së mësipërme u konstatua:

- Nga verifikimi i dokumentacionit të mësipërme sjellë nga O.E. V.A. sh.p.k., në lidhje me përmbushjen e kriterëve për një inxhinier mekanik, në dokumentin e sjellë nga O.E. “kontratë individuale”, që mban datën 06.12.2021, O.E. V. A.sh.p.k. me administrator z. A. Z. në rolin e punëdhënësit merr në punë njëkohësisht z. A. Z. në rolin e punëmarrësit.
- Gjithashtu gjatë argumentimit të specifikimeve teknike nga Njësia e Prokurimit, vihen re që një pjesë e konsiderueshme e makinerive të marra në dorëzim nga shoqëria S.s.a., janë teje të amortizuara dhe nuk janë dorëzuar sipas kushteve të kontratës së koncesionarit të datës 03.09.2009 “Për dhënie me koncesion të shërbimit të kontrollit të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkio në RSH” Pika 3.7 “QKT ekzistuese dhe QKT e re duhet të jenë në një gjendje të arsyeshme mirëmbajtje, pastërtie dhe pamjeje, duke marrë parasysh vjetërsinë dhe amortizimin e arsyeshëm dhe brenda parametrave teknik për një funksionim normal në përputhje me destinacionin e tyre”.
- Kontrata me Nr.1576 prot, datë 05.01.2023, afati dorëzimit mallrave 77 ditë kalendarike. Amendimi kontratës ose shtyrja e afatit të dorëzimit të mallrave 4 muaj nga data amendimi i saj përlllogaritur për afërsisht me përfundimin e punimeve me qëllim realizimin e kontratës me këtë objekt. Amendimi i kontratës me Nr.1576/33 datë 21.03.2023 me afat dorëzimi të mallrave ose afat lëvrimi 77 ditë.

15.Titulli i gjetjes:	Vlerësim i procedurës së prokurimit nga ana e KVO, në mospërputhje me legjislacionin në fuqi.
Situata:	Gjatë auditimit të procedurës së prokurimit “Blerje pajisjesh për qendrat e kontrollit teknik (Furnizim-Vendosje e Makinerive dhe Pajisjeve të Testimit të Q.K.T pranë Drejtorive Rajonale), është kërkuar në lidhje me përmbushjen e kriterëve, një inxhinier mekanik, ku në dokumentin e sjellë nga O.E. “kontratë individuale”, që mban datën 06.12.2021, O.E. V. A. sh.p.k. me administrator z. A. Z. në rolin e punëdhënësit merr në punë njëkohësisht z. A. Z. në rolin e punëmarrësit.

Kriteri:	Neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” V.K.M- së Nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.
Ndikimi/Efekti:	Mos realizimi i objektit të kontratës
Shkaku:	Neglizhenca e krijuar nga ana e KVO-së
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Organet drejtuese të DPSHTRR-së të bëjnë të mundur verifikimin e dokumentacionit justifikues të O.E. pjesëmarrës dhe njëkohësisht fitues dhe të analizojë situatën nëse z. A.Z.në cilësinë e inxhinierit mekanik është tërësisht i angazhuar në përmbushjen e objektivave të kontratës dhe nuk ndikohet nga roli i tij si administrator i subjektit me të cilin operon në treg.

Përsa është trajtuar në këtë pjesë të P/Raportit të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacion me shkresë nr. 409/5 prot, datë 06.12.2023 “Kundërshtime për akt konstatimet e grupit të auditimit të KLSH”, nga ana e përfaqësuesve të institucionit, të cilat janë të paraqitura më poshtë, pa ndërhyrje dhe rregullime nga ana drejtshkrimore:

Pretendimet e subjektit:

Së pari: Lidhur me shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur nga ky ofertues rezulton që:

Ofertuesi "V. A." shpk për plotësim të kriterëve të përcaktuara në DT, ndër të tjera ka paraqitur edhe kontratat e punonjësve, ku ndër kontratat e punonjësve të tjerë ka paraqitur edhe kontratë për vetë Administratorin. Fakti që administratori i shoqërisë ka nënshkruar kontratë pune për veten e vet, vërteton njëkohësisht edhe punësimin dhe profesionin e tij në kompani. Rrjedhimisht në listën e punonjësve të cilët derdhin kontributin e sigurimeve shoqërore figuron edhe Administratori, pra nga subjekti është nënshkruar edhe kontrata përkatëse për punësimin dhe profesionin e tij pranë subjektit.

Së dyti: Lidhur me konstatimin e bërë nga Grupi i Auditimit mbi gjendjen e makinerive të testimit ju konfirmojmë që për shkak të amortizimit të paisjeve të testimit bazuar edhe në shfaqjen e difekteve të njëpasnjëshme u pa e domosdoshme zhvillimi i kësaj procedure prokurimi. Nga Komisioni i hartimit të specifikimeve teknike në specifikimet teknike pjesë të dokumentacionit të dosjes për këtë procedurë rezulton që nga ky Komision nuk janë përmendur kushtet e dorëzimit të kontratës së konçesionarit SGS.

Së treti: Lidhur me zbatimin e kontratës së nënshkruar për këtë objekt ju sqarojmë që:

Kontrata e nënshkruar me nr.1576 prot., datë 05.01.2023 është në proces realizimi. Sa i përket afatit të realizimit është parë e domosdoshme shtyrja e afatit të realizimit të kontratës për faktin që ne vetë si AK nuk kishim përfunduar punimet për shtimin e tre Linjave të reja ku do të instalohet një pjesë e paisjeve. Gjithashtu nuk ishin gati hapja e vendeve për postet e reja në disa Qendra Kontrolli ku do të ndryshohet linja e Kontrollit nga Linjë kamionash në Universale. Arsye e këtyre vonesave erdhi si rezultat i vazhdimësisë së punimeve për rikonstruksionin e Qendrave të Kontrollit Teknik në të gjitha Drejtoritë Rajonale.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit të KLSH –së:

Në lidhje me gjetjet e kryera nga grupi i auditimit në lidhje me kriterin mbi punonjësia në cili duhet të ishte i profesionit inxhinier mekanik, gjetja konsiston nëse personi z. A. Z., njëkohësisht edhe administrator i firmës, sa i angazhuar mund të jetë në lidhje me zbatimin e kushteve të kontratës, si dhe kontrata është një marrëveshje dy palëshe ose më shumë palëshe e cila përcakton dhe rregullon të drejtat dhe detyrimet ndërmjet tyre, dhe në këtë rast nuk mund të konsiderohet si një kontratë e mirëfillt edhe pse profesioni i z. A. Z. është inxhinier mekanik. Konstatimi i grupit të auditimit qëndron në dokumentacionin dërguar nga ana e O.E. jo në lidhje me përmbushjen e kapaciteteve të O.E.

Në lidhje me pajisjet e amortizuara dhe amendimin e kontratës është bërë një përkrahje nga ana e grupit të auditimit ku në fund të raportit përfundimtar i shërben për të arritur një konkluzion. Do të thotë që gjatë hartimit të akt konstatimit, grupi i auditimit thekson ose konstaton gjetje që jo domosdoshmërisht kanë të bëjnë me devijimi ligjore por gjetje që i shërbejnë në arritjen e një konkluzioni ose që mund ti nevojiten për propozimet për përmirësimet ligjore.

Për këto arsye, sa më sipër, observacioni juaj nuk pranohet.

- Procedura e prokurimit me objekt: “Blerje letër dhe karton me logo”, viti 2022”,

1. Urdhër Prokurimi Nr.4774/6 datë 04.05.2022		
1. Lloji i procedurës së Prokurimit Procedurë e Hapur MK me një Operator Ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara.	2. Njësia e Prokurimit Z.R. S. Znj.B. Gj. Z.F. S.	3. Njësia e Hartimit të Specifikimeve Teknike,përlllogaritjes fondit limit Znj.E. D. Z.A. B. Z.E. M.
4. Fondi limit (pa tvsh) 38,286,000 lekë	5. Burimi i Financimit Vet Financim (të ardhurat e institucionit)	6. Data e hapjes së tenderit 23.05.2022
7. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës 1. A. shpk 23,000,000, lekë pa tvsh 2. I. shpk 22,925,000 lekë pa tvsh 3.M. D. shpk 35,531,000 lekë pa tvsh 4.O. P. 19,658,000 lekë pa tvsh b) kualifikuar 3 O. P. 19,658,000 lekë pa tvsh	8. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave Z.D. A. Z.A. Gj. Z.Sh. L.	9. Oferta fituese (pa tvsh) O. P. shpk 19,650,000 lekë Dokumentacioni tekniko-ligjor të rregullt si dhe çmimi më i ulët
10. Data e lidhjes së kontratës Nr.4774/13 Datë 22.06.2022	11. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 18,636,000 lekë	12. Ankimime S’Ka
13.Komisioni i marrjes në dorëzim, ndjekjes dhe zbatimit të kontratës Znj.E. H. Znj. L. Z Z.E. M.	14. Fletë hyrja 18 dt 28.06.2022 30 dt 25.07.2022 29 dt 25.07.2022 28 dt 25.07.2022 31 dt 01.08.2022 34 dt 22.08.2022	15. Afati i kontratës 60 ditë
16.Situacioni përfundimtar/certifikata pranimit mallit 118017 prot dt. 12.09.2022	17. Likuiduar deri dt sipas formularit urdhër transfertës 09.11.2022 për vlerën 25,589,600 lekë me tvsh	

Zhvillimi i procedurës

Argumentimi i fondit limit

Me shkresën me Nr.351/1 Prot, datë 21.02.2022 është bërë kërkesa nga Drejtoria e Targave dhe Shtypshkrimeve për nevojat e zhvillimit procedurës “Blerje letër dhe karton me logo”. Arsytet mbi zhvillimin e procedurës grupi punës i argumenton si vijon, duke qenë letra dhe kartoni me logo do të përdoren kryesisht për prodhim regjistrash të ndryshëm për zhvillimin e mësimit të teorisë, fatura të ndryshme për gjoba ,fatura shërbimi regjistrimi mjetesh, fatura shërbimi leje drejtimi, certifikata për transport ndërkombëtar mallrash, veshje dosari, certifikatë e identifikimit të treguesve teknikë, akt kalim pronësie si dhe një sërë dokumentesh të tjera është e nevojshme zhvillimi i kësaj procedure.

Me Urdhrin e Titullarit z. B. G. Nr. 4774/1 Prot, datë 07.03.2022 është ngritur komisioni i përlllogaritjes së fondit limit, hartimit të kriterëve teknike të kualifikimit si dhe specifikimeve teknike me përbërje vijon, (E. D. (Kryetar), A. B. , E. M.).

Komisioni nëpërmjet relacionit me Nr. 4774/3 Prot., datë 31.03.2022 argumentoi sasinë, përcaktoi çmimin, hartoi kriteret e veçanta si dhe specifikimet teknike. Në lidhje me sasinë e përcaktuar komisioni është mbështetur mbi bazën e të dhënave nga konsumi mesatar mujor i vitit fundit dhe periudhës Janar-Mars 2022 të dërguara nga Drejtoria e Targave dhe Shtypshkrimeve. Sasia e kërkuar është:

Nr	Emertimi	Njesia e matjes	Sasia e kërkuar
1	Leter 90 gr ngjyre krem	Fije	150.000
2	Leter 80 gr ofset	Fije	500.000
3	Leter 90 gr ofset	Fije	50.000
4	Leter 60 gr ofset/m2(70-100)	Fije	10.000
5	Leter 80 gr me logo	Fije	500.000

6	Karton bristol me logo	Fije	50.000
7	Papër Coat(Strice)(100-110cm)	M	500 M

Ndërkohë që në lidhje me çmimin e përcaktuar janë marr ofertat nga OE si më poshtë:

- I. sh.p.k. me ofertë ekonomike 44,810,000 lekë pa tvsh si dhe cmim/njësi 495 lekë pa tvsh;
- 4. C. sh.p.k. me ofertë ekonomike 35,393,000 lekë pa tvsh si dhe cmim/njësi 500 lekë pa tvsh;
- A. sh.p.k. me ofertë ekonomike 34,655,000 lekë pa tvsh.

Çmimi është mbështetur në mesataren e 3(tre) ofertave ekonomike me vlerë 38,286,000 lekë pa tvsh.

Hartimi i kriterëve të veçanta të kualifikimit dhe specifikimeve teknike

Hartimi i kriterëve të veçanta të kualifikimit dhe specifikimeve teknike është kryer nga (E.D., A.B., E. M.).

KVO ngritur me urdhrin e Titullarit realizoi hapjen e ofertave sipas përcaktimeve në DST nga ku rezultoi se u paraqitën OE si më poshtë :

Nr.	OE	NIPTI	Oferta ekonomike	Vlerësimi i KVO
1	A. shpk	J--N	23,000,000	Kualifikuar
2	I. Shpk	K--D	22,925,000	Kualifikuar
3	M. D. shpk	J--N	35,531,000	S' kualifikohet pasi: Nuk ka paraqitur certifikatën ISO 27001:2013 Sistemi Menaxhimit Sigurisë Informacionit
4	O. P.	L--M	19,658,000	Kualifikuar dhe shpallur fitues

16.Titulli i gjetjes:	Hartimi i specifikimeve teknike jo në përputhje me objektin e kontratës
Situata:	Gjatë auditimit të procedurës së prokurimit me objekt “Blerje letër dhe karton me logo” 2022, në dokumentet standarde të tenderit DST, në pikën 2.1.2 të kapacitet profesional të O.E. është kërkuar Certifikata ISO 27001;2013, Sistemi Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit. Ky kriter nuk është i lidhur ngushtë dhe nuk është në përpjesëtim me objektin e prokurimit pasi natyra objektit të procedurës ka të bëjë me blerjen e mallit e cila në asnjë moment nuk lidhet cënimin e sigurisë informacionit. Është lënë rekomandim nga Agjencia e Prokurimit Publik (APP) mbi rishikimin e këtij kriteri pasi nuk është i lidhur ngushtë dhe në përpjesëtim me natyrën e objektit të prokurimit por përsëri nuk është marr në konsideratë nga NJP.
Kriteri:	Nenin 36 “Specifikimet Teknike”, Ligji nr.162 dt.23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.
Ndikimi/Efekti:	Pengon konkurrencën e drejtë
Shkaku:	Hartimi i specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta diskriminuese
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Organet drejtuese të DPSHTRR-së, gjatë hartimit të specifikimeve teknike të bazohet në legjislacionin dhe udhëzimet përkatëse duke hartuar specifikime teknike të cilët janë gjithëpërfshirëse duke krijuar pjesëmarrje të gjerë të O.E. dhe jo diskriminuese si dhe të jenë të detajuara në mënyrë që të jenë të kuptueshme për O.E. pjesëmarrës dhe që të përlllogaritet drejtë fondi limit.

Përsa është trajtuar në këtë pjesë të P/Raportit të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacion me shkresë nr. 409/5 prot, datë 06.12.2023 “Kundërshtime për akt konstatimet e grupit të auditimit të KLSH”, nga ana e përfaqësuesve të institucionit, të cilat janë të paraqitura më poshtë, pa ndërhyrje dhe rregullime nga ana drejtshkrimore:

Pretendimet e subjektit:

“Gjetja nr.1 në faqen 3,në dokumentat e tenderit, në pikën 2.1.2 të kapacitet profesional të OE të kërkuar certifikatë ISO 27001:2013, sistemi menaxhimit të sigurisë informacionit, ky kriter nuk është i lidhur ngushte dhe nuk është në përpjestim me objektin e prokurimit...Ju bëjmë me dije se nevoja e domosdoshme për këtë certifikatë ISO është e lidhur ngushtë dhe në përpjestim me objektin e prokurimit pasi, referuar specifikimeve teknike, malli objekt prokurimi do të furnizohet i loguar me logon zyrtare të DPSHTR-së. ISO 27001 është standarti më i njohur në botë për sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit (ISMS)... Me krimin kibernetik në rritje dhe kërcënime të reja që shfaqen vazhdimisht mund të duket e vështirë apo dhe e pamundur të menaxhosh rreziqet kibernetike.

Oëndrimi i Grupit të Auditimit të KLSH –së:

Referuar pretendimeve të mësipërme në lidhje me gjetjen 1, sqarojmë se: Pretendimet tuaja, nuk merren në konsideratë në hartimin e këtij projekt-raporti, pasi Kërkesa për paraqitjen e certifikatës ISO 27001:2013, sistemi menaxhimit të sigurisë së informacionit nuk lidhet drejtpërdrejtë me natyrën e objektit të prokurimit. AK duhet të mjaftohet që në lidhje me përmbushjen e kërkesave të cilësisë të paraqiten test-raporte të kryera në laborator, fletë-analiza etj .Pra një kërkesë e tillë mbi sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit është e panevojshme.

Për këto arsye, sa më sipër, observacioni juaj nuk pranohet.

- Procedura e prokurimit me objekt: “Mobilim i objekteve të reja të ndërtuara nga DPSHTRR e ndarë me lote , DRSHTRR Berat, Korçë, Lac, Vlorë”, viti 2021”

1. Urdhër Prokurimi Nr.13183 datë 07.07.2021		
1. Lloji i procedurës së Prokurimit Procedurë e Hapur MK me një Operator Ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara	2. Njësia e Prokurimit Znj.A.GJ. Z.M. K. Z.B.Gj.	3. Njësia e Hartimit të Specifikimeve Teknike,përlllogaritjes fondit limit Z.F.P. Z.M. K. Znj.J.J.
4. Fondi limit (pa tvsh) 66,456,983 lekë 4 Lote	5. Burimi i Financimit Vet Financim (të ardhurat e institucionit)	6. Data e hapjes së tenderit 23.08.2021
7. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës Loti I(Berat): 1.”R.-A.” 0 leke 2.”B.” 17,900,000 lekë pa tvsh 3.”B.” 18,182,550 lekë pa tvsh 4.”E.” 18,282,150 lekë pa tvsh 5.”Sh.” 7,775,640 lekë pa tvsh Kualifikuar Loti I 1.”B.” 17,900,000 lekë pa tvsh b) Pjesëmarrës Loti II (Korcë): 1.”R.-A.” 0 leke 2.”B.” 17,900,000 lekë pa tvsh 3.”B.” 18,182,550 lekë pa tvsh 4.”E.” 18,182,150 lekë pa tvsh 5.”M.” 0 leke 6.”Sh.” 7,775,640 lekë pa tvsh	Kualifikuar Loti II 1.”B.” 17,900,000 lekë pa tvsh c) Pjesëmarrës Loti III (Lac): 1.”R.-A.” 0 leke 2.B. 18,561,550 lekë pa tvsh 3.B. 20,561,550 lekë pa tvsh 4.E. 20,718,850 lekë pa tvsh 5.M. 0 leke 6.Sh. 7,510,620 lekë pa tvsh 7.K.&S. K.18,962,700 lekë pa tvsh 8.R. C.19,837,000 lekë pa tvsh Kualifikuar Loti III K.&S. K. 18,962,700 lekë pa tvsh 2”B.” 17,900,000 lekë pa tvsh d) Pjesëmarrës Loti IV(Vlorë): 1.”R.-A.” 0 leke 2.B. 7,084,700 lekë pa tvsh 3.E. 7,547,650 lekë pa tvsh 4.B. 7,508,650 lekë pa tvsh 5.K.& S. K. 6,988,800 lekë pa tvsh 6.Sh.3,398,520 lekë pa tvsh Kualifikuar Loti IV 1.K.& S.K. 6,988,800 lekë pa tvsh 2. B. 7,084,700 lekë pa tvsh	9. Oferta fituese (pa tvsh) Loti I ”B.” 17,900,000 lekë pa tvsh Loti II ”B.” 17,900,000 lekë pa tvsh Loti III B. 18,561,550 lekë pa tvsh Loti IV BOE K.&S.K. 6,988,800 lekë pa tvsh
10. Data e lidhjes së kontratës Nr.22075 Datë 20.10.2021(Loti I Berat) Nr.23538 Datë 05.11.2021(Loti II Korçë)	11. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 5,106,633 për 4 lote	8. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave Z.D. A. Z.S. I. Znj.D. N.
		12. Ankimime S’Ka

Nr.22076 Datë 20.10.2021(Loti III Lac) Nr.21145 Datë 12.10.2021 Loti IV Berat)		
13.Komisioni i marrjes në dorëzim, ndjekjes dhe zbatimit të kontratës Nr.22186 Datë 21.10.2021,M. X.,L.F.,D. Z.(Loti I Berat) Nr.23539 Datë 05.11.2021,A.M., L. R.,O. L. (loti II Korçe) Nr.22187prot,, datë 21.10.2021,E. M.,B.T., A. L. (Loti III Lac) Nr.21146 Datë 12.10.2021, M. M.,N.D.,S.M. (Loti IV Vlorë)	14. Certifikata pranimit mallit 11231 dt 03.12.2021 Lac 9911/1 dt. 03.12.2021 Berat 4528 dt. 08.06.2022 Korçë 12231 dt 03.12.2021 Vlorë	15. Afati i kontratës 30 ditë

Zhvillimi i procedurës:

Argumentimi i fondit limit

Me shkresën me Nr.9067 Prot. datë 12.05.2021 është bërë kërkesa nga Drejtuesi i njësisë së shërbimeve mbështetëse z. D. A. mbi nevojat e zhvillimit të procedurës me objekt “Mobilim i objekteve të reja të ndërtuara nga DPSHTRR”.

Nëpërmjet relacionit përmbledhës me Nr.10607 Prot. datë 01.06.2021, komisioni i hartimit të kritereve teknike dhe përlllogaritjes së fondit limit hartoi kërkesat për kualifikim si dhe përlllogaritë fondin limit. Përlllogaritja e fondit limit u krye nga komisioni i ngritur me urdhrin Nr.348, datë 14.05.2021 me përbërje si vijon, (F. P. Kryetar, M.K. anëtar, J.J. anëtare). Në lidhje me sasinë e argumentuar u citua që duke qenë se janë godina të reja të ndërtuara rishtazi dhe mobilitet e vjetra ekzistuese janë nxjerr jashtë përdorimit është parë e domosdoshme që këto godina të rimobilohen nga e para. Më pas nëpërmjet skicimeve përkatëse, planimetrisë, numrit të zyrave dhe ambienteve, nevojave të përgjithshme të Institucioneve u përcaktua sasia e nevojshme që do blihen. Në përcaktimin e çmimit komisioni është mbështetur në testimin e tregut me 3(tre) oferta të marra nga OE për të 4 lotet e zhvilluara si më poshtë:

- Ofertat e administruara për lotin e **I**, “Mobilim i DRSHTRR Berat”, si më poshtë :
Sha. D. me NIPT J--J me ofertë ekonomike 19,417,440 lekë pa tvsh.
R.-A. shpk me NIPT J--M me ofertë ekonomike 19,753,290 lekë pa tvsh.
E.shpk me NIPT J--P me ofertë ekonomike 19,581,616 lekë pa tvsh
Fondi limit i përlllogaritur është **19,828,418 lekë pa tvsh për lotin I**.
- Ofertat e administruara për lotin e **II** “Mobilim i DRSHTRR Korçë” si më poshtë :
E. shpk me NIPT J--P me ofertë ekonomike 19,581,616 lekë pa tvsh.
Sh. D. me NIPT J--J me ofertë ekonomike 19,282,820 leke pa tvsh.
R.-A. shpk me NIPT J--M me ofertë ekonomike 20,208,820 lekë pa tvsh.
Fondi limit i përlllogaritur është **19,828,418 lekë pa tvsh për lotin II**.
- Ofertat e administruara për lotin **III**, “Mobilim i DRSHTRR Lac” si më poshtë:
Sh. D. me NIPT J--J me ofertë ekonomike 19,417,440 lekë pa tvsh.
R.-A. shpk me NIPT J--M me ofertë ekonomike 19,753,290 lekë pa tvsh
E. shpk me NIPT J--P me ofertë ekonomike 18,570,750 lekë pa tvsh.
Fondi limit i përlllogaritur është **19,247,160 lekë pa tvsh për lotin III**.
- Ofertat e administruara për lotin e **IV**, “Mobilim i DRSHTRR Vlorë” si më poshtë :
M.shpk me NIPT K--H me ofertë ekonomike 7,483,432 lekë pa tvsh
E. shpk me NIPT J--P me ofertë ekonomike 7552,986 lekë pa tvsh.
Sh. D. me NIPT J--J me ofertë ekonomike 7,662,500 lekë pa tvsh.

Fondi limit i përlogaritur është **7,552,986 lekë pa tvsh për lotin IV.**

Në të gjitha lotet është aplikuar mesatarja e ofertave ekonomike.

Hartimi i kritereve të veçanta të kualifikimit dhe specifikimeve teknike

Hartimi i kritereve të veçanta të kualifikimit është kryer nga (M.K., F. P., J. J.).Komisioni i ngritur me urdhrin 13627/1 datë 30.08.2021 realizoi hapjen e ofertave nga ku rezultoi se u paraqitën OE si më poshtë :

Loti I(Berat)

Nr.	OE	Oferta ekonomike	Vlerësimi i KVO
1	R.-A.	0,00	S' kualifikohet pasi: Nuk ka paraqitur asnjë dokument.
2	B. shpk	17,900,000	Kualifikuar dhe shpallur fitues
3	B. shpk	18,182,550	S' kualifikohet pasi: Nuk plotëson shtojcën “Njoftimi i kontratës”, seksioni 3,Informacioni ligjor,ekonomik,financiar dhe teknik, 3.1 Sigurimi i ofertës i zbatueshëm, pasi nuk ka paraqitur sigurimin e ofertës në vlerën e përcaktuar. OE nuk plotëson kriteret e përcaktuara në DST, shtojca 7, kriteret e veçanta ,pika 2.1 “Kapaciteti Profesional” pasi nuk përmbush kërkesën e nënpikës 2.1.2 ku kërkohet ISO 28001:2007 pasi Iso e paraqitur i ka skaduar afati më datë 12.06.2021.
4	E.shpk	18,182,150	S' kualifikohet pasi: OE nuk plotëson kriteret e përcaktuara në DST, shtojca 7, kriteret e veçanta ,pika 2.1 “Kapaciteti Profesional” pasi nuk përmbush kërkesën e nënpikës 2.1.2 ku kërkohet ISO 28001:2007 pasi Iso e paraqitur i ka skaduar afati më datë 12.06.2021 OE nuk përmbush kërkesën e nënpikës 2.3.9 pasi nuk ka paraqitur mostrat e kërkuara.
5	S. shpk	7,775,640	S' kualifikohet pasi: OE nuk i plotëson kriteret e përcaktuara në DST, shtojca 7, kriteret e vecanta të kualifikimit, pika 2.3, “Kapaciteti Teknik” pasi nuk përmbush kerkesën e nënpikës 2.3.3/c ku kërkohet një arkitekt ,nuk është paraqitur diploma e arkitektes A. K. por është ngarkuar vetëm lista e notave. OE nuk përmbush kërkesën e nënpikës 2.3.9 pasi nuk janë paraqitur mostrat e kërkuara.

Loti II(Korcë)

Nr.	OE	Oferta ekonomike	Vlerësimi i KVO
1	R.-A.	0,00	S' kualifikohet pasi: Nuk ka paraqitur asnjë dokument.
2	B.shpk	17,900,000	Kualifikuar dhe shpallur fitues
3	B.shpk	18,182,550	S' kualifikohet pasi: Nuk plotëson shtojcën “Njoftimi i kontratës”, seksioni 3,Informacioni ligjor,ekonomik,financiar dhe teknik, 3.1 Sigurimi i ofertës i zbatueshëm, pasi nuk ka paraqitur sigurimin e ofertës në vlerën e përcaktuar. OE nuk plotëson kriteret e përcaktuara në DST, shtojca 7, kriteret e veçanta ,pika 2.1 “Kapaciteti Profesional” pasi nuk përmbush kërkesën e nënpikës 2.1.2 ku kërkohet ISO 28001:2007 pasi Iso e paraqitur i ka skaduar afati më datë 12.06.2021.
4	E. shpk	18,182,150	S' kualifikohet pasi: OE nuk plotëson kriteret e përcaktuara në DST, shtojca 7, kriteret e veçanta ,pika 2.1 “Kapaciteti Profesional” pasi nuk përmbush kërkesën e nënpikës 2.1.2 ku kërkohet ISO 28001:2007 pasi Iso e paraqitur i ka skaduar afati më datë 12.06.2021 OE nuk përmbush kërkesën e nënpikës 2.3.9 pasi nuk ka paraqitur mostrat e kërkuara.
5	S. shpk	7,775,640	S' kualifikohet pasi: OE nuk i plotëson kriteret e përcaktuara në DST, shtojca 7, kriteret e vecanta të kualifikimit, pika 2.3, “Kapaciteti Teknik” pasi nuk përmbush kerkesën e nënpikës 2.3.3/c ku kërkohet një arkitekt ,nuk është paraqitur diploma e arkitektes A. K. por është ngarkuar vetëm lista e notave. OE nuk përmbush kërkesën e nënpikës 2.3.9 pasi nuk janë paraqitur mostrat e kërkuara. OE nuk përmbush kerkesën e nënpikës 2.1, “Kapaciteti Teknik” i OE ,nënpika 2.1.6 pasi nuk ka certifikata ISO BS Pas 99:2012 ka skaduar me datë .03.02.2021
6	M.shpk	0,00	Nuk ka paraqitur asnjë dokument

Loti III(Lac)

Nr.	OE	Oferta ekonomike	Vlerësimi i KVO
1	R.-A.	0,00	S' kualifikohet pasi:

Nr.	OE	Oferta ekonomike	Vlerësimi i KVO
			Nuk ka paraqitur asnjë dokument.
2	B. shpk	17,900,000	Kualifikuar dhe shpallur fitues
3	B. shpk	18,182,550	S' kualifikohet pasi: Nuk plotëson shtojcën “Njoftimi i kontratës”, seksioni 3, Informacioni ligjor, ekonomik, financiar dhe teknik, 3.1 Sigurimi i ofertës i zbatueshëm, pasi nuk ka paraqitur sigurimin e ofertës në vlerën e përcaktuar. OE nuk plotëson kriteret e përcaktura në DST, shtojca 7, kriteret e veçanta ,pika 2.1 “Kapaciteti Profesional” pasi nuk përmbush kërkesën e nënpikës 2.1.2 ku kërkohet ISO 28001:2007 pasi Iso e paraqitur i ka skaduar afati më datë 12.06.2021.
4	E. shpk	18,182,150	S' kualifikohet pasi: OE nuk plotëson kriteret e përcaktura në DST, shtojca 7, kriteret e veçanta ,pika 2.1 “Kapaciteti Profesional” pasi nuk përmbush kërkesën e nënpikës 2.1.2 ku kërkohet ISO 28001:2007 pasi Iso e paraqitur i ka skaduar afati më datë 12.06.2021 OE nuk përmbush kërkesën e nënpikës 2.3.9 pasi nuk ka paraqitur mostrat e kërkuara.
5	Sh.shpk	7,775,640	S' kualifikohet pasi: OE nuk i plotëson kriteret e përcaktuara në DST, shtojca 7, kriteret e vecanta të kualifikimit, pika 2.3, “Kapaciteti Teknik” pasi nuk përmbush kerkesën e nënpikës 2.3.3/c ku kërkohet një arkitekt ,nuk është paraqitur diploma e arkitektes A.K.por është ngarkuar vetëm lista e notave. OE nuk përmbush kërkesën e nënpikës 2.3.9 pasi nuk janë paraqitur mostrat e kërkuara. OE nuk përmbush kerkesën e nënpikës 2.1, “Kapaciteti Teknik” i OE ,nënpika 2.1.6 pasi nuk ka certifikata ISO BS Pas 99:2012 ka skaduar me datë .03.02.2021
6	M. shpk	0,00	Nuk ka paraqitur asnjë document
7	K. &S. K.	18,962,700	Kualifikuar
8	R.c.	19,837,000	S' kualifikohet pasi: Nuk përmbush kriteret e vecanta të kualifikimit,pika 2.1, “Kapacitet Profesional”, pasi certifikatat ISO nuk përfshijnë objektin e prokurimit. OE nuk përmbush nënpikën 2.1.3 ku kërkohet ISO 28001:2007.

Loti IV(Vlorë)

Nr.	OE	Oferta ekonomike	Vlerësimi i KVO
1	R.-A.	0,00	S' kualifikohet pasi: Nuk ka paraqitur asnjë dokument.
2	B.shpk	7,084,700	Kualifikuar
3	B. shpk	7,508,650	S' kualifikohet pasi: Nuk plotëson shtojcën “Njoftimi i kontratës”, seksioni 3,Informacioni ligjor,ekonomik,financiar dhe teknik, 3.1 Sigurimi i ofertës i zbatueshëm, pasi nuk ka paraqitur sigurimin e ofertës në vlerën e përcaktuar. OE nuk plotëson kriteret e përcaktura në DST, shtojca 7, kriteret e veçanta ,pika 2.1 “Kapaciteti Profesional” pasi nuk përmbush kërkesën e nënpikës 2.1.2 ku kërkohet ISO 28001:2007 pasi Iso e paraqitur i ka skaduar afati më datë 12.06.2021.
4	E. shpk	7,547,650	S' kualifikohet pasi: OE nuk plotëson kriteret e përcaktura në DST, shtojca 7, kriteret e veçanta ,pika 2.1 “Kapaciteti Profesional” pasi nuk përmbush kërkesën e nënpikës 2.1.2 ku kërkohet ISO 28001:2007 pasi Iso e paraqitur i ka skaduar afati më datë 12.06.2021 OE nuk përmbush kërkesën e nënpikës 2.3.9 pasi nuk ka paraqitur mostrat e kërkuara.
5	Sh. shpk	3,398,520	S' kualifikohet pasi: OE nuk i plotëson kriteret e përcaktuara në DST, shtojca 7, kriteret e vecanta të kualifikimit, pika 2.3, “Kapaciteti Teknik” pasi nuk përmbush kerkesën e nënpikës 2.3.3/c ku kërkohet një arkitekt ,nuk është paraqitur diploma e arkitektes A. K. por është ngarkuar vetëm lista e notave. OE nuk përmbush kërkesën e nënpikës 2.3.9 pasi nuk janë paraqitur mostrat e kërkuara. OE nuk përmbush kerkesën e nënpikës 2.1, “Kapaciteti Teknik” i OE ,nënpika 2.1.6 pasi nuk ka certifikata ISO BS Pas 99:2012 ka skaduar me datë .03.02.2021
6	K.	6,988,800	Kualifikuar dhe shpallur fitues

Konkluzion i përgjithshëm

- Në procedurat e prokurimit publik të kryera nga AK, për periudhën objekt auditimi, pothuajse në të gjitha procedurat e audituara, nga ana e APP është dhënë asistencë teknike për kërkesat e veçanta për kualifikim. Pavarësisht se rekomandimet e dhëna nga APP janë zbatuar sipas shtojcave të modifikimit të DST-ve, kjo ka sjellë shtyrjen e afatit të procedurës së prokurimit.
- Parregullsi në hartimin e kriterëve në dokumentet e tenderit(DST).Më konkretisht vihet re se pothuajse në të gjitha procedurat e zhvilluara në kërkesat në lidhje me kapacitetin

ekonomik/financiar kërkohet që xhiro mesatare vjetore të jetë sa dyfishi i vlerës së fondit limit të përlogaritur. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin Nr. 162/2020, neni 77, pika 3(Kërkesat për kualifikimi) ku thotë : *Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.* Kriter ky i cili nuk nxit pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm.

- Afatet e lëvrimin të mallrave pothuajse në të gjitha procedurat e audituara , në DST afatet e lëvrimin të mallit përcaktohen nga 1 deri në 45 ditë, duke bërë që numri i OE pjesëmarrës të kufizohet pasi në disa raste është e pamundur për OE ofertues të përgatisin të gjithë sasinë e mallit me një afat të tillë lëvrimi.
- Në përlogaritjen e fondit limit pothuajse në të gjitha procedurat e realizuara përlogaritja e fondit limit realizohet me testim tregu me 3(tre) oferta nga ku rezulton se në ofertat e paraqitura nga OE të ndryshëm nuk pasqyrojnë vlerën reale të tregut. Gjithashtu nga verifikimi në SPE në kontrata e ngjashme të paraqitura nga OE të shpallur fitues, vihet re se testimi tregut është me një vlerë më të madhe krahasuar me kontratat e ngjashme të realizuar nga këto OE. Në asnjë rast nuk është marr në konsideratë përlogaritja e fondit limit duke iu referuar kontratave të ngjashme, të realizuara nga institucione të ndryshme me të njëjtën natyrë objekt prokurimit. Pra kemi të bëjmë me një fryrje të fondit limit të përlogaritur mbi vlerën reale të tregut. Veprime këto në kundërshtim me nenin 76 të VKM RPP Nr.285 datë 19.05.2021.

17.Titulli i gjetjes:	Parregullsi në hartimin e kriterëve në lidhje me kërkesat për kapacitetin ekonomik-financiar
Situata:	Gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit me objekt “Mobilim i objekteve të reja të ndërtuara nga DPSHTRR e ndarë me lote , DRSHTRR Berat, Korçë, Lac, Vlorë” u konstatua parregullsi në hartimin e kriterëve në dokumentet e tenderit(DST).Më konkretisht vihet re se pothuajse në të gjitha procedurat e zhvilluara në kërkesat në lidhje me kapacitetin ekonomik/financiar kërkohet që xhiro mesatare vjetore të jetë sa dyfishi i vlerës së fondit limit të përlogaritur. Kriter ky i cili nuk nxit pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm.
Kriteri:	Neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar.
Ndikimi/Efekti:	Kufizimin e numrit të OE pjesëmarrës .
Shkaku:	Neglizhencë nga ana e anëtarëve të NJP
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	AK, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, të marrë masa që në kërkesat në lidhje me kapacitetet ekonomik-financiar, të përcaktojë qartë kufirin minimal të xhiros vjetore në përputhje me LPP dhe VKM. Pra të përcaktohen sa më qartë kërkesat mbi kapacitet ekonomik-financiar referuar parimeve të ligjit.

18.Titulli i gjetjes:	Afate të shkurtra kohore të pamjaftueshme në lëvrimin e mallrave
Situata:	Gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit me objekt “Mobilim i objekteve të reja të ndërtuara nga DPSHTRR e ndarë me lote , DRSHTRR Berat, Korçë, Lac, Vlorë”, afatet e lëvrimin të mallrave pothuajse në të gjitha procedurat e audituara në DST përcaktohen nga 1 deri në 45 ditë,

	duke bërë që numri i OE pjesëmarrës të kufizohet madje në disa raste dhe duke i shkaktuar pamundësi OE ofertues të përgatisin të gjithë sasinë e mallit me një afat kaq të shkurtër kohor të përcaktuar.
Kriteri:	Neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar;
Ndikimi/Efekti:	Kufizimin e numrit të OE pjesëmarrës .
Shkaku:	Mos llogaritje e saktë e kohës së nevojshme për realizimin e nevojave
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	AK, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, të marrë masa në përcaktimin e afateve kohore në lidhje me lëvrimin e mallrave, të shihet e arsyeshme apo të merret në konsiderate në mënyrë të tillë që në përcaktimi i afatit të lëvrimin të mallrave të mos kufizojë numrin e OE pjesëmarrës.

- Procedura e prokurimit me objekt: “Blerje karta memorie për tahografët digjital, viti 2021”,

1. Urdhër Prokurimi Nr.239, datë 20.10.2021		
1. Lloji i procedurës së Prokurimit Procedurë e Hapur	2. Njësia e Prokurimit Znj.A. D. Znj.B.Gj. Z.A. N.	3. Njësia e Hartimit të Specifikimeve Teknike,përlllogaritjes fondit limit Z.A. N. Z. K. A. Z.D. L.
4. Fondi limit (pa tvsh) 52,930,760 lekë	5. Burimi i Financimit Vet financim(të ardhurat e institucionit)	6. Data e hapjes së tenderit 01.12.2021
7. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës C.s.d. 47,628,000 lekë I. G.e 49,808,640 lekë b) kualifikuar: C. d., 47,628,000 lekë I. g. 49,808,640 lekë	8. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave Z.D. A. Zj.R. Sh. Z. F. S.	9. Oferta fituese (pa tvsh) 47,628,000 lekë C. d..
10. Data e lidhjes së kontratës Kontratë mallrash nr. 27664 datë 22.11.2021	11. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 5,302,760 lekë	12. Ankimime Nuk ka
13.Komisioni i marrjes në dorëzim, ndjekjes dhe zbatimit të kontratës Z. E.H. Znj. K. A. Znj.F.M.	14. Fletë hyrja Dt 22.12.2022 3334 copë kontrata 1 Dt 13.04.2022 3000 copë kontrata 2 Dt 11.10.2022 1332 copë kontrata 3	15. Afati i kontratës 48 muaj
	17. Likuiduar deri dt 21.10.2022	

Zhvillimi i procedurës:

Argumentimi i fondit limit

Me shkresën me Nr.17567 Prot, datë 02.09.2021 është bërë kërkesa nga Drejtori i Regjistrimit të mjeteve z. A. N. për nevojat e zhvillimit të procedurës “Blerje karta memorie për tahografët digjital”. Sipas kontratës Nr.1 me Nr.20540 Prot datë 28.10.2020 sasia e prokuruar po shkon drejt përfundimit dhe si rrjedhojë kërkohet që të merren masat e nevojshme për zhvillimin e procedurës në kohë për pajisjen me karta të memories të tahografit digjital të lëshuara nga DPSHTRR për drejtuesit e mjeteve , të përfshirë në ligjin nr.9514 ,datë 18.04.2006, “Për aderimin e Republikës

së Shqipërisë në marrëveshjen europiane, për punën e ekuipazheve të mjeteve të përfshira në transportin ndërkombëtar rrugor (AETR).

Me Urdhrin e Titullarit z. B.G. Nr.18065 Prot, datë 08.09.2021 është ngritur komisioni i përllogaritjes së fondit limit, hartimit të kriterëve teknike të kualifikimit si dhe specifikimeve teknike me përbërje si vijon, (A.N. Kryetar, K. A. anëtare, D. L. anëtar).

Komisioni nëpërmjet një relacioni argumentoi sasinë, përcaktoi çmimin nëpërmjet testimit të tregut me 3(tre) oferta, hartoi kriteret e veçanta si dhe specifikimet teknike. Në lidhje me sasinë e përcaktuar komisioni është mbështetur në kërkesat e shumta të paraqitura, numrit mesatar të aplikimeve nga ku u pa e domosdoshme që sasia e nevojshme është 6000 copë karta memorie për tahograf digjital. Ndërkohë që në lidhje me çmimin janë marr ofertat nga OE si më poshtë :

- C. d., kompani me bazë në Slloveni me ofertë ekonomike cmim/njësi 9,236,70 lekë, me vlerë totale 55,420,200 lekë pa tvsh.
- I. G., kompani me bazë në Francë me ofertë ekonomike cmim/njësi 9,228,68 lekë, me vlerë totale 55,372,080 lekë pa tvsh.
- A.S. , kompani Shqiptare me ofertë ekonomike 8,000 lek cmim/njësu, me vlerë totale, 48,000,000 lekë pa tvsh.

Në ofertën e dërguara nga 2 kompanitë e huaja oferta e dërguar nga ana e tyre është në monedhën euro dhe si rrjedhojë është marr kursi këmbimit i datës 14.10.2021.

Cmimi është mbështetur në mesataren e 3(tre) ofertave ekonomike me vlerë 52,930,760 lekë.

Hartimi i kriterëve të veçanta të kualifikimit dhe specifikimeve teknike

Hartimi i kriterëve të veçanta të kualifikimit si dhe specifikimeve teknike është kryer nga , (A. N. Kryetar, K.A.anëtare, D. L. anëtar).

Komisioni i vlerësimit të ofertave, ngritur me urdhrin Nr.19133/12 Prot, datë 11.10.2022, nëpërmjet sistemit elektronik , realizo hapjen e ofertave në datën dhe orën e përcaktuar në DST nga ku rezultoi se morën pjesë 2 OE :

Nr.	OE	Oferta ekonomike	Vlerësimi i KVO
1	C.d Slloveni	47,628,000	Kualifikuar dhe shpallur fitues.
2	I. g. Francë	49,808,640	Kualifikuar

Komisioni, vendosi të shpalle fitues OE “C. d.”, sipas kriterit të përcaktuar në DST si oferta më e ulët me një diferencë nga OE pjesëmarrës “I. g.” 2,180,640 lekë.

19.Titulli i gjetjes:	Aplikim i çmimit të kartave memorie të tahografëve më i ulët se sa prokurohet
Situata:	Gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit me objekt “Blerje karta memorie për tahografët digjital, viti 2021”, çmimi i aplikimit të përcaktuar nga Udhëzimi i përbashkët të Ministrisë Financave dhe Ekonomisë (MFE) dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) me Nr.9785/1 datë 01.06.2022 dhe me Nr.12 datë 30.05.2022 është 40 euro ose 4,821 lekë më pak se çmimi i kontratës lidhur ndërmjet AK dhe OE “C. d.”.Pra për sa më sipër nga çmimi i aplikimit të përcaktuar nga udhëzimi përbashkët si dhe çmimit të kontratës së lidhur, për sasinë prej 6000 karta memorie tahograf digjital AK ka humbur $6000 \cdot 4,821 = 28,926,000$ lekë.

Kriteri:	Ligji nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”
Ndikimi/Efekti:	Rritja e shpenzimeve të institucionit
Shkaku:	Krijimi i lehtësirave për përdoruesit e tahografit
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Organet drejtuese të DPSHTRR-së, në lidhje me vendosjen dhe përcaktimin e çmimit të përdorimit të kartës së memories së tahografëve, të marrin në konsideratë rrethanat dhe faktorët e tjerë, se cila është kategoria që është e prekur nga vendosja e këtij çmimi dhe se sa implikohet kjo kategori në lidhje me këtë çmim, duke qenë se impakti kryesisht është në biznese dhe jo në individ.

- Procedura e prokurimit me objekt: **“Botim manuali të përgatitur për kandidatët që do të pajisen me leje drejtimi të kategorive A1, A2, A, B1, BE, viti 2022”**

Urdhër Prokurimi Nr.11597/8 datë 16.06.2022		
1. Lloji i procedurës së Prokurimit Procedurë e Hapur(Elektronike) MK me një Operator Ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara	2. Njësia e Prokurimit Z.R. S. Znj.B. G. Z.F. S.	3. Njësia e Hartimit të Specifikimeve Teknike,përlllogaritjes fondit limit Z.J. V. Z.E. B. Z.F. S.
4. Fondi limit (pa tvsh) 39,600,000 lekë	5. Burimi i Financimit Vet Financim (të ardhurat e institucionit)	6. Data e hapjes së tenderit 03.10.2022
7. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës 1. I. shpk 25,200,000, lekë pa tvsh 2. K. K. shpk 27,312,000 lekë pa tvsh 3.A. D. P. shpk 29,000,000 lekë pa tvsh 4.A. C. shpk 36,800,000 lekë pa tvsh b) kualifikuar me vendimi te KPP I. shpk 25,200,000 lekë pa tvsh	8. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave Z.D. A. Znj.E. D. Z. E. C.	9. Oferta fituese (pa tvsh) 25,200,000 lekë I. shpk Anomalisht e ulët por e argumentuar nga OE
10. Data e lidhjes së kontratës Marëveshje Kuadër Nr.11587/54 Datë 29.03.2023	11. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 14,400,000 lekë	12. Ankimime Ka
13.Komisioni i marrjes në dorëzim, ndjekjes dhe zbatimit të kontratës Kontrata pjesore lidhur 03.06.2023 , zbatimi kontratës është jashtë periudhës së auditimit, për shkak të vonesave të shkaktuara nga ankesat e paraqitura nga OE.	14. Fletë hyrja	15. Afati i kontratës
16.Situacioni përfundimtar/Faturë malli/shërbimi	17. Likuiduar deri dt	

Zhvillimi i procedurës:

Argumentimi i fondit limit

Me shkresën me Nr.11597 Prot, datë 27.04.2022 është bërë kërkesa nga Drejtoria e Drejtuesve të Mjeteve (DDM), për nevojat e zhvillimit të procedurës “Botim manuali të përgatitur për kandidatët që do të pajisen me leje drejtimi të kategorive A1,A2,A,B1,BE”. Lindjen e nevojave për zhvillimin e një procedurë të tillë grupi punës e argumenton me faktin se duke u mbështetur në praktikat ndërkombëtare të cilët botimin e manualit e bëjnë nga specialistët e vet është parë e nevojshme ose e domosdoshme botim i një manuali nga ekspertët e DPSHTRR ku më pas do të unifikohet dhe do shpërndahet manuali. Me urdhrin e Titullarit z. B.G. me Nr.11597/1 Prot, datë 27.04.2022 është ngritur komisioni i përlllogaritjes së fondit limit, hartimit të kriterëve teknike të

kualifikimit si dhe specifitimeve teknike me përbërje si vijon, (J. V.Kryetar, E. B.anëtar, F. S. anëtar).Komisioni ka në përbërje specialist fushe për hartimin e këtij manuali. Ky komision nëpërmjet relacionit me Nr.11597/5 Prot, datë 10.05.2022 argumentoi sasinë, përcaktoi çmimin nëpërmjet testimit të tregut me 3(tre) oferta, hartoi kriteret e veçanta të kualifikimit dhe specifikimet teknike.

Në lidhje me sasinë e përcaktuar është mbështetur mbi bazën e të dhënave të dërguara nga drejtoria ekonomike, sektori i statistikave me shkresën me nr.11597/3 datë 04.05.2022, nga ku numri i të regjistruarve për pajisje me leje drejtimi për kategoritë A1,A2,A,B1,B dhe AB për vitin 2020,2021 është mesatarisht 61.000 aplikantë. U vendos që sasia e nevojshme për tu prokuruar është 80.000 botime për gjatë gjithë kohëzgjatjes së marrëveshjes kuadër (MK) me afat 24 muaj.

Në lidhje me çmimin e përcaktuar janë marr ofertat nga OE si më poshtë:

- I. shpk me NIPT L--L me ofertë ekonomike 39,600,000 lekë si dhe cmim/njësi 495 lekë pa tvsh.
 - E.F. shpk me NIPT K--T me ofertë ekonomike 40,000,000 lekë si dhe cmim/njësi 500 lekë pa tvsh
 - A. shpk me NIPT J--N me ofertë ekonomike 39,200,000 lekë si dhe cmim/njësi 490 lekë pa tvsh.
- Mesatarja e 3(tre) ofertave ekonomike me vlerë 39,600,000 lekë pa tvsh.

Hartimi i kriterëve të veçanta të kualifikimit dhe specifitimeve teknike

Hartimi i kriterëve të veçanta të kualifikimit si dhe specifitimeve teknike është kryer nga (J.V., E. B. dhe F. S.). Hartimi i tyre është shoqëruar me ankesa nga ana e OE si më poshtë:

Në datën 24.06.2022 është paraqitur ankesa nga OE “I.”shpk, me pretendimin se disa nga kriteret e hartuara nuk janë në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit. Ankesa e paraqitur është dërguar pranë Autoritetit Kontraktor si dhe në Komisionin e Prokurimit Publik (KPP).

Pas publikimit të dokumenteve të tenderit, në datën 30.06.2022 është dërguar rekomandim nga Agjencia e Prokurimit Publik në lidhje me ndryshimin e disa nga kriterëve të hartuara pasi nuk janë në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit.

Pas depozitimit të ankesës nga ana e OE, me Urdhrin e Titullarit 11597/12 Prot, datë 28.06.2022 është pezulluar procedura, nga ku më pas është ngritur komisionit i shqyrtimit të ankesës duke vendosur të pranojë pjesërisht ankesën e OE.

Me anë të shkresës Nr.11597/17 Prot, dhe shkresës me Nr.11597/18, datë 04.07.2022 është dërguar informacion përmbledhës pranë KPP lidhur me vendimmarrjen e saj përse i pëket ankesave të paraqitura nga OE, “I.” shpk.

Më pas KPP me vendim e saj ka modifikuar DST duke pranuar ankesën e OE “I.” shpk.

Me shkresën me Nr.11597/25 Prot, AK u vendos shtyrja e afatit të hapjes së ofertave, nga ku u përcaktua data e hapjes së ofertave 03.10.2022 ora 10:00.

Më datë 03.10.2022 u realizua hapja e ofertave nëpërmjet sistemit elektronik nga 3(tre) anëtarët e KVO nga ku rezultoi se morën pjese 4(katër) si më poshtë:

Nr.	OE	Oferta ekonomike	Vlerësimi i KVO
1	I. shpk	25,200,000	S' kualifikohet pasi: Nuk plotëson (kriteret e veçanta të kualifikimit), pika 2.3.2, aftësitë teknike dhe profesionale mbi të cilën duhet të vërtetohet se disponon kapacitetet e nevojshme si stafin e nevojshëm për realizimin e kontratës dhe llojin e makinerive që disponon pasi në faturën e paraqitur ose në akt-zhdoganimin KVO gjykon se OE nuk ka specifikuar përmasat, formatin e makinerisë si dhe mostrat e paraqitura nuk janë në përputhje me specifikimet teknike
2	K.K. shpk	27,312,000	Kualifikuar
3	“A.D.P.” shpk	29,000,000	S' kualifikohet pasi:

Nr.	OE	Oferta ekonomike	Vlerësimi i KVO
			Nuk përmbushur shtojcën 7 .OE nuk disponon stafin e nevojshëm , OE nuk specifikon formatin e makinës qepëse.
4	A.-C. shpk	36,800,000	S' kualifikohet pasi: Nuk përmbush kriteret e vecanta të kualifikimit

Në përfundim KVO vendosi të shpall të rregullt ofertën e OE “K. K.”shpk duke gjykuar dokumentacion e tij të rregullt si dhe duke skualifikuar 3(tre) OE , me arsyetimin që nuk plotësojnë kriteret e DST.

Kundër këtij vendimi OE “I.” ka paraqitur ankesën e tij me datë 21.11.2022 nëpërmjet sistemit elektronik duke pretenduar se përmbush kriteret e përcaktuara në DST.

Me urdhërin e Titullarit nr.834/1 datë 21.11.2022 u pezullua procedura dhe u ngrit komisioni shqyrtimit të ankesave.

Me vendimin nr.11597/32 datë 25.11.2022 Komisioni i shqyrtimit të ankesave KSHA vendosi të mos pranojë ankesën e paraqitur nga ana e OE “I.” shpk .

Më pas është dërguar relacion në KPP, nga ku KPP mori në shqyrtim ankesën duke i kërkuar AK që të vërë në dispozicion mostrat fizikisht duke qenë se OE u skualifikua pasi mostrat e dërguara nuk përmbushin specifikimet teknike.

Me vendimin Nr.33/2023, nr.2584/9 prot., datë 18.01.2023 KPP vendosi që mostrat e paraqitura të dërgohen në një laborator testues të licensuar.

Pas testimit të mostrave si dhe vendimit të KPP, KVO vendosi që të pranojë ankesën e paraqitur nga OE “I.”, të rishqyrtojë procedurën duke shpallur fitues OE “I.” me dokumentacion të rregullt kualifikues si dhe oferta më e ulët e paraqitur.

Më pas është kërkuar që OE “I.” të sjell dokumentacionin fizik provues.

KVO në datën 07.03.2023 ka kërkuar përsëri verifikim fizik në terren të pajisjeve dhe makinerive prodhuese nga ku më pas i konsideroi të rregullta dhe plotësojnë kërkesat e AK.Në përfundim OE i shpallur fitues ishte “I.”shpk.

Nga auditimi u konstatuan këto mangësi:

Komisioni i hartimit të kriterëve të veçanta dhe specifikimeve teknike me përbërje si vijon, (J. V. Kryetar, E. B. anëtar, F.S.anëtar) nuk ka vepruar në përputhje me legjislacionin përkatës në lidhje me hartimin e kriterëve të kualifikimit si dhe specifikimeve teknike. Duke theksuar faktin që në përbërjen e saj ka ekspert fushe është jo në proporcion kërkesa e përcaktuar në DST si më poshtë: OE të vërtetojnë që disponojnë makineri shtypëse 61x43 formati letrës, 5C+llak. Një OE pjesëmarrës duhet të disponojë 1 pajisje shtypi të përmasa 5 Color+llak , për aq kohë sa në DST dhe specifikime teknike nuk kërkohet që mallrat e prokuruar të jenë në 5 ngjyra të ndryshme. Pra në asnjë rast nuk është kërkuar që makina shtypëse të shtyp me 5 ngjyra, njëkohësisht në shtojcën 5 të specifikimeve teknike të DST përcaktohet:

- Letra të jetë format A4;
- Numri faqeve 216;
- Letra e brendshme 110gr/m2;
- Pjesa e brendshme e shtypur me 4 ngjyra bazë+llak Etj.

Pra specifikohet që pjesa e brendshme që do shtypet të jetë me 4 ngjyra.

20. Titulli i gjetjes:	Kontradikta të krijuara gjatë hartimit të specifikimeve teknike
Situata:	Gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit me objekt “Botim manuali të përgatitur për kandidatët që do të pajisen me leje drejtimi të kategorive A1, A2, A, B1, BE, viti 2022”, kërkesa e përcaktuar në DST si më poshtë: OE të vërtetojnë që disponojnë makineri shtypëse 61x43 formati letrës, 5C+llak. Një OE pjesëmarrës duhet të disponojë 1 pajisje shtypi të përmasa 5 Color+llak , për aq kohë sa në DST dhe specifikime teknike nuk kërkohet që mallrat e prokuruar të jenë në 5 ngjyra të ndryshme. Pra në asnjë rast nuk është kërkuar që makina shtypëse të shtyp me 5 ngjyra, njëkohësisht në shtojcën 5 të specifikimeve teknike të DST përcaktohet: <ul style="list-style-type: none"> · Letra të jetë format A4; · Numri faqeve 216; · Letra e brendshme 110gr/m2; · Pjesa e brendshme e shtypur me 4 ngjyra bazë+llak Etj. Pra specifikohet që pjesa e brendshme që do shtypet të jetë me 4 ngjyra.
Kriteri:	Nenin 36 “Specifikimet Teknike”, Ligji nr.162 dt.23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”
Ndikimi/Efekti:	Krijon konfuzion në pjesëmarrjen e O.E. si dhe në vlerësimin e ofertave nga KVO
Shkaku:	Mos rakordim midis kriterëve dhe specifikimeve të hartuara
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Organet Drejtuese të DPSHTRR-së, gjatë hartimit të specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta të tregojnë kujdes në hartimin e tyre, të bazohet në legjislacionin dhe udhëzimet përkatëse duke hartuar specifikime teknike të cilët janë gjithëpërfshirëse duke krijuar pjesëmarrje të gjerë të O.E. dhe jo diskriminuese si dhe të jenë të detajuara në mënyrë që të jenë të kuptueshme.

Përsa është trajtuar në këtë pjesë të P/Raportit të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacion me shkresë nr. 409/3 prot, datë 09.10.2023 “Kundërshtime për akt konstatimet e grupit të auditimit të KLSH”, nga ana e përfaqësuesve të institucionit, të cilat janë të paraqitura më poshtë, pa ndërhyrje dhe rregullime nga ana drejtshkrimore:

Pretendimet e subjektit:

Procedura “Botim i manualit të përgatitur për kandidatët që do të pajisjen me leje drejtimi të kategorive A1,A2,A,B1,BE”

“Gjetja nr.1 në faqen 4, në lidhje me kërkesën në specifikime teknike ku është përcaktuar që pjesa e brendshme e shtypur me 4 ngjyra bazë+llak bëhet me dije se manuali përmban imazhe me rezolucion të lartë dhe madje dokumentat teksti të.....

Oëndrimi i Grupit të Auditimit të KLSH –së:

Referuar pretendimeve të mësipërme të cilat janë të njëjta si në observacionet e sjella gjatë fazës të projekt raportit, duke mos sjellë fakte apo prova të reja, grupi i auditimit mban të njëjtin qëndrim.

Për këto arsye, sa më sipër, observacioni juaj nuk pranohet

II.2.7. “Auditim me zgjedhje sipas periudhave mbi rregullshmërinë e blerjeve me vlera të vogla (shpenzimet administrative për automjete, udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit, sponsorizime, etj)”

Analiza dhe vlerësimi zbatimit të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël (Korrik 2021-Dhjetor 2022)

Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor(DPSHTRR) sipas viteve 2021, 2022 ka realizuar 77 procedura blerje me vlera të vogla, në shumën 24,371,070 lekë, për blerjen e artikujve dhe shërbimeve si dhe të grup artikujve dhe grup-shërbimeve.

Nga auditimi për blerjet me vlera të vogla, sipas viteve objekt auditimi, rezultoi se janë zhvilluar sa vijon:

Vitet	Blerje të vogla		Seleksionuar për tu audituar bazuar në riskun e auditimit		
	Numër	vlerë	Numër	vlerë	në % ndaj totalit
6 majori 2021	22(12)shkresore	7,583,304	5	3,055,000	40.2%
2022	50(28)shkresore	16,787,766	14	9,434,822	56.2%
Totali	77(40)shkresore	24,371,070	19	13,469,822	55.2%

lekë
Burimi i të dhënave DPSHTRR

Ngritja dhe zgjedhja e komisionit për caktimin e personave përgjegjës që do të administrojnë në mënyrë të vazhdueshme procesin e prokurimit pranë DPSHTRR është bërë në fillim të vitit me urdhërin nr.125 datë 07.01.2022 me përbërje (A. Gj.me profesion juriste, A. D. me profesion juriste, F. D. me profesion juriste, G. P. me profesion juriste, M. A. me profesion ekonomiste, B. Gj.me profesion ekonomiste, E. C. me profesion ekonomist, S. U. me profesion përkthyes, R. S. jurist).

Ngritja dhe zgjedhja e komisionit BVV është bërë në fillim të vitit me urdhërin nr.128 datë 05.01.2022 me përbërje (F. D. Kryetare, M. A.anëtare dhe G. P. anëtare).

Tabela e procedurave të prokurimit me blerje me vlerë të vogël të audituara

Nr	Objekti	OE fitues	Vlera e fituar	Aktë i marrjes në dorëzim datë
1	Blerje bateri UPS	I.	300,000	04.11.2021
2	Blerje materiali letër që do përdoret për lejen e qarkullimit	A.	850,000	13.12.2021
3	Hologramë për lejen e qarkullimit	S.	925,000	31.12.2021
4	Sigurim i aseteve nga zjarri	E. Sha	892,000	28.12.2021
5	Sinjalistike dhe brandim i objekteve	S.	980,000	20.01.2022
6	Automatizim i procedurave ëeb online	O. C.	749,800	15.07.2022
7	Blerje usb dongle-Security	H.P.	907,500	02.11.2022
8	Modul ne ëeb ndërveprim me përdoruesit	F. B.G.	649,900	01.03.2023
9	Mirëmbajtje e sistemit të kamerave dhe GPS	F. S.	800,000	12 muaj të pjesshme
10	Furnizim me uje për punonjësit	L.	795,622	04.07.22 urdhëri
11	Mbrojtja e aseteve nga zjarri dhe rreziqet shtese	E.	999,200	Certifikate sigurimi 01.03.22
12	Blerje materiale pastrimi	Xh. G.	378,700	21.12.22
13	Blerje artikuj kancelarie	M.g&D.	400,000	06.06.22
14	Shërbim karrotreci për automjete retro	A.I.	301,000	16.06.22
15	Mates manual drite	A. A.	980,000	18.07.22
16	Blerje leter speciale per lejen e qarkullimit	A.	940,000	04.03.22
17	Blerje kondicioner inverter	C.	660,000	07.07.22
18	Blerje holli protokollar	A. O.	873,000	06.06.22
19	Sinjalistike dhe brandim i objekteve	S.	980,000	20.01.2022

Baza e të dhënave Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor

Nga auditimi i tyre u konstatuan këto mangësi:

Në procedurën me vlerë të vogël “Blerje holli protokollar” me urdhër prokurimi nr.8862/3 datë 23.05.2022, përllogaritja e fondit limit e kryer me testim tregu me 3(tre) oferta është në

kundërshtim me VKM Nr.285 RRPP datë 19.05.2021, neni 76 ,b si dhe Udhëzimin Nr.5 datë 25.06.2021 pika 7 pasi përlllogaritja e fondit limiti behët duke u mbështetur në testimin e tregut me 3(tre) oferta ekonomike të administruara. Në testimin e tregut, ofertat e administruara nga OE “F. T. Person (PF) me NIPT L--F dhe OE “I. E.” Person Fizik me NIPT K--E nuk e kanë në veprimtarinë e tyre natyrën e objektit të prokurimit.

- Dokumentacioni i dorëzuar nga OE i shpallur fitues “A. O.” PF rezulton se nuk përmbush kushtet e përcaktuara në ftesën për ofertë. Konkretisht në ftesën për ofertë ishte përshkruar që OE duhet të vërtetojë se ka realizuar kontrata të mëparshme me institucione publike apo private shoqëruar me faturat përkatëse. Faturat e ngarkuara nga OE nuk përputhen me natyrën objekt prokurimi, pasi fatura tatimore me Nr.14 datë 03.12.2020 si dhe fatura me Nr.20 datë 13.12.2021, mallrat e shitur kanë të bëjnë me dekore te ndryshme, kryesisht zbulurime për vitin e ri.

- AK të marr në konsideratë në të gjitha rastet e procedurave të prokurimit për OE ofertues që marrin pjesë , të kërkojnë deklarata mbi origjinën e mallrave të tyre në mënyrë të tillë që të vërtetohet që aktiviteti tyre përputhet me natyrën e objektit të prokurimit duke shmangur vonesat në zhvillimin e procedurave.

- Në procedurën me vlerë të vogël “Blerje kondicioner inverter” me urdhër prokurimi nr.16678 datë 30.05.2022 përlllogaritja e fondit limit e kryer me testim tregu me 3(tre) oferta është në kundërshtim me VKM Nr.285 RRPP datë 19.05.2021, neni 76 ,b si dhe Udhëzimin Nr.5 datë 25.06.2021 pika 7 pasi përlllogaritja e fondit limit behët duke u mbështetur në testimin e tregut me 3(tre) oferta ekonomike të administruara. Në testimin e tregut ofertat e administruara nga OE “S.-T.” me NIPT L--G dhe OE “A.-T.” K--Q janë OE të cilët në fushën e veprimtarisë së tyre nuk e kanë objekt primar natyrën e objektit të prokurimit.

- Në kriteret e vendosura në ftesën për ofertë nga ana e KBV si kriter kualifikues është kërkuar që OE duhet të disponojnë Certifikata ISO të ndryshme, ISO 9001:2015(Sistemi Menaxhimit të Cilësisë),ISO 14001:2015(Sistemi Menaxhimit të Mjedisit), ISO 41001:2018 (Sistemi Menaxhimit të Objekteve).

- Pavarësisht se certifikimet ISO janë të nevojshme pasi tregon aftësinë e organizatës për të përmbushur kërkesat e klientëve, certifikimet ISO nuk lëshohen për një të mirë apo shërbim, por certifikata lëshohet për sistemin e krijuar nga organizatat për të prodhuar këtë të mirë.Si i tillë qëllimi i dokumentimit si dhe prodhimi i produkteve ose shërbimeve ,organizata , të gjitha shitjet, marketing, financa, komunikim, burime njerëzore, dokumentacion, zhvillimi dizajni, studimi R., prokurim etj. Për sa më sipër ISO 9001:2015(Sistemi menaxhimit të Cilësisë), ISO 14001:2015 (Sistemi Menaxhimit të Mjedisit) janë kritere te nevojshme për të vërtetuar besueshmërinë e biznesit ,certifikata ISO 41001:2018 (Sistemi Menaxhimit të Objekteve) është kërkesë kufizuese pasi ul numrin e OE pjesëmarrës.

- Në procedurën “Blerje letër speciale” për lejen e qarkullimit” afati i lëvrimit të mallit në ftesën për ofertë është përcaktuar 1(një) ditë pas shpalljes së fituesit. AK duhet të marr në konsideratë që afati i lëvrimit të mallit një ditë pas shpalljes së fituesit mund ti krijojë vështirësi OE që të përgatisin të gjithë sasinë pasi është i pamjaftueshëm afati kohor i saj. Afati lëvrimit mallit është e nevojshme që në të gjitha procedurat me vlerë të vogël të përcaktohet minimumi 3(tre) pas shpalljes së fituesit.

Përcaktimi i afatit të lëvrimit të mallit 1(një) ditë pas shpalljes së fituesit ka bërë që OE i renditur i pari të tërhiqet nga procedura e prokurimit për arsye të pamjaftueshmërisë së kohës për të realizuar procedurën.

- Në procedurën “Blerje aparat matës manual për tejçim drite” për vitin 2022 në dokumentet e dërguara nga OE fitues të përcaktuara në ftesën për ofertë rezultoi se nuk përmbushet kriteri Autorizim Prodhuesi/Distributori pasi deklarata e prodhuesit është e pa noterizuara e pa firmosur dhe vulosur dhe si rrjedhojë e bën të pavlefshme vërtetësinë e këtij dokumenti.

Zhvillimi i procedurave

- Në asnjë rast të përdorimit të formës së prokurimit “Blerje me vlerë të vogël”, fondi limit nuk ka qenë mbi 800,000 lekë pa TVSH, pra mbi kufirin monetar të përcaktuar me vendimin e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”, neni 56 “Procedura e prokurimit me vlerë të vogël” .
- Në të gjitha rastet AK ka bërë përlllogaritjen e fondit limit, duke u bazuar në ofertat e marra në treg dhe të pasqyruara dokumentin e hartuar për llogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike.
- Nga Komisioni i Prokurimit me Vlera të Vogla është zbatuar limiti i përcaktuar për prokurimet me vlera të vogla i cili nuk është tejkaluar në asnjë rast.
- Nuk ka copëzim fondi.
- Miratimi i kërkesës për prokurim në të gjitha rastet janë miratuar nga Nëpunësi i Autorizuar i AK.
- Shpallja elektronike në sistem e procedurës, është realizuar në kohën e përcaktuar sipas dispozitave ligjore në fuqi. Anëtarët e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël në të gjitha rastet, pasi kanë krijuar në sistem dosjen e tenderit, u janë drejtuar nëpërmjet ftesës për ofertë (sipas formularit nr. 3), 5 (pesë) operatorëve ekonomikë për një periudhë 1-2 ditë nga nxjerrja e urdhrit të prokurimit.
- Në të gjitha rastet është zbatuar kriteri i çmimit më të ulët për klasifikimin përfundimtar.
- Në të gjitha rastet nga anëtarët e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël, është mbajtur procesverbal për shpalljen e OE fitues, mbi bazën e ofertës më të ulët të shpallur nga sistemi. (Në të gjitha rastet ishin printuar ofertat e gjeneruara nga sistemi).
- Në të gjitha rastet OE fitues është njoftuar nëpërmjet sistemit elektronik. Në rastet e tërheqjes së ofertave të vendeve të para është dokumentuar me shkresat zyrtare nga operatorët ose printimit nga sistemi i emali-ve të kryera nga AK(njoftimi) dhe OE(përgjigja).
- Procesverbalet e mbajtura nga komisioni për kalimin tek operatori i radhës kanë qenë të firmosura nga komisioni.
- Në dosjen e prokurimeve me vlera të vogla ndodheshin Faturat Tatimore Shitje, të njëjta me vlerën e ofertuar si dhe me urdhër shpenzimet përkatëse.
- Për gjithë periudhën objekt auditimi për procedurat me blerje të vogla, është bërë inventarizimi i dosjeve dhe arkivimi, sipas Udhëzimit nr. 3 datë 08.01.2018, “Për zhvillimin e Prokurimeve me vlerë të vogël në sistem të prokurimit elektronik për autoritetin kontraktor dhe operatorët ekonomik “ku thuhet shprehimisht që “Autoriteti kontraktor duhet të bëjë arkivimi e procedurës së prokurimit brenda 1ditë punë nga mbyllja e fazës së njoftimit fitues”, pasi faza arkivimit të kontratës është e papërfunduar.
- Për të gjitha rastet e blerjeve si për shërbimet dhe mallrat është kryer procesi i marrjes në dorëzim të mallit dhe shërbimit nga komisioni i ngritur për çdo rast nga Nëpunësi Autorizues.

21. Titulli i gjetjes:	Përlllogaritje e gabuar e fondit limit
Situata:	Në procedurën me vlerë të vogël “Blerje hollë protokollare” me urdhër prokurimi nr.8862/3 datë 23.05.2022, përlllogaritja e fondit limit e kryer me testim tregu me 3(tre) oferta. Në testimin e tregut të kryer nga KBV ofertat e administruara nga OE “F. T. (PF) me NIPT L--F dhe OE “I. E.”

	PF me NIPT K--E nuk e kanë në veprimtarinë e tyre objektin të prokurimit.
Kriteri:	Ligji nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar; Udhëzim Nr.5 datë 25.06.2021 i APP.
Ndikimi/Efekti:	Mos pasqyrim të saktë të vlerës së fondit limit.
Shkaku:	Mos verifikim të saktë në QKB të veprimtarisë së OE
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	AK, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, KBV në rastet e përlllogaritjes së fondit limit me testim tregu me 3(tre) oferta ekonomike të verifikojë veprimtarinë në QKB të OE nga ku të përputhet veprimtaria e tyre me objektin e prokurimit.

22. Titulli i gjetjes:	Nuk është kërkuar asnjë deklaratë apo vërtetim në lidhje me mallrat të cilët nuk prodhohen nga OE
Situata:	Në disa procedura të cilat OE ofertues nuk janë prodhues nuk është kërkuar asnjë deklaratë apo vërtetimin në lidhje me origjinën e këtyre mallrave. Më konkretisht në asnjë rast nuk vërtetohet se cili është prodhuesi në mënyrë të tillë që të vërtetohet lidhja ndërmjet prodhuesit apo distributorit të autorizuar prej tij me OE
Kriteri:	Ligji nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar; Udhëzim Nr.5 datë 25.06.2021 i APP.
Ndikimi/Efekti:	Nuk jep garanci në përmbushjen e kushteve teknike të kontratës si dhe origjinën e mallit
Shkaku:	Neglizhencë e njëjësive të hartimit të kriterëve teknike
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	AK, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, të kërkojë në lidhje me OE ofertues, në rastet e tilla kur ato nuk janë prodhues deklarata apo vërtetime të ndryshme mbi origjinën e mallrave që të vërtetohet lidhja ndërmjet prodhuesve apo distributorëve të autorizuar prej prodhuesit me OE ofertues në procedurat e prokurimit.

Përsa është trajtuar në këtë pjesë të P/Raportit të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacion me shkresë nr. 409/5 prot, datë 08.12.2023 “Kundërshtime për akt konstatimet e grupit të auditimit të KLSH”, nga ana e përfaqësuesve të institucionit, të cilat janë të paraqitura më poshtë, pa ndërhyrje dhe rregullime nga ana drejtshkrimore:

Pretendimet e subjektit:

Bazuar sa më sipër, sqarojmë se për shkak të natyrës specifike të mallit objekt prokurimi Komisioni i është drejtuar subjekteve të cilat kanë objekt veprimtarie gjithëpërfshirës të llojit “tregtim mallra të ndryshme” si dhe në përlllogaritjen e fondit limit është marrë mesatarja e tre ofertave. Gjithashtu referuar udhëzimit të Blerjeve të Vogla nr.05, datë 25.06.2021, “Mbi përdorimin e procedurës mbi blerjen me vlerë të vogël dhe zhvillimet e saj me mjete elektronike”, Komisioni mund të përdorë metodën e testimit të tregut, pa qenë e domosdoshme administrimi i ofertave, por vetëm treguesit e çmimeve në procesverbalin e mbajtur për këtë proces. Referuar udhëzimit për blerjet e vogla nga ne si Komision janë bërë pjesë të dosjes të treja ofertat e vëna në dispozicion, të cilat kanë shërbyer për përlllogaritjen e fondit limit objekt prokurimi.

Sa më sipër mendojmë se veprimet e Komisionit nuk janë në kundërshtim me VKM Nr.285 (RRPP), dhe Udhëzimin nr.5, datë 25.06.2021.

- Referuar argumentimit të gjetjes nr.2. në lidhje me faturat tatimore të cilat kanë të bëjnë me shitje mallrash jo

në përputhje me mallin objekt prokurimi e cila nuk është marrë në konsideratë nga ju:

Sqarojmë dhe riargumentojmë se Komisioni i Blerjeve të Vogla duke u bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 40 dhe neni 56, ka përcaktuar në ftesën për ofertë që Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se ka realizuar përvojë të mëparshme të ngjashme me një ent publik ose me sektorin privat.

Referuar formës së procedurës “Blerje e vogël”, si dhe me qëllim pjesëmarrjen e gjerë të ofertuesve në garë, nuk është përcaktuar një vlerë fikse për realizimin e përvojës së mëparshme. Kështu që Komisioni ka vlerësuar vetëm faturën nr 14, datë 03.12.2020, pjesë e së cilës është zëri “Barrierë për kontroll hyrje -dalje”. Komisioni ka vlerësuar këtë zë si realizim kontrate të mëparshme për shkak të ngjashmërisë me mallin objekt prokurimi “Barriera vertikale gold” që AK ka blerë nëpërmjet kësaj procedurë. Kërkesa për përvojën e mëparshme është vlerësuar e rëndësishme për të njohur përvojën e ofertuesve, me qëllim që fituesi i mundshëm të zotërojë kapacitetet dhe përvojën e duhur si dhe të realizojë me sukses lëvrimin e mallrave objekt i kontratës. Gjatë kësaj procedure lëvrimi i mallrave është realizuar me sukses.

Sa më sipër mendojmë se veprimet e Komisionit nuk janë në kundërshtim me VKM Nr.285 (RRPP), dhe Udhëzimin nr.5, datë 25.06.2021.

Referuar argumentimit të gjetjes nr.1 në lidhje me mangësitë e testimit të tregut, konkretisht se subjektet ofertuese për testimin e tregut, “S.-T. shpk” dhe “A.-T. shpk” nuk kanë primare në veprimtarinë e tyre natyrën e objektit e prokurimit, e cila nuk është marrë në konsideratë nga ju:

Bazuar sa më sipër, sqarojmë se subjektet e sipërpërmendura kanë të përfshirë objektin e prokurimit në fushën veprimtarisë së tyre. Referuar Udhëzimit të Blerjeve të Vogla nr.05, datë 25.06.2021, “Mbi përdorimin e procedurës mbi blerjen me vlerë të vogël dhe zhvillimet e saj me mjete elektronike”, Komisioni mund të përdorë metodën e testimit të tregut, pa qenë e domosdoshme administrimi i ofertave, por vetëm treguesit e çmimeve në procesverbalin e mbajtur për këtë proces. Nga ne si Komision është gjykuar të merren parasysh këto oferta të cilat kanë objekt veprimtarie “tregtim të sistemeve të kondicionimit” dhe mendojmë se fusha e veprimtarisë së tyre përfshin objektin e prokurimit

Sqarojmë dhe riargumentojmë gjetjen e grupit të kontrollit të KLSH, si më poshtë:

Komisioni i blerjeve të vogla ka vendosur afatin e lëvrimit të mallit 1 (një) ditë nga shpallja e fituesit për shkak të gjendjes emergjente të nevojës së institucionit për mallin objekt prokurimi.

Sa më sipër mendojmë se veprimet e Komisionit nuk janë në kundërshtim me VKM Nr.285 (RRPP), dhe Udhëzimin nr.5, datë 25.06.2021. Megjithatë nga ne si Autoritet Kontraktor është marrë në konsideratë rekomandimi i grupit të auditit për procedurat në vijim.

Oëndrimi i Grupit të Auditimit të KLSH –së:

Referuar pretendimeve të mësipërme në lidhje me gjetjen nr. 22 Dokumentacioni i dorëzuar nga OE i shpallur fitues “A. O.”, grupi i auditimit merr në konsideratë osbervacionin duke reflektuar përgjatë materialit, ndërsa në lidhje me gjetjet e tjera osbervacionet të cilat janë të njëjta si në osbervacionet e sjella gjatë fazës të projekt raportit, duke mos sjellë fakte apo prova të reja, grupi i auditimit mban të njëjtin qëndrim.

Për këto arsye, sa më sipër, osbervacioni juaj pranohet pjesërisht

II.2.8. “Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit (identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK Mjedisi i Kontrollit, Menaxhimi i Riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informimi, Komunikimi dhe Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raportit përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm)”

Në zbatim të nenit 8, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2011 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR) i lind detyrimi për ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik gjatë çdo viti.

Për vitin 2021, është ngritur grupi i menaxhimi strategjik dhe ndryshuar sipas urdhrave, si më poshtë vijon:

- Urdhër nr. 49, datë 21.01.2021 “Për ngritjen e grupit për menaxhimin strategjik”;

- Urdhër nr. 49/1, datë 24.05.2021 “Për një shtesë në urdhrin nr. 49, datë 21.01.2021 “Për ngritjen e grupit për menaxhimin strategjik”, shtuar z. D.L..

Për vitin 2022, është ngritur grupi i menaxhimi strategjik dhe ndryshuar sipas urdhrave, si më poshtë vijon:

- Urdhër nr. 33, datë 11.01.2022 “Për ngritjen e grupit për menaxhimin strategjik”;
- Urdhër nr. 33/1, datë 08.04.2022 “Për një shtesë në urdhrin nr. 33, datë 11.01.2022 “Për ngritjen e grupit për menaxhimin strategjik”, shtuar zj. Xh. M., z. A. Sh. dhe zj. D. B.;
- Urdhër nr. 33/2, datë 08.04.2022 “Për një ndryshim në urdhrin nr. 33, datë 11.01.2022 “Për ngritjen e grupit për menaxhimin strategjik”, zëvendësuar z. A.N. me z. A. P.;

Për vitin 2023, është ngritur grupi i menaxhimi strategjik dhe ndryshuar sipas urdhrave, si më poshtë vijon:

- Urdhër nr. 01, datë 05.01.2023 “Për ngritjen e grupit për menaxhimin strategjik”;
- Urdhër nr. 01/1, datë 21.02.2023 “Për një ndryshim në urdhrin nr. 01, datë 05.01.2023 “Për ngritjen e grupit për menaxhimin strategjik”, zëvendësuar zj. I. H. me zj. A. P.;
- Urdhër nr. 01/2, datë 29.05.2023 “Për një shtesë në urdhrin nr. 01, datë 05.01.2023 “Për ngritjen e grupit për menaxhimin strategjik”, shtuar z. S. I.;
- Urdhër nr. 01/3, datë 30.05.2023 “Për një ndryshim në urdhrin nr. 01, datë 05.01.2023 “Për ngritjen e grupit për menaxhimin strategjik”, zëvendësuar zj. A. P. me zj. A. Gj. deri në rikthimin në detyrë të zj. A. P..

Në zbatim të nenit 18, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2011 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 28, datë 15.12.2011 “Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike”, Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR) i lind detyrimi për plotësimin e Pyetësorit të Vetëvlerësimit për Funkcionimin e Sistemeve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, hartimin e Deklaratës për Cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm, Raportit Vjetor të DPSHTRR-së dhe Planit të Veprimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.

Për sa më sipër, për vitin 2021, janë përgatitur materialet si më poshtë vijon:

- Me shkresën nr. 4763 Prot, datë 23.02.2023, është hartuar Deklarata për Cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm të DPSHTRR për vitin 2021;
- Hartuar raporti për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të DPSHTRR-së për vitin 2021;
- Plotësuar pyetësori i vetëvlerësimit për funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit për vitin 2021;
- Hartuar plani i veprimit për menaxhimin financiar dhe kontrollin për vitin 2022.

Materialet e cituara më sipër, janë dërguar pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresën nr. 4763/1 Prot, datë 23.02.2022.

Për vitin 2022, janë përgatitur materialet si më poshtë vijon:

- Me shkresën nr. 3866 Prot, datë 27.02.2023 është hartuar Deklarata për Cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm të DPSHTRR për vitin 2022;
- Hartuar raporti për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të DPSHTRR-së për vitin 2022;

- Plotësuar pyetësori i vetëvlerësimit për funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit për vitin 2022;
- Hartuar plani i veprimit për menaxhimin financiar dhe kontrollin për vitin 2023.

Materialet e cituara më sipër janë dërguar pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresën nr. 3866/1 Prot, datë 27.02.2023.

Mjedisit të Kontrollit

Hartimi i procedurës standard, gjurma e auditit për dokumentimin, ruajtjen, qarkullimin dhe nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve nga strukturat e DPSHTRR-së;

Hartimi i procedurës për mënyrën e administrimit dhe shpërndarjes së Kartave të Tahogرافit;

Hartimi i procedurave për administrimin dhe shitjen e artikujve si: targa souvenir, katalogu Retro, etj;

Hartimi i procedurës që do të ndiqet për furnizimin, dokumentimin, ruajtjen, daljen nga magazina të mallrave/materialeve që do përdoren në eventet e organizuara nga DPSHTRR.

Menaxhimi i riskut

Me shkresën nr. 4763/1 Prot, datë 23.02.2022, është dërguar pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe regjistri i riskut për vitin 2022, si dhe nga Drejtori i Përgjithshëm është miratuar regjistri i riskut nr. 3866/2 Prot, datë 28.02.2023, i përditësuar për vitin 2023.

Aktivitetet e Kontrollit

Në pjesën e aktiviteve të kontrollit do të përfshihet veprimtaria e auditit të brendshëm. Me anë të shkresës nr. 18396/1 Prot., datë 20.10.2020, dërgohet “Plani strategjik dhe vjetor i veprimtarisë së Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm për vitet 2021-2023”, si dhe “Plani vjetor 2020, i rishikuar”

Gjithashtu me anë të shkresës nr. 3688 Prot., datë 15.02.2022, dërgohet raporti për Veprimtarinë e DAP-së për vitin 2021.

Informimi dhe Komunikimi

Në përmbushje të informimit dhe komunikimit, informatizimit të informacionit, rritjes së shërbimeve dhe pagesave online me klientët, rritjes së transparencës me publikun duke e informuar në kohë reale për ndryshimet ligjore dhe për shërbimet e reja që ka ofruar DPSHTRR-ja; është strukturuar rrjeti i brendshëm i marrjes dhe dhënies së informacionit ndërmjet niveleve të ndryshme hierarkike në funksion të arritjes së objektivave.

Digjitalizimi i shërbimeve u përqendrua në mbledhjen, përpunimin dhe analizimin e të dhënave për: studimin e eksperiencës së qytetarëve në marrjen e shërbimit; rishikimin e proceseve operacionale; rishikimin e modeleve të aplikuara, etj.

Monitorimi

Gjatë vitit 2022, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor ka ndërmarrë një sërë masash për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësi dhe plan veprimi për të ardhmen. Gjatë kësaj periudhe është këmbëngulur në:

- Automatizimin e procedurave online në ëeb.
- Ndërtimi i Modullit në ëeb për ndërveprim me përdoruesit.
- Përmirësimi i sistemit të e-DPSHTRR dhe financiar sipas kërkesave për fiskalizim.
- Implementimi i sistemit të monitorimit në ambientet brenda dhe jashtë në të gjitha qendrat e kontrollit teknik pranë çdo drejtorie rajonale me sistemin e monitorimit të DPSHTRR-së.

- Rritja e masave organizative dhe teknike sipas ligjit nr. 2/2017 “Për sigurinë Kibernetike.
- Informatizimi i shërbimeve në Drejtorinë Licensimit dhe Certifikimit si dhe në Drejtorinë e Drejtuesve të Mjeteve.
- Ndjekja e debitorëve në lidhje me vjeljen e taksës së TVMP-së dhe TVML-së.

Për sa më sipër u konstatua:

- Në përgjithësi organizimi dhe funksionimi e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit (Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK. Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informimi, Komunikimi dhe Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm) është i plotësuar dhe në koordinim me njëra tjetrën.
- Nga shqyrtimi i ankesave drejtuar institucionit, u vu re që në rastet e shit-blerjeve të mjeteve pranë noterive ekziston mundësia që pala blerëse e mjeteve të mos dërgojnë kontratën e shit-blerjes pranë zyrave të DPSHTRR, duke bërë të mundur që të mos ndryshohet pronësia e mjetit. Edhe në rastet kur pranë sporteleve paraqitet pala shitëse, nga DPSHTRR nuk merret në konsideratë ndryshimi i pronësisë.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga Auditimi: Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

-Nga **20 masa organizative** të rekomanduara gjithsej, **16** janë zbatuar plotësisht, **1** është në proces zbatimi dhe **3** nuk janë zbatuar.

-Nga **1 masë për shpërblim dëmi e rekomanduar dhe e zbatuar plotësisht.**

-Nga **1 masë për eliminimin e efekteve negative konstatuar në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike e rekomanduar, por e pa zbatuar.**

Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit. (neni pika)

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 15, të Projektraportit të Auditimit)

1.1 Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrë masa për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, të hartojë një plan veprimi për detyrat e përcaktuara duke përcaktuar afatet dhe personat përgjegjës për zbatimin e tyre.

Menjëherë

2. Gjetje nga Auditimi: Vendimet e marra nga Këshilli Mbikëqyrës në përgjithësi janë në përputhshmëri me aktet ligjore e nënligjore në fuqi për sa i përket tematikave për të cilat janë marrë, por nga auditimi i praktikave të disa vendimeve të marra nga Këshilli Mbikëqyrës me dokumentacionin e plotë justifikues, vihet re një menaxhim jo i duhur financiar i institucionit për arsyet e mëposhtme:

- vendimi për marrjen me enfiteozë të sheshit funksional të Qendrës së Kontrollit Teknik dhe Fizik Fier, ku nuk është përdorur çmimi referencë për m² i marrjen me qira është 37 lekë/m² bazuar në VKM nr. 54 datë 05.04.2014, por një çmim tjetër më i lartë, ku është hasur pengesë nga Bashkia Fier, edhe pse përmirësimi i kushteve të Qendrës së Kontrollit Teknik dhe Fizik Fier është në të mirë të banorëve të Bashkisë Fier. Gjithashtu nisur nga më sipër kontrata e mësipërme, nuk shihet si kontratë enfiteoze nga Bashkia Fier pasi Enfiteoza ka si qëllim jo vetëm përdorimin e sendit,

por edhe përmirësimin e tij, i cili duhet të cilësohet në kontratë, gjë e cila nuk është marrë në konsideratë gjatë diskutimit të çmimit nga ana e Bashkisë Fier.

- Vendimi nr. 30 datë 22.07.2022 “Për miratimin e kërkesës për huadhënie për A. sh.a.”, për mbështetje financiare në formën e huadhënies deri në shumën 936,000,000 lekë të ndara në këste mujore. Në dokumentacionin mbështetës jepen sqarime të detajuara që DPSHTRR nuk mund të mbulojë këtë shumë me fondet e veta, por gjithashtu jep si alternative marrjen e një overdrafti pranë bankave të nivelit të dytë. Në gjykimin e grupit të auditimit dhe praktikave më të mira nuk duket e arsyeshme marrja e një overdrafti për huadhënien drejt një shoqërie tjetër.

Sa më sipër është në kundërshtim me Statutin e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, Rregulloren nr. 10562/1 Prot., datë 19.06.2018 dhe Ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 25, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1 Rekomandimi: Organet Drejtuese të DPSHTRR-së, gjatë marrjes së vendimeve të kenë në konsideratë menaxhimin e fondeve në proporcion me 3 E (efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet), marrjen e vendimeve në proporcion me objektivat e institucionit si dhe të krijimin e kushteve për arritjen e tyre sipas strategjive të institucionit.

Në vijimësi

3. Gjetje nga Auditimi: DPSHTRR kryen aktivitetin e saj në bazë Rregullore së Brendshme dhe Statutit. Rregullorja e Personelit është miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 27, datë 23.11.2012, e cila nuk është azhurnuar me ndryshimet në Statut dhe strukturë dhe nuk i përgjigjet stadi të zhvillimit të drejtorisë. Me urdhrin e Drejtorit nr. 778, datë 19.06.2018 është hartuar dhe miratuar “Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të transportit rrugor” por nuk është e miratuar nga Këshilli Drejtues. Rregullorja e Brendshme vijon të jetë e miratuar vetëm nga Drejtori dhe jo nga Këshilli Drejtues.

Statuti i Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, ka ndryshuar referuar shkresës nr. 14825, datë 07.06.2022, drejtuar Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë me lëndë “Për miratimin e disa ndryshimeve në statutin e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor” dhe miratuar ndryshimet e kërkuara nga Drejtori i Përgjithshëm me shkresën nr.4572, datë 21.12.2022, ose miratuar 6 muaj me vonë. Edhe pse në DPSHTRR ka patur ndryshime të vazhdueshme të “Rregullores së brendshme” apo edhe të “Strukturës së DPSHTRR” si dhe në “Statutin e DPSHTRR” vihet re se “Rregullorja e Personelit të DPSHTRR-së” nuk është përditësuar dhe (përsëkrimet e punës) nuk janë miratuar në Këshillin Drejtues. Sa më sipër në mospërputhje me Pikën “m”, neni 10 “Kompetencat e Këshillit Drejtues” i Statutit, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 33, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1 Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Njerëzore në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrë masa për përmirësimet në Rregulloren e Personelit duke reflektuar ndryshimet e vazhdueshme të Rregullores së Brendshme dhe Statutit të DPSHTRR, si edhe miratimin e saj nga strukturat drejtuese duke respektuar afatet kohore, me qëllim funksionimin e institucionit sipas kërkesave të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme dhe Statut të Institucionit.

Menjëherë

4. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi në lidhje me zbatimin e Strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi për periudhën 01.07.2021 deri më 31.12.2022, u konstatua se struktura dhe pagat e punonjësve të DPSHTRR, kanë pësuar ndryshime referuar urdhrave të Ministrit Infrastrukturës dhe Energjisë. Rekrutimi i punonjësve është kryer sipas procedurave të përcaktuara që nga njoftimet, aplikimet, paraqitja e dokumentacionit dhe vlerësimi nga komisioni i ngritur për këtë qëllim. Megjithatë është rritur

numri i shërbimeve, konstatohet rritje e numrit të punonjësve si në përbërje të Kabinetit ashtu edhe në Njësi, Drejtori dhe Sektorë. Struktura e DPSHTRR (Administrata) përbëhet nga Kabineti me 12 persona, 5 Njësi me 10 Sektorë dhe 60 persona si edhe 10 Drejtori me 27 Sektorë dhe 142 persona. Pra, struktura është e organizuar në 1 Kabinet, 5 Njësi, 10 Drejtori dhe 37 Sektorë me numër punonjësish 214 persona.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 33, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të DPSHTRR dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore, të analizojnë dhe vlerësojnë nevojat për numrin e punonjësve referuar strukturës organike të DPSHTRR, me qëllim uljen e numrit të punonjësve dhe shfrytëzimin me efektivitet të kohës së punës në çdo Njësi, Drejtori dhe Sektorë, pa cenuar cilësinë e shërbimeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi në lidhje me emërimin e punonjësve në mbështetje të nenit 21, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, “Forma e Kontratës së punës”, nenit 8 të vendimit nr. 27 datë 23.11.2012, të Këshillit Drejtues, Rregullores së Personelit të DPSHTRR dhe strukturën e miratuar për rekrutimin e punonjësve, nga verifikimi i administrimit të dosjeve të punonjësve të DPSHTRR-së, Drejtorive Rajonale dhe DTSH-së u konstatua se në Drejtorinë e Auditit të Brendshëm nga 7 punonjës, 4 prej tyre kanë kryer detyrën pa u pajisur me certifikatën e auditit të brendshëm, Gjithashtu, mangësi u konstatuan në emërimin e punonjësve nga ku në 5 raste rezultuan mospërputhje në nivelin arsimor të punonjësve krahasuar me nivelin arsimor të kërkuar nga DPSHTRR, si dhe në drejtim të administrimit të dokumentacionit të dosjeve të personelit. Konkretisht, nga auditimi i ushtruar në 112 dosje personeli të DPSHTRR dhe Degëve Rajonale për plotësimin e dosjeve të personelit me dokumentacionin ligjor, u konstatua se 17 prej tyre nuk janë të plotësuara me dokumente si certifikata, vërtetime nga prokuroria dhe gjykata, si edhe në 3 dosje mungojnë vlerësimet vjetore të punës. Po kështu u konstatua se këto dosje nuk kanë rregullshmëri në pasqyrimin, renditjen sipas inventarit si edhe mënyrën e mbajtjes së dokumenteve pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore. Sa më sipër në kundërshtim me ligjin nr.114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik neni 11 “Punësimi i audituesit të brendshëm” germa “ç”, Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 33, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të DPSHTRR dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore, të marrin masa për emërimin e punonjësve sipas nivelit arsimor dhe profesional referuar kërkesave të miratuara për çdo vend pune si edhe plotësimin dhe arkivimin e dosjeve me dokumentacionin ligjor-profesional me qëllim rritjen e nivelit profesional dhe realizimin e objektivave të institucionit.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga Auditimi: Të ardhurat dhe shpenzimet, mbi të cilat planifikimi i tyre nuk ka qene i saktë, dhe devijanca e tyre në lidhje me realizimin është e lartë.

Shpenzimet janë rritur ndërkohë që të ardhurat janë pakësuar. Shpenzimet për vitin 2022 krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021 kemi rritje të shpenzimeve në masën 21% ose 479,994 mijë lekë ndërsa për të ardhurat për vitin 2022 krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021 ka një tejkalim me 11% ose 323,652 mijë lekë më tepër.

Në 12/mujorin 2022, Fitimi bruto nga aktiviteti i Drejtorive Rajonale dhe DPSHTRR arriti vlerën 577,549 mijë lekë, duke u ulur me -49,951 mijë lekë ose me 8% më pak krahasuar me Programin Ekonomik për të njëjtën periudhë të vitit.

Zërat si “Shpërblime për vjetërsi ne pune” “Gjoha dëmspërblime” dhe “Humbje nga kursi” nuk janë planifikuar. Për sa më sipër në mospërputhje me Ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 43, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6.1 Rekomandimi: Organet drejtuese të DPSHTRR, gjatë hartimit të buxheteve, të analizojnë me kujdes situatën e institucionit, të hartojnë plane financiare për përmirësimin e tyre, negocimin e kushteve më të mira si dhe mundësitë e shtimit të kapitalit të shoqërive duke marrë në konsideratë legjislacionin në fuqi si dhe të kryerjen e një planifikimi të saktë të të ardhurave dhe shpenzimeve, duke u bazuar dhe në vitet e mëparshme.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga Auditimi: Nga analiza e zërave të pasqyrës së “Pozicionit Financiar” dhe analizës së të drejtave dhe detyrimeve konstatohet se institucioni ka të drejta dhe detyrime të mbartura që nga vitet 2005-2016, për të cilat nuk janë krijuar provizionime. Të drejtat janë në vlerën 19,715,496 lekë, të cilat përbëhen nga gjendjet e llogarive në fund të vitit 2022 si:

- llog. 427 “Kërkesa të tjera të arkëtueshme” paraqitet në vlerën 2,979,035 lekë, që përfaqëson detyrimet e personelit të pa arkëtuara nga Drejtoritë ose në procese gjyqësore të krijuara që nga viti 2008, ku vlerën më të madhe të detyrimeve e kanë punonjësit e Drejtorisë Rajonale Tiranë, prej 2,111,919 lekë, për të cilat nuk është marrë asnjë masë për ndjekjen, arkëtimin dhe vlerësimin e tyre, duke tejkaluar afatet e kërimit të këtyre të drejtave, pasi janë parashkruar.

- llog. sintetike “Instrumente të tjera borxhi detyrime buxheti” në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 6,096,620 lekë, e cila përbëhet nga gjendja e llogarisë 4664 “Derdhur gabimisht” në vlerën 5,809,740 lekë, që përfaqëson detyrimet që kanë për kthim DRT për sa paguar më tepër tatim fitimi për vitin 2022 dhe nga sistemimi i veprimeve për shpenzim për sa faturuar tepër në vlerën 286,880 lekë.

- llog. 468/467 “Debitorë të tjerë” paraqitet në fund të vitit 2022 në vlerën 10,639,841 lekë, me një zbritje prej 2,196,247 lekë nga viti 2021, që përfaqëson detyrimet e punonjësve të lindura nga rekomandimet e KLSH dhe Ministria e linjës si edhe nga proceset gjyqësore për largimet që janë të pa arkëtuara në kohë. Për disa raste nuk është ngritur padi me pretendimin për mungesë adresash të sakta si dhe detyrime të subjekteve private për detyrime të lindura ndaj DPSHTRR të cilat janë në ndjekje në shkallë të ndryshme të gjyqësorit, vlera të cilat janë të konsiderueshme, dhe ndikojnë negativisht në rritjen e të ardhurave. Sa më sipër është në mospërputhje me SKK 6. “Provizionet, detyrimet dhe aktivet e kushtëzuara” pika 3, si dhe Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të Ardhurat”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 43, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

7.1 Rekomandimi: Drejtoria e Ekonomike në bashkëpunim me Drejtoritë Rajonale dhe Drejtorinë Juridike të marrin masa për analizimin e hollësishtëm të debitorëve, për gjetjen e saktë të të dhënave të debitorëve fizik (ish-punonjës) dhe të subjekteve fizikë e juridik, duke identifikuar shumatat pa mundësi arkëtimi të klientëve/debitorëve të ndryshëm, si dhe të sigurojë inicimin e një procesi rivlerësimi, ku të gjitha të drejtat me palët e treta të analizohen sipas vjetërsisë dhe mundësive reale për arkëtimin dhe likuidimin e tyre, ku të propozohen masa konkrete, duke mos e përjashtuar masat administrative si dhe të gjitha rrugët ligjore për mbledhjen ose shuarjen e tyre.

-Drejtoria e Ekonomike të marrë masa për krijimin e provizioneve për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme, pasi të jenë evidentuar të dhënat për klientët/debitorët, si shumën e detyrimit, vjetërsinë e tyre dhe situatën aktuale të tyre, duke kaluar më parë të gjitha rrugët e mundshme ligjore për mbledhjen e tyre.

Menjëherë

8. Gjetje nga Auditimi: Gjendja e llogarisë 460 “Hua të dhëna dhe interesa për t’u paguar” në fund të vitit 2022 paraqitet në shumën 429,099,135 lekë, vlerë që përfaqëson detyrimin e A. Sha për huanë e dhënë sipas VKD nr. 30, datë 22.07.2022 “Për miratimin e huadhënies së Albcontrol Sha” miratuar nga MIE me shkresën 5646/1 datë 26.07.2022. Huaja është dhënë në shumën 421,200,000 lekë dhe interesat e huasë në vlerën 7,898,236 lekë. Në lidhje me këtë huadhënie u krye auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Institucioni nga ku rezultoi se, DPSHTRR për periudhën 01.08.2022-04.01.2023 ka tërhequr shumën 429,099,135 lekë nga “Banka Credins”, nga të cilat vlera 100,000 Euro në formën e overdraftit me interes 1.5%. Në nenin nr. 4 “Detyrimet e Huamarrësit” në pikën 4.5 përcaktohet se: “Kthimi i shumës së marrë do të kryhet menjëherë me përmirësimin e situatës ekonomike të Huamarrësit(A.), në llogarinë bankare të Huadhënësit, brenda muajit Dhjetor të vitit 2023”

Pika 4.6, përcakton se, “Në rast pagese me këste, kësti i parë do të paguhet nga Huamarrësi brenda muajit Shtator 2023 në vlerën 300,000,000 lekë. Kësti i dytë do të paguhet nga Huamarrësi brenda muajit Tetor 2023 në vlerën 300,000,000 lekë. Pjesa e mbetur do të paguhet nga Huamarrësi brenda muajit Dhjetor 2023. Nga auditimi konstatohet se ende nuk ka filluar shlyerja e huasë si edhe nga DPSHTRR, nuk ka komunikim shkresor me Huamarrësin për kthimin e Huasë. Sa më sipër është në kundërshtim me Kontratën e Huasë nënshkruar në datën 24.08.2022 neni 4 “Detyrimet e Huamarrësit”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 43, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

8.1 Rekomandimi: Strukturat Drejtuese të DPSHTRR të marrin masa për shlyerjen e Huasë nga shoqëria “A.” në respektim të kushteve kontraktuale, me qëllim shlyerjen e overdraftit të marrë nga “C. B.” dhe arkëtimin e të ardhurave të krijuara nga DPSHTRR.

Menjëherë

9. Gjetje nga Auditimi: Sipas të dhënave dhe analizës së gjendjes së llogarisë 401-404 “Furnitorë e llogari të lidhura me to (detyrime ndaj furnitorëve)” në fund të vitit 2022 në vlerën 229,997,821 lekë rezulton se, detyrimet e konstatuara ndaj furnitorëve dhe klientëve për parapagime në periudhën ushtrimore janë në vlera të konsiderueshme dhe nga Drejtoria e Ekonomike nuk janë marrë masat e nevojshme për shlyerjen e detyrimeve ndaj të tretëve. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, neni 12 “Përgjegjësia menaxheriale e nëpunësve zbatues” dhe Udhëzimin nr.30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 56, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

9.1 Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike të marrë masa për shlyerjen në kohë të detyrimeve ndaj Furnitorëve dhe Klientëve me qëllim uljen e borxhit dhe eliminimin e penaliteteve të mundshme nga pagesat e vonuara.

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Gjetje nga Auditimi: Gjendja e llogarisë 486 “Shpenzime te periudhave te ardhshme” në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 5,835,167 lekë, gjendje e cila është regjistruar nga DR Tiranë, dhe pasqyron detyrimet e punonjësve të Drejtorisë Rajonale Tiranë, që janë në procese gjyqësore, të trashëguara prej vitit 2016. Kjo gjendje krahasuar me vitin 2021 ka rritje në vlerën 2,164,476 lekë. Për detyrimet e proceseve gjyqësore, DR Tiranë duhej të krijonte provizionin për vlerën e tyre 5,835,167 lekë. Sa më është sipër në mospërputhje me SKK 6 “Provizionet, detyrimet dhe aktivet e kushtëzuara” pika 37.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 56, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

10.1 Rekomandimi: Drejtoria e Ekonomike të marrë masa të menjëhershme për njohjen në kontabilitet të vlerës së plotë të proceseve gjyqësore të cilat kanë marrë formë të prerë si shpenzime

të periudhës në “Pasqyrën e performancës financiare” të institucionit dhe krijimin e provizioneve si një detyrim në pasqyrën e “Pozicionit financiar”

Menjëherë

11. Gjetje nga Auditimi: Gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit me objekt “Blerje Prokat Leje Qarkullimi për mjetet rrugore”, oferta e dhënë nga O.E. "A." shpk me ofertë 23,600,000 lekë pa TVSH, është shpallur ofertë anomalisht e ulët, ku pas sqarimeve të dhëna nga O.E. është pranuar si ofertë e suksesshme, ku një prokat leje qarkullimi jepet me çmimin 59 lek. Nisur nga kjo, përlllogaritja e fondit limit si dhe zhvillimi i procedurave të mëparshme të ngjashme mbi blerjen e prokatis të lejeve të qarkullimit është kryer mbi një përlllogaritje jo të saktë të fondit limit, duke rritur kostot e institucionit. Sa më sipër është në mospërputhje me nenin 13 “Neni 13 “Studimi paraprak i tregut”, VKM Nr. 285, Datë 19.5.2021 “Për Miratimin E Rregullave Të Prokurimit Publik.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 70, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

11.1 Rekomandimi: Organet Drejtuese të DPSHTRR-së, gjatë përlllogaritjes së fondit limit të përdorin mënyrën më efektive të mundshme, si dhe në rastin kur merren oferta në treg nga O.E., të merren nga ato subjekte të cilat kanë eksperiencë në treg, në mënyrë që të shmangen aludimet mbi rritjen e fondit limit.

Në vijimësi

12. Gjetje nga Auditimi: Gjatë zbatimit të kontratës me objekt “Blerje Prokat Leje Qarkullimi për mjetet rrugore”, sipas Procesverbalit nr. 1 në marrjen në dorëzim të prokatis të lejeve të qarkullimit, mbajtur më datë 11.06.2022, u morën në dorëzim në total 17474 copë prokat leje qarkullimi. Nga grupi i auditimit u konstatua që numri serial i marrjes në dorëzim ishte 0000000096402 dhe jo 0000000000001 siç duhet të ishte, duke marrë në konsideratë që është dorëzimi i parë dhe numri serial të vazhdojë nga numri 1. Sa më sipër është në mospërputhje me Nenin 107 “Zbatimi dhe Mbikëqyrja e kontratës”, të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 70, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

12.1 Rekomandimi: Organet drejtuese të DPSHTRR-së, Komisioni i ndjekjes dhe i zbatimit të kontratës, të marrë në konsideratë të gjitha kushtet e kontratës dhe të garantojë zbatimin e tyre me përpikmëri nga të dyja palët.

Në vijimësi

13. Gjetje nga Auditimi: Gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit me objekt “Blerje Prokat Leje Qarkullimi për mjetet rrugore”, Specifikimet Teknike janë të detajuara dhe në grupin e hartimit të specifikimeve teknike konstatohet se nuk është asnjë specialist i fushës për hartimin e tyre si dhe nga grupi i marrjes në dorëzim nuk është asnjë pjesëtarë specialist i fushës për verifikimin e tyre për marrjen në dorëzim si dhe laboratorë për verifikimin e tyre. Sa më sipër është në mospërputhje me nenin 74 “Vendim Nr. 285, Datë 19.5.2021 Për Miratimin E Rregullave Të Prokurimit Publik”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 70, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

13.1 Rekomandimi: Organet drejtuese të DPSHTRR-së, gjatë zhvillimit të një procedure prokurimi, të kenë në konsideratë që në përbërje të njësisë së prokurimit është detyrimisht, personi përgjegjës për prokurimin, dhe të paktën një specialist fushe, në rast se kërkohen njohuri të specializuara për objektin e prokurimit.

Në vijimësi

14. Gjetje nga Auditimi: Gjatë auditimit të procedurës së prokurimit “Blerje pajisjesh për qendrat e kontrollit teknik (Furnizim-Vendosje e Makinerive dhe Pajisjeve të Testimit të Q.K.T pranë Drejtorive Rajonale), është kërkuar në lidhje me përmbushjen e kriterëve, një inxhinier mekanik, ku në dokumentin e sjellë nga O.E. “kontratë individuale”, që mban datën 06.12.2021, O.E. V. A. sh.p.k. me administrator z. A.Z. në rolin e punëdhënësit merr në punë njëkohësisht z. A. Z. në rolin e punëmarrësit. Sa më sipër është në mospërputhje me Nenin 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” V.K.M- së Nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 70, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

14.1 Rekomandimi: Organet drejtuese të DPSHTRR-së të bëjnë të mundur verifikimin e dokumentacionit justifikues të O.E. pjesëmarrës dhe njëkohësisht fitues dhe të analizojë situatën nëse z. A. Z. në cilësinë e inxhinierit mekanik është tërësisht i angazhuar në përmbushjen e objektivave të kontratës dhe nuk ndikohet nga roli i tij si administrator i subjektit me të cilin operon në treg.

Menjëherë

15. Gjetje nga Auditimi: Gjatë auditimit të procedurës së prokurimit “Blerje letër dhe karton me logo” 2022, në dokumentet standarde të tenderit DST, në pikën 2.1.2 të kapacitetit profesional të O.E. është kërkuar Certifikata ISO 27001;2013, Sistemi Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit. Ky kriter nuk është i lidhur ngushtë dhe nuk është në përpjesëtim me objektin e prokurimit pasi natyra e objektit të procedurës ka të bëjë me blerjen e mallit e cila në asnjë moment nuk lidhet cënimin e sigurisë së informacionit. Është lënë rekomandim nga Agjencia e Prokurimit Publik (APP) mbi rishikimin e këtij kriteri pasi nuk është i lidhur ngushtë dhe në përpjesëtim me natyrën e objektit të prokurimit por përsëri nuk është marrë në konsideratë nga NJP. Sa më sipër është në mospërputhje me Nenin 36 “Specifikimet Teknike”, Ligji nr.162 dt.23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 70, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

15.1 Rekomandimi: Organet drejtuese të DPSHTRR-së, gjatë hartimit të specifikimeve teknike të bazohen në legjisllacionin dhe udhëzimet përkatëse duke hartuar specifikime teknike të cilët janë gjithëpërfshirëse duke krijuar pjesëmarrje të gjerë të O.E. dhe jo diskriminuese si dhe të jenë të detajuara në mënyrë që të jenë të kuptueshme për O.E. pjesëmarrës dhe që të përlllogaritet drejtë fondi limit.

Në vijimësi

16. Gjetje nga Auditimi: Gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit me objekt “Mobilim i objekteve të reja të ndërtruara nga DPSHTRR e ndarë me lote , DRSHTRR Berat, Korçë, Laç, Vlorë” u konstatua parregullsi në hartimin e kriterëve në dokumentet e tenderit(DST).Më konkretisht vihet re se pothuajse në të gjitha procedurat e zhvilluara në kërkesat në lidhje me kapacitetin ekonomik/financiar kërkohet që xhiro mesatare vjetore të jetë sa dyfishi i vlerës së fondit limit të përlllogaritur. Kriter ky i cili nuk nxit pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm. Për sa më sipër në mospërputhje me Nenin 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 70, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

16.1 Rekomandimi: AK, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, të marrë masa që në kërkesat në lidhje me kapacitetet ekonomik-financiar, të përcaktojë qartë kufirin minimal të xhiros vjetore në përputhje me LPP dhe VKM. Pra të përcaktohen sa më qartë kërkesat mbi kapacitetet ekonomik-financiar referuar parimeve të ligjit.

Në vijimësi

17. Gjetje nga Auditimi: Gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit me objekt “Mobilim i objekteve të reja të ndërtuara nga DPSHTRR e ndarë me lote, DRSHTRR Berat, Korçë, Laç, Vlorë”, afatet e lëvrimin të mallrave pothuajse në të gjitha procedurat e audituara në DST përcaktohen nga 1 deri në 45 ditë, duke bërë që numri i OE pjesëmarrës të kufizohet madje në disa raste dhe duke i shkaktuar pamundësi OE ofertues të përgatisin të gjithë sasinë e mallit me një afat kaq të shkurtër kohor të përcaktuar. Sa më sipër është në mospërputhje me Nenin 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 70, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

17.1 Rekomandimi: AK, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, të marrë masa në përcaktimin e afateve kohore në lidhje me lëvrimin e mallrave, të shihet e arsyeshme apo të merret në konsideratë në mënyrë të tillë që në përcaktimi i afatit të lëvrimin të mallrave të mos kufizojë numrin e OE pjesëmarrës.

Në vijimësi

18. Gjetje nga Auditimi: Gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit me objekt “Botim manuali të përgatitur për kandidatët që do të pajisen me leje drejtimi të kategorive A1, A2, A, B1, BE, viti 2022”, kërkesa e përcaktuar në DST si më poshtë:

OE të vërtetojnë që disponojnë makineri shtypëse 61x43 formati letrës, 5C+llak. Një OE pjesëmarrës duhet të disponojë 1 pajisje shtypi të përmasa 5 Color+llak , për aq kohë sa në DST dhe specifikime teknike nuk kërkohet që mallrat e prokuruar të jenë në 5 ngjyra të ndryshme. Pra në asnjë rast nuk është kërkuar që makina shtypëse të shtyp me 5 ngjyra, njëkohësisht në shtojcën 5 të specifikimeve teknike të DST përcaktohet:

- Letra të jetë format A4;
- Numri faqeve 216;
- Letra e brendshme 110gr/m²;
- Pjesa e brendshme e shtypur me 4 ngjyra bazë+llak Etj.

Pra specifikohet që pjesa e brendshme që do shtypet të jetë me 4 ngjyra. Për sa më sipër në mospërputhje me Nenin 36 “Specifikimet Teknike”, Ligji nr.162 dt.23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 70, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

18.1 Rekomandimi: Organet Drejtuese të DPSHTRR-së, gjatë hartimit të specifikimeve teknike dhe kritereve të veçanta të tregojnë kujdes në hartimin e tyre, të bazohen në legjislacionin dhe udhëzimet përkatëse duke hartuar specifikime teknike të cilët janë gjithëpërfshirëse duke krijuar pjesëmarrje të gjerë të O.E. dhe jo diskriminuese si dhe të jenë të detajuara në mënyrë që të jenë të kuptueshme.

Në vijimësi

19. Gjetje nga Auditimi: Në procedurën me vlerë të vogël “Blerje holli protokollar” me urdhër prokurimi nr. 8862/3 datë 23.05.2022, përlllogaritja e fondit limit e kryer me testim tregu me 3(tre) oferta është në kundërshtim me VKM Nr.285 RRPP datë 19.05.2021, neni 76 ,b si dhe Udhëzimin Nr.5 datë 25.06.2021 pika 7 ku citon që përlllogaritja e fondit limit bëhet duke u mbështetur në testimin e tregut me 3(tre) oferta ekonomike të administruara. Në testimin e tregut të kryer nga KBV ofertat e administruara nga OE “F. T. (PF) me NIPT L.....F dhe OE “I. E.” PF me NIPT K.....E nuk e kanë në veprimtarinë e tyre objektin të prokurimit. Sa më sipër është në mospërputhje me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar; Udhëzim Nr.5 datë 25.06.2021 i APP.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 94, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

19.1 Rekomandimi: A.K., Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, KBV në rastet e përlllogaritjes së fondit limit me testim tregu me 3(tre) oferta ekonomike të verifikoje veprimtarinë në QKB të OE nga ku të përputhet veprimtaria e tyre me objektin e prokurimit.

Në vijimësi

20. Gjetje nga Auditimi: Në disa procedura të cilat OE ofertues nuk janë prodhues nuk është kërkuar asnjë deklaratë apo vërtetimin në lidhje me origjinën e këtyre mallrave. Më konkretisht në asnjë rast nuk vërtetohet se cili është prodhuesi në mënyrë të tillë që të vërtetohet lidhja ndërmjet prodhuesit apo distributorit të autorizuar prej tij me OE. Sa më sipër është në mospërputhje me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar; Udhëzim Nr.5 datë 25.06.2021 i APP.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 94, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

20.1 Rekomandimi: AK, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, të kërkojë në lidhje me OE ofertues, në rastet e tilla kur ato nuk janë prodhues deklaratë apo vërtetime të ndryshme mbi origjinën e mallrave që të vërtetohet lidhja ndërmjet prodhuesve apo distributorëve të autorizuar prej prodhuesit me OE ofertues në procedurat e prokurimit.

Në vijimësi

B. Masa për Eliminimin e Efekteve Negative të Konstatuara në Administrimin e Fondeve Publike dhe për Menaxhimin me Ekonomicitet, Eficence dhe Efektivitet të Fondeve Publike.

1. Gjetje nga Auditimi: Për periudhën objekt auditimi u konstatua se janë ekzekutuar 18 vendime të formës së prerë për personat të janë larguar nga puna. Detyrimi i paguar për këto vendime të formës së prerë për periudhën objekt auditimi është **15,258,500 lekë**, konstatohet se nga këto 18 vendime, 14 prej tyre janë ekzekutuar me zyrë përmbarimore, për të cilat është shpenzuar vlera **872,389 lekë**. Janë edhe 3 vendime të tjera në fazën e Apelit, të cilat nuk kanë përfunduar. Nëse ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë do të ishte kryer me ekzekutim vullnetar do të minimizoheshin kostot në buxhetin e DPSHTRR. Sa më sipër është në mospërputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 33, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të DPSHTRR, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria Juridike në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike, të marrin masa për likuidimin e menjëhershëm të detyrimeve që rrjedhin nga proceset gjyqësore përpara vendimeve të zyrave përmbarimore, me qëllim uljen e kostove të këtyre detyrimeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga Auditimi: Gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit me objekt “Blerje karta memorie për tahografët digjital, viti 2021”, Çmimi i aplikimit i përcaktuar nga Udhëzimi i përbashkët të Ministrisë Financave dhe Ekonomisë (MFE) dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) me nr. 9785/1 datë 01.06.2022 dhe me nr.12 datë 30.05.2022 është 40 euro ose 4,821 lekë më pak se çmimi i kontratës lidhur ndërmjet AK dhe OE “C. d.”. Pra për sa më sipër nga çmimi i aplikimit të përcaktuar nga udhëzimi përbashkët si dhe çmimit të kontratës së lidhur, për sasinë prej 6000 karta memorie tahograf digjital AK ka humbur $6000 * 4,821 = 28,926,000$ lekë. Për sa më sipër në mospërputhje me ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 70, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1 Rekomandimi: Organet drejtuese të DPSHTRR-së, në lidhje me vendosjen dhe përcaktimin e çmimit të përdorimit të kartës së memories së tahografëve, të marrin në konsideratë rrethanat dhe faktorët e tjerë, se cila është kategoria që është e prekur nga vendosja e këtij çmimi dhe se sa implikohet kjo kategori në lidhje me këtë çmim, duke qenë se impakti kryesisht është në biznese dhe jo në individ.

Menjëherë

C. MASA DISIPLINORE:

C.1. Për punonjësit në marrëdhënie pune

C.1.2 Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës apo me statute të parashikuara në ligje të veçanta

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; germa (b, c, ç) e nenin 58-“*Llojet e masave disiplinore*”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”; VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”; neni 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”; shkronja (b) e neni 9 “*Masa disiplinore*”, të kontratës individuale, **i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të DPSHTRR**, që bazuar në performancën e punonjësve dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë dhe marrjen e masave disiplinore si vijon:

Masë disiplinore nga “*Vërejtje*” deri në “*Paralajmërim për largim nga puna*” për punonjësit e mëposhtëm:

znj. A. Gj. në cilësinë e anëtarit të Njesisë e Prokurimit për procedurën e prokurimit me objekt:

- “*Blerje Prokat Leje Qarkullimi për mjetet rrugore*” në mospërputhje me Nenin 74 “Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit”, i VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar.

znj. B. GJ., në cilësinë e anëtarit të Njesisë e Prokurimit për procedurën e prokurimit me objekt:

- “*Blerje Prokat Leje Qarkullimi për mjetet rrugore*”.
- “*Blerje Letër dhe Karton me logo*” në mospërputhje me Nenin 74 “Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit”, i VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar.

z. A. N. në cilësinë e anëtarit të Njesisë e Prokurimit për procedurën e prokurimit me objekt:

- “*Blerje Prokat Leje Qarkullimi për mjetet rrugore*” në mospërputhje me Nenin 74 “Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit”, i VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar.

z. R. S. në cilësinë e anëtarit të Njesisë e Prokurimit për procedurën e prokurimit me objekt:

- “*Blerje Letër dhe Karton me logo*” në mospërputhje me Nenin 74 “Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit”, i VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar

z. F. S. në cilësinë e anëtarit të Njesisë e Prokurimit për procedurën e prokurimit me objekt:

- “*Blerje Letër dhe Karton me logo*” në mospërputhje me Nenin 74 “Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit”, i VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e*

rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe në cilësinë e anëtarit të komisionit të hartimit të Specifikimeve Teknike për procedurën me objekt:

- *“Botim Manuali të përgatitur për kandidatët që do të pajisen me leje drejtimi të kategorive A1, A2, A, B1, BE”* në mospërputhje me Nenin 36 “Specifikimet Teknike”, Ligji nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

z. F. P., në cilësinë e anëtarit të komisionit të hartimit të Specifikimeve Teknike për procedurën me objekt:

- *“Mobilim i objekteve të reja të ndërtuara nga DPSHTRR e ndarë në lote”* në mospërputhje me Nenin 36 “Specifikimet Teknike”, Ligji nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

z. M. K., në cilësinë e anëtarit të komisionit të hartimit të Specifikimeve Teknike për procedurën me objekt:

- *“Mobilim i objekteve të reja të ndërtuara nga DPSHTRR e ndarë në lote”* në mospërputhje me Nenin 36 “Specifikimet Teknike”, Ligji nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

znj. J. J., në cilësinë e anëtarit të komisionit të hartimit të Specifikimeve Teknike për procedurën me objekt:

- *“Mobilim i objekteve të reja të ndërtuara nga DPSHTRR e ndarë në lote”* në mospërputhje me Nenin 36 “Specifikimet Teknike”, Ligji nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

z. J. V., në cilësinë e anëtarit të komisionit të hartimit të Specifikimeve Teknike për procedurën me objekt:

- *“Botim Manuali të përgatitur për kandidatët që do të pajisen me leje drejtimi të kategorive A1, A2, A, B1, BE”* në mospërputhje me Nenin 36 “Specifikimet Teknike”, Ligji nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

z. E.B., në cilësinë e anëtarit të komisionit të hartimit të Specifikimeve Teknike për procedurën me objekt:

- *“Botim Manuali të përgatitur për kandidatët që do të pajisen me leje drejtimi të kategorive A1, A2, A, B1, BE”* në mospërputhje me Nenin 36 “Specifikimet Teknike”, Ligji nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

V. Lista e dokumentacionit të auditimit

1. Akt Verifikim nr.1, datë 29.09.2023 *“Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm KLSH-së”*.
2. Akt Konstatim nr. 1, datë 29.09.2023 *“Auditim mbi menaxhimin financiar dhe Kontrollit”*.
3. Akt Konstatim nr. 2-3, datë 29.09.2023 *“Mbi zbatimin e strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi”*.
4. Akt Konstatim nr. 4, datë 29.09.2023 *“Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në mbajtjen e evidencës kontabile, ndjekjen e debitorëve e kreditorëve, si dhe menaxhimin e aktiveve”*.

5. Akt Konstatim nr. 5, datë 29.09.2023 “*Hartimi, shqyrtimi dhe miratimi i programit ekonomiko-financiar në organet drejtuese të ndërmarrjes dhe në institucionet eprore, si dhe realizimi i tij*”.
6. Akt Konstatim nr. 6-12, datë 29.09.2023 “*Mbi zbatimin e ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike dhe ankandet, lidhjen dhe zbatimin e kontratave*”.
7. Akt Konstatim nr. 13, datë 29.09.2023 “*Auditim me zgjedhje sipas periudhave mbi rregullshmërinë e blerjeve me vlera të vogla (shpenzimet administrative për automjete, udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit, sponsorizime, etj)*”.

Shënim: Të gjithë punonjësit që atakohen në këtë Raport Përfundimtar auditimi duhet t’u bëhet prezent mangësitë dhe problemet për të cilat mbajnë përgjegjësi, mundësisht t’u jepen fotokopje të dokumentacionit që ka lidhje me ta, në mënyrë që të njihen dhe të bëjnë komentet dhe shpjegimet përkatëse, nëse kanë.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT